



KATËR QYTETE HISTORIKE NË BALLKANIN JUGPERËNDIMOR

Nësa dhe Sfida

Ky libër paraqet katër qytete historike me rëndësi europiane dhe madje globale: Gjirokastrën, Janinë, Ohrin dhe Prizrenin. Jo vetëm ata edhe rajoni – Ballkani Jugperëndimor – janë ende të panjohur në pjesën tjetër të Europës, por edhe vetë banorët e këtyre qyteteve, për shkak të rrethanave historike, e kanë njohur pak njëri tjetrin për dekada me radhë.

Ky libër paraqet për herë të parë në një kontekst të përbashkët, trashëgiminë urbane dhe kulturore, problemet e menaxhimit në të katër qytetet, si dhe njohuritë e deritanishme për to në nivel ndërkombëtar. Para së gjithash dhe për më tepër ai synon të forcojë ndjeshmërinë që këto qytete të këtij rajoni, veçanërisht të formësuara nga Perandoritë Bizantine dhe Osmane, të konfirmohen si pjesë të Trashëgimisë Sonë të Përbashkët Europiane, të cilat duhen ruajtur e mirëmbajtur, detyrë kjo për gjithë Europën.

Ky botim është prodhuar në kuadrin e projektit “Vlerat Europiane në Trashëgimi”, financuar nga Komisioni Europian.



European Commission



ISBN 978-99956-747-4-8



9 789995 167474

KATËR QYTETE HISTORIKE NË BALLKANIN JUGPERËNDIMOR

KATËR QYTETE HISTORIKE NË BALLKANIN JUGPERËNDIMOR

Stephan Doempke, Anduela Lulo (Caca) dhe Sadi Petrela (eds.)

Nësa dhe Sfida





KATËR QYTETE HISTORIKE NË BALLKANIN JUGPERËNDIMOR

Nësa dhe Sfida

**Stephan Doempke,
Anduela Lulo (Caca)
dhe Sadi Petrela (red.)**

Botuar nga:
Organizata për Ruajtjen
dhe Zhvillimin e Gjirokastrës – GCDO
(sot Fondacioni “Gjirokastra”)

në bashkëpunim me:
Akademinë për Trajnim
dhe Asistencë Teknike
Fondacionin EGNATIA EPIRUS
Shoqatën Tregtare
të Artizanëve Maqedonas

Tiranë 2012

Pasqyra e Përmbajtjes

Parathënie	7
<i>Sadi Petrela</i>	
Vlerat Europiane në Trashëgimi dhe Rrjeti i Qyteteve Historike të Europës Juglindore	9
<i>Stephan Doempke</i>	
Struktura historike e qyteteve të Ballkanit: Hapësira, Pushteti, Kultura dhe Shoqëria	17
<i>Maximilian Hartmuth</i>	
Gjirokastra – Kronikë në gur	25
<i>Stephan Doempke</i>	
<i>(me Oliver Gilkes, Sadi Petrela, Emin Riza and Elenita Roshi)</i>	
Hyrje	25
Historia	27
Qyteti historik	33
Kalaja	35
Pazari	41
Kënga Polifonike	44
Ndërtesat e kultit	45
Lagjet e banuara	50
Menaxhimi	70
Janina – Qyteti i artit dhe letrave	75
<i>Varvara Papadopoulous dhe Vassilis Birbos</i>	
Hyrje	75
Historia	76
Qyteti i monumenteve	81

Kalaja	81
Monumentet e krishtera të qytetit	87
Monumentet myslimane të qytetit	90
Ndërtesat me interes arkitekturor dhe historik	91
Muzetë	92
Ishulli	93
Çështjet e menaxhimit	100
Prizreni – Qyteti i filigranit	109
<i>Bariu Zenelaj</i>	
Hyrje	109
Kosova dhe Prizreni	112
Monumentet e Trashëgimisë Kulturore	117
Sfidat e menaxhimit të qendrës historike	143
Ohri – Qyteti i shekujve	147
<i>Goran Paçev</i>	
Hyrje	147
Rëndësia historike	150
Çfarë thonë njerëzit e famshëm për Ohrin	157
Monumentet e rëndësishme arkeologjike dhe arkitekturore	159
Zejet e Ohrit	178
Menaxhimi	184
Bibliografia	191
Autorët	192
Informacion mbi fotot dhe hartat e përdorura	194
Partnerët e Projektit EVAH	196
Adresa të nevojshme	198

Doempke, Stephan; Lulo (Caca), Anduela; Petrela, Sadi (red.)
Katër Qytete Historike të Ballkanit Jugperëndimor - Vlera dhe sfida
200 faqe, me fotografi dhe grafikë e harta

Botuar nga Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës në bashkëpunim me Akademinë për Trajnim dhe Asistencë Teknike, Fondacionin Egnatia Epirus dhe Shoqatën Tregtare të Artizanëve Maqedonas.

Tiranë 2012

NE: Doempke, Stephan

1. Qytetet Historike 2. Trashëgimia Kulturore 3. Gjirokastra 4. Janina 5. Ohri 6. Prizreni 7. Trashëgimia Botërore 8. Arte dhe Artizanate 9. Europa Juglindore 10. Vlerat Europiane 11. Komisioni Europian 12. Iniciativa e Shoqërisë Civile

© Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës – GCDO 2012

Kjo vepër mbrohet nga e drejta e autorit me të gjitha pjesët përbërëse të saj. Çdo përdorim përtej të drejtave të parashikuara nga ligji për të drejtën e autorit, pa miratimin e botuesit është i papranueshëm dhe i dënueshëm. Kjo i referohet sidomos riprodhimit të figurave dhe/ose tekstit përmes printimit, fotokopjimit, përkthimit, digjitalizimit, mikroformave, mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave në sisteme elektronike.

Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë botim nuk shprehin opinionin e botuesit për sa i përket statusit ligjor të ndonjë vendi, territorit apo autoriteteve të tij ose për sa i përket kufinjve të tyre.

Autorët janë përgjegjës për zgjedhjen dhe paraqitjen e fakteve të këtij libri dhe për opinionet e shprehura në të, të cilat jo domosdoshmërisht janë edhe ato të botuesit.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet në ndonjë formë pa miratimin me shkrim të botuesve, përveç citimit në pasazhe të shkurtra.



Ky botim është mundësuar me mbështetjen e Bashkimit Europian. Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Organizatës për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës dhe në asnjë mënyrë nuk shpreh pikëpamjet e Bashkimit Europian.

Autorët:

Vesna Avramovska, Clara Puech, Kalliopi Rekata, Bariu Zenelaj, Erkan Zerdari.

Përkthimi:

Language Solutions l.t.d.

Kopertina dhe faqosja: Xhoan Guga, Delta Print Studio

Shtypur nga: Gent Grafik

Mirënjohje:

Ky botim u bë i mundur përmes një granti nga Direktori XI i Komisionit Europian, akorduar nga "Shërbimi për Shoqërinë Civile". Falënderime të sinqerta shkojnë për Henk Visser, Suzan Arslan dhe Genc Pasko nga Komisioni Europian, për mbështetjen e tyre, këshillat konstruktive, shpirtin bashkëpunues miqësor dhe për inkurajimin e përhershëm. U jemi mirënjohës, së pari autorëve të teksteve, fotove, hartave dhe ilustrimeve ë për bashkëpunimin në përpilimin e materialeve të këtij libri : Lejla Haxhiç, Albert Kasi, Kreshnik Merxhani, Elena Nasto, Enkeleida Roze, Jusuf Xhibo dhe Fikret Tikvesh, si edhe Katherine Kyes e Goran Todorovski për përshtatjet gjuhësore.

Në emër të grupit botues:

Stephan Doempke, Anduela Lulo (Caca) dhe Sadi Petrela

Parathënie

Libri “Katër qytete të Ballkanit Perëndimor – vlera dhe sfida” është pjesë e rëndësishme e projektit EVAH-Vlerat Europiane në Trashëgimi, financuar nga Bashkimi European. Ashtu si vetë projekti, dhe ky botim zhvillohet në 4 pjesë, nga një për secilin nga “qytetet e EVAH-ut”: Gjirokastra, Janina, Ohri dhe Prizreni. Megjithatë ai ka një unitet dhe qëllim të qartë. Ai synon të krijojë një urë tjetër komunikimi, duke evidentuar vlerat e përbashkëta, por edhe specifikat e trashëgimisë kulturore që këto 4 qytete sjellin në kulturën europiane.

Libri përpiket ta shohë trashëgiminë kulturore si mjet identifikues, po aq edhe si produkt të zhvillimit historik të përbashkët. Pa tjetër edhe si faktor nga më të rëndësishmit për integrimin europian. Për këtë botim, ashtu si për gjithë EVAH-un, Europa është në radhë të parë realitet kulturor. Në Ballkanin Perëndimor vërehet një entuziazëm dhe shpresë e pashuar për integrimin në Bashkimin European dhe mundësitë që ai ofron, por, për fat të keq, kjo nuk shoqërohet me një përpjekje koresponduese në fushën e menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe njohjen e përvojave përkatëse europiane. Prandaj i frymëzuar nga EVAH-u, ky botim e sheh trashëgiminë kulturore si mundësi zhvillimi dhe integrimi të dorës së parë, që për fat të keq nuk njihet sa duhet dhe, për pasojë, as nuk menaxhohet si duhet, duke bërë shpesh që potenciale të mëdha të rezultojnë në realitete të vakëta.

Si të gjithë aktivitete e tjera të projektit, libri i drejtohet publikut të gjerë dhe vendimmarrëse në shkallë vendore, kombëtare dhe rajonale. Secilit në gjuhën përkatëse, prandaj edhe botohet në shqip, greqisht dhe maqedonisht. Ai u drejtohet edhe vendimmarrësve europianë, me synimin që të mund t’i ndihmojë ata të kuptojnë më mirë potencialet dhe mundësitë, por edhe pengesat në fushën e menaxhimit të trashëgimisë kulturore në vendet tona. Prandaj libri botohet edhe në anglisht. Në këtë kuptim ne shpresojmë se libri do të jetë edhe një urë dy kalimëshe, që jo vetëm sjell më afër nesh realitetet europiane, por bën edhe veprimin e anasjelltë. Secila nga 4 pjesët e librit natyrshëm u shkrua nga partnerët përkatës dhe bashkëpunëtorët e tyre : Akademia për Trajnim dhe Asistencë Teknike - ATTA e Prizrenit, Egnatia Epirus Foundation – EEF e Janinës, Shoqata Tregtare e Artizanatit Maqedonas- MATA dhe Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës – GCDO.

Si përfaqësues i GCDO-së*¹ (e cila është organizatë lider e projektit EVAH) dhe redaktor i këtij libri, falënderoj organizatat dhe autorët që, me iniciativë dhe përpjekje të lavdërueshme, morën përsipër plotësisht në përgjegjësinë e tyre, përmbajtjen e teksteve përkatëse. Po ashtu dua t'u shpreh mirënjohje për mirëkuptimin për të lejuar gjatë redaktimit disa ndryshime të vogla të teksteve fillestare, që nuk kanë prekur aspak tërësinë e përmbajtjes dhe formës së tyre. Shprehim mirënjohje gjithashtu për Qendrën për Migrim Ndërkombëtar dhe Zhvillim-CIM, që mundësoi punësimin e një eksperti ndërkombëtar pranë GCDO-së dhe, si rezultat edhe kontributin e tij në projektin EVAH.

Libri është pajisur me një Hyrje për strukturën social-kulturore të qyteteve historike të Ballkanit, shkruar nga Maximilian Harmuth, si dhe me një përshkrim të detajuar të aktiviteteve të projektit EVAH dhe Rrjetit të Qyteteve Historike të Europës Juglindore që ai krijoi, me pjesëmarrjen e 4 organizatave të shoqërisë civile, partnere në projekt.

I krijuar me punë dhe bashkëpunim të shkëlqyer dy vjeçar në zbatim të EVAH-ut, Rrjeti ka tashmë shanse shumë të mira të vazhdojë më tej. Libri "Katër qytete të Ballkanit Perëndimor – vlera dhe sfida", bashkë me udhëzuesin "Menaxhimi i integruar i qyteteve historike" dhe dokumentarin "Mure dhe Ura", të tre këto produkte të projektit tonë të përbashkët, mund të shërbejnë si një platformë e instrument shumë i mirë për bashkëpunime të tjera të frytshme në thellim të asaj çka EVAH bëri : njohjen e mundësive që ofron menaxhimi i trashëgimisë kulturore si bazë zhvillimi dhe integrimi, duke dhënë edhe një shembull e model bashkëpunimi rajonal.

Në emër të partnerëve, falënderoj Bashkimin Europian që financoi këtë botim, ashtu si gjithë projektin.

Sadi Petrela
Drejtor Ekzekutiv
Fondacioni "Gjirokastra" – Organizata për Ruajtjen
dhe Zhvillimin e Gjirokastrës.

Nëntor 2012

¹ GCDO tashmë ka marrë emrin e ri Fondacioni "Gjirokastra" - FGJ, pa ndërruar qëllimet dhe objektivat, por veçse me qëllim që emri të përshtatet me realitete e reja të veprimtarisë së Organizatës

Vlerat Evropiane në Trashëgimi dhe Rrjeti i Qyteteve Historike të Europës Juglindore

nga Stephan Doempke*

“Qytetet dhe rajonet janë aktorë të rëndësishëm në kontekstin evropian si rrjedhojë e trashëgimisë së tyre kulturore, si trashëgimisë jo-materiale – në formën e mjeshtërive dhe teknikave, zakoneve, traditave dhe kuzhinës – dhe asaj materiale në formën e ndërtesave, peizazheve natyrore dhe të kultivuara, veprave të artit dhe aplikative. Historikisht, trashëgimia e qyteteve dhe rajoneve të pavarura, konkurruese është më e vjetër se sa ajo e shteteve kombëtare...

Në shumë qytete dhe rajone evropiane, trashëgimia kulturore që mund të njihet sipërfaqësisht me tiparet e stilit karakteristik, përmban në vetvete një spektër shumë të gjerë dallimesh kulturore në një hapësirë shumë të vogël. Këto kujtesa të integruara historikisht të diversitetit kulturor, mund të na ndihmojnë në gjithashtu të integrojmë dallimet e sotme kulturore dhe t’i marrim ato në zotërim... Vetëm nëse ne vazhdojmë të njohim se sa shumë migrimi dhe lëvizshmëria janë përgjegjëse për integrimin historik, zhvillimin dhe karakterin kulturor të Europës dhe, se sa shumë – duke kapërcyer si kufizimet lokale ashtu edhe lustrën e nacionalizimit – trashëgimia e saj kulturore është kudo një ‘trashëgimi hibride’, një përzierje e përbërësve tejet të ndryshëm shoqëror, etnik dhe kulturor nga burime të shumta, do të arrijmë kuptimin dhe interpretimin e duhur të trashëgimisë sonë. Sepse vetëm atëherë ajo trashëgimi kulturore do t’i shërbejë qëllimit të saj të vërtetë: atij të integritetit dhe identifikimit nëpërmjet krijimit të imazheve të qarta dhe të besueshme të vetvetes, në të cilat numri më i madh i mundshëm i banorëve të Europës të mund të shohin të pasqyruar vetveten. (“Qytetet dhe rajonet. Përgjegjësia e tyre kulturore dhe si ata mund ta përbushin atë. - Manual”. Një shpirt për Europën: Berlin 2009)

“Megjithatë ndryshimi i shpejtë i kushteve themelore të kohërave moderne (si p.sh. rritja e shpejtë e konkurrencës ekonomike dhe presioni shoqëror i zhvillimit, ndryshimi klimatik, ndryshimi demografik, etj.), përbëjnë një sfidë të madhe në menaxhimin e shumë zonave urbane historike, të cilat nuk mund të menaxhohen më nëpërmjet politikave tradicionale një-vektoriale. Mungesa e shkëmbimit shumë-planesh me autoritetet përgjegjëse menaxhuese, dhe mungesa e politikave të integruara të zhvillimit urban të



qëndrueshëm, të cilat lidhin ruajtjen e trashëgimisë kulturore me zhvillimin shoqëror ekonomik të peizazhit historik urban, do të rezultojë me të gjitha gjasat në zona urbane jo-konkurrese me vlerësim të ulët nga banorët dhe vizitorët gjithashtu” (www.urbaact.eu/en/projects/cultural-heritage-city-development/hero/our-project/).

Këto citime nga dokumente kyç që kanë të bëjnë me qytetet historike në Europë theksojnë se peizazhi historik urban nuk mund të shihet vetëm si një shumë e monumenteve të rëndësishme, por duhet të konsiderohet si organizëm që jeton dhe hapësirë jetese vitale për banorët e tij. Ato ilustrojnë më mirë se çdo gjë tjetër qëllimin e përgjithshëm të projektit EVAH - Vlerat Europiane në Trashëgimi dhe lidhjes së tij me Ballkanin Perëndimor, prodhim i të cilit është edhe ky libër.

Vështirë të gjeje dikë banor në Ballkanin Perëndimor, i cili të mos jetë i bindur se ata janë pjesë e Europës, si historikisht ashtu edhe kulturalisht, dhe prandaj anëtarësimi në Bashkimin Europian është rrjedhojë gati natyrale. Megjithatë, ky anëtarësim shihet më së shumti si mundësi për zhvillimin ekonomik dhe garantimin e sundimit të ligjit. Ndërsa, ndërgjegjësimi se Bashkimi Europian është edhe mbretëri e vlerave të përbashkëta kulturore (të cilat janë në të vërtetë themelet e tij), evidentohet më pak.

Si rezultat, promovimi i kulturës dhe trashëgimisë nuk është prioritet i lartë politik në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Prandaj promovimi i Europës si realitet kulturor dhe kuptimi se vlerat e përbashkëta kulturore janë në bazë të stabilitetit politik dhe ekonomik, të cilat e bëjnë Bashkimin Europian një model kaq tërheqës, është i një rëndësie të veçantë për të përgatitur këto vende për aderim në Bashkimin Europian. Objektiv i Projektit EVAH është që të japë një kontribut thelbësor dhe të qëndrueshëm në këtë aspekt.

Përkeqësimi i gjendjes së përgjithshme të qyteteve historike është një problem kyç që lidhet me trashëgiminë kulturore në të gjitha shtetet post-socialiste. Ky problem ka shumë shfaqje:

- Ndërtesat historike, veçanërisht shtëpitë private popullore, nuk janë restauruar ose janë shpërfytyruar me shtesa e sotme të papërshtatshme, shpesh të bëra pa leje.
- Strukturat publike urbane si p.sh. trotualet, sheshet, hapësirat për çlodhje, ndriçimi, etj. janë neglizhuar ose janë kryer modernizime pa pasur një njohje të duhur të autenticitetit, integritetit ose anës cilësore të kontekstit urban.
- Shërbimet publike, si p.sh. menaxhimi i mbetjeve dhe rregullimi i trafikut janë shumë jo efikase, duke kontribuar dukshëm në shpërbërjen vizuale dhe kulturore të qyteteve historike.
- Punishtet dhe dyqanet e artizanatit mungojnë në qytetet historike ose e kanë të vështirë të mbijetojnë, sepse u mungon një mjedis arkitekturor që do të krijonte një atmosferë të favorshme për bizneset e tyre.

Në rrënjë të këtyre problemeve është mungesa e njohurive, ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve si tek publiku, ashtu dhe tek vendimmarrësit në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Kjo është e dukshme në:

Mbi të gjitha, vendimmarrësit nuk vlerësojnë sa duhet rëndësinë e trashëgimisë kulturore si bazë për zhvillim (zhvillim ekonomik, zhvillim njerëzor, kohezion social) dhe kështu nuk vlerësojnë sa duhet nevojën për investime publike për zhvillimin e biznesit dhe turizmit në qytetet historike. Në shoqëritë ku bashkëpunimi nuk ka qenë kurrë i fortë dhe në kushtet kur shteti sot përballlet me dy shtylla të reja të pushtetit – biznesin privat dhe shoqërinë civile - botëkuptimi për nevojën për bashkëpunim mes këtyre tre shtyllave nuk është zhvilluar ende mirë.

Shumë vendimmarrës nuk janë të ndërgjegjshëm gjithashtu mbi ndërlikimet e kornizës ekzistuese ligjore për restaurimin dhe rijetëzimin e qyteteve historike dhe promovimin e artizanatit. Ndërsa shpesh legjislacioni kombëtar mbron me efikasitet monumente kulture të veçanta, ligje të tjera si p.sh. ligji i privatizimit, ligji i trashëgimisë, ligji i taksave, ligji i planifikimit dhe ndërtimit, pengojnë restaurimin e ndërtesave private historike dhe parandalojnë përshtatjet e brendshme, të cilat mund të ndihmonin përdorimin e ndërtesave historike popullore për lloje të tjera përdorimi bashkëkohor.

Për shkak të mungesës së përgjithshme të interesit për trashëgiminë kulturore, por edhe për shkak se kultura nuk është një kapitull në procedurat e aderimit në Bashkimin Europian, detajet e shumë standardeve dhe traditave europiane e ndërkombëtare përkatëse janë të panjohura për shumicën e vendimmarrësve. Shumë prej tyre nuk kanë pasur mundësi të njohin nga afër personalisht pamjen mjaft të mirë të qyteteve historike, që i gjen pothuajse kudo në Bashkimin Europian; kështu nuk kanë pasur mundësi të shohin se si mbrapa kësaj situatë qëndron një masë konventash të përpunuara shumë mirë, udhëzimesh, rekomandimesh dhe programesh, të cilat së bashku mishërojnë parimet dhe vlerat europiane për trashëgiminë kulturore, si në mënyrë të nënkuptuar ashtu edhe të drejtpërdrejtë.

Një aspekt kyç i këtyre problemeve ka të bëjë me vlerat kulturore të ndërtesave popullore dhe qyteteve historike. Shumë vendimmarrës janë të pak të ndërgjegjësuar rreth koncepteve kyçe në ruajtjen e qyteteve historike, si p.sh. autenticiteti dhe integriteti dhe transformimin e tyre në udhëzime praktike. Shumë prej tyre nuk kanë standardet estetike për të vlerësuar nevojën e udhëzimeve të qarta për strukturën e shtëpive, shesheve publike dhe objekteve në qytetet historike, të cilat të pajtohen me stilin dhe pamjen historike. Si rrjedhojë e dekadave të shtetit totalitar, pakënaqësisë popullore shumë të gjerë të sotme ndaj shtetit dhe në kushtet e lirisë së re të dhe të drejtave të individit, shoqëruar kjo me mentalitetin mbizotërues të shkeljes së rregullit, si vendimmarrësit, ashtu si edhe pronarët e shtëpive kanë vështirësi të pranojë nevojën për udhëzime dhe detyrime në emër të mbrojtjes së të mirave të përbashkëta që përmbajnë qytetet historike.

Si rezultat, nuk janë marrë disa masat e duhura për mbrojtjen dhe rijetëzimin e qyteteve historike dhe artizanatit, si p.sh reformimi i ligjeve përkatëse, zbatimi i tyre efikas dhe përgatitja e një numri të mjaftueshëm zyrtarësh kompetentë në këtë fushë. Popullata dhe bizneset private nuk kanë një kornizë të përshtatshme rregullatore, madje as informacionin e duhur dhe masa e investimit publik është shumë larg nga nevojat.

Megjithëse turizmi është prioritet i qartë i shumë qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor, niveli i përpjekjes aktive politike për themelimin e bizneseve që kanë lidhje me turizmin në qytetet historike nuk korrespondon me prioritetet e deklaruara. Në veçanti, artizanët (dhe industri të tjera kulturore) – të cilët mund të luajnë rol thelbësor në zhvillimin e lagjeve historike – kanë mangësi në kuptimin e nevojave të tyre specifike.

Projekti EVAH filloi në 1 Janar 2011 nën Instrumentin e Shoqërisë Civile të Komisionit Europian, objektivi i të cilit është fuqizimi e shoqërinë civile në një mjedis dhe kulturë të demokracisë me pjesëmarrje dhe nxitja e zhvillimit të partneriteteve dhe rrjeteve të qëndrueshme të organizatave të shoqërisë civile për të kontribuar në rritjen e përfshirjes së të tyre si në kuadrin e Ballkanit Perëndimor, ashtu edhe midis rajonit dhe Bashkimit Europian.

Në projektin EVAH, bashkëpunuan katër partnerë nga katër vende, marrëdhëniet e cilëve në të shkuarën e afërt kanë qenë deri diku të vështira: Shqipëria, Greqia, Kosova dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.

Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës (GCDO), organizata lider në projekt, punon për zhvillimin e qëndrueshëm të Gjirokastrës dhe rajonit të saj nëpërmjet konservimit dhe nxitjes së rijetëzimit në qytetin historik, mbështetjen e turizmit të qëndrueshëm dhe promovimin e artizanatit e mjeshtërive tradicionale.

Akademia për Trajnim dhe Asistencë Teknike (ATTA) u themelua me qëllimin për të fuqizuar shoqërinë civile të Kosovës, për të ndërtuar dhe rritur kapacitetet e saj. Fushat e saj të veprimit janë ngritja e kapaciteteve, zhvillimi i komunitetit, integrimi europian, harmonizimi i politikave publike mes Kosovës dhe Bashkimit Europian, hartimi i politikave publike dhe kultura.

Fondacioni Egnatia Epirus (EEF) nga Janina, Greqi, i cili përfaqëson partnerin nga një shtet i Bashkimit Europian, promovon aktivitete që përfshijnë teknologji informacioni të përparuara dhe rrjetet telekomunikative, bashkëpunimin ndërkufitar, promovimin dhe regjistrimin e trashëgimisë kulturore, iniciativa alternative të eko-agro turizmit dhe mbështetje për sektorin e artizanatit.

Së fundi, *Shoqata Maqedonase e Tregtimit të Artizanatit (MATA)* është një organizatë jo-fitimprurëse, jo-qeveritare që ka si synim të nxisë zhvillimin e sektorit të artizanatit në ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe të arrijë ndryshime shoqërore të prekshme dhe përfitime për artizanët, duke dhënë mbështetje për ndërgjegjësim, zhvillimin e produktit, hyrjen në treg dhe ndërtimin e kapaciteteve.

Projekti EVAH kishte si objektiv përfshirjen në aktivitetet e tij të vendimmarrësve kyç në nivele kombëtare, rajonale dhe lokale, ndërsa përfituesit përfundimtarë ishin banorët dhe bizneset, duke përfshirë artizanët në katër qytete historike, një numër i përlogaritur në rreth 40.000 persona. Në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, e gjithë popullsia më e madhe e këtyre qyteteve, me total rreth 275.000 njerëz kanë përfituar nga Projekti.

Gjatë gjithë zbatimit të Projektit, u sollën në vëmendje instrumentet, organizatat, projektet, rrjetet dhe iniciativat përkatëse të Bashkimit Europian. Në veçanti, Projekti Trashëgimia si një Mundësi (HerO) dhe “Një Shpirt për Europën” (A Soul for Europe), të cilat janë shumë të

rëndësishme në këtë kontekst, kontribuan shumë në krijimin e një dialogu me kolegë europianë.

Duke pasur parasysh se çekuilibri mes zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së strukturave urbane historike shpesh rezulton në stanjacion ekonomik ose në humbje të trashëgimisë kulturore, Projekti Hero kishte si synim të zhvillonte strategji menaxhimi të integruara dhe novatore për peizazhet urbane historike. Objektivi i tij kryesor ishte lehtësimi i gjetjes së ekuilibrit të duhur mes mbrojtjes së trashëgimisë kulturore ndërtimore dhe zhvillimit të qëndrueshëm social-ekonomik, duke fuqizuar aftësinë tërheqëse dhe konkurruese të qyteteve historike.

“Një Shpirt për Europën” është një iniciativë e qytetarëve europianë, të cilët promovojnë fuqinë e kulturës në të gjitha fushat e politikës për integrimin europian, duke u përpjekur të ndërtojnë Europën nëpërmjet integritit të historive kombëtare, sistemeve të vlerave, pikëpamjeve mbi botën dhe dialogut ndërkulturor. E mbështetur nga Parlamenti Europian, “Një Shpirt për Europën” është duke ndërtuar rrugë të reja komunikimi, modele novatore bashkëpunimi mes shoqërisë civile dhe institucioneve europiane, qeverive kombëtare dhe autoriteteve të tjera.

Duke publikuar dhe shpjeguar këto instrumente europiane, si publiku i BE-së, ashtu dhe ai në Ballkanin Perëndimor u ndërgjegjësuan rreth rolit që luan BE-ja në mbrojtjen dhe rritjen e diversitetit kulturor, ndërkohë që Projekti kontribuoi në promovimin e parimeve dhe vlerave të Bashkimit Europian dhe në rritjen e bashkëpunimit rajonal.

Për të siguruar efektivitet sa më të madh të Projektit, në fillim të tij u kryen anketime me vendimmarrësit për të matur nivelin e tyre të njohurive dhe ndërgjegjësimit rreth aspekteve të ndryshme që lidhen me trashëgiminë kulturore dhe u krijua një Platformë Rrjetëzuese e Informacionit Teknologjik, si një mjet komunikimi për partnerët dhe organizatat e asociuara në projekt si dhe me publikun, vendimmarrësit dhe Organizatat jo-Qeveritare të interesuara. Ajo u lidh me platforma të tjera *online* ekzistuese që kanë lidhje me kulturën si p.sh “European Heritage Network”, “HISTORYCENTRES_NET”, “Epoch Network” dhe CultureWatchEurope.

Gjatë kohëzgjatjes së tij gati 2 vjeçare, Projekti organizoi katër seminare praktike rreth temave të cilat mbartnin një lidhje të drejtpërdrejtë me punën e vendimmarrësve, si p.sh. “Trashëgimia Kulturore si Motor për Zhvillim Ekonomik”, “Ruajtja e Njohurive: Artet dhe Artizanati dhe Rijetëzimi i Qyteteve Historike”, “Instrumentet Europiane për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore” dhe “Vlerat Europiane në Udhëzimet e Menaxhimit për Qytetet Historike”.

Çdo seminar u ndoq nga rreth 50 pjesëmarrës prej vendeve partnere, përfaqësues të Partnerëve dhe Organizatave të Asociuara, në veçanti nga ministritë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe planifikimin urban, agjencitë përkatëse për trashëgiminë kulturore, komisionet e përhershme

të parlamenteve kombëtare përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe planifikimin urban, administratat rajonale; nga qytetet e OSHC-ve partnere, morën pjesë kryetarë të bashkive, zyrtarë bashkiakë përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe planifikimin urban dhe Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë.

Mbështetje shpesh u dha nëpërmjet publikimit të manualit “Menaxhimi i Integruar i Qyteteve Historike”, si një mjet praktik pune dhe burim në shërbim të vendimmarrësve të të gjitha niveleve për udhëzime praktike të nevojshme që i ndihmojnë ata të marrin vendime të përditshme lidhur me qytetet historike përkatëse. Manuali mbështetet mbi literaturën standarde ekzistuese; në anekse janë botuar të gjitha konventat europiane e ndërkombëtare përkatëse, si dhe dokumente të tjera.

Përpjekje të veçanta u kryen për të njohur publikun e gjerë, veçanërisht të rinjtë, me problemet e mbrojtjes dhe zhvillimit të qendrave të qyteteve historike. U prodhua një DVD edukative për përdorim në shkolla dhe institucionet e arsimit publik, e cila krahason katër qytetet në projekt me Regensburgun, një qytet historik i menaxhuar veçanërisht mjaft mirë nga një partner i asociuar në Projektin EVAH. Në fund, por jo më me pak rëndësi, artistë rinj nga të katër qytetet, u ftuan të reflektojnë temën e projektit nga një perspektivë artistike ose krijuese. Puna artistike që ata prodhuan u prezantua në një ekspozitë shëtitëse.

Zhvillimi i një rrjeti të qëndrueshëm midis Organizatave të Shoqërisë Civile që punojnë në qytetet historike dhe artizanat ka çuar në një ndjenjë të rritur përfshirjeje dhe kapacitetesh mes tyre, por edhe në ndërtimin e një dialogu e partneritetit të fortë rajonal midis Organizatave të Shoqërisë Civile brenda vetë rajonit, me autoritetet publike dhe me kolegët e tyre europianë.

Projekti është përpjekur të nxisë ndërgjegjësimin e publikut të gjerë dhe të vendimmarrësve se ata janë europianë, jo thjesht duke u bazuar në gjeografi dhe ekonomi, por kryesisht për shkak të një trashëgimie kulturore dhe historike të përbashkët, siç edhe është shprehur në deklarinë se kultura është një “Shpirt për Europën”. Ajo shpjegon se historia dhe kultura e përbashkët janë elemente përcaktuese të Europës dhe se historia kulturore është e shprehur në mënyrë më të dukshme dhe të spikatur në qytete dhe ndërtesa, si në ato popullore ashtu dhe ato fetare, në stile të cilat janë karakteristike dhe/ose unike për Europën.

Një ndërgjegjësim më i mirë rreth dimensionit europian të trashëgimisë kulturore mund të çojë në një vlerësim më të madh të qyteteve historike dhe artizanatit, autenticitetit të tyre, integritetit dhe diversitetit, si nga publiku i gjerë, ashtu edhe nga vendimmarrësit kyç në të gjitha nivelet. Ata morën mesazhet se kultura dhe trashëgimia janë duke u bërë pararoja në konkurrencën për investime dhe u njohën me nismat e shumta europiane rreth qyteteve historike. Rrjedhimisht ata kuptojnë më mirë potencialet e këtyre qyteteve dhe janë më të gatshëm për të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre. Në të njëjtën kohë, kapacitetet për të zgjidhur probleme ekzistuese janë rritur dukshëm.

Në të njëjtën kohë, rrjeti i ri i Organizatave të Shoqërisë Civile që punojnë për qytetet historike dhe artizanatin do të zhvillohet dhe do të ndajë një përjasje të përgjithshme, qëllime dhe orientim europian të përbashkët. Ato do të komunikojnë, koordinojnë dhe bashkëpunojnë më mirë me njëra-tjetrën dhe me autoritetet shtetërore, duke u bazuar në një platformë rrjetëzuese të Informacionit Teknologjik. Për më tepër, rrjeti i Organizatave të Shoqërisë Civile do të jetë një homolog i unifikuar i institucioneve europiane, iniciativave dhe rrjeteve që punojnë në fushën e qyteteve historike dhe artizanatit.

Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor aspirojnë të bëhen anëtarë të Bashkimit Europian – në të vërtetë për të gjithë ata ky është prioriteti më i lartë politik. Gjithsesi, përtej një ndjenje të përgjithshme të “përkatësisë europiane”, një pjesë e madhe e popullsisë do ta kishte të vështirë të shpjegonte me saktësi se çfarë e bën atë pjesë të sferës kulturore europiane. Koha e gjatë në izolim dhe varfëria e kanë penguar mundësinë e zhvillimit të një eksperience vlerash dhe parimesh të përbashkëta për shumicën e banorëve të Ballkanit Perëndimor.

Në projekt, kemi prezantuar trashëgiminë kulturore të shteteve partnere si “Trashëgimia Jonë e Përbashkët”. Kemi inkurajuar pikëpamjen se trashëgimia kulturore e të katër shteteve pjesëmarrëse është trashëgimi e përbashkët për të gjitha grupet etnike ose kombet që jetojnë këtu, duke u përpjekur për të kontribuar në një shkëmbim dhe mirëkuptim ndëretnik. Domethënë, shqiptarët duhet ta konsiderojnë trashëgiminë që lidhet me kulturën maqedonase, greke etj. si trashëgiminë e tyre gjithashtu dhe të marrin përgjegjësi për ta mbrojtur atë; dhe në të njëjtën mënyrë, maqedonasit duhet ta konsiderojnë trashëgiminë shqiptare, greke etj. gjithashtu si trashëgiminë e tyre dhe të marrin të njëjtën përgjegjësi për të; kështu me radhë për të gjitha kombet në zonën e shteteve partnere dhe në Ballkan. Shkurtimisht, të gjitha komunitetet etnike duhet të zhvillojnë më mirë një ndjenjë përgjegjësie për të gjithë trashëgiminë se sa çdo komunitet i vetëm të zhvillojë një ndjenjë vetëm për atë që e konsideron si “të tijën”. Kjo do të ndihmojë për të ikur nga mentaliteti “ne kundër tyre” në një mentalitet “ne së bashku”.

Së dyti, ne kemi prezantuar trashëgiminë kulturore në vendet tona sigurisht si pjesë të trashëgimisë së përbashkët europiane, që përfaqëson vlera europiane dhe kjo është reflektuar duke shpjeguar veçoritë dhe tiparet kryesore në historinë dhe ndërtimin e qyteteve europiane. Nga ana tjetër, kemi nxjerrë në pah dallimet, duke ilustruar gjithashtu parimin e Europës “Unitet në Diversitet” – një nga vlerat më të larta të saj.

* *Stephan Doempke, koordinator i Projektit EVAH deri në Mars 2012.*

Struktura historike e qyteteve të Ballkanit: hapësira, pushteti, kultura dhe shoqëria

Maximilian Hartmuth

Qytetet Ballkanike si pasqyrë e shoqërisë

Për vizitorët nga pjesa tjetër e Evropës, struktura historike e vendbanimeve urbane në Gadishullin Ballkanik shpesh evokon reagime të ngjashme: arkitektura e tyre para moderne dhe struktura urbane duket jo vetëm disi e panjohur, por për sa i përket stilit dhe teknologjisë, duket gjithashtu çuditërisht homogjene në një rajon të gjerë midis Banja Lukës dhe Edirnes. Arsyeja për këto të dyja është se për një kohë shumë të gjatë midis shekujve të katëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë, pjesa më e madhe e gadishullit ishte e bashkuar nën sundimin e një sundimtari të vetëm, sulltanit osman. Me instalimin e tij në fron në Stamboll në 1453, u zhvillua një shtet i centralizuar, nënshtetasit e shumtë të të cilit, si dhe mallrat dhe idetë e tyre, udhëtonin lirshëm midis nyjeve të një rrjeti urban me zgjerim dinamik në Ballkan dhe më tej. Ishte shumë e zakonshme, për shembull, që një ndërtues ose marangoz nga Maqedonia Perëndimore me terren të thyer të mund të gjendej duke punuar 400 km në veri, në Beograd. Modelet për arkitekturën urbane monumentale të rajonit shpesh vinin nga Stambolli, i cili furnizonte gjithashtu shtresën e lartë të shoqërisë provinciale me një stil elite për t'u imituar në përputhje me potencialin ekonomik të tyre.

Në përzgjedhjet që lidhen me veshjen ose zbukurimin e shtëpive, dallimet fetare ishin shpesh më pak të rëndësishme se dallimet klasore. Megjithatë, pamja e jashtme e qyteteve reflektonte një hierarki fetare, e cila ishte themelore për shoqërinë osmane deri në ardhjen e modernitetit. Një numër i madh monumentesh të jashtëzakonshme u ndërtuan në vendbanimet urbane me zhvillim të shpejtë në Ballkan, midis shekujve të pesëmbëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë, por kishat nuk bënin pjesë ndër to. Pas pushtimit osman të një vendi të caktuar, ndërtesa më monumentale në qytet konvertohej zakonisht në xhami dhe, përgjithësisht, ndërtimi i kishave “*ex novo*” ndalohej nga ligji Hanefit. Riparime të nevojshme për strukturat më të vjetra konsideroheshin të ligjshme, me kusht që të kishin autorizim perandorak. Kishat e ndërtuara në Ballkanin Osman përpara shekullit të nëntëmbëdhjetë rindërtoheshin shpesh brenda përmasave të ndërtesave më të vjetra në vendndodhje – një rregull që sigurisht kufizoi shumë potencialet e projektimit, derisa gradualisht u hoq në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Ishte në dekadat e mesme të këtij shekulli, vetëm disa dekada përpara rënies së perandorisë, koha kur kisha monumentale u

kythe në pamjet e qyteteve otomane; por edhe atëherë kabanoret e larta nuk do të guxonin të kalonin lartësitë e minareve të xhamive.

Sidoqoftë, është e rëndësishme të kuptohet se qyteti osman në Ballkan nuk ishte një produkt i mosndërhyrjes (*laissez-faire*), por ndoqi praktika të caktuara, të cilat nuk kanë qenë gjithmonë të dukshme për historianët, sepse rrallë regjistroheshin qartësisht. Një nga këto praktika është se pamja e qyteteve reflektonte rendin otoman të gjërave, veçanërisht për sa i përket hierarkive fetare. Ndarja tipike e qytetit në një qendër plot jetë, të rrethuar nga një unazë lagjesh rezidenciale, pothuajse të veçuara, duhet thënë se ka pasqyruar idealin e një ndarjeje funksionale midis jetës private me atë publike.

Sistemi tradicional i banesave si struktura që lira qëndrojnë lirshëm në mjediset e rrethuara me mure dhe me kopshte të vogla, krijon mundësinë jo vetëm të ekspozimit të tyre ndaj dritës së diellit, por edhe të përshtatjes së këtyre strukturave ndaj nevojave në ndryshim për sa i përket hapësirave dhe funksioneve. Vendosja e shpesh të banesave mbi shpate, atje ku ishte e mundur, sigurisht që e bëri sistemin e kanalizimeve më efikas. Megjithëse kjo arkitekturë mund të ketë ndjekur kështu parime të ngjashme, ajo ndryshonte shumë nga një rajon në tjetrin. Dëborë e shpesh të, për shembull, mund t'i ketë bërë të detyrueshme çatitë e pjerrëta, ndërsa mungesa e drurit i bëri njerëzit t'i ktheheshin gurit. Dallimi, për shembull midis ndërtesave në Bosnje me Hercegovinën fqinjë – njëri rajon i orientuar drejt Adriatikut, tjetri drejt brendësisë së Ballkanit dhe të dyja të ndara nga kreshta kryesore e Vargmalit Dinarik – mund të jetë i konsiderueshëm. Gjithsesi dhe pavarësisht se çfarë mund të sugjerojnë disa libra, duhet të pranojmë se dimë shumë pak rreth arkitekturës së banesave në Ballkan përpara shekullit të nëntëmbëdhjetë, për arsyen e thjeshtë se kanë mbijetuar shumë pak struktura, të cilat mund të datohen nga ajo periudhë. Kjo e bën gjithashtu të vështirë të thuhet diçka e pakundërshtueshme rreth zhvillimit të arkitekturës së banesave në këtë rajon. Arkitektura e banesave në qytetet ballkanike që kanë arritur deri tek ne pasqyron gamën e llojeve dhe formave që gjenden në shekullin e nëntëmbëdhjetë.

Arkitektura Urbane

Ndërsa në shumë pak raste (si për shembull në Sofje dhe Selanik) ende mund të gjenden monumente që datojnë nga Antikiteti i Vonë, lagjet e “qytetit të vjetër” në qytetet ballkanike ruajnë, në masë të madhe, strukturën dhe ndërtimin e shekullit të nëntëmbëdhjetë, sado që monumentet e tyre kryesore janë zakonisht më të vjetra. Ishte në këtë periudhë kur modele të reja urbane hynë në skenën ballkanike dhe, herë pas here, në konkurrencë të egër me ato tradicionale. Askund nuk është kjo më e dukshme se në Sarajevë ku ka një ndryshim të menjëhershëm nga Bashçarshija – një lagje, struktura e së cilës mund të gjendet afërsisht në dekadat rreth vitit 1500, por që në formën e saj të tanishme pasqyron ndryshimet që ndodhën rreth vitit 1900 (si për shembull sheshi i hapur me një shpërndarës uji pseudo-osman të llojit *sebil*) dhe lagja rrotull ndërtuar në stilin e “rrugës kryesore” të Europës Qendrore, e quajtur Ferhadija, e cila lindi rreth viteve 1900, si një kundër-model ndaj qendrës së vjetër. Në Shkup, lumi Vardar është kufiri midis një lagjeje “tradicionale” pazari, e cila u shfaq nën fortesë, duke filluar nga shekulli i pesëmbëdhjetë dhe një pjesë

“moderne”, që u zhvillua me shpejtësi vetëm në shekullin e kaluar. Në Sofje dallimet kanë qenë më të mprehta: transformimi i saj në kryeqytetin e kombit bullgar rreth vitit 1900 la pas pak gjurmë të së shkuarës otomane. Unaza rrugore që rrethon qendrën e Sofjes të sjell ndërmend konfigurimin e Vjenës, ku në këtë periudhë, shumë bullgarë shkuan të mësojnë për arkitekturë dhe fusha të ngjashme me të.

Shumica e strukturave urbane më të vjetra të qyteteve Ballkanike datojnë gjithashtu nga periudha otomane dhe jo më herët. Përjashtimet monumentale përfshijnë disa bazilika të tipit katedrale të ndërtuara në brendësi të Ballkanit, në një periudhë të rivendosjes së sundimit bizantin rreth shekujve të njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë, përfaqësuar me disa nga shembujt më mirë të ruajtur në Prizren, Serres, Verroia dhe Ohër. Ajo periudhë pa një ringjallje të vërtetë të jetës urbane në rajon pas pushtimeve të egra barbare të shekullit të shtatë – në një shkallë që nuk do të përsëritej deri në shekujt e mëvonshëm të pesëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë. Ishte atëherë kur shumë qytete ballkanike përfunduan monumentet e tyre kryesore të para shekullit të nëntëmbëdhjetë. Si rregull, kjo nuk ishte arkitekturë që buronte nga procese lokale dhe nga puna (projektet) e artistëve lokalë, por ndiqte llojet dhe stilet e formuluar në atë që mund të quhet “rajoni metropolitan osman” rreth Detit Marmara, ku ndodheshin qytetet e vjetra perandorake: Stambolli, Bursa, dhe Edirneja (për rrjedhojë edhe arritjet kryesore të projektimit arkitekturor osman).

Standardizimi i llojeve arkitekturore osmane u mundësoi krahinave mjaft të largëta që të krijonin monumente me karakter deri diku të dallueshëm. Devijimet e modeleve standarde ishin në përgjithësi kuptimplote, në kuptimin që ato pasqyronin statusin ose ambicien e lartë të një padroni të caktuar ose datonin nga një periudhë në të cilën detajet nuk ishin ende të standardizuara, por liheshin në zgjedhje të ndërtuesve dhe muratorëve. Për shembull, madhësia dhe sofistikimi i pazakontë (në kontekst provincial) i xhamisë së Gazi Hüsrev Beut në Sarajevë pasqyronte, me të gjitha gjasat, jehonën e origjinës së padronit të saj – ai ishte djalë lindur në Maqedoni i një princeshe otomane – si dhe shkallën e pazakontë të pushtetit të dhënë sunduesit të një rajoni me rëndësi strategjike për zgjerimin e hegemonisë otomane në Europën Qendrore dhe Jugore.

Pavarësisht nga përmasat, arkitektura urbane e qyteteve otomane u zhvillua mbi një kuadër të paracaktuar llojesh. Në përputhje me rëndësinë e krahinës ku ndodheshin, mund të gjenden Xhuma Xhami (në periudhën e hershme zakonisht vetëm një), shtëpi lutjeje më të vogla në përdorim nga lagje të veçanta, hane, tregje të mbuluara për mallra luksoze, banja publike (“kafenetë e seksit të bukur”), shkolla fillore dhe të mesme, ujësjellës, shatërvanë publike etj. Popullariteti i kubeve jo vetëm si element strukturor, por edhe ikonografik është shumë i dukshëm në shumë ngulime osmane të dikurshme. Ne dimë pak rreth dekorimit fillestar të interierëve të këtyre ndërtesave, por zbukurimi i portaleve është ndonjëherë domethënës.

Në shekullin e pesëmbëdhjetë, banjat publike ishin shpesh të privileguara sa i përket monumentalitetit dhe dekorimit. Në fund të atij shekulli, që përkon me një nevojë më të madhe për mbikëqyrjen e faljes myslimane në kohë “herezish”, u krye një ndryshim i rëndësishëm, që efektivisht e

rezervoit ruajti arkitekturën monumentale për Xhuma Xhamitë. Një qytet si Sarajeva mund të kishte deri në shtatë xhami me kube. Në fund të shekullit të gjashtëmbëdhjetë erdhi një tjetër ndryshim – jehonë e zhvillimeve në kryeqytet – nga patronazhi i xhamive tek grumbujt e ndërtesave përreth shkollave të arsimit të mesëm, *medresetë*. Sidoqoftë, kjo periudhë sjell edhe një rënie të rëndësishme të patronazhit arkitekturor në përgjithësi. Krahasuar me periudhën 1425-1575, në tre shekujt që vijuan, u shfaqën pak struktura të ngjashme monumentale.

Një ndryshim madhor tipologjik ndodhi në shekullin e nëntëmbëdhjetë, kur u prezantua një infrastrukturë moderne shkollimi, sigurie dhe komunikimi, duke zvogëluar peshën në ndërtimin e ndërtesave me funksione fetare. Shpesh anashkalohet fakti se përparimi i arkitekturës dhe planifikimi urban i llojit evropian i parapriu pavarësisht së kombeve ballkanike nga sundimi otoman. Zjarret në përgjithësi të shpeshta, të ndihmuar nga përdorimi gjerësisht i drurit në arkitekturë, jepnin një mundësi që shteti të ndërhynte në rindërtimin e zonave urbane sipas parimeve moderne, “racionale”. Në periudhën e vonë, shteti otoman kishte, herë pas here, nevojë të ndërtonte lagje të tëra të reja për popullatat refugjate (myslimane). Lagja *Maxhir maalo* në Shkup (nga turqishtja *Muhaxhir mahallesi*, d.m.th. “lagja e refugjatëve”) ishte e para në qytet që u planifikua dhe u zhvillua sipas një rrjeti “racional”, ortogonal. Në Manastirin e vonë otoman u zhvillua një rrugë kryesore përfaqësuese e stilit evropian e quajtur *Shirok sokak* (fjalë për fjalë: “ruga e lartë”), por fillimisht e quajtur *Hamidije*, sipas sulltan Abdylhamidit II. Ky ishte emri gjithashtu i një lagjeje elegante periferike në Selanik.

Rrugë të ndryshme zhvillimi

Ka pasur shumë tundim për t’i imagjinuar qytetet e Europës Juglindore si përfaqësuese të tipave të caktuara, në përputhje me fuqitë e dikurshme dominuese në pjesë të ndryshme të rajonit – kështu kemi lexuar për “qytetin otoman”, homolog i atij veneciano/dalmat, “qytet ballkanik”, “qytet hungarez” etj. – por në të vërtetë ka shumë pak shembuj normativë të një pohimi të tillë. Nuk duhet të harrohet se në kohën e ardhjes së pushtimit otoman qytetet tashmë ekzistonin në Ballkan. E vërteta është që otomanët, herë-herë, duket se ngurronin të ndërhynin në mënyrë drastike në strukturën ekzistuese urbane. Ndonjëherë muret mbrojtëse rrafshoheshin dhe kishat e mëdha konvertoheshin, por nganjëherë nuk ndodhte asnjë nga këto. Në shumë raste, bërthama urbane otomane me institucionet përkatëse islamike zhvillohej jashtë qyteteve mesjetare të rrethuara me mure, pothuajse si një ngulim i ri, i cili me kalimin e kohës, për sa i përket rëndësisë, zëvendësonte qendrën më të vjetër të vendbanimit. Pa dyshim që pushtimi solli transformime të rëndësishme, por këto ndoshta më mirë mund të përshkruhen si otomanizim i vendbanimeve ekzistuese se sa një implementim i “modeleve urbane” otomane në një “*tabula rasa*”. Sigurisht, një numër i rëndësishëm qytetesh ballkanike kanë themele otomane pa precedentët mesjetarë urbanë, si p.sh Sarajeva, Novi Pazari, Korça ose Razgradi. Tre shembujt qytetesh ballkanike historike të spikatur, që po paraqesim në vazhdim, na japin një ide të rrugëve të ndryshme të zhvillimit të tyre.

Qyteti mesjetar i rrethuar me mure i Ohrit duket se është marrë nga osmanët prej një feudali shqiptar në fund të shekullit të katëmbëdhjetë. “Osmanizimi” ndodhi më pas, duke vijuar në këtë formë: kisha kryesore e qytetit me mure, Shën Sofia e shekullit XI u kthye në Xhuma Xhami. Zona përreth saj u bë “lagje qeveritare” e vogël, me rezidencën e guvernatorit, një punishte për prerjen e monedhave otomane dhe një tempull të vogël, kushtuar një nëpunësi të martirizuar otoman. Jashtë kësaj zone të vogël, lagjet në brendësi të mureve mesjetare të qytetit, qëndruan megjithatë, në pjesën më të madhe, të krishtera. Ohri i ri, mysliman, lindi jashtë mureve, përgjatë bregut të liqenit. Ishte ky vendi ku u vendosën institucionet e mëdha islamike (duke përfshirë një medrese me një skriptorium) dhe ishte gjithashtu ky vendi ku familja Ohrizade, e cila duket se ka dominuar politikën e Ohrit në shekujt e gjashtëmbëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë, kishte rezidencën e saj të madhe dhe disa ndërtesa publike të lidhura me të. Paraardhësi i familjes kishte konvertuar një manastir që dominonte qytetin në xhami, sipas gjasave nën hirin e sulltanit. E vendosur shumë larg nga lagjet myslimane të Ohrit, ndërtesa u identifikua me faktin se këtu shpërndahej ushqim falas për nevojtarët, pavarësisht besimit. Ndoshta ky veprim shërbente si mjet për rritjen e rolit të familjes Ohrizade në qytet.

Nga ç’ka mund të rindërtohet në një masë deri diku të konsiderueshme, del se vendbanimi ishte si i ndarë ashtu edhe i bashkuar. Qyteti i vjetër me mure qëndroi i banuar nga jo-myslimanë, përveç një zone përreth rezidencës së pashait dhe Shën Sofisë, në të cilën u ndje prania e pushtetit të qendrës otomane. Gjithsesi, pjesa më dinamike e Ohrit ishte ajo që ne mund ta quajmë Qyteti i Poshtëm, ku ndodheshin shumica e institucioneve islamike të qytetit dhe banonte familja dominuese në lokalitet. Ndoshta struktura urbane e Ohrit mund të shihet si shprehëse jo vetëm e ndarjes myslimane/të krishtere, por gjithashtu ndarjes mes elitës lokale myslimane (e përfaqësuar këtu nga Ohrizadët) dhe qendrës së largët të pushtetit otoman (e përfaqësuar nga pashai dhe “xhamia e sulltanit”, d.m.th. nga Shën Sofia e konvertuar). Qendra moderne e Ohrit u zhvillua nga periferia dikur me dominim mysliman drejt vendit të sheshtë poshtë lagjes së rrethuar me mure, e cila ka mbetur një zonë kryesisht rezidenciale/turistike.

Shkupi, i cili kishte qenë gjithashtu një vendbanim i rëndësishëm mesjetar dhe rezidencë e dinastëve serbë, u pushtua afërsisht në të njëjtën kohë me Ohrin. Megjithatë, këtu ngjarjet u shpalosën krejt ndryshe. Njohuritë rreth strukturës fizike të Shkupit para-otoman priten që të rriten me publikimin e zbulimeve nga gërmimet që vazhdojnë në zonën e kalasë. Është e qartë, gjithsesi, se Shkupi otoman/mysliman u zhvillua në gropën mes kalasë dhe kodrës Gazi Baba. Interesant është fakti se bartësit kryesorë të këtij transformimi ishin tre breza nga një familje e kufinj-sulmuesve, të cilët e kishin bërë Shkupin bazën e tyre për inkursione në Shqipëri dhe Serbi. Institucionet e themeluara prej tyre rezultuan në lindjen graduale të një lagjeje të re tregtare-kulturore në zonën e sotme të bashkisë Çair. Kjo falë institucioneve të themeluara atje nga komandanti i sulmuesve Ishak Bej dhe djali i tij Isa: Ilixha, bujtina, shtëpi lutjeje, etj.

“Xhamia e Madhe” e Shkupit u ndërtua në kodrën Gazi Baba nga sulltani osman Murati II. Megjithëse, rreth viteve 1500, popullata e qytetit kishte mbetur në vend sa i përket numrit, monumentet e reja të mrekullueshme

që datojnë nga kjo periudhë tregojnë se si Shkupi ishte rritur për t'u kthyer në kryeqytetin e Maqedonisë së Sipërme, nën sundimin osman. Ai ishte bërë gjithashtu një vitrinë për arkitekturën e rajonit përreth, duke lënë pas lehtësisht prodhimin e arkitekturës bashkëkohore në Ohër, Manastir dhe madje në Selanik. Me mbërritjen e hekurudhës dhe refugjatëve nga vende të tjera të Ballkanit, filloi zhvendosja graduale e qendrës së qytetit në drejtim të bregut jugor të Vardarit, ku nën sundimin serb dhe jugosllav, lindi një qendër e re që hyri në konkurrencë me qendrën e vjetër në veri të lumit.

Së fundi, Sarajeva u shfaq si vendbanim i ri otoman në një rrafshinë malore; vendndodhja e saj ishte e domosdoshme nga pikëpamja strategjike për shtrirjen më tej në zona veriore me burime minerare përralore. Historia e herët e Sarajevës është e mjegullt, por duket se në çerekët e dytë dhe të tretë të shekullit të pesëmbëdhjetë, një pararojë kufitare në territor armik u shkri me një fshat ekzistues (i krishterë) afër një vahu mbi lumin Miljacka, duke u kthyer në vendbanim më të rëndësishëm, që mund të ishte mbështetje për rezidencën (*sarajin*) e guvernatorit otoman. Shtysa kryesore në këtë proces duket të ketë qenë mësymësi Isa Bej, djali i Ishak Beut të Shkupit, i përmendur më sipër. Sarajeva u bë shpejt zona e një qendre urbane aktive ("Bashçarshija") – ndoshta si reflektim i rëndësishëm që luante tregtia në bumin e lindjes së qyteteve otomane në shekullin e gjashtëmbëdhjetë në zonat afër kufirit mysliman-të krishterë. Në dekadat e mesme të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, Sarajeva u pajis me një strukturë arkitekturore monumentale të pazakontë; pak monumente të krahasueshme me to u shtuan në tre shekujt pasardhës.

Nën sundimin austro-hungarez (1878-1918), pozicioni qendror që Bashçarshija kishte në strukturën e qytetit u sfidua me sukses nga një lagje qendrore e llojit evropian që u ndërtua afër saj. Këto zhvillime shënojnë fillimin e ekspansionit perëndimor në qytet, i cili vazhdoi nën sundimin jugosllav. Fillimisht qytet orientar/kolonial deri diku i marginalizuar, Sarajeva pothuajse katërfishoi popullsinë pas Luftës së Dytë Botërore. Emrat e dy bashkive të reja urbane të themeluara në këtë periudhë janë shprehëse për këtë nisje: *Novo Sarajevo* (Sarajeva e Re) dhe *Novi Grad* (Qyteti i Ri). Qendra monumentale u zhvendos nga Bashçarshija dhe lagja rreth katedrales neo-mesjetare të ndërtuar nga Habsburgët drejt fillimit të një bulevardit me shumë korsi, që duket i pafund dhe shënohet nga qiellgërvishtës, të cilët sfidojnë dominimin vertikal të minareve dhe kambanoreve në peizazhin e Sarajevës.

Të tri rastet tregojnë se zhvillimi nuk u nxit nga një "kulturë" monolitike apo ndonjë frymë ose mentalitet specifik, por, si në vendbanimet e reja ashtu edhe ato para-ekzistuese, ishte rezultat i ndërveprimit mes grupeve dhe individëve, që herë-herë kishin interesa shumë të ndryshme. Në Ohër dhe Shkup, këto dallime – në këtë rast, me shumë gjasa midis Stambollit dhe mbajtësit të pushtetit provincial – mund të jenë reflektuar gjithashtu në strukturën e qytetit. Edhe më shumë kërkime krahasuese janë të nevojshme, përpara se të mund të përpiqemi të bëjmë përgjithshme të proceseve urbanizuese në Ballkan, të cilat do të mund të kalonin provat e kohës.





GJIROKA STRA

Kronikë në Gjur


nga Stephan Doempke,
me Oliver Gilkes, Sadi Petrela, Emin Riza dhe Elenita Roshi

Hyrje

Shumë i pasur në vlera arkitekturore historike, qyteti muze i Gjirokastrës është një nga qytetet e rëndësishme që hedhin dritë mbi jetën urbane në Shqipëri në periudhën e vonë mesjetare. Gjirokastra është e vendosur mbi një kodër mbizotëruese – pikë natyrshëm e përshtatshme për fortifikim ushtarak; ajo mori rëndësi për shkak të vendndodhjes strategjike që mundëson kontrollin e Luginës së Drinos – një nga rrugët kryesore nga porti i Durrësit dhe Shqipëria qendrore për në Greqi dhe Bizant. Tokat e pasura bujqësore të Luginës së Drinos ishin një arsye tjetër për mirëqenien e familjeve gjirokastrite.

Qyteti historik u përfshi në Listën e Trashëgimisë Botërore në vitin 2005, si një “shembull i rrallë i një qyteti osman të ruajtur mirë” në Ballkan, që merr vlerë universale edhe nga dy faktorë shtesë: sfondin e vendosjes së qytetit dhe shtëpitë tradicionale.

Gjirokastra i ka fillimet e veta në një kala ushtarake dhe administrative të shekullit të 13^{te}. Ndryshe nga shumë qytete të tjera të Ballkanit, qyteti nuk ka qenë qendër zejtarie që në fillimet e veta, por qendër ku jetonin pronarë shqiptarë të mëdhenj tokash, si dhe zyrtarë të Perandorisë Osmane; kjo gjë që ndikoi si në karakterin e qytetit, ashtu edhe të shtëpive të tij.





Ato që i japin tonin qytetit janë gjithsesi lagjet rezidenciale. Ato përcaktohen nga terreni i thyer, i karakterizuar nga pjerrësi të thepisura dhe skarpate, përroska të thella dhe kreshta të ngushta. Si pasojë është krijuar një lloj unik banese, me një gamë të gjerë varietetesh të krijuara përmes përshtatjes me terrenin e ndryshueshëm; kjo sjell bashkëjetesën e mjedisit natyror me krijimet njerëzore, që i jep qytetit karakterin e tij të pa ngatërrueshëm.



Ismail Kadare lindi në Gjirokastrë në vitin 1936 dhe është një nga bijtë më të njohur të qytetit. Ai është njeri i letrave – poet, romancier, historian dhe gazetar, i cili ka shkruar gjerësisht për Shqipërinë dhe vendin e saj në Europë. Qyteti i tij i lindjes është i pranishëm në shumë nga veprat e tij, tre prej të cilave janë ekskluzivisht për Gjirokastrën: “Kronikë në Gur” i përkthyer në shumë gjuhë, “Çështje të Marrëzisë”, botuar në vitin 2005 dhe “Darka e Gabuar” në vitin 2008.

“Ky ishte një qytet i çuditshëm, që dukej sikur kishte dalë në luginë një natë dimri si një qenie parahistorike dhe duke u kacavjerrë me mundime të mëdha i ishte qepur faqes së malit... Gjithçka në këtë qytet ishte e vjetër dhe e gurtë, duke nisur nga rrugët dhe krojet e gjer te pullazet e shtëpive të tij të mëdha shekullore, që ishin të mbuluar me pllaka guri ngjyrë hiri, të ngjashme me ca luspa gjigande. Ishte e vështirë të besoje se nën atë koracë gjallonte dhe ripërtërihej mishi i butë i jetës.”

Shtëpia gjirokastrite është një përzierje unike e tipareve shqiptare, osmane dhe rajonale epirote. Konceptimi funksional i saj është përzierje e kulturave shqiptare e osmane dhe pasqyron aktivitetin ekonomik të pronarëve si zotërues të mëdhenj tokash dhe zyrtarë. Sipas traditës shqiptare, kati



përdhes nuk është i banueshëm; përdoret për ruajtjen e prodhimeve bujqësore dhe për sterat e mëdha, që ndërtoheshin për shkak të mungesës së ujërave sipërfaqësore në qytet. Kjo zgjidhje lehtëson funksionin mbrojtës të shtëpisë. Ndarja dhe projektimi i dhomave në katet e sipërme pasqyron familjen shqiptare dhe mënyrën e saj të jetesës, me nuanca nga shijet osmane dhe stili i kohës.

E gjithë ndërtesa, me përjashtim të katit të sipërm, është ngritur me gurë, sipas traditës shqiptare, ndërsa kati i fundit, një strukturë me trarë dhe listela druri të suvatuara dhe me një rresht dritaresh dhe tarraca, është tipike për banesat osmane. Mbulimi i çatave të shtëpisë dhe portës me rrasa guri gëlqeror lokal është një element stilistik unik epirot.

Kombinimi i këtyre elementeve funksionale dhe stilistike nuk mund të gjendet në asnjë vend tjetër veç Gjirokastrës. Në rajonin e Epirit ka ndërtesa të veçanta të këtij lloji ka; në të gjithë Ballkanin ka disa qytete me shtëpi të stilit plotësisht osman. Por moria e banesave të tilla unike të vendosura në një mjedis urban që përcakton karakterin e qytetit, si edhe larmia e madhe e formave - nga pothuajse plotësisht mbrojtëse deri në gjerësisht qytetare dhe nga shqiptare në osmane, e bëjnë Gjirokastrën një fenomen urban pa paralel gjëkund në botë.

Historia

Të dhënat arkeologjike konfirmojnë se ka pasur një vendbanim në Gjirokastrë që rreth viteve 500 p.e.s. Janë zbuluar mure të trasha të ndërtuara me blloqe të mëdha, që flasin se ky vend ka qenë fortifikim i rëndësishëm në periudhën para romake (para vitit 168 p.e.s) dhe ndoshta është fortifikuar përsëri në fund të Perandorisë Romake. Përmendja e parë e vendbanimit është regjistruar në vitin 1336 nga kronisti bizantin Johan Kantakuzeni, i cili e përmend atë si kala dhe si qytet.

Origjina e emrit të Gjirokastrës është më pak e qartë. Shpjegimi më piktoresk është që qyteti mori emrin e Princeshës Argjiro, motra e zotit feudal të qytetit, e cila u hodh nga muri rrethues së bashku me djalin e saj të vogël për të mos rënë në duart e armikut. Sipas një shpjegimi tjetër emri vjen nga *Argjirët*, emri i një grupi fisnor para-romak, i cili popullonte zonën ose i një klani vendas në rajonin e Gjirokastrës. Një shpjegim tjetër është që qyteti e merr emrin nga fjala greke argjend - *argýro* dhe *kastro* (kala), referim ky për gurin në muret, rrugët dhe çatitë që shkëlqen si argjend në shi.

Lugina e Drinos ka qenë për mijëra vjet rrugë natyrore tregtie midis Detit Adriatik dhe Greqisë. Për shkak të rëndësisë gjeografike dhe tokave të pasura bujqësore, ajo ka një histori të gjatë vendbanimesh paqësore si dhe konfliktesh të përgjakshme. Këtu kanë bashkëjetuar dhe janë ndërthurur shumë kultura, si ajo ilire, epirote, maqedonase, romake, sllave, shqiptare, bizantine, greke, otomane, arumune dhe rome dhe lugina ruan edhe sot një karakter multi etnik.



Nuk ka pasur asnjë qytet në luginë deri kur Mbreti molos Pirro themeloi Antigonenë, në anën lindore të rrjedhës së Drinos, në vitin 295 p.e.s. Por pas disfatës së Mbretit Filip V i Maqedonisë në vitin 168 e.j. Konsulli Roman Pal Emili urdhëroi shkatërrimin e Antigonesë, dhe banorët e saj u shitën si skllëvër.

Në shekullin e 2^{te} e.j. Perandori Adrian pa një mundësi për ta rigjallëruar këtë zonë, duke themeluar një qytet të ri. Adrianopoli u ndërtua në një kodrinë të ngritur mbi lumin Drino në qendër të luginës, me synim që të mblidhte së bashku komunitetet e shpërndara të luginës, të cilat kishin mbetur pa një pikë referimi që nga shkatërrimi i Antigonesë 400 vjet më parë. Në shekullin e 6^{te}, mendohet se qyteti u riemërtua Justinianopolis dhe kishte peshkopin e vet. Pak më vonë u braktis dhe në mesjetë u gropos nga sedimentet e lumit.

Gjatë mesjetës rajoni ishte në trazira pasi fuqi të ndryshme, avarët dhe bizantinët, bullgarët dhe serbët konkurronin për kontrollin mbi të. Normanët, nën drejtimin e Bohemondit u përpoqën ta pushtonin zonën në shekullin XI nga një bazë në Butrint. Kjo ishte epoka kur shqiptarët u shfaqën për herë të parë si popull historik dhe nisën të krijonin shtetet e veta. Sundimtarët tyre kishin nevojë për kala, kështu në shekullin XI u ndërtua Kalaja e Gjirokastrës.

Në shekullin XIII, Gjirokastra dhe rajonet përreth saj u sunduan nga familja e Gjin Zenebishit. Perandoria Osmane që u shtri në Europë në fund të shekullit XIV, e përfshiu Gjirokastrën nën sundimin e vet në vitin 1419, sundim që zgjati deri në vitin 1912, pothuajse 500 vjet. Në këtë kohë qyteti kishte 163 banesa. Ai lulëzoi si kryeqyteti i *Sanxhakut* (njësi administrative osmane) shqiptar për më shumë se një shekull, derisa u zëvendësua nga Delvina gjatë regjimit të Sulltan Sulejmanit të Madhërisëm (1520-1566). Gjirokastra luante rol administrativ si seli e *kadiut* (gjyqtar); me vendndodhjen strategjike e rrethinat e pasura, qyteti mbeti i rëndësishëm dhe në vitin 1583 e dyfishoi numrin e popullatës para-osmane. Ai përjetoi rritje të mëtejshme në shekullin XVII, kohë kur ishte zgjeruar pothuajse sa qyteti historik i tanishëm dhe u përcaktuan parimet e kompozimit të tij urban.



Evlia Çelebi ishte zyrtar osman, i cili në shekullin XVII, udhëtoi në të gjithë Perandorinë, në emër të Sulltanit. Ai ka sjellë përshkrimin e parë të detajuar të Gjirokastrës në vitin 1670:

“Kalaja është një ndërtim i vjetër me gurë, vendosur përgjatë kreshtës së një shkëmbi të lartë...Bedenat e saj të gjata dhe solide i ngjajnë një galerie. Brenda kalasë ka vetëm një rrugë kryesore që kalon nga lindja në perëndim. Në të dyja anët e rrugës janë të rreshtuara 200 shtëpi dykatëshe guri, me çati të ndërtuar vetëm me pllaka... Përballë portës lindore të kalasë, poshtë një argjinature të pjerrët, ndodhet lagja e të pafeve, e quajtur Kuçuk Varosh (Qyteti i Vogël). Ajo përbëhet nga 200 shtëpi të mëdha të ndriçuara. Nën shkëmbinj të në veri të kalasë ndodhet pazari i vjetër, i quajtur Pazari i Kalasë, që përbëhet nga 40 dyqane të vegjël. Ky pazar ka porta druri në të dyja anët, shumë të ngjashme me ato të një bezistani, të cilat i mbyll roja çdo natë...



Ali Pashë Tepelena e mori Gjirokastrën në vitin 1811. Lindur pranë qytetit të vogël të Tepelenës në vitin 1744, ai i ngjiti shkallët nga kryetar çete banditësh në guvernator rajonal – Pasha të Epirit. Nën sundimin e Ali Pashës, Gjirokastra u bë bastion strategjik dhe tregtar mes dy kryeqyteteve të tij binjake Tepelenës dhe Janinës, duke hedhur këshu themelet e pasurisë së saj. Gjirokastra u zhvillua si kurrë më parë dhe ishte kjo periudha kur u ndërtuan shtëpitë e para të mëdha, të cilat i dhanë qytetit pamjen karakteristike që ruan edhe sot. Gjithsesi, ambicia e tij për t’u fortifikuar sa të ishte gjendje t’i kundërvihej Perandorisë Osmane dështoi, kur Sulltan Mahmuti II e përmbysi dhe e ekzekutoi në Janinë në vitin 1822. Pasi vrasjes së Ali Pashës, qyteti vazhdoi të zhvillohej si qendër administrative osmane dhe qendër tregtare e bujqësore.



Piktori peizazhist dhe poeti anglez **Edward Lear** kaloi në Gjirokastrë dy herë, në vitin 1848 dhe përsëri në 1859, gjatë udhëtimeve të tij nëpër Ballkan. Këto ishin vitet e muzgëta të Perandorisë Osmane dhe Lear përshkroi dhe pikturoi një botë që po zhdukej me shpejtësi. Shkrimet e Lear-it, por mbi të gjitha skicat dhe pikturat e tij ishin përshkrimet e para me të vërtetë të ndjera të këtyre trojeve, që kur Çelebi kishte kaluar atje 150 vjet më parë. Peizazhi që ai pa ishte pjellor dhe aktiv, por udhëtimi i vështirë; rrugët, e shkatërruara që nga koha e Ali Pashës, ishin veçse pak më të mira se shtigjet.

Arghyro Kastro është në fakt tre qytete: dhe asnjë vend nuk do të ishte rregulluar dot më bukur për përjetësimin e armiqësive mes familjeve që turbullonin gjatë harmoninë e saj. Shtëpitë rivale të vendosura në anët e kundërta të të njëjtës përrorskë mund lehtësisht të shprehnin zemëratën ndaj njëra-tjetrës: ndërsa në dukje banorët e tyre ishin vetëm pak metra larg, në të vërtetë zënka e trashëguar ishte një orë larg zbritje dhe ngjitje, por, pasi Aliu i pashmangshëm pushtoi qytetin, komunitetet e ndara i reshtën grindjet dhe, që nga ajo kohë e tutje, konfliktet u pakësuan njësoj sa edhe mes shtetasve në hapësirat e gjera ku ai sundonte.

Shtëpitë në hapësira të veçanta kanë një ajrim më të pavarur, ato janë shpërndarë sa andej këtej mbi skërka dhe gërxe ose në nivele të vogla të izoluar apo platforma dheu; secila është e zbukuruar me gëlqere dhe arabeska, që u japin ndërtesave në tërësi (që kanë formë të bukur) një karakter shumë të këndshëm në ngjyrë dhe të finiturë.



Gjatë periudhës së mëvonshme të shekullit XIX Gjirokastra ishte në krye të përpjekjeve për ngritjen e identitetit kombëtar shqiptar. Në vitin 1880 Kuvendi i Gjirokastrës shprehu mbështetjen për çështjen e vetë-qeverisjes dhe të rezistencës ndaj sundimit osman. Në vitin 1908, u hap në qytet shkolla e parë në gjuhën shqipe në Gjirokastrë, e quajtur Liria, e pasuar nga një sërë klubesh dhe shoqëri patriotike. Ndërtesa – e restauruar rishtazi – vazhdon të ekzistojë në majë të një kodre të izoluar pranë pazarit, dhe një monument rikujton fillimin shkrimi dhe këndimit shqip në Shqipërinë e jugut.



Çerçiz Topulli lindi në vitin 1880 në një familje të shquar gjirokastrite dhe u bë udhëheqës i një çete luftëtarësh për liri gjatë një periudhe kur në Perandorinë Osmane kishte trazira të konsiderueshme. Në vitin 1908 luftëtarët e tij vranë bimbashin, komandantin turk të qytetit; pasoi një betejë e famshme në Mashkullorë, nga e cila Topulli me çetën e tij mundi të shpëtonte. Me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në 1912, ai nisi luftën për mbrojtjen e kufijve të shtetit të ri dhe u vra në Shqipërinë e veriut gjatë Luftës I Botërore. Në vitin 1934 përpara Bashkisë u ngrit për të një statujë e gdhendur nga Odise Paskali; eshtrat e tij u rivarrosën në Gjirokastrë në vitin 1937.



Në fillim të shekullit XX, kur po përcaktoheshin kufijtë e Shqipërisë së sotme, Gjirokastra ishte një territor i debatuar. Shqipëria shpalli pavarësinë në 1912, kur po zhvillohej Lufta I Ballkanike, e cila u njoh nga fuqitë europiane në Londër 1 vit më vonë. Për disa muaj gjatë vitit 1914 Gjirokastra ishte pjesë e Republikës Autonome të Epirit, nën drejtimin e Gjeneral Zografos, i cili synonte bashkim me Greqinë. Vetëm pas Luftës I Botërore, fuqitë e Antantës (Britania, Franca dhe Rusia) e bindën Greqinë të hiqte dorë nga pretendimi i saj për këtë zonë me shumicë etnike shqiptare. Kufiri aktual u ratifikua në shkallë ndërkombëtare në vitin 1921.



Gjatë regjimit të Mbretit Zog (1928-1939), Gjirokastra ishte një nga qendrat më të rëndësishme kulturore dhe tregtare në vend. Në këtë kohë u ndërtua edhe burgu i madh në kala. Qyteti u pushtua nga italianët në vitin 1939, gjë që shkaktoi lëvizjen e rezistencës kundër pushtimit italian dhe atij të mëvonshëm gjerman. Në vitet e luftës, Gjirokastra ra disa herë nën pushtimin e forcave të ndryshme: grekëve, italianëve dhe gjermanëve përpara se të çlirohej në vitin 1944 nga partizanët që drejtoheshin nga Enver Hoxha, i lindur në Gjirokastrë. Gjirokastra u bë bazë për çlirimin pjesës tjetër të vendit në nëntor të po atij viti. Shumica e shkatërrimeve më të mëdha në qytet u shkaktuan nga bombardimet britanike dhe artileria gjermane.



Vitet e komunizmit sollën një industrializim në shkallë të gjerë. Në vitin 1961 Gjirokastra u shpall Qytet Muze nga regjimi komunist në përpjekje për të restauruar dhe konservuar trashëgiminë kulturore unike të qytetit. Një forcë punëtoresh e konsiderueshme u angazhua për të mirëmbajtur lagjet e vjetra. Në të njëjtën kohë, u ndërtua një qytet i ri socialist poshtë qytetit historik, i cili shpejt do të merrte disa nga funksionet urbane të Gjirokastrës. Shumë njerëz u strehuan në pallatet e reja, duke u larguar nga qyteti historik.





Rënia e regjimit komunist në mars të vitit 1992, e gjeti ekonominë e Gjirokastrës në rënie të shpejtë. Në komplekset industriale të vjetruara dhe jo-efikase, komunistët kishin punësuar shumë më tepër njerëz se ç'nevojiteshin, me qëllim punësimin e plotë të popullsisë; rrëzimi i komunizmit çoi në humbjen e mijëra vendeve të punës. Pasuan shumë trazira civile, Muzeu Kombëtar i Armëve u grabit dhe statuja gjigante e Enver Hoxhës, që kishte dominuar qytetin, u rrëzua.

Trazirat u përsëritën në vitin 1997, me rënien e skemave financiare piramidale, që çuan në humbjen e kursimeve të jetës së shumë njerëzve.

Një pjesë e konsiderueshme e Pazarit u dogj dhe u dëmtua dhe qyteti u bë i dhunshëm dhe i pakontrollueshëm. Kriza shpërtheu një emigracion masiv dhe braktisjen e shumë ndërtesave historike, që shteti nuk mund t'i mirëmbante më.



Shkatërrimi i

shërbimeve publike në zonat rurale pas vitit 1997 solli mijëra emigrantë të brendshëm në Gjirokastrë. Ata kërkuar strehim në qytetin e ri të poshtëm, ku shpërtheu një bum ndërtimi i pa precedent, i pa planifikuar dhe i pakontrolluar. Si pasojë, Gjirokastra sot është një qytet i ndarë, ku pjesa më e madhe e jetës ekonomike ndodh në qytetin e ri, ndërsa qyteti historik vuan nga braktisja në shkallë të gjerë dhe rënia.





Qyteti Historik

Mjedisi natyror


Qyteti shtrihet në rrëzë të Malit të Gjerë, në një terren të ashpër luginash të ngushta, përroskash të thella dhe pak shpatësh të vogla e të buta. Guri nga malet aty pranë është materiali kryesor i ndërtimit të qytetit. Në këtë terren plot kontraste ngrihet një kodrinë e thepisur, mbi të cilën janë ndërtuar kalaja, pjesët e lashta të qytetit dhe qendra e tij. Me pozicionin e saj komandues, ajo gjithmonë ka qenë dominuese në pamjen e përgjithshme të qytetit, ndërsa filloi ta humbte funksionin e vet si një ndërtim mbrojtës që nga gjysma e dytë e shekullit XIX.

Qyteti otoman

Planifikimi i qytetit historik të Gjirokastrës, ashtu siç mbetet sot, është pa dyshim osman. Ai nuk u ndërtua në terren të sheshtë pranë lumit, siç do të pritej në një qytet të Europës Perëndimore, por në mal për të kursyer tokat bujqësore. Së dyti, përbërësit kryesorë të tij janë:

- Kalaja, e cila shërbente si pallat për sunduesin dhe si fortifikim ushtarak
- Pazari, si zona për zejtarë dhe tregti
- ndërtesat fetare (kishat, xhamitë dhe teqetë)
- lagjet e banuara.

Gjirokastra nuk kishte sheshe urbane që të shërbenin si vende takimi për popullatën dhe as bashki për përfaqësimin e tyre: e vetmja ndërtesë që personifikonte sundimin dhe administratën ishte kalaja dhe të vetmet hapësira sociale ishin komplekset fetare. Mungonte një shesh qendror, reth të cilit të vendoseshin institucionet sociale kryesore – qeveritari,



kisha dhe Bashkia. Zonat e banuara ishin të veçura nga pazari: nuk kishte banesa në pazar dhe nuk kishte hapësira tregtare në zonat e banuara. Në arkitekturë dallimi mund të shihet midis ndërtimeve të dendura dykatëshe që janë ngjitur me njëra-tjetrën në pazar dhe banesave të veçura të familjeve të Gjirokastrës, të cilat i japin qytetit pamjen e tij unike. Disa zgjatje të rrugës në Pazarin e Vjetër, Lagjet Hazmurat dhe Varosh përfaqësojnë kalimet midis dy sferave.






Një ndryshim erdhi me mbërritjen e modelit perëndimor të shtetit dhe të shoqërisë gjatë periudhës së sundimit të Mbretit Zog dhe më pas komunistëve. U ndërtuan një sërë godina publike kryesore si Bashkia, qendra kulturore, posta, terrene sportive, një hotel dhe pallate dhe u krijua një shesh i madh midis pazarit dhe lagjeve

të banuara, si dhe shkolla dhe kopshte brenda zonave të banuara. Me fillimin e bizneseve private pas vitit 1991, për herë të parë në zonat e banuara filluan të lulëzonin dyqane të vogla, duke treguar transformimin e mëtejshëm të Gjirokastrës nga një qytet osman në një qytet perëndimor.

Kalaja

Kalaja është pa dyshim ndërtesa më mbresëlënëse e qytetit. Arkeologët besojnë se vendi ku ajo është ndërtuar, banohej që nga Epoka e Hekurit në shekujt e 8^{te} – 7^{te} p.e.s. Fortifikimet e para – muret e ndërtuara me blloqe gurësh – janë ngritur me shumë mundësi që nga shekulli i 5^{te} p.e.s. gjatë kohës kur Epiri po bëhej fushë beteje midis fiseve ilire, maqedonasve dhe forcave të Romës. Një kala shumë më e madhe me një sipërfaqe prej 2.5 hektarësh u ndërtua në anën lindore të kreshtës që shihte nga lugina e Drinos nga Despotati i Epirit nën patronazhin bizantin në shekujt e 12^{te} dhe të 13^{te}. Me rënien e Perandorisë Bizantine, Gjirokastra u sundua nga familje feudale shqiptare e Gjini Zenebshit.






Pas pushtimit osman të fillimit të shekullit XV, kalaja u zgjerua dhe u përmirësua vazhdimisht. U ndërtuan shtesa gjatë gjithë periudhës osmane, ndërkohë që kalaja zgjerohej në jug-perëndim, përgjatë kreshtës.

Udhëtari turk Evlia Çelebi ka lënë informacione interesante mbi kalanë në mesin e shekullit XVII. Duke e përshkruar atë pikërisht në fazën e parë të zgjerimit përfundimtar të saj, ai raporton se, krahas strukturave ushtarake dhe funksioneve për qëllime mbrojtëse, kishte banesa dhe stera të mëdha, si dhe xhami. Mund të supozohet që në atë kohë kalaja dukej si një fshat i rrethuar nga një mur mbrojtës, shumë e ngjashme me atë që shfaq Kalaja e Beratit sot, por duke shtuar strukturat ushtarake.

Kalaja e Gjirokastrës që shohim sot është kryesisht vepër e Ali Pashës. Që nga viti 1811, ai filloi një program thelbësor ndërtimi, duke shtuar kullën e sahatit në skajin verior, një numër të madh magazinash nëntokësore dhe fortifikimet jugore për të rrethuar të gjithë sipërfaqen e zënë tashmë nga kalaja. Ali Pasha largoi familjet që jetonin brenda mureve rrethuese të fortifikuara dhe e rezervoi kalanë plotësisht për qëllime ushtarake, krahas rezidencës së tij.





Ali Pasha gjithashtu ndërtoi një akuedukt që sillte ujin e pijshëm nga një distance prej më se dhjetë kilometra nga një burim nën Malin e Sopotit për në terat e mëdha të ujit, që shtrihen në bllokun qendror të kalasë. Akuedukti prej guri u vizatua nga piktori i famshëm britanik Edward Lear, i cili udhëtoi së tepërmi në rajon. Në një bllok mbi Lagjen Manalat ekziston ende një seksion i vogël, i njohur nga vendasit si Ura e Ali Pashës ose Ura e Manalatit.



Që nga koha e Ali Pashës, rëndësia e kalasë ka ardhur duke u pakësuar gradualisht. Ajo që kishte mbetur nga akuedukti u shemb në vitin 1932 dhe me gurët e tij u ndërtua një burg në zemër të kalasë, i cili u përdor për më shumë se 30 vjet rresht nga Mbreti Zog, fashistët italianë dhe gjermanë dhe nga komunistët shqiptarë.

Ka tre hyrje kryesore për në kala – në perëndim, veri dhe lindje – dhe dy hyrje dytësore. Porta gjigante Lindore ose e Vezirit ishte një nga portat kryesore për në kështjellë që të çonte tëposhtë drejt jugut. Thuhet se Ali Pasha hynte përmes kësaj porte kurdoherë që vinte nga kryeqyteti i tij Janina. Në punimet e saj fine prej guri bëjnë pjesë korniza të dhëmbëzuara dhe mbetjet e një kati të dytë që përfshinte qemerin,



dyert, shkallët dhe muret e oxhakut. Kishte disa hapësira të brendshme të kalasë, që kishin kate të dyta dhe të treta, ku ishin vendosur banesat për nëpunësit e kalasë dhe garnizonin e saj.



Disa hapa më në jug mund të shihet muri i cili përcaktonte kufirin e jashtëm të kalasë përpara zgjerimit të kryer nga Ali Pasha. Prapa një hapësire të ngushtë, vija siluetë e një çatie në formë kupole tregon një ndërtesë që më përpara ka qenë fetare, ndoshta një bazilikë. Menjëherë prapa saj është një *tyrbe*, ose varr për dervishë, e cila përmban eshtrat e dy baballarëve, Baba Sulltanit dhe Baba Kapllanit, njerëz të shenjtë të shekullit të 16^{te}-17^{te}, të cilët kanë jetuar dhe punuar në Gjirokastrë. *Tyrbja* është ndoshta e Urdhrit Sa'di të myslimanëve Sufi, ku thuhet se ishte anëtarësuar Ali Pasha; me zgjerimin e kalasë, ai arriti ta përfshinte *tyrben* brenda mureve të saj mbrojtëse.

Duke vazhduar drejt jugperëndimit, përmes **një sërë tunelesh dhe kupolash masive**, arrihet në pikën më të lartë të kalasë. Këto nën struktura dhe fortifikimet e mësipërme u ndërtuan nga Ali Pasha pas vitit 1811. Ato formojnë themelet e bedenave të sipërme dhe gjithashtu përdorshin si magazina dhe si dhoma për rojet.

Nga hyrja perëndimore dhe lindore, një sistem galerish treshe me kupola, e ashtuquajtura **Galeria e Madhe**, shtrihet drejt veriut, e mbushur me pjesë artilerie, të cilat janë braktisur ose u janë marrë forcave pushtuese italiane dhe gjermane gjatë Luftës II Botërore. Topat italianë, me pak përjashtime, zënë





anën e djathtë të galerisë, ndërsa artileria gjermane shtrihet në të majtë. Në fund të kësaj galerie në të majtë është një tank i vogël italian. Pranë tij ndodhet një statujë e madhe e Heroit Partizan vepër e Odise Paskalit, i cili është edhe autor i statujës së Çerçiz Topullit në sheshin kryesor.

I hapur në vitin 1971, **Muzeu Kombëtar i Armëve** ndodhet aty ku dikur ishte një pjesë e burgut të ndërtuar nga italianët në majën e kullës më të madhe të kalasë. Janë të ekspozuara armët shqiptare të përdorura gjatë luftërave për pavarësi të vitit 1912 dhe 1920, si dhe armët e përdorura nga partizanët shqiptarë dhe trofetë nga Lufta II Botërore. Në muze është përfshirë edhe një përzgjedhje e vogël pikturash të realizimit socialist në Shqipëri, pjesë e një koleksioni shumë më të gjerë.



Në një galeri tjetër të Kalasë është vendosur **Muzeu i Gjirokastrës**. Ai është i pari i llojit të tij që mbarat një shpjegim të historisë së qytetit dhe rajonit përreth, si dhe portretizon disa nga personalitetet më të rëndësishme të historisë. Në vitrinat e tij janë paraqitur edhe objekte arkeologjike, sidomos nga gërmimet e fundit në Adrianopol, armë nga periudha otomane dhe objekte të tjera nga periudha komuniste.

Hyrja në **burg** arrihet përmes një dërr hekuri në galerinë e parë të Muzeut Kombëtar të Armëve. Projektuar nga italianët, burgu u ndërtua nga



regjimi i Mbretit Zog dhe u përdor që nga viti 1932. U përdor nga forcat pushtuese italiane dhe gjermane gjatë Luftës së Dytë Botërore, më pas nga regjimi komunist derisa u mbyll përfundimisht në vitin 1968.



Një pjesë e vogël e burgut që është e hapur për vizitorët u shndërrua në muze nga regjimi komunist në vitet 1970', duke ndjekur modelin e burgjeve "revolucionare" në Bashkimin Sovjetik dhe gjetkë.

Në fund fare të bllokut të qelive, pranë një dhome torturash dhe ekzekutimesh,

ndodhet një ekspozim që përkujton partizanet e reja, Bule Naipi dhe Persefoni Kokëdhima të cilat u ekzekutuan. Aty janë rrobat e vajzave dhe litari që pretendohet të jetë përdorur për varjen e tyre nga nazistët në vitin 1944. Në fund të korridorit, përmes kangjellave të çelika të mbyllura në të djathtë, mund të shihen pjesa tjetër e burgut dhe qelitë e ndëshkimit.



Koleksioni i topave të vjetër që ndodhet më tej në Kala, përmban mbetjet të armëve origjinale të kalasë osmane, shumë prej të cilave datojnë nga koha e Ali Pashës. Ky koleksion është tipik, që përfshin topa me predha nga një deri në 6 kg, shumë prej të cilëve janë armë detare të marra nga anijet.

Më tej janë mbetjet e një **avioni trajnues të Forcave Ajrore Amerikane**, një Lockheed T-33 Shooting Star dy-vendesh, i cili u detyrua të ulej në Aeroportin e Rinasit, pranë Tiranës në dhjetor të vitit 1957, pasi pati probleme teknike. Piloti iu kthye Shteteve të Bashkuara pak më vonë, por aeroplani u mbajt nga autoritetet shqiptare. Ky trofe krenar i Luftës së





Ftohtë, të cilin regjimi komunist e emërtoi si aeroplan spiun, u soll në kala në vitin 1969.

Ali Pasha ndërtoi nën **bedenat e kështjellës** një grup sterash me madhësi sa një katedrale, që furnizoheshin me ujë nga perëndimi nëpërmjet akueduktit. Skaji verior i kalasë dominohet nga **kulla e sahatit**, e cila u ngrit nga Ali Pasha. Osmanët kishin një kulturë të pasur në prodhimin e sahatëve dhe, që nga shekulli i 17th e në vazhdim ndërtuan kulla sahatësh në të gjithë perandorinë. Kulla katrore e sahatit të Gjirokastrës është shembull tipik.

Poshtë kullës së sahatit është një **fortesë e madhe me qemer**, që dikur ishte vendi i një baterie topash. Frëngjitë dominojnë mbi qytet dhe rrugën që të çon në portat kryesore të kalasë. Aty pranë, poshtë shkallëve prej guri, ndodhej një depo baruti drejtkëndor, e veçuar me kujdes nga zona përreth nëpërmjet një kalimi nën qemer. Shtegu që të çon në **portën e veriut** është i shtruar posaçërisht për vargun e kafshëve të ngarkuara, që përbënin mjetet kryesore të transportit në kohën kur u ndërtua kalaja.

Pazari

Jeta në Gjirokastrë ka qenë e përqendruar për një kohë të gjatë në kalanë mesjetare dhe një pjesë e madhe e popullatës jetonte brenda mureve të saj të forta. Në kohërat para-osmane, popullata mbështetej në tregti, ndërsa disa u shërbenin feudalëve, klanit të Zenebishëve, të cilët kontrollonin rajonin dhe e përdornin kalanë si bazën e tyre. Osmanët



konsoliduan pushtimet e tyre në rajon dhe e bënë Gjirokastrën kryeqytet të *saxhakut* (provincë) të ri shqiptar në vitin 1419. Administrata në rritje dhe garnizoni mbështetës siguruan nxitje për rritjen e qyteti jashtë mureve të kalasë. Fillimisht ai u shtri në kreshtën jashtë portës veriore të kalasë, një zonë që njihet ende si *Pazari i Vjetër*.

Në vitet 1580' qyteti kishte më shumë se 400 banesa dhe ishte bërë qendër tregtie, që i shtojte rëndësisë së saj administrative. Në shekullin e 17^{të}, guvernatori osman Memi Pasha, planifikoi dhe ndërtoi një qendër të re tregtare për Gjirokastrën përgjatë shpatit perëndimor të kodrës, *Pazarin e Ri*, (më tej të përmendet thjesht si Pazarit). Ai shtrihet nga një pikë lidhjeje qendrore, e ashtu-quajtura "Qafa e Pazarit" në pikëtakimin e pesë rrugëve, të cilat e lidhin atë me lagjet e banuara në të gjitha drejtimet dhe përfshinte një xhami të ndërtuar veçanërisht për t'i shërbyer zejtarëve të pazarit. "Qafa" është akoma qendra e qytetit historik.



Kur njerëzit nga zonat rurale përreth vinin në Gjirokastër për tregti, pazar ose për çështje administrative, ata kishin *hanin* e tyre të veçantë ku qëndronin. Hani Zagoria në rrugën Hazmurat është shembulli i fundit që ka mbetur nga këto hane. Fshatarët vinin përmes përroskës dhe e linin gjënë e gjallë në han. Qendër e tregtimit të gjësë së gjallë, pazari ishte plot me prodhues dhe shitës të vegjël zejtarë – farkëtarë, argjendarë, lëkurëpunues, rrobaqepës,



zbukurues, këpucarë etj. Lëkurëpunuesit, shalëbërësit dhe regjisit e lëkurës ishin kryesisht myslimanë, ndërsa zejet e punimit të metalit dhe të argjendit praktikoheshin nga familje të krishtera, ashtu si dhe tregtia e gëzofit.



Pazari u shkatërrua pothuajse plotësisht nga zjarri dhe u rindërtua në vitet 1750'. Pas një zjarri tjetër shkatërrues në shekullin e 19^{te}, ai u rindërtua përsëri. Rrugët e tij, duke ruajtur akset e vjetra, u zgjeruan dhe shtëpitë që u ndërtuan në këtë periudhë janë ato që ekzistojnë edhe sot. Në periudhën e vet të lulëzimit në fillimin e shekullit të 20^{te}, pazari i Gjirokastrës kishte rreth 410 punishte dhe ishte një qendër zejtarie për gjithë Shqipërinë e jugut.

Terreni i pjerrët është arsyeja e ndërtimit të godinave në blloqe që vijnë duke zbritur. Arkitektura e tyre pothuajse uniforme dhe përdorimi i gjerë i gurëve të gdhendur vërtetojnë rindërtimin e plotë të të gjithë pazarit në një periudhë të vetme, në vitet 1850 – 1870. Përgjithësisht godinat dy-katëshe kanë një dyqan ose punishte poshtë dhe hapësirë për magazinim sipër.

Nuk është vetëm pazari që karakterizohet nga një arkitekturë homogjene, por i njëjti stil mbizotëron edhe në ndërtimin e shtëpive të banuara të Gjirokastrës në atë periudhë. Kjo e integron mirë pazarin në pamjen e përgjithshme të qytetit. Pazari i Gjirokastrës është një rast i rrallë në të gjithë Ballkanin i një ansambli godinash origjinale, që nga gjysma e dytë e shekullit të 19^{te}, që e kanë ruajtur funksionin e tyre fillestar deri më sot.



Pazari ka disa trotuare me kalldrëm me kompozime të jashtëzakonshme. Shumica e rrugëve me kalldrëm në Gjirokastrë janë shtuar me një përzierje shistesh argjilore të zezë dhe gurësh gëlqerorë rozë dhe të bardhë (ato rozë



“ngjyrosen” për shkak të procesit të oksidimit të hekurit). Pasi pësoi shkatërrime të mëdha gjatë Luftës II Botërore, qyteti u rindërtua në periudhën komuniste. Njëqind mjeshtra u punësuan në mënyrë të vazhdueshme nga shteti për të vazhduar punimet restauruese dhe të

mirëmbajtjes me qëllim ruajtjen e ndërtesave historike.

Gjatë periudhës së trazirave civile në vitet 1997-1998 pazari pësoi përsëri dëme të mëdha dhe u bë i shkretë. Sot shumë prej dyqaneve të tij mbeten ende të zbrazët; megjithatë, me futjen e Gjirokastrës në Listën e Trashëgimisë Botërore në vitin 2005 dhe me rritjen pasuese të turizmit, filloi një proces i ngadaltë, por i qëndrueshëm rigjallërimi, i cili mori një dinamikë të re përmes krijimit të një dyqani artizanal në vitin 2007. Që nga ajo kohë, janë hapur disa punishte dhe galeri dhe në Pazar është rikthyer gjallëria.

Kënga polifonike

Gjirokastra është një nga qendrat më të njohura të këngës polifonike. Deri njëzet vjet më parë, kjo traditë e vjetër e lidhur thellë me identitetin kombëtar shqiptar në Shqipërinë e jugut, ishte pjesë e jetës së përditshme në shumë kafene të pazarit dhe në më shumë se 600 shtëpi familjesh të qytetit.

Kënduar kryesisht nga këngëtarë meshkuj, muzika shoqëron tradicionalisht një gamë të gjerë ngjarjesh shoqërore, si dasma, funerale, gosti për të korrurat dhe festa fetare. Ajo është paraqitur gjithmonë në Festivalin e famshëm Folklorik të Gjirokastrës, ngjarja kulturore sistematike më e madhe e kombit, që organizohet si një konkurs kombëtar nga niveli lokal deri në nivel kombëtar.



Ndërtimet fetare

Ashtu si e gjithë Shqipëria, Gjirokastra ka qenë fillimisht e krishterë dhe thuhet se Kisha e Kryqit në Labovë që ndodhet pranë saj është themeluar nga Perandori Justinian që në fillim të shekullit të 6^{te}. Në vitin 1515, pas pothuajse 100 vjet sundim osman, kishte akoma 12,257 familje të krishtera në rrethin e Gjirokastrës, krahasuar me thjesht 53 shtëpi myslimane. Shumë familje shqiptare u kthyen në myslimanë për të shmangur rekrutimin e djemve nga Perandoria.

Shqipëria është sot qendra botërore për traditat Sufi të Islamit, të cilat në Shqipërinë e sotme quhen në mënyrë kolektive “Bektashizëm”, ndonëse bektashinjtë janë vetëm një nga katër urdhrat e dervishëve në vend, krahas urdhrave Halveti, Rifa'i dhe Sa'di. Të katra këto kanë qenë të pranishme në Gjirokastër.

Përhapja e Sufizmit në Shqipëri filloi nga Gjirokastra dhe është veçanërisht e pranishme në jug të vendit. Më pas Sufitë lëvizën në mënyrë kolektive për në Shqipëri, fillimisht kur trupat jeniçere u shpërbënë nga Sulltan Mahmudi II në 1826 dhe më pas, kur Turqia u bë një shtet laik dhe urdhrat e dervishëve u ndaluan nga Ataturku. Përllogaritet se një e treta e myslimanëve shqiptarë sot janë ndjekës të “Bektashizmit”, veçanërisht intelijenca dhe shumë nga liderët e tij ishin në krye të lëvizjes kombëtare shqiptare, në fundin e viteve 1800' dhe në fillimin e viteve 1900'.



Jeta fetare në Shqipëri u kufizua më pas ndalua pasi komunistët morën pushtetin në vitin 1944. Mijëra priftërinj dhe murgësia, imamë dhe baballarë humbën jetën

ose iu desh të largohen nga vendi. Të gjitha ndërtesat fetare u mbyllën, në rastet kur nuk u shkatërruan kur, në vitin 1967 Shqipëria deklaroi formalisht se ishte vend ateist. Aktivitetet fetare u lejuan përsëri pas rënies së komunizmit dhe sot në Shqipëri njihen zyrtarisht katër besime: Krishterimi katolik dhe ortodoks, Islami (Suni) dhe Bektashizmi.

Kisha e Shën Sotirës

Shën Sotira ndodhet në skajin më verior të kalasë, në Lagjen Pazari i Vjetër. U ndërtua në vitin 1784 dhe ka një projektim tipik ortodoks – me formë drejtkëndëshe dhe orientim sipas boshtit lindje-perëndim. Kisha quhet gjithashtu Mitropolia e Vjetër, pasi dikur ishte selia e peshkopit ortodoks lokal.



Shën Sotira është një kishë e llojit bazilikë me tre nefet. Hapësira e brendshme përbëhet nga narteksi, ekzonarteksi dhe altari. Nefi kryesor i gjerë dhe dy nefet anësore më të ngushta mbulohen nga harqe cilindrike. Në pjesën e altarit, ka tre absida. Më vonë në hyrjen e kishës u shtua kambanorja.

Kupola e tavanit të Shën Sotirës ka një ikonë të Krishtit Gjithëkrijues, Krishtit gjithësundues, që nga qielli sheh poshtë besimtarët e grumbulluar, duke dëgjuar lutjet e tyre dhe duke u kujtuar atyre për praninë e tij të kudondodhur.

Menjëherë sapo futesh në kishë në të djathtë është *metamorfoza*, një pupitër e gdhendur me dorë që mban dy ikona që simbolizojnë transformimin hyjnor të Krishtit.

Ikonostasi i gdhendur me zbulurime daton që nga fundi i shekullit të 18^{te}. Të gjitha ikonat e vogla përgjatë rreshtit të sipërm janë origjinale, ashtu si edhe dy ikona në secilën anë të derës qendrore ose mbretërore në rreshtin e poshtëm. Të gjitha ikonat e tjera përgjatë brezit të poshtëm janë kopje, ashtu si dhe kryqi në pjesën e sipërme në qendër të ikonostasis, origjinalët u zhduken gjatë viteve komuniste.

Pjesa e brendshme i kishës u dëmtua rëndë gjatë komunizmit dhe pikturat origjinale në mure u shkatërruan. Tashmë muret mbulohen nga ikona të vëna në kornizë, shumë prej të cilave të pikturuar kohët e fundit nga artistë vendas. Disa objekte që varen nga shufra çeliku, të quajtura *temjanica*, u shpëtuan nga kisha të tjera gjatë periudhës së shkatërrimit komunist.

Xhamia e Pazarit

Xhamia e pazarit është e vetmja xhami që ka mbetur nga 15 xhamitë në Gjirokastrë. Asnjë nuk e di saktësisht përse kjo xhami u kursye. Pas vitit 1967, ndërtesa, me tavanin e vet të lartë në formë kupole, u përdor si cirk për akrobatët. Me fundin e regjimit komunist, xhamia është rikonstruktuar.

Xhamia ishte pjesë e planit fillestar të Memi Pashës në shekullin e 17^{te} për Pazarin. Ajo u shkatërrua nga një zjarr në shekullin e 18^{te}, dhe u rindërtua



rreth viteve 1754-1755, së bashku me pjesën tjetër të pazarit. Xhamia u projektua qëllimisht që të shtrihet deri tek balli i rrugës, duke krijuar një paradë të vogël dyqanesh të mbyllura, të cilat u dhanë me qira për të siguruar fonde për mirëmbajtjen e xhamisë. Deri edhe sot, komuniteti mysliman është pronari më i madh i ndërtesave në pazar.

Në anën perëndimore të ndërtesës në nivel të rrugës është një **mjedis i vogël tetëkëndor**, që përdoret për larjen rituale përpara se besimtarët të falen brenda xhamisë. Dyert kryesore të xhamisë kanë mbishkrime

të gdhendura në arabisht: ai në të djathtë i bën lutje *Allahut*; ai në të majtë Profetit Muhamed, themeluesit të Islamit. Dhomat nga brenda kanë dekorim dhe mobilim të thjeshtë, siç ka ndodhur gjithmonë me xhamitë e Gjirokastrës.

Në këndin në të djathtë të hyrjes kryesore është hyrja për në **kullën e minares**. Ka 99 shkallë për të arritur majën, ku secila simbolizon emrat e Zotit, siç jepen në Kuran. Minarja u ndërtua me gurë, që kishin secili një kanal në qendër. Sapo vendoseshin në vend dhe kanalet viheshin në një vijë, në to derdhej plumb i shkrirë që i mbante gurët të lidhur dhe konsolidonte blloqet.

Ka disa rrënoja të xhamive të vogla në pjesë të tjera të qytetit. Në krahasim me xhamitë në qytetet e tjera shqiptare, ato të Gjirokastrës nuk kanë karakteristika të veçanta. Ajo që i dallon xhamitë e Gjirokastrës janë dekorimi i vogla, si dhe dekorimi i varfër, veçanërisht në pjesën e jashtme. Xhamitë e Gjirokastrës janë përgjithësisht njëngjyreshe. Ashtu si dhe pazari, ato shkrihen plotësisht me arkitekturën e qytetit, nga i cili kanë marrë shumë elemente, si në pamjen e jashtme, ashtu edhe në detajet arkitektonike.

Xhamia në Meçite, Shtatë Krojet dhe Hamami

Kompleksi i xhamisë, hamamit dhe shtatë krojet në fund të një përroske, të njohura së bashku si “Shtatë Krojet”, ka qenë qendra sociale e një lagjeje të quajtur Meçite dhe një nga hapësirat e pakta publike të hapura të Gjirokastrës. Krojet u ndërtuan në themelet e xhamisë Meçite të shekullit XVII. Rrënojat e kullës së minares ndodhen menjëherë në të djathtë të

krojeve. Xhamia, e njohur për çatinë e saj me dekorim të fisëm, dikur arrihej nëpërmjet shkallëve të ndërtuara mbi kroje. Ajo u shkatërrua në vitin 1967, gjatë fushatës antifetare dhe që atëherë, ndërtesa e ka humbur funksionin e saj social.



Burimet ujore në këtë vend janë gjë e veçantë për Gjirokastrën dhe mund të ketë qenë arsyeja fillestare, që është zgjedhur ky vend për të ndërtuar një kult fetar. **Krojet** vazhdojnë të ekzistojnë dhe në ballinën e kroit qendror është gdhendur një mbishkrim i bukur osman:



*“Është ndërtuar me një krua që të jetë sa më i përdorshëm.
Duke nisur që nga themeli, të ketë lutje sa më shumë
Xhamia do të jetë e famshme, po ashtu edhe themeluesi i saj.
Ai që ndërtoi kroit do të jetë i lumturuar
Nga të gjithë besimtarët, ndaj këtij kroi dhe ndërtuesit të tij.
Meqenëse Muin Arslan¹ është naib² dhe zotërues i botës.
Sot radha ime, nesër jotja, (edhe) profetët kanë ndërtuar jetë.
Me dashmirësi, me sinqeritet të pastër, jepuni lutjen e vërtetë të gjithëve”.*

Hamami (Banja turke) është i vetmi ndërtim i këtij lloji në Gjirokastrë. Ai ishte në përdorim që kur Evlia Çelebi e vizitoi qytetin në vitin 1672 dhe është një nga hamamet e pakta që kanë shpëtuar në Shqipëri. Hamami i Meçites u ndërtuan në dy faza. Në fazën e parë, u ndërtuan tre dhoma, dy për banjë me vaskë dhe një për banjë me avull. Më pas, u shtua një dhomë veshjeje.

¹ Ky duhet të jetë emri i themeluesit.

² Naib është një “gykatës zëvendësues” (Tr. Ott.)



Teqeja

Datuar në shekullin e 17^{te} ose më përpara, **Teqeja e Kodrës së Shtufit**, në anën e kundërt të qytetit, ishte qendër tjetër kryesore e Urdhrit Sufi të Bektashinjve. Mund të shihen aty rrënojat e shtatë *tyrbeve*. *Tyrbja* kryesore, në majë fare të kodrës, përmban varret e tre dervishëve të rëndësishëm.



Kompleksi i madh i **Teqesë së Zallit**, që ndodhet midis Gjirokastrës dhe Lazaratit, u themelua në vitin 1780 nga Asim Baba, një njeri i shenjtë, i cili thuhet se e kishte prejardhjen nga shtëpia e Profetit. Që nga këtu Bektashizmi u shpërnda nëpër Shqipëri. Teqja e Zallit ka qenë teqja më e rëndësishme e Gjirokastrës dhe kishte rëndësi të veçantë në shekullin e 19^{te}. Porta e saj ka anash *tyrbe* me çati konike dhe ajo kishte një bibliotekë të pasur, e cila u shkatërrua nga komunistët në vitin 1944. Një nga dervishët e teqes ishte Baba Rexhepi, i cili u largua nga Shqipëria për shkak të komunistëve dhe themeloi teqen e parë bektashiane në Shtetet e Bashkuara.




Baba Hasan Dede themeloi një teqe të Urdhrit Rifa'i në Gjirokastrë. Sipas Evlia Çelebi varri i tij ka qenë një nga vendet më të shquara të pelegrinazhit në Gjirokastrë.

Ka gjithashtu referenca për praninë e Urdhrit të Sa'di në Gjirokastrë, me të cilin duket se ka pasur lidhje Ali Pashë Tepelena.

Lagjet e banimit



Topografia ekstreme e Gjirokastrës ka bërë që lagjet e banuara të mbeten pak a shumë si njësi të veçuara, por jo aq sa të thyejnë pamjen unike të qytetit. Lagjet Pazar i Vjetër, Pllakë dhe Hazmurat, të ndërtuara në dy kreshta thujse paralele, përbëjnë ansamblin më karakteristik dhe më piktoresk të shtëpive në Gjirokastrë. Ajo që i bën këto lagje të shquhen është kompaktësia, përshtatja e suksesshme me relievin dhe larmia e pamjeve.



Banesat e mëdha të Lagjeve Palorto dhe Manalat, të ndërtuara në shpate kodrinore të pjerrëta, kanë kompozim të ndryshëm, që nxjerr në pah vëllimin si bllok të ndërtimeve. Ansamblet e të dyja pjesëve të Lagjes





Dunavat, të lidhura me mjeshtëri me terrenin, kanë kompozicion më të lirë dhe ndërtesat e tyre janë më të personalizuar, duke e bërë të gjithë kuadrin më piktoresk. Lagja Cfaqë të jep një përshtypje më të hapur dhe më rurale.

Është e pamundur të përfshihet Gjirokastra në një vështrim; këtu qyteti fshihet dhe më tej zbulohen ndërtesat e tij madhështore. Një nga sekretet e qytetit është që shumë prej ndërtesave më madhështore, mund të shihen vetëm nga kodra përballë. Kur u shkon afër ose u qëndron tek porta, është thujse e pamundur t'i zbulosh, të fshehura prapa mureve të larta dhe kopshteve të rregulluara me merak.

Shtëpia gjirokastrite



Historia e Zhvillimit

Lavdia e madhe e Gjirokastrës janë shtëpitë e fortifikuara, të njohura me emrin *kullë* (fjalë turke), shenjë e mirëqenies dhe e statusit të saj rajonal që nga shekulli i 17^e deri në pavarësinë kombëtare. Statusi i Gjirokastrës nën Perandorinë Osmane si një qendër administrative lejoi ndërtimin e shtëpive *kulla*, si dhe përgatitjen e brezave të zejtarëve të aftë për të kryer punimet. Ka rreth 600 ndërtesa të tilla në të gjitha lagjet historike të qytetit.

Karakteristikat e Përgjithshme

Shtëpitë e mëdha i japin tonin qytetit; ato janë elementi kryesor i kompozimit dhe arritja arkitekturore më e shquar e tij. Me një numër relativisht të madh variantesh, banesa gjirokastrite përbërën një lloj të veçantë në banesat qytetare shqiptare. Ajo ka karakteristika të veçanta në kompozim, planimetri dhe vëllime, si edhe elemente të veçanta strukturore:

1. Shtëpia gjirokastrite është projektuar në lidhje me lartësinë e saj dhe versionet e ndryshme të saj bazohen në numrat e ndryshëm të kateve.
2. Shtëpia gjirokastrite karakterizohet nga funksionet e saj mbrojtëse, të cilat shfaqen në sipërfaqen e vogël të katit përdhës në raport me lartësinë, frëngjitë dhe dritaret e vogla në katet e poshtme.
3. Ka një marrëdhënie organike të shtëpive me terrenin shkëmbor. Vendndodhja në shpatet e pjerrëta lejonte rritjen e sipërfaqes së shtëpive, duke shtuar dy kate më shumë në krahasim me shtëpitë osmane tradicionale, të cilat kishin dy kate.

Mënyra shqiptare e jetesës në atë kohë ka luajtur gjithashtu rolin e vet në këtë arkitekturë: nevoja për të treguar fuqi dhe pasuri ose strukturat mbrojtëse për fiset që në mënyrë të pashmangshme luftonin me njëri tjetrin, nevoja për të ndërtuar struktura të sigurta për të strehuar bagëtitë në dimër dhe për të depozituar ujë në muajt e gjatë të thatë të verës, si dhe nevoja për hapësira që pasqyronin kulturën e popullit të Gjirokastrës, mikpritjen e madje mirëqenien në një tokë shpesh të ashpër. Pothuajse të gjitha shtëpitë kanë stera të mëdha uji, pasi Gjirokastra nuk ka ujëra sipërfaqësore, me përjashtim të pak burimeve që thahen gjatë verës.

Natyre mbrojtëse, një nga karakteristikat më të rëndësishme të shtëpisë gjirokastrite, gjithsesi ka ndryshuar me kalimin e kohës. Ky tipar ishte në rritje e sipër deri në fund të periudhës së lulëzimit të shtëpisë gjirokastrite dhe më pas filloi të bjerë dhe të zhduket plotësisht në fund të shekullit të 19^ë. Karakteristika të dukshme që lidheshin me sigurinë ishin muret me gurë të rëndë, dritaret e vogla me kangjella në katet e poshtme dhe frëngjitë për armët e zjarrit. Krahas funksioneve mbrojtëse, disa nga karakteristikat kanë më shumë karakteristik, pasi kodrina e pjerrët nga ana e pasme i bënte ndërtesat të cenushme prej sulmeve nga lart.

Ndërtimi

Ndërtimi i shtëpisë gjirokastrite ka dy pjesë të veçanta: katet e poshtme me gurë të rëndë, cilësi që i ka rrënjët në shtëpitë rurale shqiptare - kullat, katet e fundit, ndërtuar me dru dhe të suvatuara ndiqnin kulturën urbane osmane, si në inxhinieri ashtu edhe në projektim. Gjithsesi, elementi osman tipik i ndarjes funksionale sipas gjinisë, në pjesën për burra dhe atë të ndarë për gra nuk është i pranishëm në shtëpinë gjirokastrite.

Muret me gurë, deri në një metër të trashë në bazë, janë të lidhur me llaç gëlqereje dhe me breza druri për t'i dhënë ndërtimit fleksibilitet në rast tërmeti. Në shumë shtëpi bien në sy harqet e larta (*qemerët*), ndonjëherë

me kolona, të cilat kanë funksion të dyfishtë, estetik dhe për t'i dhënë shtëpisë qëndrueshmëri. Zakonisht mbi *qemer* kishte një hapësirë të hapur me çati ose tarracë (*kamerie*), që lidhte dhomat e tjera dhe siguronte hapësirë për të pushuar në ajër të pastër.

Kati i fundit, i cili duhet të ishte i freskët për t'u përdorur në muajt e verës, ndërtohej me skelet druri me mure prej listelash druri të mbuluara me suva të veçantë të prodhuar me gëlqere të vjetruar, lesh dhie, të bardhë veze dhe rërë të imët, të përziera me kashtë.



Çatitë dhe Oxhaqet

Çatia prej guri gëlqeror gri me oxhaqet e veta karakteristike është veçori përcaktuese e shtëpisë gjirokastrite dhe përbën elementin thelbësor të peizazhit urban të qytetit. Kjo lloj çatie është e pranishme kudo në rajonin historik të Epirit, por jo në pjesën tjetër të Shqipërisë dhe Greqisë, ku mund të gjendet vetëm në fshatra të veçanta. Prandaj mund të supozohet që ajo është një element autokton i arkitekturës së Gjirokastrës, që daton përpara ndikimit osman.

Për ndërtimin e kapriatës, që është në vetvete një strukturë shumë komplekse, përdorej lëndë lisi e fortë vendase, e cila mund të mbante peshën e madhe të pllakave të gurta. Guri gëlqeror për çatinë merrej nga malet aty pranë dhe ndahet me mjeshtëri në pllaka vetëm pak cm të trasha – sa më e hollë të ishte pllaka, aq më e madhe ishte mjeshtëria. Duhet mjeshtëri e veçantë për t'i vendosur pllakat mbi konstruksionin e kapriatës në mënyrë që të krijohen çati të papërshkueshme nga uji. Nuk përdoret llaç; vetë pesha e pllakave i mban ato në vend. Gjithsesi, çatia ka nevojë për mbikëqyrje të vazhdueshme. Veçanërisht përpara dhe pas stuhive dhe shirave të rrebeshta të dimrit, ato duhet të vendosen në vendin e duhur, në mënyrë që të pengojnë ujin të hyjë në binarët e drunjtë që mbajnë çatinë.

Pasuria e pronarit të shtëpisë mund të dallohej nga numri i oxhaqeve në çatinë e saj. Meqenëse çdo vatër zjarri në shtëpi kishte oxhakun e vet, numri i oxhaqeve tregonte numrin e dhomave me ngrohje. Disa shtëpi të pasura thuhet se kanë pasur deri në dhjetë oxhaqe, duke kontribuar në peizazhin madhështor të çatave të Gjirokastrës.

Për të penguar ujin që të rridhte poshtë në mure, çatitë duhet të ishin më të dala përtej tyre, gjë që përsëri



kërkonte mbështetje me trarë druri nga jashtë, të përshtatshëm për të mbajtur peshën masive. Të gjitha këto elemente, pllakat, oxhaku dhe trarët mbajtës, të ndërtuara sipas kërkesave të mjedisit natyror, çojnë në krijimin e një pamje tipike, harmonike dhe shumë estetike të çatisë gjirokastrite.

Oborret dhe kopshtet



Pothuajse çdo shtëpi gjirokastrite rrethohet nga një ose më shumë oborre dhe kopshte, të mbrojtura nga porta të mëdha e mure të larta, të cilat ua shtojnë shtëpive natyrën madhështore. Harku mbi derë zakonisht përmbante një relief të vogël në turqishte osmane, që tregonte vitin e ndërtimit sipas kalendarit mysliman,

ndonjëherë të rrethuar nga punime të tjera artistike. Këto hapësira të hapura sigurojnë një farë distance të shtëpive nga njëra-tjetra dhe lejojnë shpesh të mëvonshme në ndërtesa, sipas ndryshimit të nevojave të banorëve. Kopshtet siguronin zarzavate dhe fruta për konsum të përditshëm, ashtu siç bëjnë edhe sot. Në kohët e vështira të sundimit komunist, kur prona private mbi mjetet prodhuese ishte e ndaluar, izolimi i kopshteve urbane shpesh lejonte mbajtjen sekrete të pulave, madje edhe të ndonjë deleje ose dhie.

Kopshtet urbane janë një karakteristikë e rëndësishme, por që përgjithësisht e shpërfillohet e strukturës urbane të Gjirokastrës, sa i përket projektimit dhe


ekonomisë së saj. Kopshtet urbane janë një tipar i rrallë në qytetet europiane, prania e tyre në Gjirokastrë përbën një aspekt tjetër të veçantisë së këtij qyteti.






Variacionet

Shtëpia gjirokastrite shfaqet në tre variante, të përcaktuara sipas kriterit të kompozicionit planimetrik dhe vëllimor: varianti pingul, varianti me një krah dhe varianti me dy krahe. Ka gjithashtu zgjidhje të veçanta, ndonëse jo të përfshira në njërin prej këtyre varianteve, por që ruajnë sidoqoftë karakteristikat e shtëpisë gjirokastrite.




Varianti pingul është më i thjeshti dhe, në të njëjtën kohë, baza e zhvillimit të mëpasëm të shtëpisë gjirokastrite. Për sa i përket kompozimit, ai përfaqëson një bllok në formë prizmi, me bazë drejtkëndore, me dy ose tre kate. Dy katet e para lidhen nëpërmjet shkallëve të jashtme. Shtëpia shquhet për natyrën e saj të mbyllur dhe i ngjan deri diku *kullës* shqiptare të veriut. Kompozimi i thjeshtë dhe kompakt, përshtatur në mënyrë karakteristike me relievin, si dhe lartësia e bëjnë këtë shtëpi të përshtatshme veçanërisht për qëllime mbrojtjeje. Midis shembujve të paktë të varianteve pingule të mbetura, vlen të përmenden shtëpitë Dhrami, Stavri, Roqi dhe Çeribashi.




Varianti me një krah përbën llojin më të shpeshtë të shtëpisë gjirokastrite. Ai është zotëruar mirë nga ndërtuesit, të cilët, duke ruajtur parimet kryesore të kompozimit, kanë shtuar në shumë raste elemente krijuese. Shembuj të shquar të këtij varianti janë shtëpitë Kikino (1825), Beqiri (1827), Resaj (1831), Toro dhe Çene, ndërsa shtëpia Çabej përfaqëson një përjashtim për shkak të shtesës së saj të mëvonshme.



Varianti me dy krahë, ndoshta më karakteristiku i shtëpisë gjirokastrite, është më i larti. Si në variantin me një krah, ashtu edhe atë me dy krahë, shtëpitë gjirokastrite duken më të fisme dhe më të plota. Të dhënat tregojnë se formimi i tyre daton në fillimin e shekullit të 18^{ie}, madje edhe më herët. Disa nga shembujt më të fisëm të variantit me dy-krahë janë shtëpitë Zekate (1812), Skëndulate (1823), Belaj, Babaramo (fundit i shekullit të 18^{ie}) dhe Cico (1821). Shtëpitë Angonate (1881), Babameto (1885/1887) dhe, deri diku, shtëpia Fico (1908), e cila përfaqëson zhvillime të vonshme të këtij varianti, kur ky i humbi tiparet e veta mbrojtëse.





Periodha gjatë viteve 1810-1830 mund të konsiderohet periudha klasike e shtëpisë gjirokastrite. Gjatë asaj kohe u ngritën shumë ndërtesa të mëdha me vlera të shquara arkitekturore, që shfaqin më qartë karakteristikat thelbësore të tyre.

Shtëpia gjirokastrite shquhet për lartësinë (orientim vertikal). Dhomat lidhen përmes korridoreve dhe shpesh me njëra-tjetrën. Kompozimi është shumë i lirë. Por ai që i jep diversitet dhe lartësi planimetrisë dhe volumit të shtëpisë gjirokastrite është gjysmë-kati (mezanin) midis katit përdhes dhe atij të sipërm. Që nga formimi i variantit pingul me tre kate, shtëpia gjirokastrite krijoi një diferencim funksional midis kateve, që mbeti një nga tiparet e rëndësishme të saj deri në vitet 1880. Humbja e kësaj karakteristike lidhet me përdorimin e katit përdhes si hapësirë për të jetuar, që kur u zhdukën nevojat për mbrojtje, mbajtjen e kafshëve dhe depozitimi i sasive të mëdha të produkteve bujqësore për dimër.

Pjesa e brendshme

Pjesa e palëvizshme e mobilimit, si platformat e ngritura prej druri (*dhipato*), raftet dhe sëndukët (*musandrat*) e inkorporuara, të lidhur në mënyrë organike me ndërtimin, përbëjnë një tipar të rëndësishëm të shtëpisë gjirokastrite, ashtu si dhe të shtëpive shqiptare në përgjithësi. Kjo zgjidhje krijon hapësira në dhoma. Krahas divaneve të ulëta, asgjë nuk



ndërhyn në vëllimin e dhomave. Kamare të vogla të zbukuruar në mure luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm.

Në shtëpitë me një ose me dy krahë, të cilat kanë shkallë të brendshme dhe sheshpushime në katet e sipërme, u krijuan hapësira të reja të quajtura *divane*, të cilat lidhnin krahët e shtëpive dhe dhomat e veçanta. *Divani* në katin e fundit ishte zakonisht një ballkon mjaft i madh, i ndërtuar i gjithi prej druri dhe me dekorime me gdhendje në mure, dyer dhe shtylla që mbështesin çatinë.



Ndryshe nga pjesa e brendshme, e cila është menduar me kujdes nga ana arkitekturore, pjesa e jashtme e shtëpisë gjirokastrite është më pak e përpunuar. Për shkak të orientimit, është bërë kujdes vetëm me fasadën dhe në disa raste janë dekoruar gjithashtu edhe muret anësore. Jashtë ka





pak detaje arkitekture; shpesh përzihen bashkë elemente të veçanta. Por në disa shtjellime më të zhvilluar, muret e jashtme dhe, në disa raste, muret anësore të dhomave janë dekoruar me piktura murale. Në përgjithësi, muri i jashtëm i odës dekorohet me vizatime të stilit barok dhe muret anësore paraqesin dy luanë të ulur përballë njëri-tjetrit, një homazh ndaj kulturës veneciane.

Dekorimi

Punimet në dru të gdhendur, të pikturuara dhe praruar ishin traditë e përhapur në Perandorinë Osmane. Afresket e pikturuara në muret e dhomës kryesore të pritjes ishin një përshtatje lokale e kësaj tradite. Në shekullin e 18^{të} u fut një stil dekorativ i njohur si “Periudha e Tulipanëve”, i cili theksonte skenat me lule dhe kurora të ndërlikuara. Ky stil u zhvillua në një stil më pompoz në fillimin e shekullit të 19^{të}, ndonjëherë i quajtur Rokoko Osmane. Tematika kryesore përbëhej nga lulet, frutat dhe bimë të tjera. Shumë prej tyre janë simbolike, si shëgjët për shëndet të mirë dhe duajt e grurit për mirëqenie.



Shtëpia e Zekateve

Shtëpia e familjes Zeko është padyshim një nga banesat më përfaqësuese të Gjirokastrës, si për shkak të vendosjes në një pozicion të dukshëm, që e bën të shihet e plotë nga pothuajse çdo pikë në qytet, ashtu edhe sepse përmban të gjitha tiparet karakteristike të shtëpisë gjirokastrite në një formë thuajse ideale, duke e bërë atë një shembull ikonik të kësaj ndërtese.

Kjo shtëpi, veçanërisht e madhe dhe e fortifikuar, u ndërtua në vitet 1811-1812 me dy kulla binjake dhe një fasadë të madhe me harkim të dyfishtë. Dy harqet, *qemerët*, u ngritën për arsye strukturore, por tregojnë madhështinë e jashtëzakonshme të ndërtesës katër-katëshe.



Pronari dhe ndërtuesi i shtëpisë ishte Beqir Zeko, administrator i përgjithshëm i Ali Pashës, dhe shtëpia pasqyron statusin e tij brenda elitës sunduese të qytetit. Zeko banonte në shtëpi me djemtë e tij dhe me familjet e tyre.

Pasuria e familjes Zeko dhe madhështia e shtëpisë viheshin në dukje nga ky kompleks i madh me tre porta dhe dy oborre, që rrethojnë ndërtesën, si dhe një oxhak për secilën nga dhomat e shumta të saj.

Qasja fillestare në ndërtesë ishte nga një rrugë e vogël dhe e tatëpjetë, rruga Reshat Zani dhe porta, sot e dalë nga përdorimi në krye të këtij



shtegu, ishte dikur hyrja kryesore për miqtë. Porta e re e hyrjes ndodhet në skajin jugor të kompleksit. Fillimisht futesh në oborrin e një ndërtese të vogël fqinje, e cila dikur ishte shtëpia e shërbyesve (*odajashta*, “dhoma e jashtme”), ku patriarku i familjes, Ruzhdi Zeko, tashmë jeton me familjen e tij. Pasi kalon një portë të dytë futesh në oborrin e brendshëm të Shtëpisë së Zekateve.

Vetë Shtëpia e Zekateve është e pabanuar. Familja u shpronësua gjatë komunizmit dhe u detyrua të largohej nga shtëpia, e cila u bë, për njëfarë kohe, Muzeu Etnografik i Gjirokastrës. Pas rënies së komunizmit, familja Zeko u rivendos në pronën e saj, por tashmë ishte shumë e varfër për t’u kujdesur për të ose për ta bërë atë të banueshme sipas standardeve moderne. Që nga restaurimi i saj në vitin 2004, shtëpia ka qenë e hapur për vizitorët.

Dera e përparme madhështore çon në një sallon më të ulët, *nëndivani*. Kati përdhe nuk ishte i banuar, por gjithsesi ofron një vend të vogël për pritjen e vizitorëve rastësorë, të cilët nuk ftoheshin në katet e sipërme. Në të djathtë ndodhet rubineti i një sterc të madhe uji. Shtëpia me sterë mjaftueshmërisht të madhe për të ruajtur ujë në vjeshtë, pas muajve të thatë të verës, konsiderohej e pajisur mirë. Shirat e para të vjeshtës pastronin çatinë dhe më pas ulluqet i drejtonin furnizimet e freskëta në sterën poshtë. Në të majtë të derës ndodhet një qilar i madh me kupolë (*kube*) për ruajtjen dhe bluarjen e drithërave, si dhe për mbajtjen e pajisjeve bujqësore.



Shkallët që të çojnë në qendër të ndërtesës janë të shtruara me plloça gri me konture me bojë të kuqe, që mbron gërryerjen e çimentos gëlqerore të tretshme nga pastrimi i shpeshtë.


Kati i parë, në të vërtetë një mezanin, përmban *divanin* e poshtëm ose dhomën e pritjes dhe ka një pjesë të vogël të ngritur në njërin cep, ku uleshin personat e rëndësishëm. Një dhomë të veçantë në këtë nivel përdorej nga gratë për qëllime shtëpiake. E vendosur drejtpërdrejt mbi sterën e ujit, ajo ishte e freskët dhe kishte një zonë nën dysheme për ruajtjen e ushqimit. Këtu ndodheshin gjithashtu pajisjet e gatimit, si dhe një depo sekrete armësh.




Kati i dytë përmban dy dhoma kryesore (*oda*) që nisen nga *divani* qendror. Ato kishin planimetri të ngjashme dhe përdorshin nga dy degë të familjes si dhoma dimri, pasi muret e tyre prej guri bënëin që të ngroheshin më lehtësisht. Secila ka një tualet dhe banjë (*hamam*) pranë, të cilat ngroheshin nga zjarret në dhomat kryesore. Në të tre anët e dhomës janë vendosur mindere të ulëta dhe brenda në mure janë ndërtuar kamare me

ZEKATE HOUSE


0 5m




ground floor



first floor



second floor



third floor

-  storage
-  cistern
-  domestic
-  living
-  steam bath
-  WC
-  ceremonial

rafte për enë. Në njëren anë është *musandra*, një raft i madh, në të cilin ruheshin dyshekë dhe mbulesa të tjera gjatë ditës. *Musandra* fsheh disa shkallë të shkurtra që çojnë në një galeri të vogël (*dhipato*) që shikon mbi secilën dhomë. Gratë dhe fëmijët grumbulloheshin në këto galeri gjatë takimeve formale kur burrat e shtëpisë prisnin miq.

Kati i tretë përmban dhomën më të madhe të pritjes, si dhe dy dhoma më të vogla. *Divani* i katit të tretë është veçanërisht i madh me një *çardak* të gjerë, i cila ofron një vështrim spektakolar mbi qytetin dhe luginën poshtë. Kreu i familjes dhe miqtë e tij kryesorë uleshin në podiumin e ngritur për të pirë kafe dhe duhan. Dy dhomat më të vogla janë dhoma që përdoreshin në verë dhe që ndiqnin modelin e dhomave në katin e mëposhtëm. Në pjesën e pasme të katit të tretë dhe të katërt ka ambiente për kuzhinën, të cilat përdoren përkatësisht në dimër dhe në verë.



Dhoma kryesore në këtë kat ishte menduar të ishte një dhomë pritjeje për shumë qëllime. Është e madhe dhe e dekoruar me kujdes dhe përdorej për rastet më të rëndësishme sociale si dasmat. Projektimi dhe dekorimi i shtëpisë mendohet të jetë punë e mjeshtrit arkitekt dhe dekorues, Petro Korçari, i cili ishte një nga të preferuarit e Ali Pashës



Një galeri e përpunuar dhe *musandra* mbulon portën e hyrjes dhe tualetin pranë saj. Tavani është i gdhendur shumë hollë dhe i praruar. Dritaret, të mbuluara me xhama shumëngjyrësh, nuk lejojnë diellin e fortë të depërtojë dhe krijojnë freski.



Shtëpi të tjera

Shtëpia e Angonateve, e ndërtuar në një pozitë shumë dominuese, është shtëpia më e madhe e qytetit. Ajo u ndërtua rreth vitit 1881 për dy familje, me një përbërje simetrike të dukshme. Pranë, në pjesën e përparme ka një strukturë shtesë, e cila lidhet mirë me banesën, duke formuar një ansambël arkitekturor me vlera të shquara, që sheh mbi pjesën kryesore të Pazarit. Tashmë dhomat janë shumë më të specializuara se sa në ndërtesat e mëparshme, ku funksioni ishte shumëqëllimësh, ndonëse hapësirat kryesore të pritjes dallohen gjithsesi nga dhomat e tjera. Moria e dritareve tregon se tashmë funksioni mbrojtës merret më pak në konsideratë në projektimin bazë dhe se jeta brenda shtëpive merr tjetër rëndësi.



Shtëpia Babameto i përkiste një kompleksi më të gjerë të Urdhrit të Dervishëve Halvetinj, i cili i dha kësaj lagjeje emrin e parë: Teqe. Krahas Shtëpisë së Babametove, kompleksi përfshinte të gjithë zonën ku sot ndodhet Odeoni dhe Medreseja. Ai përfshinte edhe teqen, si dhe dy puse. Evlia Çelebi shkruante: “Rreth oborrit të Xhamisë Teqe janë qelat e Teqesë Halveti dhe, në njërën anë, janë varret e shumë shenjtorëve dhe njerëzve të shquar”. I tërë kompleksi fetar u shkatërrua gjatë periudhës komuniste; Shtëpia e Babametove është e vetmja strukturë e mbetur. Asaj iu vu emri sipas pronarit të parë të saj Baba Meto, njeriu i shenjtë që ishte kujdestari i Teqesë në kohën e tij.

Kjo ndërtesë e fisme është një banesë e dyfishtë: një nga rastet e rralla në Gjirokastër ku dy shtëpi janë bashkuar nën të njëjtën çati dhe janë ndërtuar qëllimisht kështu që në fillim. Ky projektim pasqyron ndikimin në



rritje të mënyrës së jetës së Europës Perëndimore në fund të shekullit XIX, që prirë drejt njërive familjare më të vogla dhe të ndara. Asaj gjithashtu i mungon çdo tipar mbrojtës. Ka dy mbishkrime me data të ndryshme në hyrjet kryesore. Njëra ka datën 1885 dhe tjetra 1887. Kësaj shtëpie i mungojnë terat e ujit, që është një tipar normal i shtëpisë gjirokastrite. Këtu ishte e panevojshme, pasi pusët nuk mungonin në këtë pjesë të qytetit, shtëpia kishte dy të tilla në oborr.

Shtëpia e Babaramo është një ndërtesë me vlera të rëndësishme tipologjike, të cilat i përkasin variantit me dy-krahë. Pavarësisht ndryshimeve të kryera me kalimin e kohës, nuk është e vështirë të përcaktohet ndërtimi i kësaj shtëpie në fund të shekullit XVIII.

Shtëpia e Beqirëve përfaqëson një nga arritjet më të mira të shtëpisë me një-krah. Kompozimi fillestar është ruajtur mirë, ndonëse kanë humbur shumë elemente arkitekturore origjinale. Banesa duhet të jetë ndërtuar në fillimin e shekullit XIX.



Shtëpia Dhrami, shembull i ndërtesës pingule, është një ndërtim me interes të madh tipologjik. Ashtu siç duket nga kompozimi i pazakontë i katër kateve, që kishin nga një dhomë secili, funksioni i kësaj banese ishte të ruante dhe të mbronte Lagjen "Palorto". Në një fazë më të vonshme, ambientet e katit të dytë dhe të tretë u ndanë në dy dhoma me qëllim që të krijohej hapësirë për shkallët, të cilat fillimisht ishin të jashtme.



Muzeu Etnografik i Gjirokastrës ndodhet në vendin ku dikur ishte shtëpia e fëmijërisë së Enver Hoxhës, diktatorit komunist të Shqipërisë nga viti 1944 deri në vitin 1985. Ndërtesa e muzeut u ndërtua në vitin 1966, pasi shtëpia origjinale u shkatërrua nga zjarri. Ajo është e modeluar sipas shtëpive gjirokastrite



tradicionale, duke marrë shumë nga elementet kulturore klasike. Nga viti 1966 deri në vitin 1991 ndërtesat shërbyen si Muzeu i Luftës Nacional Çlirimtare. Në vitin 1991 në këtë hapësirë u transferua Muzeu Etnografik.

Shtëpia e Ficove është me interes të veçantë; e ndërtuar në vitin 1908, ajo lejon gjurmimin e evolucionit të shtëpisë gjirokastrite deri në fillimin e shekullit të 20^{ie}, kohë pas së cilës kjo lloj shtëpie nuk u ndërtua më. Trajtimi arkitekturor i pjesës së brendshme dhe të jashtme paraqet zhvillime të reja: pjesa e brendshme është më e thjeshtë, pjesa e jashtme është më e pasur me elemente të reja. Nga përpara ka dy porta me harqe dhe kjo është e vetmja shtëpi në Gjirokastrë me ornamente druri të përpunuar të pedimenteve dhe të kornizave të dritareve.





Shtëpia e Kikinove përfaqëson një nga arritjet më të mira të shtëpisë gjirokastrite me një-krah. Ajo u ndërtua në vitin 1825 dhe është ndërtesë trekatëshe, me kompozim kompakt, rreth një bërthame kryesore bashkuese, e cila përfundon me një *çardak* në katin e fundit. *Kamerieja* është ruajtur në gjendje të mirë, dhe pikturat murale me motive me lule dhe të jetës së përditshme janë ndoshta pikturat murale më të fisme dhe më të përpunuara që mund të gjenden në Gjirokastrë sot.



Shtëpia e Resajve (1831) është një shembull tjetër i dallueshëm i shtëpisë gjirokastrite me një-krah. Banesa përputhet në mënyrë të përsosur me terrenin shkëmbor, mbi të cilin është vendosur. Për të pasur këtë përputhje, katet u ndërtuan në mënyrë të pabarabartë, duke përdorur dy, tre dhe katër blloqe ndërtimi pa prekur kompozicionin e banesës.



Shtëpia e Skëndulateve përfaqëson një nga arritjet më të dalluara të shtëpisë gjirokastrite, e ndërtuar në vitin 1823 dhe e ruajtur në gjendjen e vet fillestare. Ajo ka pasur 46 oxhaqe, që tregojnë mirëqenien e familjes Skënduli. Dhoma kryesore e miqve (*oda*) në veçanti shquhet për tavanin



e dekoruar dhe kolonat prej druri, që bashkë me shumë dekorime të tjera druri në shtëpi, i japin asaj një vlerë të papërsëritshme. Numri i madh i vrimave të përgjimit dhe i kyçeve të sofistikuara të dyerve kryesore janë dëshmi e funksionit të saj mbrojtës.

Shtëpia Stavri është një shembull tjetër i versionit origjinal të shtëpisë gjirokastrite, që shfaq një kompozim unik me një gjysmë-kat. Në katin e banuar ka dy dhoma ndenjeje dhe dy dhoma me funksione mbështetëse.

Shtëpia e Torove është një shembull shumë i rrallë i shtëpisë gjirokastrite me mbylljen e hapësirës së shkallëve brenda volumit të ndërtesës. Mbyllja e hapësirës së shkallëve krijon tre ambiente karakteristike të shtëpisë gjirokastrite.






Në **Shtëpinë e Laboviti**, të ndërtuar me stil neo-klasik, Vasil Laboviti, mjek i cili kishte studiuar në Gjermani, ftoi një komandant nazist për darkë, gjatë të cilës, e bindi të mos ekzekutonte 70 burra gjirokastritë në vitin 1944. Për këtë ai u akuzua më pas nga komunistët për bashkëpunim me armikun. Ismail Kadare e përdori këtë histori për një nga romanet e tij, “Darka e Gabuar” (2008).



Menaxhimi

Qyteti historik i Gjirokastrës mbrohet ligjërisht nga Dekreti mbi Qytetin Muze (1961, 2007), Ligji mbi Trashëgiminë Kulturore (2003) dhe statusi i saj si Sit i Trashëgimisë Botërore (2005). Ndërsa Dekreti dhe statusi i Trashëgimisë Botërore mbrojnë të gjithë zonën e qytetit historik, Ligji mbi Trashëgiminë Kulturore merr, për më tepër, në mbrojtje edhe më se 600 ndërtesa monumente kulturore të kategorisë së 1^{re} dhe të 2^{te}.



Në realitetin praktik, gjithsesi, qyteti vazhdon të ketë një sërë problemesh, disa prej të cilave për shkak të historisë së pafat të 70 viteve të fundit dhe disa për shkak të disa boshllëqeve në legjislacionin ekzistues. Si pasojë, integriteti i Qytetit Historik të Gjirokastrës është nën kërcënim akut.

Regjimi i Trashëgimisë Kulturore të UNESCO-s, i cili bazohet në rregulla komplekse të ligjit ndërkombëtar dhe të diplomacisë, nuk është shumë i njohur nga banorët dhe veçanërisht nga pronarët e shtëpive private. Përgjithësisht nuk dihet se statusi i trashëgimisë botërore mund të humbet dhe nuk ka ndonjë ide të përbashkët për koncepte të tilla si “autenticiteti” dhe “integriteti”: ndryshimet dramatike që vërehen në qytetin historik, shpesh as nuk pranohen të jenë problem. Bashkëkohorja dhe Modernia konsiderohen gjerësisht se janë më të Bukurat.

Për më tepër, anketimet tregojnë se rreth 40% e banorëve të ndërtesave historike nuk e dinë që shtëpia e tyre është monument kulture.

Pronarët e një pjese të madhe të shtëpive historike në Gjirokastrë nuk kanë dokumente për të provuar që shtëpitë ishin të tyre përpara se komunistët t’i shpronësonin dhe t’i bënin ato pronë të shtetit. Së fundi po bëhen përpjekje nga qeveria dhe nga një organizatë jo-qeveritare për regjistrimin e shtëpive.

Deri në vitin 1998, shumica e elitës intelektuale të Gjirokastrës u largua për shkak të situatës së paqëndrueshme politike dhe ekonomike; midis tyre shumë ishin pronarë të shtëpisë. Ata kanë ndërtuar mjete të reja jetese aty ku jetojnë dhe nuk kanë varësi nga shtëpitë e tyre në Gjirokastrë, por përgjithësisht as nuk i ato, si simbol të lidhjes me qytetin e lindjes.

Në kontrast me ligjin e zakonshëm të trashëgimisë në Shqipëri, ku shtëpinë e prindërve e trashëgonte djali i vogël, ligji i ri, më i drejtë, mbi trashëgiminë përcakton që trashëgimia ndahet në mënyrë të barabartë midis të gjithë fëmijëve. Kjo ka bërë që shtëpitë të kenë deri edhe 70 pronarë, të cilët duhet të bien të gjithë dakord për çdo ndryshim që i bëhet shtëpisë. Për më tepër, mbizotërojnë ide jo-realiste mbi vlerën e shtëpive, për restaurimin dhe modernizimin e të cilave nevojiten dhjetëra ose qindra mijëra euro.

Meqenëse, siç është e natyrshme, një nga trashëgimtarët mund të mos jetë dakord me restaurimin ose shitjen e shtëpisë, tregu i





shtëpive po zhvillohet shumë ngadalë dhe vetëm rreth 10-30% e shtëpive mund të jenë të banuara. Aktualisht shteti nuk ka asnjë bazë ligjore për të ndërhyrë dhe shumë nga shtëpitë, që janë plotësisht ose pothuajse të zbrazëta, janë të ekspozuara ndaj rrënitimit.



Rregullat aktuale që drejtojnë restaurimin dhe modernizimin e ndërtesave publike të mbrojtura si monumente kulture, së bashku me konfrontimet e politike pa kompromis, si dhe një mentalitet i përgjithshëm jo-bashkëpunues, e bëjnë jashtëzakonisht të vështirë marrjen e lejes për modernizimin e ndërtesave historike. Si pasojë, shumë banorëve u duhet të jetojnë në kushte të papranueshme. Në këtë gjendje të vështirë, ata veprojnë duke bërë restaurime sipas vendimit të tyre dhe, si pasojë e mungesës së ekspertizës, vlerat historike po humbasin çdo ditë.



Së fundi, mungojnë dekrete dhe udhëzues të detajuar, të cilët janë thelbësorë për zbatimin e ligjeve ekzistuese; edhe përgjegjësitë nuk janë gjithmonë të qarta. Në mungesë të dokumenteve për politikën strategjike kyçe, si një plan tërësor menaxhimi dhe zhvillimi, një plan zhvillimi të turizmit dhe udhëzuesit për projektimin e ndërtesave, sinjalistikës dhe hapësirave publike, ekspertët përgjegjës kanë pak dokumente të sakta ligjore, në bazë të të cilave mund të marrin vendime transparente dhe të verifikueshme. Për më



tepër, ka shumë pak përvojë në Shqipëri në rijetëzimin dhe modernizimin e ndërtesave historike ose në mbrojtjen e ansambleve urbane dhe të hapësirave publike.

Si pasojë, ka një modernizim të ngadaltë dhe të pakontrolluar të banesave dhe të infrastrukturës publike, që kërcënon shkatërrimin e karakterit osman të qytetit. Këto ndërhyrje janë të dukshme për këdo, por fatkeqësisht nuk ka ndërhyrje për t'i ndaluar

Kohët e fundit UNESCO është shqetësuar për gjendjen në Gjirokastrë. Kjo është një shenjë shprese se komuniteti ndërkombëtar, qeveria shqiptare dhe Bashkia e komuniteti lokal do mund të punojnë së bashku për të shpëtuar një nga ansamblet urbane më mbresëlënëse në Europë.




* Ky tekst ka përdorur gjerësisht burimet e mëposhtme:

Felicity Booth dhe Elenita Roshi (ed.): *Gjirokastra. The Essential Guide*. Tirana/Norwich: Gjirokastra Conservation and Development Organization 2009

Emin Riza: *Gjirokastra. Qyteti Muze*. Tiranë: Shtëpia Botuese 8 Nëntori 1978

Qyteti Muze i Gjirokastrës. Skedari i Nominimit i Trashëgimisë Botërore 569bis. <http://whc.unesco.org/en/list/569/documents/>



JANINA

Qyteti i Arsteve dhe Letrave

nga Varvara N. Papadopoulou dhe Vasilis Birbos

Hyrje

Qyteti i Janinës është kryeqendër e Rajonit të Epirit dhe një nga qendrat më të rëndësishme tregtare, kulturore dhe intelektuale në Greqinë veriperëndimore. Janina ndodhet 420 km në veriperëndim të Athinës dhe 260 km në jugperëndim të Selanikut. Qyteti shtrihet në një lartësi prej 480 metra mbi nivelin e detit, në bregun perëndimor të Liqenit Pamvotis.


Liqeni Pamvotis dhe baseni rrethues janë përvijuar nga vargmale; në pjesën veriore më dominuesi është mali Mitsikeli. Në të kaluarën, një liqen më i vogël, i njohur si Liqeni Lapsista, ndodhej në veri të basenit, por u tha në mesin e shekullit XX. Karakteristikat kryesore të qytetit janë: liqeni, një nga ekosistemet më të rëndësishme në rajon; flora dhe fauna e pasur; klima unike, e cila kombinon elementët mesdhetarë dhe ata mesatarë europianë, duke krijuar verë të nxehtë dhe të thatë dhe dimër të ftohtë e me shira.

Qyteti i Janinës është selia e Rajonit të Epirit. Në një distancë prej 6 km nga qendra e qytetit gjendet kampusi i Universitetit (një nga kampuset më moderne në Europë), ndërsa Spitali Universitar dhe Spitali i Përgjithshëm "G. Haxhikosta" u shërbejnë jo vetëm banorëve të Janinës, por edhe atyre të gjithë Greqisë veriperëndimore.





Sot, qyteti është një nga qendrat më të rëndësishme tregtare, kulturore dhe intelektuale të Greqisë veriperëndimore. Fakti se pjesa më e madhe e popullsisë urbane, e cila është afërsisht 100.000 banorë, përveç 20.000 studentëve, është e përqendruar në qytet, rezultojnë në shtrirjen e masës së popullsisë kryesisht në drejtim të jugut. Pjesa më e madhe e banorëve punojnë në sektorin terciar dhe sekondar, d.m.th. në tregti, shëndet publik, arsim, administratë publike, si dhe në sektorët e prodhimit dhe ndërtimit. Vetëm një numër i vogël merren me bujqësi, blegtori dhe industrinë e drurit.



Qyteti i Janinës është gjerësisht i njohur si qyteti i argjendarëve. Që prej periudhës bizantine, ajo ka qenë qendra më e rëndësishme greke e prodhimit dhe e shitjes së sendeve të punuara në argjend. Muzeu Arkeologjik, Muzeu Bizantin dhe Muzeu Bashkiak kanë një koleksion të pasur, që mbulon historinë e gjatë të zonës. Ato gjithashtu organizojnë evente të rëndësishme kulturore. Eventet kulturore të organizuara gjatë vitit e bëjnë Janinën një qytet plot gjallëri. Eventet si “Epirotika” që mbahet në muajt e verës, përfshijnë ekspozita, koncerte dhe shfaqje teatrale. Eventet e organizuara nga Qendra Kulturore e Bashkisë së Janinës, ekspozita tregtare “Epirus”, e mbajtur në fillim të verës dhe të tjera, tërheqin jo vetëm banorët lokalë, por gjithashtu vizitorë nga rajoni më i gjerë i Epirit.

HISTORIA

(Varvara N. Papadopoulou)

Periudha prehistorike – kohët e lashta

Gjurmët e ekzistencës njerëzore në zonë mund të datohen që nga Periudha e Paleolitit të Sipërm, sipas zbulimeve nga gërmimet në Shpellën Kastritsa, në jug të qytetit. Në zonë mund të gjendet një numër i madh vendbanimesh, që datojnë nga Koha e Bakrit të Vonë dhe Bronzit të Hershëm deri në atë romake. Kjo i është atribuar geomorfologjisë së

rajonit dhe ekzistencës së një ekosistemi të pasur, që ishte mikpritës për krijimin e ngulimeve të vogla bujqësore të përhershme. Pas shekullit V para Krishtit, zonat e banuara filluan të lulëzojnë, ndërkohë që u krijuan vendbanime të tjera të fortifikuara.

Sipas burimeve, Molosët, banonin zonën në antikitet. Sipas mitologjisë greke, Molosët ishin pasardhësit e Neoptolemeut, djalit të Akilit. Në fund të shekullit V para Krishtit ose fillimin e shekullit IV para Krishtit, u krijua Lidhja Molose, si një koalicion midis Molosëve dhe fiseve të tjera të Epirit, nën udhëheqjen e Molosëve. Selia e shtetit të tyre ishte qyteti i lashtë i Pasaronit, i ndodhur në kodrën e Megalo Gardiki, në veri të Janinës. Gërmimet e ndërmarra vitet e fundit në kodrën e Kastritsas, në jug të basenit, nxorën në dritë një tjetër qytet të rëndësishëm antik, që daton që nga koha e Pasaronit të lashtë. Është përcaktuar se ky është qyteti antik i rrethuar me mure Tekmona.

Gërmimet e fundit brenda kalasë nxorën në pah një fortifikim të lashtë, në majën e të cilit ishte ndërtuar një fortifikim bizantin. Gërmimet nxorën gjithashtu në dritë monedha, si dhe rrënojat e ndërtimeve të një qyteti të lashtë, emri i të cilit, gjithsesi, mbetet i panjohur.

Jo larg nga qyteti, në mes të një lugine të ngushtë në këmbët e Malit Olytsika (Tomarosi i lashtë), shtrihet Tempulli i famshëm i Dodonës. Sipas historianëve, Tempulli i Dodonës u themelua me të gjitha gjasat në Kohën e Bakrit të Hershëm (2600-1900 para Krishtit) dhe i kushtohej zotit grek Zeus. Megjithatë, ka të dhëna se një orakull ekzistonte më parë në të njëjtin vend. Orakulli i kushtohej perëndeshës së euforisë dhe pjellorisë, Perëndesha e Madhe, adhurimi i së cilës ishte shumë i zakonshëm në zonën e Mesdheut lindor. Perëndesha e vjetër quhej Dione; ajo dhe Zeusi ishin çifti hyjnor i tempullit të Dodonës. Simboli dhe shtëpia e tyre ishte pema e shenjtë e lisit, e cila ishte e vizatuar në monedhat e argjendta të Lidhjes Epirote që prej fundit të shekullit III para Krishtit. Pritëreshat interpretonin shushurimën e gjetheve të lisit ose fluturimin e pëllumbave për të përcaktuar vullnetin e zotave.

Pushtimi Romak i rajonit në vitin 168 para Krishtit, pavarësisht shkatërrimit të qyteteve epirote dhe skllavërimit të banorëve të tyre, nuk solli ndonjë ndryshim radikal në peizazhin e banuar dhe zbulime të ndryshme arkeologjike dëshmojnë vazhdimësinë e banimit gjatë kësaj periudhe.

Periudha Bizantine

Zona ka vetëm pak zbulime arkeologjike që lidhen me shekujt e hershëm bizantinë, ndërsa nuk ka fare për qytetin dhe kalanë. Pikëpamja që pranohej më parë se qyteti u themelua nga perandori bizantin Justinian në shekullin VI nuk pranohet sot.

Në vitin 879, emri Janina u përdor për herë të parë, megjithëse etimologjia e emrit është ende në diskutim. Në vitin 1082, Ana Komnena përmend në veprën e saj *"Aleksiada"* se *"kështjella"* ishte ndërtuar nga pushtuesi norman Bohemund Guiscard, i cili kishte pushtuar qytetin dhe kishte qëndruar për një kohë të shkurtër, në përpjekje për të pushtuar territore



nga Perandoria Bizantine. Sipas burimeve historike, qyteti ishte i rrethuar nga një fortifikim i fortë, i cili u riparua nga Bohemundi. Pas Rënies së Kostandinopojës në 1204, Mihali I Komen Duka sundoi Epirin nga 1205-1215, ku ai themeloi një shtet të decentralizuar bizantin, të mirënjohur in Despotat të Epirit, kryeqytet i të cili ishte Arta. Ai solli shumë familje fisnike bizantine (si p.sh. familjen Filantropinoi, Strategopuloi dhe Melisinoi), të cilat ishin arratisur nga Kostandinopoja pas rënies së saj. Ndërkohë, ai restauroi dhe përforcoi fortifikimet ekzistuese.

Nga fundi i shekullit XIII qyteti i Janinës u bë qendër e rëndësishme në rajon, me mure të fuqishme, kisha dhe shtëpi të mëdha. Në atë kohë, ishulli i Liqenit Pamvotis u bë një komunitet manastiri i rëndësishëm. Anëtarët e familjeve fisnike bizantine, si Filantropinoi dhe Strategopuloi themeluan manastiret e famshme kushtuar Shën Nikollës. Burime historike nga e njëjta periudhë e përshkruajnë kalanë si të pathyeshme. Në fillim të shekullit XIV, Janina fitoi pavarësinë e saj nga Arta dhe u hyri nën sundimin e Perandorit Bizantin, në përputhje me dëshirën e banorëve të saj. Si shpërblim, në 1319 dhe 1321, Perandori Androniku II Paleolog lëshoi dy *krisobula* (dekrete perandorake me vula të veçanta ari), që u jepnin banorëve një gamë të gjerë privilegjesh.



Rreth vitit 1338 rajoni u rrethua disa herë nga shqiptarët, ndërsa në 1346 Janina ra nën sundimin e serbëve, të cilët kishin pushtuar shumë territore në Greqinë Qendrore dhe Veriore. Nga 1367 deri në 1384, Thomas Preljuboviç, sundoi qytetin dhe u bë i famshëm për luftimet me shqiptarët, që ishin në konflikt me të për të dominuar zonën. Pas vdekjes së tij, drejtuesi i Janinës ishte Esau Buondelmonti nga familja fiorentine Acciaiuoli dhe më vonë, Karli I Tocco, dukë i Qefalonisë.

Periudha Pاسبizantine - Otomane

Në vitin 1430, qyteti i Janinës iu dorëzua otomanëve, pas një serie negocimesh. Sipas urdhrat të Sulltan Muratit të II, i njohur si “*Rregulli i Sinan Pashës*”, ruheshin të gjitha privilegjet e mëparshme dhe qytetarëve u sigurohej përjashtime nga taksat, tregti e lirë dhe imunitet nga burgosja, nga zënia rob dhe indoktrinimi i fëmijëve. Osmanëve nuk u lejohej të



jetonin në kala, aty ku jetonin kryesisht të krishterë dhe hebrenj. Pas pushtimit osman, qyteti u shtri kryesisht jashtë mureve të kalasë, ku u krijuan disa lagje myslimane.

Shekulli XVI u karakterizua nga një lulëzim demografik. Dy dokumente otomane, të shkruar në 1564 dhe 1579, japin informacion të

rëndësishëm rreth qytetit me një popullsi prej 7.000 banorësh. Në 1611, revolta e pasuksesshme e Dionis Filozofit, peshkop i Trikkit dhe Stagonit, çoi në shumë ndryshime në qytet, ndërsa të krishterët u dëbuan nga kalaja. Që nga ai çast dhe më tej, vetëm turqit e hebrenjtë u lejuan të vendoseshin në kala. Krishterët më të varfër u vendosën në lagjet e regjësve të lëkurëve në anë të liqenit, ndërsa ata më të pasurit në lagjet veri-perëndimore. Shumë, gjithsesi, u detyruan të emigrojnë në Europën qendrore dhe veriore.

Pas vitit 1611, lagjet e qytetit u rritën në numër dhe popullsia myslimane u shtua si rrjedhojë e islamizimit të vazhdueshëm. Pavarësisht revoltës së pasuksesshme të Dionisit, gjatë sundimit otoman, qyteti dhe zona përreth gëzuan një prosperitet ekonomik dhe kulturor në shekullin XVII dhe XVIII. Qyteti u bë një qendër e rëndësishme intelektuale falë shkollave të famshme që u themeluan me lejen e autoriteteve otomane. Shkolla Epifanios (më vonë e quajtur Shkolla Maroutsios), Shkolla e Madhe e themeluar nga tregtari Emmanouil Giouma (1677), shkolla Kaplanios dhe Shkolla Zosimea ishin midis institucioneve më të rëndësishme arsimore, ku dhanë mësim njerëz të shquar të letrave.

Që prej shekullit të XVII, Janina ishte rruga nëpërmjet së cilës kalonin në Greqi librat e publikuar në shtypshkronjat greke të Venecias. Shumë nga shtypshkronjat në pronësi të grekëve ishin themeluar nga imigrantë nga Janina, si Nikolaos Glykis, Nikolaos Sarros dhe Dimitrios Theodosiou. Qarkullimi i lirë i librave në zonë dhe funksionimi i shkollave në qytet e bënë Janinën një nga vendlindjet e Iluminizmit Grek në shekujt XVIII dhe XIX.

Ali Pasha (1788-1822)

Në 1788, Ali Pashai u emërua zyrtarisht guvernator i Janinës. Aliu u bë një personalitet politik sa i rëndësishëm aq edhe i diskutueshëm i kohës. Ai caktoi shumë grekë të famshëm në pozicione të larta dhe favorizoi tregtarët dhe artizanët lokalë.



Gjatë kësaj periudhe, Janina ishte një qendër e rëndësishme e artizanatit dhe tregtisë në Ballkan. Tregtarët dhe artizanët ishin të organizuar në shoqata (*esnafia* ose *roufetia*); ata kishin aktivitet tregtar në Principatat Danubiane, në Europën Perëndimore, Rusi dhe Egjipt. Tregtia e tyre konsistonte në mallra lëkure, pëlhura dhe artikuj argjendi. Në kohën e Ali Pashës, qyteti u bë një pikë qendrore e vëmendjes europiane nëpërmjet themelimit të konsullatave, tregtisë ndërkombëtare dhe marrëdhënieve diplomatike që ai krijoi. Vijoi një lulëzim demografik dhe qyteti u zgjerua me lagje të reja, duke vazhduar deri në vitet 1960.

Luftërat e shumta të Ali Pashës dhe qëllimi i tij për të fituar pavarësinë nga Porta e Lartë rezultuan në ndërtimin e shumë fortifikimeve në të gjithë rajonin. Në Janinë, një kala e fortë mbi rrënojat bizantine u përfundua në vitin 1815.

Në korrik 1820, Sulltani e deklaroi Ali Pashën femohues dhe në gusht qyteti u rrethua nga trupat osmane; rrethimi zgjati një vit e gjysmë. Në 1822 Ali Pasha u vra në ishullin e liqenit të Janinës. Për shkak të rrethimit,



ekonomia në lulëzim dhe jeta e banorëve u përfshinë nga trazira dhe shumë banorë duhej të kërkonin strehë në rajonet e afërme, ndërsa një pjesë e madhe e qytetit u dogj.

Gjysma e dytë e shekullit XIX – ditët e sotme

Reformat (*Tanzimat*) e Sulltan Abdul Mexhidit në 1856, të cilat kërkonin respektimin e të drejtave dhe pronës të çdo nënshetasi në territorin otoman pavarësisht fesë, nuk ishin një ndihmë e madhe për ekonominë, megjithëse ato përforcuan borgjezinë greke.

Rënia e tregtisë solli rënien e zejeve. Në 1868, me urdhër të Rashim Pashait, Vali (komandant) i Epirit, tregu iu vu zjarri, me qëllim për ta rindërtuar atë. Rashim Pasha ftoi arkitektë francezë për të hartuar dhe zbatuar planin e ri. Shumë ndërtesa u rindërtuan, tregu u zgjerua në drejtim të veriut dhe një qendër tregtare e dytë u ndërtua në drejtim të jugut, në zonën Kaloutsiani.

Gjatë Luftës së Parë Ballkanike (1912-1913) dhe si pjesë e rebelimit të përgjithshëm për çlirimin e shumë territoreve greke, forcat e armatosura greke rrethuan qytetin e Janinës. Në 21 Shkurt, 1913, guvernatori Esat Pasha firmosi dorëzimin e qytetit dhe Janina, si dhe zona përçark iu aneksua shtetit grek.

Pas çlirimit, pati një zhvillim të ngadaltë, i cili u ndërpre gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjatë së cilës një pjesë e rëndësishme e komunitetit çifut u ekzekutua në kampet gjermane të përqendrimit. Në dekadat që pasuan luftën, kishte një lulëzim spektakolar demografik dhe ekonomik. Tradita e pasur intelektuale e qytetit vazhdon sot me Universitetin e Janinës, e cila u themelua në 1964, si dhe shkolla të tjera. Qyteti organizon gjithashtu shumë aktivitete të rëndësishme kulturore lokale.

Monumentet e qytetit

(Varvara N. Papadopoulou)

Kalaja

Historia


Kalaja e Janinës është e ndërtuar në fund të pjesës juglindore të qytetit, mbi një gadishull të vogël shkëmbor që shtrihet mbi Liqenin Pamvotis. Plani i saj modern daton që nga periudha e vonë osmane (fundi i shekullit XVIII - fillimi i shekullit XIX). Megjithatë, ajo ka inkorporuar pjesë të fortifikimeve të mëparshme që datojnë nga periudha e lashtë dhe Bizantine. Gërmimet e fundit sollën në dritë rrënoja arkeologjike të lashta. Ato konfirmojnë ekzistencën e një vendbanimi me mure, që daton që nga Periudha Klasike e Vonshme dhe ajo Helenistike. Rrënojat arkitekturore nga e njëjta periudhë dalin herë pas herë në dritë brenda kalasë, në të gjithë zonën e saj. Megjithatë, deri tani, kërkimi i kryer nuk ka mundur ta identifikojë këtë vendbanim me ndonjë nga qytetet e lashta epirote që janë përmendur në burimet historike.

Kalaja vazhdoi të ishte bërthama e qytetit në kohët bizantine. Në 1082, kalaja ra në duart e normanëve dhe udhëheqësi i tyre, Bohemund përforcoi murin e fortifikimit ekzistues dhe ndërtoi një fortesë të dytë në pjesën e ngritur verilindore të kalasë. Rrënojat e kështjellës, të cilat janë ruajtur deri në ditët e sotme, përfshijnë kullën rrethore, e cila u inkorporua më vonë në Sarajin e Ali Pashait, si dhe rrënojat e kullës së dytë verilindore.



Në Periudhën e Vonë Bizantine (shekulli XIII-XV), qyteti i Janinës përjetoi një zhvillim unik dhe përbënte një qendër të rëndësishme administrative e ekonomike. Kjo i mundësoi themeluesit të “Despotatit të Epirit”, Mihali I Komneni Duka (1200-1215) të vendosë aty për të banuar disa familje të emigruara nga Kostandinopoja, si p.sh familjen Filanthropinoi dhe Strategopouloi dhe, në të njëjtën kohë, të përforcojë muret e qytetit bizantin. Ndërhyrjet në fortifikim vazhduan përgjatë shekujve XIII dhe XIV. Një pjesë e madhe e fortifikimeve është ende e ruajtur në kala, megjithëse nuk është e lehtë për t’i njohur ato.

Fortifikimi bizantin i periudhës në fjalë përbëhej nga një mur i fortë rrethues, zona e të cilit korrespondonte në pjesën më të madhe me atë të



murit që rrethon kalanë e sotme. Sipas burimeve të shkruara, muri rrethues ishte i mbrojtur nga një hendek i gjerë me ujë nga ana e tokës. Në intervale, kishte edhe kulla. Një nga më të famshmet është Kulla Thomas, e cila ndodhet në jug të portës kryesore të sotme. Fillimisht, besohej se ishte “kullë” e ndërtuar nga guvernatori serb i qytetit, Thomas Preljuboviç (rreth 1380). Gërmimet e fundit të ndërmarra nga Shërbimi Arkeologjik kanë sjellë në dritë disa zbulime, të cilat vërtetojnë se kjo është porta perëndimore e fortifikimit bizantin të kalasë.

Dy kodrat shkëmbore në pjesën verilindore dhe juglindore të kalasë u shndërruan në dy fortesa. Pallati i sundimtarit u ndërtua në fortesën verilindore, ndërsa Kisha Metropolitane e Kryeëngjëllit Mihal dhe Kisha e Krishtit Pantokrator u ndërtuan në fortesën juglindore; shtëpitë e feudalëve u ndërtuan këtu gjithashtu, sipas disa pikëpamjeve.



Pas dorëzimit të qytetit tek otomanët në 1430, muret me shumë gjasë u rindërtuan. Ndërhyrjet nga Ali Pasha (1788-1822) në murin rrethues dhe fortesat e ndryshuan rrënjësisht formën e kalasë. Këto ndërhyrje përfunduan në 1815; qëllimi i tyre ishte që ta bënin kalanë një fortesë të fuqishme dhe të papushtueshme, të barabartë me fuqinë e Ali Pashait.



Gjatë ndërhyrjeve të Ali Pashës, u ruajtën vetëm pjesët në gjendje të mirë të fortifikimit ekzistues post-bizantin. Një mur i fuqishëm i ri u ndërtua jashtë murit para ekzistues dhe hendeku midis mureve u mbulua me harqe dhe arkada. Ndërtime të tjera me qemer u ndërtuan gjithashtu në nivelin më të ulët. Në nivelin më të lartë, u krijua një rrugë e gjerë perimetrike, e cila përdorej për qëllime ushtarake dhe kishte shumë frëngji topash.




Pjesë e fortifikimit ishte gjithashtu hendeku i gjerë, që datonte nga periudha bizantine dhe mbushej me ujërat e liqenit, duke dhënë përshtypjen se kalaja ishte e ndërtuar mbi një ishull, në pjesën e saj jugperëndimore dhe perëndimore.

Fortifikimi juglindor, i quajtur **Its Kalé**, është krejtësisht vepër e Ali Pashait. Atje ai kishte ndërtuar pallatin e tij, sarajin dhe ndërtesa të tjera për rojet e tij.

Në vitet e fundit, Shërbimi Arkeologjik, ka ndërmarrë një numër të madh punimesh restauruese dhe rregulluese në muret mbrojtëse për të rritur reputacionin e kalasë dhe monumenteve të saj të mbrojtura.

Monumentet e kalasë

Fortesa verilindore



Sipas historisë, **Xhamia e Asllan Pashës** u ndërtua në fillim të shekullit XVII (me shumë mundësi në 1618) në vendin e kishës bizantine të Shën Janit.

Është një ndërtesë katrore me një kube gjysmë sferike, arkada përqark pjesëve veriore, perëndimore dhe jugore dhe me një portik të mbyllur në ditët e sotme. Në sallën kryesore është *Mihrabi*, një kamare në mur e përdorur për lutje, e suvatuar dhe me dekoracione në relief.



Muzeu Bashkiak është vendosur në Xhami që prej vitit 1933. Ai ka tre koleksione përfaqësuese për tre komunitetet që jetonin në kala gjatë historisë së saj: grekët, hebrenjtë dhe myslimanët. Objektet janë donacione nga familje lokale fisnike dhe datojnë nga shekujt XVIII-XX.

Tyrbja (mauzole) ndodhet në lindje të Xhamisë së Asllan Pashës. Sipas traditës, ky monument varrimi i përkiste Asllan Pashait dhe u ndërtua në fillimin e shekullit XVII.

Medreseja ndodhet në juglindje të Xhamisë së Asllan Pashait. Me të gjitha gjasat është një ndërtim bashkëkohor (fillimi i shekullit XVII). Ajo funksiononte si institucion fetar i lartë, ku qëndronin dijetarët. Është një ndërtesë e madhe dhe e zgjatur me 12 dhoma fjetjeje me kube dhe një dhomë mësimdhënieje qendrore e madhe, me çati druri. Sot, dhoma qendrore e mësimdhënies ka një koleksion privat armësh, poçerie, monedhash dhe sendesh të tjera historike.



Kështjella Juglindore (Its Kalé)

Sot fortesa juglindore është një sit arkeologjik i hapur për publikun. Ajo shtrihet mbi dy nivele, ku ruhen shumë monumente otomane, pjesa më e madhe e të cilave janë restauruar nga Shërbimi Arkeologjik.



Saraji (Pallati) i Ali Pashait

u ndërtua në pjesën e ngritur perëndimore të Its Kalé, me pamje nga liçeni. Shumë udhëtarë europianë në Greqi në shek. XIX e përshkruan Sarajin si një ndërtesë fisnike dhe mbresëlënëse me ornamente dhe dekorime të pasura.




Pas rënies së Ali Pashait (1822), Pallati vazhdoi të funksionojë si qendër administrative deri në 1870, kur u dogj krejtësisht. Sot, rrënojat e pjesës perëndimore të pallatit ruhen së bashku me disa ndërtesa të tjera të jashtme. Spitali Ushtarak u ndërtua mbi rrënojat e ndërtesës kryesore të Sarajit disa vite më vonë. Në 1958, në atë vend u ngrit Pavijoni Mbretëror dhe që prej 1995, Muzeu Bizantin i Janinës.

Shtatë sallat e **Muzeut Bizantin** ekspozojnë zbulime të rëndësishme nga gërmimet, që datojnë nga Periudha e Hershme Krishtere deri në fillimin e shekullit XX, si p.sh monedha, ikona dhe poçeri nga rajoni më i gjerë i



Epirit. Një vend të spikatur në koleksionin e Muzeut kanë zënë skulpturat bizantine nga kishat në zonën e Thesprotisë, dy ikona Bizantine nga Arta, etj. Ndër objektet e ekspozuara bëjnë pjesë ungjij të shkruar me dorë dhe libra të printuar në Venecia nga shtëpi botuese greke etj, të cilat e familjarizojnë vizitorin me historinë dhe zhvillimin e qytetit të Janinës përgjatë shekujve.

Thesari. Kjo ndërtesë me shumë mundësi i përkiste kompleksit më të gjerë të Sarajit të Ali Pashait. Sipas traditës gojore, ky ishte “Thesari”. Ndërtesa u restaurua nga Shërbimi Arkeologjik midis viteve 1989 dhe 1990. Që nga ajo kohë dhe në vazhdim ajo ka pasur një koleksion të



përherëshëm artikujsh të argjendtë, ngaqë arti i punimit të argjendarisë ishte shumë i zhvilluar në Janinë, veçanërisht gjatë Periudhës së Vonë Bizantine.



Xhamia Fetih dominon pikën më të lartë të fortesës juglindore. Forma e saj e sotme daton nga fundi i shekullit XVIII. Sipas traditës, xhamia u ndërtua në vendin ku ndodhej Kisha Bizantine e Kryeëngjëllit Mihal. Reliktet e vetme nga Kisha Bizantine janë dy kolona mermeri të shekullit XIII, të marra nga ikonostasi ndërtuar në kamare (*mihrab*).



Kubeja dhe *mihrab*i janë të pikturua me piktura murale që shfaqin bimë dhe forma gjeometrike, si dhe nënshkrime arabe. Sot Xhamia Fetih ka një ekspozitë rreth qytetit të Janinës gjatë periudhës otomane dhe personalitetit të gjithanshëm të Ali Pashait.



Varri i **Ali Pashait** dhe një prej grave të tij ndodhet afër Xhamisë. Trupi pa kokë i Ali Pashait u varros këtu, menjëherë pas vrasjes së tij. Parmakët ekzistues me ornamente që mbulojnë varrin, janë një imitim i atyre origjinale, të cilat u zhdukën rreth vitit 1940.

Monumente brenda Kalasë

Sinagoga ndodhet në pjesën perëndimore të kalasë, në rrugën Ioustinianou. Sipas traditës, sinagoga e parë u shfaq në shekullin XIX. Forma e saj aktuale është një rindërtim i vitit 1829. Është një ndërtesë e madhe me dy arkada. *Echal* është një kamare prej mermeri në murin lindor, ku mbahen dorëshkrime të Torahut të shenjtë. Pjesa për gratë është në anën veriore. Një mur guri i lartë rrethon kopshtin.

Komuniteti hebre i Janinës ka luajtur një rol aktiv në jetën e qytetit që prej periudhës bizantine. Gjatë periudhës otomane, si nënshtetas jo-myslimanë të Perandorisë, hebrenjtë fituan disa privilegje dhe të drejtën për të ushtruar besimin e tyre. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, pjesa më e madhe e komunitetit lokal hebre u zhduk.



Biblioteka Turke, e ndërtuar vetëm pak metra nga porta kryesore e kështjellës, ishte ndofta pjesë e kompleksit të Xhamisë së Asllan Pashait. Ajo daton nga shekulli XVII. Përcaktimi i ndërtesës si bibliotekë i atribuohet një numri të madh dorëshkrimesh dhe librash që mendohet se mbaheshin aty.

Saraji Soufari ka mundësi që u ndërtua në fillim të shekullit XIX. Është një ndërtesë e madhe dykatëshe, kati përdhes i së cilës është i ndarë në katër pjesë të shtrira, të ndara nga kolona dhe arkada. Ndërtesa u përdor si Shkolla e Kavalerisë së Ali Pashait. Pas punëve të mëdha restauruese dhe rregulluese që janë ndërmarrë në ndërtesë, sot aty janë vendosur Arkivat e Përgjithshme të Shtetit –



Departamenti i Janinës.

Hamami (banja turke) ndodhet në jug të Bibliotekës dhe është një nga monumentet otomane më të hershme të ruajtura në Janinë (fillimi i shekullit XVII). Ndërtesa i është nënshtruar shumë

ndërhyrjeve të mëvonshme; ajo ka një ndarje katrore përdorej si dhomë pritjeje për vizitorët, një hapësirë të gjatë me qemer në mes, dhomat

kryesore të banjave, stera me qemer etj. Dhoma kryesore ka formën e një kryqi, me kamare të vogla katrore dhe me kube.

Monumentet e krishtera të qytetit

Kisha Metropolitane e Shën Thanasit e qytetit i kushtohet Shën Thanasit. Sipas traditës, në të njëjtin vend ekzistonte një kishë bizantine, ndërsa disa dorëshkrime nga 1619 dhe 1664 i referohen asaj si *katolikon* i një manastiri. Kisha që ne shohim sot u ndërtua midis 1831 dhe 1832 në formën e një bazilike tre-nefshe. Një qemer shumëkëndësh përvijohet nga ana lindore e jashtme e tempullit, i cili brenda ka tre pjesë dhe tre tavolina kungimi, që i kushtohen shenjtorit të vjetër mbrojtës të qytetit, Kryeëngjëllit Mihal dhe Shën Janit Evangjelist.



Në brendësi, kisha është e dekoruar me piktura murale. Sipas një nënshkrimi përkatës, afresket janë vepër e vitit 1835 nga Teodosi dhe Konstandini, biografë shenjtorësh. Ikonostasi është një shembull karakteristik i drugdhendjes epirote të shekullit XIX. Është një vepër arti e veçantë, e bërë nga artizanë të njohur të fshatit Tournovo (të quajtur sot Gorgopotamos) në Konicë. Në kishën Metropolitane ruhen një seri ikonash të vyera të lëvizshme dhe

kapaku i argjendtë i një ungjilli, i bërë nga artizani Athanasios Tzimouris në gjysmën e dytë të shekullit XIX.



Kapela e Shën Gjergjit është ndërtuar në pjesën veriore të Kishës Metropolitane, për të vendosur varrin e shenjtorit mbrojtës të Janinës, Shën Gjergji Neomartir, i cili u var nga turqit në 1838.

Kisha e Arkimandrios kushtuar ngritjes në Qiell të Shën Mërisë ishte *katolikon* (tempulli kryesor) i manastirit bizantin të Arkimandrios, i cili përmendet për herë të parë në burimet letrare në 1383. Që prej fundit të shekullit XV, Arkimandrio ka shërbyer si manastir për gratë. Gjatë gjithë pushtimit otoman deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX, manastiri ka qenë mjaft i njohur për bamirësi.

Forma aktuale e kishës është rezultat i punëve rindërtuese që u kryen nga 1858 deri në 1864. Është një bazilikë me kube e madhe, me tre nefe dhe me tre qemerë në pjesën lindore, si dhe një narteks në pjesën perëndimore. Ikonostasi prej mermeri ndan navatën nga altari. Pikturat murale të altarit janë kryer në 1885, ndërsa pjesa tjetër e kishës u pikturua në 1986. Kisha është e pasur me ikona, më e vjetra e të cilave daton në fillim të shekullit XIII. Pjesa më madhe e ikonave të ekspozuara datojnë në shekullin XVII dhe XVIII. Në juglindje përvijohet kambanorja monumentale, në formë kulle, e ndërtuar në 1915.





Kisha e Shën Ekaterinës (Aghia Ekaterini) ndodhet pak më lart se kisha e Arkimandrios dhe është në varësi të Manastirit Hyjnor të Shën Katerinës së Malit të Sinait. Kisha fillestare ishte ndërtuar në 1771 dhe u rindërtua në 1801. Ndërmjet viteve 1872 dhe 1875, kisha u rinovua krejtësisht përmes mbështetjes financiare të bamirësve Aleksios dhe Aggeliki Papazoglou. Pikturat murale në altar ishin pikturuar nga piktori epirot Alexandros Damiris. Një nga ikonat e lëvizshme më të vlefshme që mbahet në kishë tregon Shën Katerinën, vepër e vitit 1770 e pikturuar nga Ioannis Athanasiou, një artist mjaft i njohur nga fshati Kapesovo në Zagori.

Kisha e Panaghia Perivleptos kushtuar Ngjitjes në Qiell të Shën Mërisë, ishte *katolikon* i manastirit të themeluar në 1647 nga Epiphaios Igoumenos (1568-1648), tregtar i pasur nga Venecia. Kisha bashkëkohore është një strukturë e ndërtuar në 1838, sipas nënshkrimit mbi hyrjen veriore. Një nga donatorët kryesorë për ndërtimin e saj ishte Nikolas Zosimas (1758-1842), një tjetër bamirës i shquar epirot.

Kisha e Shën Marinës ndodhet në një nga lagjet më të vjetra të Janinës, e quajtur Kaloutsiani. Sipas traditës, kisha e Shën Marinës u ndërtua fillimisht në 1791, por u dogji nga trupat e sulltanit në 1820. Kisha



bashkëkohore u ndërtua në 1852 me mbështetjen financiare të vëllezërve Zosima. Ajo është një bazilikë me nefe me çati prej druri dhe me tre qemerë poligonale në lindje. Një *stoa* me portik rrethon një pjesë të murit verior, jugor dhe perëndimor. Pikturat më të vjetra murale u realizuan në 1892.

Kisha e Shën Nikolla Agoras (Shën Kolli në Treg) është vërtetuar se ka ekzistuar që nga shekulli XVII. Forma aktuale, gjithsesi, i atribuohet, punimeve restauruese që u ndërmorën nga viti 1837 deri në 1842, falë mbështetjes financiare të vëllezërve Zosima dhe George Haxhikonstas. Ikonat e lëvizshme të artit rus, një ungjill dhe sendet e tjetra që ruhen në kishë janë dhuruar nga George Haxhikonstas, mirëbërës mjaft i njohur.

Monumentet myslimane të qytetit

Deri në gjysmën e parë të shekullit XX, në qytetin e Janinës kishte shumë monumente të ruajtura myslimane. Shumë prej tyre, megjithatë, njihen vetëm nga burime historike, hartat e qytetit dhe fotografi të vjetra. Sot ruhen vetëm dy xhami jashtë zonës së kalasë.



Xhamia Kaloutsiani, që do të thotë burimi i gjakut, ndodhet në lagjen e qytetit me emër të njëjtë. Me shumë mundësi është ndërtuar në mesin e shekullit XVIII nga Haxhi Mehmet Pasha, vali (komandant) i Janinës, në vendin e një *mexhiti* (një ndërtesë otomane fetare pa minare). Kamarja (*mihrabi*), e zbukuruar me dekorime në relief mbi suva dhe froni origjinal i gdhendur në dru (*minbar*) ruhen në gjendje mjaft të mirë brenda sallës së bollshme të lutjeve. Kubeja është e zbukuruar me tema të ndryshme dekorative.

Xhamia e Veli Pashait ose Xhamia Tsiekur ndodhet në jug të kalasë, në anën juglindore të kodrës Litharitsia. Sipas traditës, xhamia u ndërtua nga Veli Pashai në fund të shekullit XVIII për të zëvendësuar një xhami më të



vjetër turke, e cila ishte ndërtuar mbi rrënojat e kishës bizantine të Shën Stefanit, që ekzistonte dikur dhe ishte prishur në fillim të shekullit XVII. Së bashku me medresenë e ndërtuar në pjesën veriore, ato formonin një kompleks fetar që ishte afër sarajit, të cilin Ali Pasha e kishte ndërtuar për djalin e tij Veli Pasha.

Fortesa Litharitsia ndodhet në një kodër të ulët me të njëjtin emër, jo larg nga kalaja në jugperëndim. Kjo strukturë mbresëlënëse, shembull i një arkitekture fortifikimi otoman të vonë, ishte ndërtuar nga Ali Pasha në fillim të shekullit XIX. Ajo përdorej për qëllime mbrojtëse si vijë e parë mbrojtëse përpara kalasë. Është e ndërtuar në formë drejtkëndëshe me shumë nivele të ndryshme. Pjesa e sipërme përdorej për të furnizuar topat, ndërsa pjesa e poshtme kishte pozicione luftimi.

Në majë të kodrës, Ali Pasha kishte ndërtuar një saraj të madh në vitin 1805, duke u bazuar në projektet e arkitektit J. Freywald. Sipas dëshmimeve, Ali Pasha kishte ndërtuar këtu pranë saraje edhe djemve të tij Muhtar e Veli. Këto ndërtesa, gjithsesi, u shkatërruan plotësisht nga një zjarr. Në vitin 1983, Shërbimi Arkeologjik ndërmori restaurime të nëpër muret



fortifikuese. Sot, në brendësi të sallave me kube të fortesës, ndodhet një kafe-restorant, ndërsa një park shtrihet në majën e kodrës.

Kulla e sahatit është një nga monumentet më të famshme të qytetit të Janinës, e shquar për përpjesëtimet e sakta të ndërtimit thuajse të përkryer. Është ndërtuar në vitin 1905 nga Osman Pasha, komandant i Epirit, për nder të Sulltan Abdul Hamid II. Ka konstruksion të ngjashëm me një kullë të mbështetur në katër qemerë të lartë, mbi të cilën është një ballkon me parmakë guri. Në të katër anët e bazës së saj janë katër shatërvanë (nuk janë në funksion sot), si dhe pllaka të shkruara me simbole otomane.



Kulla e Sahatit është puna e arkitektit P. Melirrytos (1870-1937), të cilit i janë atribuuar shumë ndërtesa publike në Janinë, si p.sh. Zyra Postare, Biblioteka Zosimea, dhe Shkolla e vjetër Zosimea. Ky lloj ndërtimi kombinon elementë neoklasikë me një stil lindor. Kulla e sahatit është ndërtuar fillimisht në qendrën e Sheshit të Poshtëm (në veri të sheshit modern, në kryqëzimin me rrugën Averoff). Megjithatë, një incident fatkeq ndodhi në vitin 1918, gjatë festimeve për fitoren e forcave aleate në Luftën e Parë Botërore, kur një top i rëndë dëmtoi edhe më shumë orën dhe bëri që ajo të transferohej në një tjetër vend.

Ndërtesa me interes arkitekturor dhe historik

Ka shumë ndërtesa me interes arkitekturor dhe historik në qytetin e Janinës. **Vila Misios**, e ndërtuar në vitin 1844 për të bujtur familjen Misios i është dhuruar Ministrisë së Kulturës dhe kryen sot një nga shërbimet e kësaj. Është një ndërtesë interesante me një oborr te brendshëm, një shembull karakteristik i arkitekturës në Janinë. **Zyra Postare Qendrore** u ndërtua në vitin 1905, duke u bazuar në projektet e arkitektit P. Melirrytos. Në fillim në ndërtesë ishte vendosur Shkolla e Mesme për Vajza, e themeluar nga Osman Pasha, komandant i qytetit.





Godina e Bashkisë është projektuar nga arkitekti A. Zachos për degën kryesore të Bankës Kombëtare të Greqisë. Fasada mbresëlënëse ka një hajut me tre harqe në katin përdhes dhe një ballkon me harqe të dendura në katin e sipërm. Fasadat e ndërtesës kanë pjesë qeramike të zbukuruara me një dizajn të këndshëm,

shumëngjyrësh dhe me forma bimësh.

Shkolla e Vjetër Zosimea funksionon sot si një shkollë e mesme. Emri i atribuohet vëllezërve Zosimas (qytetarë të pasur dhe mirëbërës, të cilët kishin emigruar në Rusi), sepse ata kishin dhuruar para për themelimin e shkollës. Në testamentin e tij, në 1841, N. Zosimas kishte shprehur dëshirën për të themeluar një shkollë të re me shpenzimet e tij, ndërtimi i së cilës u krye në vitin 1905. Ndërtesa u projektua nga arkitekti P. Melirrytos dhe fasada e saj është një riprodhim i fasadës së Universitetit Kombëtar dhe Kapodistrian të Athinës, në një përpjekje për të theksuar rëndësinë e shkollës Zosimea.



Muzetë

Vizitorët mund të marrin një pamje nga historia e rajonit dhe qyteti i Janinës në muzetë që ekzistojnë jo vetëm në Janinë, por edhe në qytetet e tjera brenda Prefekturës.

Muzeu Arkeologjik i Janinës ndodhet në Parkun Litharitsia, në qendër të qytetit. Muzeu ndodhet në një shtëpi interesante ndërtuar midis viteve

1963 dhe 1966, duke u bazuar në projektet e arkitektit Aris Konstantinidis. Objektet e ekspozuara përfshijnë gjetje nga rajoni më i gjerë i Epirit, si p.sh vegla prej kocke dhe guri të gjetura në sitet Paleolitike të Kokkinopilos-it, Asprochaliko-s, Kastritsa-s, midis të tjerash, si dhe zbulime nga Tempulli i Dodonës, nga vendbanimi dhe varrezat e qytetit Molos që u gërmua në Vitsa, nga Nekromanteioni i Akeronit dhe të tjera. Midis objekteve ka pllaka varri, rrënoja arkitekture, mbishkrime dhe një koleksion interesant monedhash nga zona dhe periudha të ndryshme. Në një nga hajatet e saj janë ekspozuar përkohësisht punime nga artistë grekë të shekullit XIX dhe XX. (Adresa: 25th Sheshi Mars, tel. 26510-01050).

Muzeu Bizantin ndodhet brenda kalasë, brenda kështjellës së brendshme e njohur si *Its Kalé*. (Adresa: Kalaja e Janinës, tel. 26510-25989, 26510-39580, faks. 26510-39342).

Muzeu Bashkiak ndodhet në Xhaminë Asllan Pasha në fortesën verilindore të kalasë. Xhamia ishte në funksionim deri në vitin 1922. Midis ekspozitave janë kostume dhe bizhuteri të vyera tradicionale nga zona të ndryshme të Epirit, artikuj argjendi dhe qeramikë, si dhe mobilie të gdhendura në dru, që i takojnë një periudhe kohore nga shekulli XVIII deri në shekullin XX. Gjithashtu ka edhe sende interesante që përfaqësojnë aktivitetet e tre komuniteteve, (krishterë, hebrej dhe myslimanë) që jetuan në qytet gjatë pushtimit osman. Koleksionet e V. Pyrsinellas, A. Pallis, sendet personale të poetit Lorentzos Mavilis, armët e G. Karaiskakis, si dhe sende të tjera janë gjithashtu në ekspozim. (Adresa: Muzeu Bashkiak, Kalaja e Janinës, tel. 26510-26356).

Muzeu Popullor u themelua nga Shoqëria e Studimeve Epirote. Ndodhet në një ndërtesë të sapo rinovuar. Midis koleksioneve të tij më të vyera janë objektet e artit tradicional epirot (tekstilet, gdhendjet me dru, artikujt e argjendit etj.), sendet kishtarë, sendet shtëpiake, qeramikat dhe kostumet lokale. (Adresa: Muzeu Popullor, Rruga 42 Michail Anghelou, tel. 26510-23566).

Muzeu i **Dyllit Pavlos Vrellis** ndodhet në fshatin Bizani, në kilometrin e 14 të Rrugës Kombëtare Janinë-Athinë. Ndodhet në një ndërtesë interesante të tipit fortesë, duke imituar shtëpitë e mëdha tradicionale epirote. Figurat prej dylli me përmasat e tyre reale paraqesin figura nga historia moderne greke, të ndara në tre njësi tematike: periudha para-revolucionare (Shkolla e Fshehtë, Shoqëria e Miqve etj.), revolucioni i 1821 (vdekja e Ali Pashës), Lufta e Dytë Botërore (gratë e Pindit etj.). Në muze janë të ekspozuara më shumë se 150 figura prej dylli, të frymëzuara nga ngjarje të ndryshme. (tel. 26510-92128).

Ishulli

Ishulli i Liqenit Pamvotis me 0.2 km² sipërfaqe, ka një vendbanim të vogël dhe shtatë manastire. Vendbanimi shtrihet në pjesën veriore dhe ekzistenca e tij është provuar se daton nga periudha bizantine. Sot, është një destinacion i famshëm turistik, që pret shumë vizitorë çdo ditë, jo vetëm për të parë manastiret, por për të mësuar gjithashtu rreth historisë dhe lidhjes së tij me vdekjen e të famshmit Ali Pasha.



Afër me vendbanimin, kryesisht afër brigjeve perëndimore dhe lindore, ka shtatë manastire, më të rëndësishmit e të cilëve janë si më poshtë:

Manastiri i Shën Nikollë Filanthropinoi

është i lidhur me familjen bizantine të Filanthropinoi, një nga familjet e Kostandinopojës që u vendos në Janinë pas vitit 1204. Manastiri lulëzoi gjatë shekullit XVI, pas ndërhyrjeve të mëdha nga abati loasaf.

Përveç *katolikonit*, rrënojat e altarit dhe qelat e ndërtruara rishtas ruhen ende sot. *Katolikoni* njihet për pikturat murale të ruajtura mirë, disa nga pikturat të ruajtura më mirë nga shekulli XVI në Epir. Vizatime të shumta zbukurojnë muret, të famshme për mesazhet teologjike dhe punimin e hollë artistik.



Pikturat murale janë bërë në tri faza të ndryshme. Faza më e vjetër daton në vitet 1531-1532, ndërsa faza e dytë në vitin 1542. Faza e tretë daton në vitin 1560 dhe i atribuohet piktorëve George dhe Fragos Kontaris, të njohur për punën e tyre në monumente të tjera në Epir dhe gjithashtu në Meteora. Pavarësisht se janë punë të kohëve dhe autorëve të ndryshëm, pikturat murale të manastirit krijojnë një ansambël unik me një varietet skenash. Shumë prej skenave karakterizohen nga origjinaliteti, si p.sh. shtatë njerëzit e mençur të Greqisë (Platoni, Apoloni i Tyana-s, Soloni, Aristoteli, Plutarku, Tuqididi dhe Kilon Lacedaemoni). Një tjetër pikturë interesante është ajo që tregon pesë anëtarët e familjes Filanthropinoi që falen përpara figurës së Shën Kollit.



Karakteristike janë gjithashtu figurat sa një bojë njeriu të shenjtoreve me veshje ushtarake, Krishti Pantokrator me engjëjt mbi kube dhe vizatimi i Ditës së Gjykimit me lumin e përvëlues të Ferrit.

Manastiri i Shën Nikolla Stratigopoulou ose Diliou

ndodhet në një distancë të afërt me Manastirin Filanthropinoi. Është themeluar në shekullin XIII nga anëtarët e familjes Stratigopouloi, një nga familjet fisnike të Kostandinopojës që ishte vendosur në Janinë pas vitit 1204, duke luajtur kështu një rol të rëndësishëm në qeverisjen lokale. Me





shumë mundësi manastiri u rinovua në shekullin XVII nga familja Dilios, gjë që shpjegon edhe emrin e dytë të manastirit.

Katolikon është një kishë një-nefshe, me çati prej druri, me absidë gjysmë rrethore në lindje dhe një narteks në pjesën perëndimore. Një seri harqesh solide me qemerë prej tulle zbukurojnë pjesën veriore dhe jugore të monumentit. Në brendësi, kisha është e dekoruar me piktura murale të vyera, që datojnë në vitet 1542-1543 dhe paraqesin skena nga jeta e Krishtit. Narteksi është i zbukuruar me skena nga jeta e Mërisë së Virgjër. Muri lindor në të djathtë dhe të majtë të hyrjes është i zbukuruar me skenën mbresëlënëse të Ardhjes së Dytë. Ikonostasi madhështor i gdhendur në dru në *katolikon* është vepra e artizanëve lokalë dhe daton nga fundi i shekullit XVIII ose fillimi i shekullit të XIX. Ikonat e tij datojnë nga shekulli XVI në shekullin XIX (sot këto ikona janë zëvendësuar me kopje).



Manastiri i Panaghia Eleousa (Virgjëresha e Dhembshurisë)



fillimisht i ishte kushtuar Shën Kollit dhe, me shumë gjasa, është themeluar përpara mesit të shekullit XVI. Emri i ri u vendos rreth vitit 1584, kur ikona e mrekullueshme e Panaghia Eleousa u transferua në manastir nga kisha e Shën Parashqevisë. Abati Nikofor ishte përgjegjës për restaurimin rrënjësor të kompleksit në shekullin XVIII. Manastiri lulëzoi në gjysmën e dytë të shekullit XIX, pas bashkimit me manastirin fqinjë të Transfigurimit, ku u themelua një seminar në vitin 1872, me leje nga autoritetet turke.

Interieri është zbukuruar me piktura që janë bërë në faza të ndryshme. Pikturat më të vjetra datojnë në shekullin XVI, ndërsa më të rejat në fillim të shekullit XVIII. Pikturat në narteksin më të ri u realizuan në vitin 1759, nga piktori Anastasios dhe djali i tij nga fshati i Kapesonovos. Ikonostasi është një shembull i hollë i mjeshtërisë vendase të drugdhendjes në fund të shekullit XVIII dhe fillim të shekullit XIX. Manastiri ka një koleksion të zgjedhur ikonash, blatimesh, sendesh lokale artizanati, si dhe punime nga piktorë të famshëm të shekullit XVI dhe XVII.



Manastiri i Metamorphosi Sotiros (Transfigurimit të Krishtit)



ndodhet jo larg nga Manastiri i Eleuzës dhe daton në gjysmën e dytë të shekullit XIX, megjithëse, sipas disa burimeve, manastiri u ndërtua në shekullin XVII. *Katolikon* i pikturua në vitin 1851 nga Anthimos, një murg nga Mali Athos. Përveç *katolikonit*, është ndërtesa e seminarit, e cila përdoret sot si bibliotekë dhe qendër konferencash.

Manastiri i Shën Joan Prodromos (Shën Jani Pagëzori)



ndodhet në pjesën lindore të ishullit, jo larg nga vendbanimi. Të dhënat e vetme historike në lidhje me themelimin e tij vijnë nga autobiografia e Theofanit dhe Nektarios Apsaras, të cilët rridhnin nga një familje fisnike, anëtarët e së cilës mbanin ofiqe të rëndësishme në qytetin e Janinës që prej epokës bizantine. Dy vëllezërit u bënë murgj në moshë të herët dhe, në 1506-1507, themeluan manastirin në vendin ku ndodhej kisha e vogël e mëparshme. Disa vite më vonë, gjithsesi, ata u detyruan ta braktisin manastirin dhe të arratisen në Meteora ku, në vitin 1542, themeluan manastirin shumë të njohur Verlaam, ku edhe qëndruan deri në vdekje.

Nuk ka të dhëna në lidhje me manastirin e Shën Joan Pagëzorit pas

themelimit të tij. Gjithsesi dihet se nga fundi i shekullit XVII manastiri u lidh me disa esnafe zejtare të qytetit, që e ndihmuan financiarisht dhe ofruan fonde për punime të ndryshme restaurimi.

Kisha është ndërtuar mbi një kompozim arkitekturor me formë kryqi, d.m.th. ka dy salla të zgjatura që kryqëzohen, duke formuar një kryq. Në perëndim, hyrja për në *katolikon* kalon përmes një narteksi me qemer, i cili është i njëkohshëm me kishën. Sipas mbishkrimit mbi hyrjen perëndimore, interieri është zbukuruar me piktura murale që nga viti 1789. Sipas mbishkrimeve përkatëse, ato u restauruan në vitet 1824 dhe 1892. Me shpenzimet e esnafeve të qytetit, ikonostasi i gdhendur në dru u ndërtua në vitin 1789, duke integruar disa pjesë nga një ikonostas më i vjetër. Deri së fundmi, ikonostasi ka qenë i zbukuruar me ikona të vyera të shekullit XVI, por tani ato ruhen gjetkë për arsye sigurie. Në qelat e rinovuara së fundmi ka një muze të vogël me tema nga liqeni, ekosistemi i tij dhe jeta e banorëve që jetuan afër liqenit.

Manastiri i Shën Panteleimonit

ndodhet në pjesën lindore të ishullit, jo larg nga Manastiri i Shën Joan Pagëzorit. Sipas burimeve të shkruara, në të njëjtin vend ekzistonte një kishë e vogël që prej fillimit të shekullit XVI, e cila i ishte dedikuar Shën Panteleimonit. Sipas udhëtarit anglez W. Lake, kisha ishte restauruar nga Ali Pasha, i cili kishte detyruar një qytetar të pasur nga Janina të mbulonte shpenzimet. Për më tepër, kisha ishte drejtpërdrejt e lidhur me Ali Pashën, përderisa ishte vendi ku ai u strehua gjatë ditëve të fundit të rrethimit nga ushtria e sulltanit. Në përfundim, ai u vra në qelat e Manastirit në Janar 1822.



Në ditët e sotme, *katolikon* i është një bazilikë me tre nefe, me çati prej druri, me narteks të ngritur në pjesën perëndimore dhe me një hajati të pasmë në pjesën jugore. Muri jugor, gjithsesi, është rrënojë e një kishë më të vjetër me piktura murale, që datojnë në kohëra të ndryshme (nga fundi i shekullit XV ose fillimi i shekullit XVI deri në shekullin XIX.) Një nga ikonat më të rëndësishme të kishës është ajo e Shën Panteleimonit, që daton nga shekujt XV-XVI. Një tjetër punë e jashtëzakonshme e shekullit XVI është ikona e Krishtit në Fron. Pjesa më e madhe e ikonave në ikonostas janë një dhuratë nga Anastasios Melas, emisar në Rusi.

Përveç *katolikonit*, brenda zonës ruhen dy ndërtesa me qela të rinovuara rishtas. Qela veriore ka një koleksion librash të shtypura përpara vitit 1500 dhe dorëshkrimesh nga manastiret në ishull. Ali Pasha u vra brenda qelës jugore. Sot, aty është një muze i vogël me sende të periudhës së Ali Pashës.





Çështjet e Menaxhimit

(Vassilis Birbos)

Ndërhyrja e parë e dukshme “e organizuar” e planifikimit urban në rajonin e qendrës së qytetit historik të Janinës (pa përmendur faktorët njerëzorë, gjeografikë dhe ekonomikë që kishin kontribuar në formimin e tij deri në shekullin XIX) ndodhi në vitin 1869, kur Rashim Pasha vijoi me kuadratizimin e rrjetit urban dhe rishpërndarjen urbane, si rezultat i një zjarri që ishte vënë qëllimisht për të shkatërruar një pjesë të qytetit. Planifikimi i ri i qytetit filloi menjëherë, sipas planeve të kryeinxhinierit Gjerman Holz, ndërsa në vitin 1883, italiani Bernasconi hartoi planimetrinë e re të qytetit. Kështu, u krijua tregu i ri i



Janinës në vitin 1870, i cili ruan formën e fillestare në një masë të madhe deri në ditët e sotme.

Dekreti i parë për Planin e Qytetit u publikua në vitin 1934. Fatkeqësisht, ky Plan parashikoi ndryshime të mëdha në komplekset e rëndësishme ndërtimore dhe arkadat, pasi planifikimi i ri i rrugëve nuk merrte parasysh gjendjen ekzistuese.

Në vitin 1989, Qendra Historike e qytetit u dekretua me Dekretin Presidencial 28-02-1989 (GAZATA QEVERITARE 605/D/89), me kushte specifike dhe kufizime të veçanta ndërtimore, të cilat dhanë rezultate pozitive në mirëmbajtjen e Qendrës Historike:

- Linja e Ndërtimit ekzistuese u ruajt *de facto*
- U imponuan kufizime ndërtimore dhe morfologjike dhe u parashikuan ndërhyrje

Pas kësaj filloi implementimi i një studimi të veçantë urban për Qendrën e Qytetit Historik, por mbeti në fazën e printimit topografik (në përgjithësi dhe jo për çdo ndërtesë). Më pas vijoi miratimi i Planit të Përgjithshëm Urban (P.P.U.), në përputhje me ligjin 1337/83, ndërsa sot të dy si P.P.U. ashtu edhe Master Plani Rregullues i basenit të Janinës janë përpunuar dhe janë në proces miratimi në përputhje me ligjin 2508/97, në të cilin janë specifikuar masat e nevojshme të planifikimit hapësinor dhe urban në rajonet e Qendrave të Qyteteve Historike.

Qyteti i Janinës, me Qendrën e tij Historike, ka ruajtur dhe pjesërisht zhvilluar një avantazh krahasimor si “qytet tërheqës në buzë të liqenit”, si rrjedhojë e mjedisit spektakolar natyror, ruajtjes së monumenteve dhe karakterit të tij tradicional, sa i përket morfologjisë arkitekturore dhe përdorimeve tradicionale të tokës, megjithëse kjo nuk është bërë në mënyrën më të mirën e mundshme.

Sa i përket fondit ekzistues të arkitekturës ndërtimore, Qendra Historike krenohet me rrugica të tëra, ku shtëpitë e vjetra janë të ruajtura mirë, furrat dhe dyqanet kanë mbetur të paprekura. Që nga shtëpitë piktoreske në rrugën Soutsou me fasadat e tyre të ngushta, të ngjeshura njëra pas tjetrës,





duke nxjerrë në pah dallimin e tyre si për nga ngjyra apo nga ndonjë element dekorativ i veçantë, deri tek shtëpitë e mëdha hijerënda në rrugën Kountouriotou me dhoma të shumta dhe hyrje mbresëlënëse,

ku jetonin dikur qytetarët e pasur izraelitë të Janinës dhe deri tek rruga Josif Evlia, zemra e pak anëtarëve që kanë mbetur nga komuniteti hebre, shtëpitë borgjeze vërtetojnë arkitekturën lokale tradicionale me parmakët karakteristike në dritare, ngjyrat e gjalla, përpjesëtimet e përsosura dhe simetrinë e mençur. Në rrugën Anexartiasias mund të shihen ende hanet dhe arkadat e famshme, të gjitha monumentet arkitekturore plot kujtime dhe jetë, me dyqane të vogla tregtare në katet përdhese dhe banesa të vogla sipër.

Megjithatë, ajo që e bën Qendrën Historike të Janinës unike është Kalaja, si për shkak se ka qenë vazhdimisht e banuar që nga themelimi i saj, ashtu dhe për interesin e madh arkitekturor. Kalaja është vendi ku të tre kulturat së bashku, d.m.th. hebraike, e krishtere dhe myslimane, sidomos kjo e fundit, lanë shenjat e tyre. Shtëpitë brenda vendbanimit tradicional të kalasë prezantojnë gjithashtu një interes arkitekturor unik, për të mos përmendur numrin e madh të monumenteve, si: Fortesa Verilindore, Xhamia e Asllan Pashës, Tyrbja (mauzoleu), Medreseja, Fortesa Juglindore (Its Kale), Saraji i Ali Pashës, Muzeu Bizantin, "Thesari", Xhamia Fetih, Varri i Ali Pashait, Sinagoga, Hamami, Sarai Soufari, Biblioteka Turke, etj.



Një anë negative është sistemi aktual i trafikut, i cili përshkon qytetin nga skaji jugor drejt skajit verior. Ky model çon në bllokimin e trafikut në lartësinë e qendrës së ndërtuar dendur, ku korsi të rrugore ose ngushtohen

ose zhduken krejtësisht. Shembull karakteristik i këtij modeli problematik është hyrja jugore për në qytet, ku të tre arteriet (ato që janë nën ndërtim) arrijnë pranë e Kalasë për t'u ngushtuar në një korsi rrugore të vetme. Për më tepër, mungesa e mënyrave të buta të transportit si p.sh hekurudha, tramvaji dhe, në përgjithësi, çdo mënyrë transportimi miqësore me mjedisin, mungesa e zonave të këmbësorëve dhe korsive të çiklizmit, vendet e pamjaftueshme të parkimit, në kombinim me përdorimin ekzistues të tokës, e përkeqësojnë në një masë të madhe problemin e trafikut, për të mos përmendur ndotjen mjedisore të Qendrës Historike.



Në kuadër të Kornizës së Tretë të Mbështetjes së Komunitetit (KMK) dhe Kornizës Referencë Strategjike Kombëtare (KRSK), u ndërmorën disa veprime për përmirësimin e Qendrës Historike, si p.sh.: programi European “Rafael – kalatë që jetojnë”, restaurimi dhe përmirësimi i fortesës Its Kale, restaurimi i mureve të jashtëm të kalasë në vitet 2006-2008, pastrimi dhe ndriçimi i mureve të kalasë, shtrimi i rrugëve kryesore brenda kalasë, reformime të ndryshme të hapësirave të hapura dhe zonave për çlodhje, përmirësimi i rrugëve tregtare në qendrën historike, financimi për përmirësimin e fasadave të ndërtesave, krijimi i zonave për këmbësorët, etj.

Sa i përket menaxhimit të Qendrave të Qyteteve historike, një element bazë i zbatimit të këtyre politikave të “zhvillimit të qëndrueshëm” në nivel evropian (Perspektiva Evropiane e Zhvillimit Hapësinor - PEZHH) dhe ndërkombëtar (Agjenda 21) janë udhëzimet e reja urbane që po implementohen në “qytetet e ndërmjetme”, duke:

- zhvilluar format e buta të komunikacionit dhe transportit dhe minimizuar largësitë midis banesave dhe vendeve të punës.
- përmirësuar mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore, zhvilluar historikun e saj, organizuar aktivitete artistike dhe përmirësuar estetikën e qytetit, si parametra kryesorë të cilësisë së jetës.
- zhvilluar një turizëm urban specifik, si dhe organizuar kongrese e aktivitete kulturore/artistike, që lidhen me profilin e fuqishëm të qytetit në nivel evropian në sektorin e drejtpërdrejtë të mjedisit natyror në kombinim me trashëgiminë historike dhe kulturore, si faktor i identitetit evropian dhe hapjes ndërkombëtare të qytetit.

“Qytetet e ndërmjetme” janë elemente bazë për zhvillimin e qëndrueshëm, në kuadër të Kornizës Referencë të Strategjisë Kombëtare (KRSK), e cila është korniza e programeve Interreg në periudhë afatgjate.

Sipas klasifikimit aktual të Zonave të Mëdha Urbane në Bashkimin European, në kategoritë e përcaktuara nga atraksioni dhe nga prioriteti i përmirësimit të tij në politikat përkatëse, qyteti i Janinës ndodhet (sipas auditit urban Eurostat 2008) në kategorinë e parë, midis pak qyteteve të ngjashëm.

Udhëzimet e përgjithshme të lartpërmendura mund të aplikohen ndaj objektivave specifike të menaxhimit urban dhe menaxhimit të Qendrës Historike të qytetit të Janinës:

- ✓ Objektivi i veçantë 1: «Vënia e theksit tek përmirësimi/ruajtja e imazhit me anë të identitetit, cilësisë estetike dhe njohjes ndërkombëtare »

Për të arritur këtë objektiv propozohen masa dhe ndërhyrje për përmirësimin dhe ruajtjen e elementëve të veçantë, të cilët përbëjnë identitetin e Qendrës Historike të qytetit.

Elementë të tillë (Pika Referimi) përfshijnë ndërtesat historike dhe të mbrojtura të qytetit (kishat, xhamitë, sinagogat, shtëpitë e mëdha, ndërtesat neoklasike, arkadat, hanet, ndërtesat publike etj.), pikat me interes historik, si dhe rrugët me karakter të veçantë, qoftë për sa i përket arkitekturës ndërtimore apo sa i përket përdorimit (rrugë tregtare, rrugë me zeje tradicionale, zona kreative dhe shëtitëse etj).

- ✓ Objektivi i veçantë 2: «Përmirësimi – mbrojtja e “Qendrës Historike”, si për sa i përket fondit kulturor dhe urban, ashtu edhe si pjesë e historisë së gjallë të qytetit (përdorimet tradicionale dhe hapësirat e banimit)”.

Tradicionalisht, Qendra Historike e qytetit të Janinës është karakterizuar nga një prani intensive e tregtisë, kryesisht brenda mureve, si dhe artizanati tradicional. Mes përdorimeve bashkëkohore është përdorimi për argëtim, kryesisht në formën e restoranteve dhe bareve, të cilat shpesh kanë zëvendësuar shitoret tregtare dhe/ose rezidencat. Në mënyrë që të ruhen të gjalla përdorimet tradicionale, banorët e përhershëm të rajonit duhet të kenë një cilësi të mirë të mjedisit urban. Kjo cilësi mund të sigurohet me zhvillimin e zonave komunitare, që do t'u lehtësojnë banorëve sigurinë e hyrjes dhe parkimit dhe nivelin e ulët të shqetësimit nga zhurmat. Sidoqoftë, rajoni i Qendrës Historike, me cilësinë estetike dhe mjedisin e strukturuar, është veçanërisht tërheqës si zonë rezidenciale.


Për të njëjtat arsye, Qendra Historike është një produkt turistik tërheqës, dhe si rrjedhojë është e nevojshme, përveç mbrojtjes urbane, edhe ruajtja e përdorimeve tradicionale tregtare dhe të artizanatit dhe për t'i nxjerrë ato në pah me një markë të veçantë, me programe promovimi, me krijimin e eventeve dhe aktiviteteve të tjera kulturore, si dhe me krijimin e itinerareve tematike turistike. Me interes të veçantë do të ishte përmirësimi i mbijetesës së tre komuniteteve fetare, të cilët kanë vulosur historinë e qytetit (të krishtere, hebraike dhe myslimane). Për shembull, prezantimi i monumenteve bizantine me anë të guidave të veçanta në intervale

të rregullta, përmirësimi i sinagogës hebraike dhe promovimi i ceremonive fetare të komunitetit hebraik, restaurimi – hapja përsëri e banjave turke (hamami) etj.

✓ Objektivi i Veçantë 3: Tregtia -Turizmi

Preokupimi kryesor është zhvillimi i qendrës historike dhe i qytetit modern të Janinës për t'u bërë qendër/pol kryesor tregtar, duke ofruar cilësi/identitet/imazh/jetë urbane dhe specializimi i saj si një vend i rrallë i tregtisë së artikulujve luksozë dhe tregtisë së veçantë në fushën e modës, kohës së lirë, dekorimit, artit, ushqimeve të luksit, publikimeve etj.

Është e qartë se përmirësimi i zonave për tërheqjen e vizitorëve duhet të ofrojë eksperiencë të ndryshme, gjë që maksimalizon përfitimet nga turizmi. Kështu, së bashku me vlerën ekologjike, historike, arkeologjike dhe kulturore të një zone të caktuar, duhet të vihet në dukje lidhja me të sotmen, rezultat ky i procesit dinamik që lidh të shkuarën me të sotmen dhe të nesërmen. Shembull tipik për sa më sipër është vendi që zënë artizanati tradicional, gatimi lokal, muzika popullore, etj. në produktin turistik. Arti tradicional i punimit të argjendit është një material i gatshëm për t'u integruar dhe shfrytëzuar, ndërsa rigjallërimi i thurjes së shportave mund të sjellë jo vetëm përfitime ekonomike, por të kontribuojë edhe për qëllimet e mbrojtjes mjedisore (kufizimin e shtrirjes së korijeve me kallamishte).




✓ Objektivi Special 4: Trafiku

Në veçanti udhëzimet e organizimit të trafikut janë:

- Reduktimi i trafikut dhe parkimit të mjeteve në qendrën historike.
- Krijimi i një rrjeti tramvaji me komunikim të shpejtë dhe të shpeshtë nëpër nyjet e veprimtarisë së qytetit.
- Përmirësimi i mënyrave ekzistuese urbane të transportit.
- Ndërtimi i zonave të reja të parkimit përreth Qendrës Historike (nëntokë, mbi tokë, në tokë).
- Krijimi i pengesave natyrore i trafikut transit nëpër Qendrën Historike (zona këmbësore, korsi trafiku të ngushta etj).
- Zgjerimi i zonave të këmbësorëve/korsive të çiklizmit me krijimin e zonave publike të këmbësorëve në ato hapësira publike që përdoren sot për parkimin e makinave.

Për shkak të natyrës komplekse të planifikimit urban, numrit të rregullave dhe ligjeve dhe numrit të shërbimeve dhe organizatave përkatëse, është e rëndësishme të parashikohet krijimi i një organizmi të veçantë që të jetë përgjegjës për menaxhimin e qendrës historike, pasi të jenë përpunuar studime urbane dhe arkitekturore të veçanta. Ky organizëm do të organizojë dhe monitorojë një database kushtuar planifikimit urban dhe të koordinojë aspekte të veçanta si a) menaxhimi i planifikimit urban dhe zonal dhe çështjeve specifike të arkitekturës, b) probleme të transportit dhe trafikut, c) çështje të tregtisë, turizmit dhe çlodhjes përmes krijimit të “komitetit të menaxhimit”. Ky komitet do të kishte kapacitetet për krijimin dhe monitorimin e një “baze të dhënash” për këto çështje dhe do të mbështeste bashkëpunimin e të gjithë aktorëve të mundshëm (qeverisja vendore, qeverisja qendrore, shoqatat etj.) me synim për të siguruar një qasje të përbashkët në përcaktimin e zonimit urban etj.



Recommended reading

For publications which appeared only in Greek language, an English translation of the entry is provided in brackets.

Chantepleure, Guy: La ville assiégée Janina – Octobre 1912-Mars 1913. Calman-Lévy : Paris 1913

Hellenic Ministry of Culture, 8th Ephorate of Byzantine Antiquities: The Fetiye Mosque in the Castle of Ioannina. Ioannina 2008 / Υπουργείο Πολιτισμού, 8^η Εφορεία Βυζαντινών Αρχαιοτήτων: Το Φετιχιέ Τζαμί στο Κάστρο των Ιωαννίνων. Ιωάννινα 2008. Greek and English text. 12 pp.

Hellenic Ministry of Culture, 8th Ephorate of Byzantine Antiquities: Ioannina. From the Byzantine Castle to the Ottoman City. Ioannina 2009 / Υπουργείο Πολιτισμού, 8^η Εφορεία Βυζαντινών Αρχαιοτήτων: Ιωαννίνα απο τη βυζαντινή κάστροπόλιτα στην οθωμανική μεγαλουπολη. Ιωάννινα 2009. Greek and English text. 36pp.

Κεραμιδιώτη, Ευτυχία: Ιωάννινα-Ζαγοροχώρια. Ιδανικός Ξεναγός. Εκδόσεις ΟΡΑΜΑ: Ραφήνα 2010 (Keramidioti, Eftychia: Ioannina-Zagorochoria. Special Guide. Editions ORAMA: Rafina 2010)

Konstantios, Dimitris: The Kastro of Ioannina. Ministry of Culture, Archeological Receipts Fund: Athens 1997

Magnat Lanniée, Zélia: Memoirs of a Year in Ioannina 1894-1895. EGNATIA EPIRUS Foundation: Ioannina 2007

Μάργαρης, Βασίλης: Γιάννενα Πέτρινα. Και η Ηπειρος όλη μια πέτρα 'ναι χτισμένη. Βασίλης Μάργαρης: Ιωάννινα 2008 (Margaris, Vassilis: Ioannina of Stone. Vassilis Margaris: Ioannina 2008)

Παπαδοπούλου, Βαρβάρα: Τα μοναστήρια του Νησιού των Ιωαννίνων. Μονή Ελεούσας: Ιωάννινα 2004 (Papadopoulou, Varvara: The Monasteries in the Island of Ioannina. Holy Monastery of Eleousa: Ioannina 2004)

Ριζαρειών Ιδρυμα: Ιωάννινα. Ολκός/Ριζαρειών Ιδρυμα: Αθήνα 1996 (Rizarion Foundation: Ioannina. Olkos/Rozarion Foundation: Athens 1996)

Σινίκη-Παπακώστα, Νίτσα: Παλιά Γιάννενα. Σχέδια-σχόλια. Εκδοτικός Οίκος «Μέλισσα»: Αθήνα 1986 (Siniki-Papakosta, Nitsa: Old Ioannina. Drawings-Comments. Melissa Editions: Athens 1986)

Σινίκη-Παπακώστα, Νίτσα: Το Κάστρο των Ιωαννίνων. Σχέδια-σχόλια. Νομαρχιακή Αυτοδιοίκηση Ιωαννίνων: Ιωάννινα: 2007 (Siniki-Papakosta, Nitsa: The Castle of Ioannina. Drawings-Comments. Prefecture of Ioannina: Ioannina 2007)

Υπουργείο Πολιτισμού, 8^η Εφορεία Βυζαντινών Αρχαιοτήτων: Τα Βυζαντινά Μνημεία της Ηπείρου. Ιωάννινα 2008 (Hellenic Ministry of Culture, 8th Ephorate of Byzantine Antiquities: The Byzantine Monuments of Epirus. Ioannina 2008)

Υπουργείο Πολιτισμού, 8^η Εφορεία Βυζαντινών Αρχαιοτήτων: Μνημεία των Ιωαννίνων. Πόλη, Νησί, Λεκανοπέδιο. Ιωάννινα 2009 (Hellenic Ministry of Culture, 8th Ephorate of Byzantine Antiquities: Monuments of Ioannina. The town, the island, the basin. Ioannina 2009)

Υπουργείο Πολιτισμού, 8^η Εφορεία Βυζαντινών Αρχαιοτήτων: Το Κάστρο των Ιωαννίνων. Ιωάννινα 2009 (Hellenic Ministry of Culture, 8th Ephorate of Byzantine Antiquities: The Castle of Ioannina. Ioannina 2009)

Ψημένος, Στέφανος Γ.: Αναξερευνητη Ηπειρος. Εκδόσεις ROAD: Αθήνα 2007 (Psimenos, Stephanos G.: Undiscovered Epirus. Road Editions: Athens 2007)

Xatzis, Dimitris: The End of our Small Town. Centre for Byzantine, Ottoman and Modern Greek Studies: Birmingham 1995

Xouliakas, Nikos: Je m' appelle Loussias, moi. Hatier - Librairie Kauffmann: Athènes 1993



PRIZRENI

Qyteti i Filigranit

Hyrje

Shekuj me radhë, nën qeverisjet e mbretërive dhe perandorive të shumta, Prizreni ka qenë qendër e rëndësishme tregtare, administrative dhe kulturore. Çdonjëra nga këto mbretëri dhe perandori, veç tjerash, la pas vetes thesare të pasura vlerash kulturore, historike dhe arkitektonike, të cilat tashmë e bëjnë Prizrenin një qytet të veçantë dhe qendër të kulturës kosovare dhe gjithëkombëtare.

Qyteti shtrihet rrëzë maleve të bukura panoramike të Sharrit dhe ndahet në dy pjesë nga Lumëbardhi. Në kohët e nxehta verore Lumëbardhi sjell pa ndalur freskinë joshëse nga Malet e Sharrit, gjersa në stinën e dimrit popullohet nga pulëbardhat shtegtare të ardhura nga bregdeti i Adriatikut, çka e bën qytetin të rrezatojë bukurinë e gërshetuar nga puna e dorës së njeriut me atë të dhuruar hyjnore.

Romakët e vjetër e quanin Therandë, bizantinët e quanin Prizdrijana, dhe të gjithë e kishin qendër, nëpër të cilën kalonte rruga e vjetër dardane “Via de Zenta”.

Besohet se lulëzimin më të madh Prizreni e përjetoi në shekullin XIV, gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, kur bëhet qytet i rëndësishëm tregtar e zejtar me mbi 1500 shitore, si dhe qendër e kulturës dhe artit.

Për Prizrenin zakonisht thuhet se është “Qytet-muze” ose qytet i burimeve dhe i bukurive. Prizreni është qyteti më i pasur kosovar me monumente të kulturës. Nën mbrojtjen e shtetit janë më tepër se 65 objekte të trashëgimisë kulturore, të gjithat me thesare artefaktesh të periudhave të ndryshme.

Në qytet jetojnë shqiptarë, turq, boshnjakë, romë dhe të tjerët, të cilët me punën e tyre ndërtojnë një mjedis të fqinjësisë së mirë, të respektit të ndërsjellë dhe një të ardhme premtuese.

Prizreni është qytet i cili duhet vizituar si për bukuritë magjepse të reflektuara nga monumentet kulturore, historike, ashtu dhe mjedisin panoramik si edhe mikpritjen e prizrenasve.



Monumentet

Me një numër të madh të objekteve fetare dhe profane në pjesën e vjetër të qytetit, të ndërtuara afër njëra-tjetrës, qendra e qytetit është tejet tërheqëse, piktoreske dhe njihet si më e ruajtura në Kosovë. Një ngjitje e shkurtër në kodrën aty pranë çon në kalanë e qytetit – nga e cila shihet tërë Prizreni. Tradita e vjetër e tolerancës ndëretnike dhe ndërfetare vërehet nga distanca e vogël ndërmjet objekteve qindravjeçare fetare, si kishat katolike e ortodokse, xhamitë dhe teqet.

Xhamitë


Prizreni ka 46 xhami, shumica e të cilave janë ndërtuar në periudhën osmane. Të ndërtuara nga punëtorët vendas dhe të disenuara mirë, ato kanë hapësira të brendshme mbresëlënëse, që lidhen me kupolat, hajajat dhe me minaret në pjesët e jashtme. Xhamitë kanë qenë të lëna pas dore me vite dhe janë dëmtuar nga lufta e vitit 1999 në Kosovë. Projektet e pasluftës, kryesisht të financuara nga Turqia, kanë filluar rinovimin dhe restaurimin e tyre. Vizitorët janë gjithmonë të mirëpritur në xhami, ndërsa gjatë kohës së faljes, ata mund të shëtisin në mjediset e jashtme. Koha e vizitës preferohet të jetë prej 08:00–12:00 dhe prej 14:00–16:00. Fotografimi është i lejuar; preferohet një veshje sa më modeste për hyrjen në xhami, si dhe duhet të hiqen këpucët para se të hyhet brenda. Disenjimi i xhamive është bërë sipas rregullave të caktuara. Zakonisht është një kupolë në ndërtesë, afër saj vjen minarja, e cila shërben për thirrjen për falje dhe *hajati* (salla), ku besimtarët heqin këpucët para se

të hyjnë brenda. Pjesa për larje përdoret për marrje të *avdesit* (rituali i pastrimit me ujë), ndërsa çdo xhami është e orientuar apo e drejtuar nga Meka. Xhamitë më të mëdha zakonisht janë të rrethuara me mure, kanë kopsht, varre, ndonjëherë edhe *tyrbe* (varrezë shenjtore), *ders'hone* (mësonjëtorë), si dhe *medrese* e *maktab* (shkollë fillore dhe e mesme fetare). Mund të vërehen edhe piktura delikate e dekorime, të cilat asnjëherë nuk portretizojnë njerëz, por fokusohen në paraqitje të figurave gjeometrike, florës, ornamenteve dhe *arabeskave* (kaligrafi arabe).

Kishat

Prizreni ka disa kisha shumë të bukura, të cilat i takojnë periudhave të ndryshme historike. Për shkak të ndërrimeve të shpeshta të sundimtarëve, ndryshuan edhe destinacionet. Kishat u takojnë besimeve ortodokse dhe katolike. Vizita brenda kishave ortodokse është e mundur vetëm me leje të veçantë, të siguruar paraprakisht nga kreu i kishës ortodokse serbe në Graçanicë, ndërsa kishat katolike janë gjithnjë të hapura.

Filigrani



Filigrani, i njohur në Kosovë si zanat i lashtë, ka përdorur arin dhe argjendin për të prodhuar stoli të punuara me saktësi e mjeshtëri të jashtëzakonshme në mijëra nyje. Filigrani besohet që e ka origjinën nga egjiptianët e lashtë dhe u përsos më vonë nga etruskët dhe grekët. Të dhënat historike tregojnë se filigrani në Kosovë ka arritur

gjatë shekullit XV dhe që nga ajo kohë nisi të prodhohet në këtë zonë. Sot janë përafërsisht rreth 200 prodhues të vegjël të filigranit në Prizren dhe në rrethinën e tij, të cilët mbijetojnë duke shitur prodhimet e tyre nëpër dyqane të veçanta. Ndër më të mëdhenjtë dhe më të njohurit është grupi i dhjetë artizanëve, të cilët punojnë bashkë në një punëtori të vogël në veriperëndim të qytetit. E quajtur thjesht Filigrani, kompania ka qenë e themeluar në sistemin e mëparshëm komunist në vitin 1947 dhe ka mbijetuar me shumë vështirësi, derisa u detyrua të mbyllet pas procesit të privatizimit pas luftës së vitit 1999. Grupi i dhjetë artizanëve tani punon jashtë ndërtesës, duke prodhuar, me metoda tradicionale, punime elegante me porosi për klientë brenda dhe jashtë vendit. Punëtorja e tyre mund të vizitohet nga çdonjëri që është i interesuar të shohë këtë lloj pune nga afër. Punëtorja gjithashtu ka edhe dyqanin me prodhime të ekspozuara, të cilat mund të blihen.

Përshkrimi i shkurtër i Kosovës dhe vendndodhjes së Prizrenit

Republika e Kosovës është një shtet i vogël në qendër të gadishullit Ballkanik. Kufizohet me Maqedoninë (IRJM), Shqipërinë, Serbinë dhe Malin e Zi dhe ka një sipërfaqe prej 10.877 km². Bazuar në Rezolutën nr. 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Kosova ka qenë territor i administruar nga Administrata Civile e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara. Propozimi gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës ka qenë i prezantuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) përmes anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 26 Mars 2007. Në deklaratën e Pavarësisë më 17 Shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës shprehu përkushtimin e tij për implementimin e plotë të marrëveshjes.

Kryeqyteti i Kosovës është Prishtina. Kosova është e ndarë në 7 rajone: Ferizaji, Gjakova, Gjilani, Mitrovica, Peja, Prishtina, Prizreni, dhe 36 njësi administrative (komuna).

Komuna e Prizrenit gjendet në jug të Kosovës dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 640km², që përbën 5.94% të territorit të përgjithshëm të Kosovës. Prizreni në perëndim ndan kufirin me Shqipërinë, në jug me komunën e Dragashit, në jug-lindje me Maqedoninë (IRMJ), në lindje me komunën e Shtërpcës, në verilindje me komunën e Suharekës, në veri me komunën e Rahovecit dhe në veri-perëndim me komunën e Gjakovës. Qendra e komunës së Prizrenit është qyteti i Prizrenit. Largësia nga Prizreni deri në Prishtinë është 77 km, Tiranë 198 km, Shkup 122 km, Podgoricë 260 km dhe Beograd 420 km.

Karakteristikat natyrore dhe topografike

Komuna e Prizrenit gjendet në lartësi 412 - 500 m mbi nivelin e detit. Është e rrethuar nga Malet e Sharrit, të cilat pikën më të lartë e arrijnë në 2748 metra. Komuna ka një rrjet të pasur dhe të dendur të lumenjve.



Lumenjtë derdhen në Drinin e Bardhë dhe në detin Adriatik. Lumenjtë të cilët rrjedhin nga Mali i Sharrit janë të shpejtë, të thellë dhe kanë çarje të ngushta, të cilat shpesh formësojnë kanione. Këta lumenj ruajnë vëllimin e ujit edhe në verë prej shkrirjes së borës nga Malet e Sharrit. Rrjedhja mesatare është 56m³/sekondë dhe rezervuari ujqor ka sipërfaqe të përgjithshme 18,592 km². Në komunën e Prizrenit kryesisht dominon klima kontinentale. Gjithashtu klima mesdhetare depërton

nga rrymat e Adriatikut, të cilat vijnë nëpërmes kanionit të Drinit të Bardhë. Kjo klimë ndihmon në kultivimin e rrushit me cilësi të lartë, si dhe pemëve e perimeve. Temperatura vjetore mesatare është 12.5 gradë celsius, me temperaturën më të ulët në 1.3 gradë celsius gjatë muajit janar dhe me temperaturën më të lartë 23.2 gradë celsius gjatë muajit korrik.

Historiku i shkurtër i Prizrenit

Prizreni, Theranda antike, gjatë periudhave të ndryshme historike shfaqet si një prej qendrave të mëdha ekonomike-kulturore. Sipas dokumenteve latine Prizrenin e hasim me emra të ndryshëm, si : Prisren, Prisrenum, Presarin, Prisarano, Prisreno, Prisori, Pristren, Prisarini, Jorsaim etj. Bizantinët e quajtën Prisdriana, Prezren, Prizorian. Në dokumentet osmane qyteti haset me emrat Tarzerin, Perserin, Zer in etj. Ndërkaq sllavët e quanin Prizren, Prezren, Prizrin, Prizdren, Prezdrin etj.

Trashëgimia kulturore e Prizrenit reflekton historinë e mrekullueshme të qytetit me një kulturë të shtresuar ndër shekuj deri në ditën e sotme. Duke e pasur një pozitë të volitshme gjeografike dhe gjeopolitike, Prizreni gjithmonë është gjendur në udhëkryq të kulturave të mëdha, si dhe të atyre etnike të cilat kanë jetuar pranë njëra tjetrës, si dardano-iliro-shqiptare, romake, bizantine, sllave, turko-osmane etj. Kjo ka bërë që në qytet, gjatë shekujve, të flitëshin disa gjuhë zyrtare.

Në vitin 1018-1019, sipas kartës së perandorit Bizantin Bazili II, Prizreni përmendet si Peshkopatë nën juridiksionin e Kryepeshkopatës së Ohrit. Në vitin 1072, nën udhëheqjen e George Voiteh-ut, u zhvillua kryengritja e popujve të Ballkanit kundër pushtetit të perandorit bizantin Mihali VII Duka, kryengritje e cila u shua më 1073. Menjëherë pas Kryqëzatës së Katërt, në vitin 1204, Prizrenin e sunduan bullgarët. Rreth viteve 1214-1216, qytetin e pushtoi Stefan Prvovençani dhe më pas u vu përsëri nën pushtimin bullgar. Gjatë kësaj periudhe, qyteti ishte i mbrojtur nga fortesa e vet dhe disa të tjera rreth tij. Prizreni ishte qytet i tregtisë së lirë, qendër e artit dhe kulturës, rezidencë e ipeshkvisë katolike dhe peshkopit bizantin, bullgar dhe serb.

Besohet se kulmin e zhvillimit Prizreni e arriti gjatë shekullit XIV. Në këtë kohë ai kishte marrë pamje tipike të qyteteve perëndimore mesjetare: *civitas* (qendër administrative dhe ekonomike) dhe *castrum* apo *castellum* (qytet kala). Sipas përshkrimeve të kohës, Prizreni i ngjante shumë Raguzës (Dubrovnikut). Në të vërtetë, Prizreni gjatë gjysmës së parë të shekullit XIV ishte qendër e madhe e kolonistëve raguzianë. Për qëllime të mbrojtjes së interesave të tyre, tregtarët raguzianë që vepronin këtu kërkuan që të emërohej një konsull në qytet. Sipas vendimit të Këshillit të Madh Raguzian të datës 8 Mars 1332, u ngrit konsullata raguziane në Prizren (*quod eius mansio sit in Prisren*).

Data e mësipërme shënon edhe fillimet e jetës konsullore në Kosovë. Ndërkaq Prizreni zotëronte eksterritorialitet gjyqësor. Një përvojë e tillë u përhap edhe në qytete të tjera të Kosovës, si në Novo Bërdë, Trepçë,

Prishtinë, Pejë dhe Janjevë. Në Prizren raguzianët ngritën edhe disa institucione të tjera, si doganën, farkëtoren për prerjen e monedhave, kisha dhe spitale. Në këtë qytet është farkuar edhe monedha me mbishkrimin “Prisren”.

Në gjysmën e dytë të shekullit XIV qyteti filloi të dobësohej për shkak të konflikteve dhe përçarjeve politike. Atë kohë, pas vdekjes së perandorit Dushan (1355), qyteti sundohej nga mbreti serb Vukashi (1360-1371), më pas nga princërit arbërorë të familjeve Balshaj dhe Kastrioti. Gjatë gjithë mesjetës në Prizren dhe rrethinë janë ngritur monumente të njohura të kultit romano-katolik (*Sancta Maria de Prisren* dhe *Sanctus Petrus supra Prisren*) dhe monumente të kultit ortodoks bizantin e serb (*Kisha e Zonjës Prene-Bogorodica Ljevishka* dhe *Manastiri i shenjtorëve Mihal Gabriel-Sveti Arhangjel afër Prizrenit*).

Ka të ngjarë që qyteti të ketë rënë disa herë në sundimin osman, derisa më 1459 ra përfundimisht nën administrimin e Perandorisë Osmane, kur nisi të lulëzojë përsëri. Në shekullin XVI u ndërtuan monumente kulturi të mrekullueshme osmane, si Xhamia e Gazi Mehmet Pashës, Hamami i Gazi Mehmet Pashës dhe Xhamia e Sinan Pashës. Në atë kohë Prizreni u bë pjesë e provincës osmane të Rumelisë. Shquhej si qytet tregtar me prosperitet, duke përfituar nga pozita gjeografike dhe nga rrugët tregtare në veri-jug dhe lindje-perëndim. Prizreni u bë qyteti më i madh i administratës osmane në Kosovë. Në fund të shekullit XVII Prizreni u pushtua nga austriakët dhe forcat e tyre aleate, mirëpo shumë shpejt osmanët përsëri e rimorën kontrollin e plotë.

Prizreni ishte qendër kulturore dhe intelektuale e Kosovës gjatë periudhës



osmane. Ishte i dominuar nga popullata myslimane, e cila e përbënte mbi 70% të popullatës së përgjithshme në vitin 1857. Në vitin 1878, në kohën e Lidhjes së Prizrenit, qyteti u bë qendra më e madhe kulturore e shqiptarëve dhe

kryeqendër e koordinimit të politikës dhe kulturës shqiptare jo vetëm të Kosovës.

Në shekullin XX qyteti përjetoi një periudhë intensive të ndërtimeve të shpejta, sidomos në zonat tregtare. Prej fundit të vitit 1918, kur u formua Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene, Prizreni u pushtua nga kjo mbretëri dhe hyri nën ombrellën e këtij shteti të sapo themeluar, i cili nga viti 1929 u quajt mbretëri e Jugosllavisë. Për dhjetëvjeçarë të tërë, qyteti u bë njëra ndër qendrat më të fuqishme të nacionalizmit shqiptar në luftën për pavarësi.

Prizreni dhe rrethina e saj u prekën rëndë nga lufta në Kosovë e vitit 1998-1999. Me të përfunduar lufta, në qershor të vitit 1999 pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare u kthye në Prizren.



E gjetura arkeologjike më e rëndësishme dhe më e famshme në Prizren është Vrapuesja e Prizrenit, një figurë e një vajze duke vrapuar, e punuar në bronz, e cila është zbuluar në shekullin XIX dhe i është shitur Muzeut Britanik, ku gjendet edhe sot. Bazuar në hulumtimet e specialistëve të Muzeut Britanik, figura është punuar në Spartë gjatë viteve 500 para Krishtit. Ajo mund të ketë ardhur në Prizren si dhuratë e veçantë apo si pre luftime.

Karakteristikat e popullsisë në Kosovë dhe Prizren

Numri i popullsisë në Kosovë, duke u bazuar në regjistrimin e fundit, është vlerësuar nga 1.800.000 deri në 2.000.000 banorë. Duke u bazuar në analizat e standardeve të vlerësimit të jetesës, mbi 88% të popullsisë kosovare janë shqiptarë të Kosovës, 7% serbë, 1.9% myslimanë boshnjakë, 1.7% romë dhe 1% turq.

Qyteti i Prizrenit është qendra administrative e komunës së Prizrenit që ka 76 fshatra dhe përafërsisht 220.000 banorë. Pas luftës së vitit 1999 së paku 40.000 persona nga komuna e Prizrenit janë zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës. Rikonstruksioni i shpejtë dhe i suksesshëm i mbi 10.000 shtëpive pas përfundimit të luftës krijoi kushte që shumica e të zhvendosurve të kthehen nëpër shtëpitë e tyre.

Komuna e Prizrenit ka përafërsisht 90% shqiptarë dhe grupe minoritare boshnjake, turke, rome dhe serbe. Bazuar në regjistrimin e përgjithshëm të Kosovës të vitit 2011, qyteti i Prizrenit është vlerësuar të ketë 178.112 banorë.



Në qytetin e Prizrenit jetojnë shqiptarë, boshnjakë, turq, romë dhe serbë. Edhe pse boshnjakët kosovarë janë grupi më i madh minoritar në numër, komuniteti turk është mjaft i mirënjohur dhe me influencë. Turqishtja flitet më së shumti edhe nga shqiptarët e Prizrenit dhe Kosovës. Në pjesën veriore, në rajonin e Podrimës, jetojnë së bashku shqiptarë dhe turq, në rajonin e Podgorës jetojnë së bashku shqiptarë dhe boshnjakë, në pjesën jug-lindore të komunës, në Luginën e Zhupës jetojnë kryesisht boshnjakë dhe pjesërisht shqiptarë dhe serbë.

Karakteristikat ekonomike të qytetit të Prizrenit

Ndërmarrjet private në komunën e Prizrenit janë të bazuara në agrikulturë, tregti, ndërtimtari dhe prodhimin e produkteve ushqimore. Bizneset private në të shumtën e rasteve kanë vështirësi në sigurimin e investimeve kapitale, si nga entitetet lokale, ashtu edhe nga ato të huaja. Problematikë shtesë është konkurrenca e produkteve nga Serbia, Shqipëria, Turqia dhe Kina, të cilat e dominojnë tregun. Për shkak të vështirësive financiare, disa kompani janë mbyllur, ndërsa të tjerat po e reduktojnë numrin e të punësuarve. Rënia ekonomike po kontribuon drejtpërsëdrejti në ngritjen e shkallës së papunësisë dhe me këtë, edhe të shkallës së varfërisë.

Strategjitë ekonomike priret të orientohen në turizmin kulturor, panoramik, rural dhe të ngjashme.

Pothuajse i gjithë prodhimi i agrikulturës dhe blegtorisë është në duart e privatëve, biznese joformale dhe në shkallë të vogël.

Në Prizren dhe komunë vepronë 7 banka përmes degëve të tyre si ProCredit, Raiffeisen, Banka Ekonomike Turke (TEB), Nova Ljubljanska Banka (NLB), Banka Private e Biznesit (BPB), Banka Ekonomike dhe Banka Kombëtare Tregtare (BKT). Gjithashtu shërbimet e veta i japin edhe institucionet mikro financiare si FINCA, KEP etj.

Llogaritet se Komuna e Prizrenit ka të punësuar rreth 21.499 persona.

Prej tyre 12.371 janë të punësuar në sektorin privat dhe 4.341 në sektorin shoqëror dhe 4.787 në sektorin publik. Shumica e të punësuarve punojnë në sektorin industrial (41%), tregti me shumicë dhe pakicë (24.6%), shërbime (20%) dhe ndërtim (13.4%).

Rreth 60% e banorëve të komunës së Prizrenit jetojnë në viset rurale dhe të ardhurat i fitojnë nga aktivitetet bujqësore. Sektori i bujqësisë dhe i blegtorisë siguron një kontribut të madh në prodhimin e brendshëm bruto të komunës, e pasur me burime të shumta bujqësore, ku përgjatë shekujve ka prodhuar lloje të ndryshme të drithërave, rrushit, pemëve dhe perimeve.

Komuna e Prizrenit ka potencial të madh për zhvillim të turizmit, duke marrë parasysh pozitën gjeografike, malet piktoreske të Sharrit, kushtet klimatike të përshtatshme dhe pasuritë e trashëgimisë së lashtë kulturore. Mikpritja e ngrohtë, e shoqëruar me ushqimin e shijshëm tradicional prizrenas, mund të haset në çdo kënd të qytetit të Prizrenit dhe përgjatë luginës së Lumbardhit dhe të Zhupës, ku mund të përjetohen çaste nga më të bukurat të ofruara nga mikpritja zemërgjerë e hotelierëve prizrenas.

Shërbimet sociale, shëndetësore dhe edukimi

Qendra për Mirëqenie Sociale (QMS) është ndër institucionet komunale e cila bart një gamë shumë të gjerë të përgjegjësive në shërbimet sociale, këshillimet familjare, etj. Divorcet, fëmijët e rrugës dhe jetimët janë disa nga problemet me të cilat kjo qendër përballet në vazhdimësi. QMS në mes të tjerash siguron asistencë materiale për njerëzit e paaftë, të moshuar dhe të cenusëm, refugjatët e kthyer, personat e zhvendosur etj.

Komuna e Prizrenit në sektorin shtetëror ka shërbimin shëndetësor parësor të mbështetur nga 32 qendra të mjekësisë familjare të shpërndara nëpër tërë komunën, si dhe shërbimin dytësor të mbështetur nga një spital rajonal me mbi 670 punëtorë shëndetësorë, i cili ofron shërbime për më tepër se 400.000 banorët e rajonit të Prizrenit. Shërbimet e ofruara janë shërbimi emergjent me kujdes intensiv dhe shërbimi stacionar.

Sektori shëndetësor privat është mjaft i përhapur dhe mbulon një pjesë mjaft të madhe të nevojave të komunës me 50 njësi private shëndetësore dhe laboratorë, mbi 30 njësi të shërbimit stomatologjik dhe mbi 40 farmaci.

Komuna e Prizrenit ofron mundësi arsimimi dhe edukimi në të tre nivelet e shkollimit fillor, të mesëm dhe arsimim të lartë. Në komunën e Prizrenit

veprojnë mbi 50 shkolla fillore publike dhe 2 shkolla fillore private, 5 të mesme publike dhe 2 shkolla të mesme private, 1 universitet publik dhe 6 institucione private të arsimit të lartë të licencuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës. Arsimi nëpër këto institucione arsimore zhvillohet në të gjitha gjuhët e komuniteteve të komunës (shqip, boshnjakisht/serbisht, turqisht).

Në komunën e Prizrenit funksionojnë edhe 2 shkolla speciale, njëra për fëmijë me vështirësi në të dëgjuar dhe folur dhe tjetra për fëmijët me zhvillim të ngadalshëm.


Objektet e trashëgimisë kulturore

Kalaja

Kalaja e Prizrenit përmban në vetvete një pjesë të rëndësishme të historisë së lashtë të qytetit. Pozicioni i saj topografik dominues mbi qytetin, peizazhi natyror tejet tërheqës dhe konfigurimi arkitektonik i menduar mjaft mirë, e bëjnë këtë objekt me vlera të padiskutueshme arkeologjike, historike dhe turistike. Është e vendosur në pjesën lindore të qytetit, mbi një kodër me formë konike, me lartësi 525 metra mbi nivelin e detit. Muret fortifikuese ndjekin izoipset e terrenit, duke rrethuar një sipërfaqe afërsisht 1.5 hektarë në trajtë thujase vezake me zgjatje veri-jug. Burimet e shkruara flasin shumë pak për kalanë e Prizrenit. Shënimi më i vjetër që dihet është ai i kronistit bizantin, Prokopi i Çezaresë, në veprën “De aedificiis” - Mbi ndërtimet. Në këtë vepër, mes fortifikimeve të meremetuara në Dardani, evidentohet për herë të parë edhe kjo kala me emrin Petrizen. Një studim më voluminoz është bërë në vitin 1969, me ç’rast, krahas gërmimeve arkeologjike, është bërë edhe incizimi arkitektonik i kalasë. Gjatë këtyre gërmimeve janë gjetur gjurmë nga shekujt XI-XIX. Vazhdimi i gërmimeve arkeologjike në vitet 2004 dhe 2009 deri në vitin 2011 nxori në pah një vendbanim parahistorik, që daton që nga epoka e bronzit dhe periudha e hershme e hekurit, vendbanim i cili ka shërbyer si bërthama e parë e jetës në këtë vend. Po ashtu, për herë të parë, këto gërmime dhanë gjurmë të arkitekturës dhe dëshmi të materialit që datojnë nga periudha romake dhe antikiteti i vonë.

Gjatë periudhës osmane, kalaja zgjerohet duke ndërtuar dhe përforcuar muret fortifikuese, ku pasurohet me objekte të reja si hamami, xhamia dhe objekte të tjera për nevoja ushtarake. Kalaja e Prizrenit funksionin primar e kreu deri në vitin 1912. Duke filluar që prej asaj kohe objekti lihet pas dore, duke filluar të





- PERIUDHA ANTIKE**
 Faza e parë (shek V p.e.s.)
- PERIUDHA E MESJETES**
 Faza e parë (shek XI)
 Faza e dytë (shek XII-XIII)
 Faza e tretë (shek XIV)
- PERIUDHA OSMANE**
 Faza e parë (shek XVI)
 Faza e dytë (shek XVII)
 Faza e tretë (shek XVIII)
 Faza e katërt (shek XVIII-XIX)
 Faza e pestë (shek XVIII-XIX)





degradohet. Nga viti 2008 fillojnë disa punë restauruese-konservuese, si masë emergjente në parandalimin e këtij procesi degradues. Kalaja është një nga pikat më interesante për hulumtimin e mëtejshëm dhe për promovimin e vlerave të turizmit kulturor- historik në territorin e Kosovës.

Kisha e Shën Premtes - Levishka



Kjo kishë u rindërtua në vitin 1307 nga mbreti Milutin mbi mbetjet e një faltoreje të vjetër, respektivisht të kishës bizantine dhe iu kushtua Shën Mërisë. Pas rënies së Prizrenit nën sundimin e Perandorisë Osmane në vitin 1455, ky objekt shndërrohet në xhami, e cila ka pasur funksion të dyfishtë: të plotësonte nevojën për

një faltore derisa të ndërtoheshin xhamitë e reja dhe të demonstronte fuqinë e sundimitarit të ri, pra t'i bënte me dije popullatës se kush ishte "zot shtëpie". Për këtë shkak objekti thirrej edhe si "Fet'hije"(çlirimtarë) dhe "Xhuma xhami" (xhamia e së Premtes). Pas ndërtimit të xhamive të para në Prizren, ky objekt sërisht shfrytëzohet si kishë deri në shekullin XVIII. Prej vitit 1756, objekti përsëri shfrytëzohet si xhami deri në vitin 1912-13, kur fillojnë Luftërat Ballkanike. Gjatë shndërrimit të kishës



në xhami objekti suvatohet nga brenda dhe jashtë, mbyllet disa dritare dhe mbi këmbanare ndërtohet minarja (pjesa e "sherefe"-së – ballkonit). Pas vitit 1913 objekti shfrytëzohet si kishë, ndërsa në vitin 1923 rrenohet minarja mbi këmbanare.

Në vitet 1950-52 bëhet restaurimi dhe konservimi i përgjithshëm i kishës, gjatë së cilit hiqet suvaja, hapen dritaret e mbyllura dhe bëhen përf forcime të tjera. Gjatë punimeve restauruese-konservuese sërisht zbulohen piktura murale në brendësi dhe pas përfundimit, objekti shndërrohet në muze. Gjatë viteve 2005-2008 janë bërë rinovime të ndryshme në pullaz dhe në e pjesët e brendshme të objektit.

Baza e objektit është drejtkëndëshe. Fillimisht objekti ka qenë me tre aniade, por me rindërtimin e saj në vitin 1307, kur shtohen pesë kube dhe ndërtohet pjesa e eksonarteksit me këmbanare, objekti merr formën e një kisha me pesë aniade, e deformuar (jo proporcionale). Nga ana e jashtme objekti nuk është i suvatuar dhe kështu struktura murale e jashtme me gurë dhe tulla është e dukshme. Nga ana e brendshme objekti është i suvatuar dhe pjesërisht i pikturuar. Ky objekt është monument i parë i qytetit të Prizrenit që u radhit në listën e UNESCO-s në vitin 2006.

Kisha e Shën Spasit (Shpëtimtarit)

Në pjesën më dominuese të pjesës së vjetër të qytetit, në jug-perëndim të kalasë, në një terren mjaft të pjerrët është ngritur kisha e Shën Shpëtimtarit. Për kohën e ndërtimit nuk kemi ndonjë të dhënë të saktë, por supozohet se është ndërtuar mes viteve 1307-1348, duke u bazuar në faktin që ky objekt përmendet në dekoratën e Dushanit (1348). Në këtë dekoratë përmendet si ndërtues i kishës Mlladen Vlladojeviq, i cili ia kushtoi atë Shën Shpëtimtarit. Më vonë këtë objekt e shfrytëzonin Cincarët që punonin në objektin e Kalasë në kohën e aristokratëve prizrenas Rrotulla (rreth 1836). Kisha ka formë drejtkëndëshe me një absidë, ndërsa pjesa e narteksit është me qemer dhe kulm dyujor nga ana e jashtme, ndërsa pjesa qendrore është me një kube. Më vonë objekti është zgjeruar në anën jugore dhe, pas djegies që pësoi në vitin 1882, i bëhet edhe një zgjerim më i madh në anën jugore dhe perëndimore, por punimet nuk përfunduan



asnjëherë. Me këtë zgjerim u planifikua që kisha të ishte më e madhe dhe u pagëzua si kisha e Shën Trinisë. Në pjesën e brendshme ka edhe piktura murale që janë bërë sipas shembullit të kishës së Levishkës në pjesën e eksonarteksit. Në vitet 1950-52 objekti restaurohet rrënjësisht, ku rrënohet pjesa e zgjeruar nga faza e dytë në anën jugore, si dhe ndërrohet pamja e jashtme e saj. Disa rinovime të mëtejshme të vogla u ndërmorën edhe në vitet 2005-2006.

Kisha e Shën Gjergjit - Runoviq

Kisha e Shën Gjergjit-Runoviqit gjendet në pjesën e vjetër të qytetit, në sheshin “Shatërvan”, respektivisht në oborrin e kishës Sinodale të Shën Gjergjit. Objekti është ndërtuar në fund të shekullit XV nga vëllezërit Runoviq. Më vonë, në fund të shekullit XIX, ndërtohet kisha Sinodale me të njëjtin emër dhe, për këtë arsye, kisha e vjetër u përdor për ruajtjen e ikonave dhe rekuizitave të tjera kishtare. Objekti i takon llojit të kishave familjare të mesjetës, me bazë drejtkëndëshe me absidë dhe ka qenë me tre aniada (nefe), që është vërtetuar gjatë gërmimeve të bëra në vitin 1994. Gjatë këtyre gërmimeve është zbuluar edhe pjesa e narteksit dhe varrezat përreth. Objekti është ndërtuar me gurë lumi me qemerë nga ana e brendshme, ndërsa nga ana e jashtme është me kulm dyujor të veshur me pllaka plumbi. Brenda objektit, në anën jug-perëndimore gjendet varri i Mitropolitit Mihajlo (1733-1818). Në mjediset e brendshme të kishës janë vendosur afresket që datojnë nga shekulli XVII. Në vitet 1994-95 objekti është restauruar dhe konservuar nga ana e jashtme dhe e brendshme, si dhe është rregulluar hapësira për rreth. Gjatë viteve 2005-2010 janë bërë disa rinovime në objekt dhe në oborr, duke përfshirë ndërrimin e pllakave të plumbit, suvatimin e brendshëm, instalimin elektrik, përforcimin dhe konservimin e pikturave murale, si dhe shtrimin e oborrit me pllaka mermeri.



Konkatedralja Zonja Ndihmëtare



Në jugperëndim të qendrës urbane, në bërthamën e vjetër të qytetit, në lagjen Qafëpazari, gjendet kisha katolike Zonja Ndihmëtare dhe objektet e tjera përcjellëse të saj. Objektin, me elemente të arkitekturës greko-romake respektivisht me stil roman, e ndërtoi në vitin 1870 argjipeshkvi Dario Bucciarelli, ndërsa më vonë, Toma Glasnoviq ngriti kambanoren dhe vendosi orën. Kisha është treaniade me altar gjysmë-harkor. Aniada e mesme është e mbuluar me pullaz dyujor, kurse aniadat anësore janë njëujore dhe të mbuluar me tjegulla. Shtyllat vertikale, shkallët dhe ballkoni janë prej druri, muret nga ana e brendshme janë të suvatuara me llaç gëlqeror, ndërsa nga jashtë janë të pa suvatuara, ku shihet struktura e murit me gurë shtufi.

Në qemerin e pjesës së mesme ndodhen afresket me teknikë “*al secco*” me prezantim të motiveve qytetare. Kështu në pikturën e Zonjës, te pjesa e altarit, prezantohen qytetarët e Prizrenit me veshjen karakteristike të kohës. Mbi çardak ndodhen pikturat e dy personave nga e kaluara e Ballkanit, Gjergj Kastriotit, prijësit të Principatës së shqiptarëve dhe Joannes de Hunyad-it, guvernatorit dhe kryekomandantit hungarez. Autori i këtyre pikturave është piktori austriak Simcowiss, i cili i pikturoi ato në vitin 1878. Objekti ka ruajtur origjinalitetin e vet deri në vitet 1970, kur me rastin e shënimit të 100 vjetorit, muret, shtyllat dhe dyshemeja u veshën me pllaka mermeri, shkallët dhe çardaku u shtruan me beton arme dhe u vendos gardhi metalik në hyrje dhe te shkallët.

Kompleksi i Konkatedrales Zonja Ndihmëtare përfshin dhe objektet tjera përcjellëse siç janë: Ndërtesa e Semenishtës (Shkolla Fetare Katolike), Ndërtesa e Priftërinjve, Ndërtesa e Motrave të Nderit, Selia e Ipeshkvisë, Ndërtesa e Famullisë dhe objektet e tjera të banimit dhe lokalet afariste.



Xhamia e “Namazgjahut”

Namazgjahu gjendet në anën veri-perëndimore të qytetit, pranë rrugës kryesore Prizren-Gjakovë. Fjala Namazgjah rrjedh nga fjala persiane që do të thotë vend për falje-lutje. Pas rënies së Prizrenit nën sundimin e Perandorisë Osmane në vitin 1455, Isa Beu, që ishte komandant i Fatih Sulltan Mehmedit, ndërtoi namazgjahun për një kohë shumë të shkurtër. Mjeshtri dhe mbikëqyrësi kryesor ishte “Çaushi” Ahmed. Pas vendosjes së plotë të administrimit osman në Prizren, Namazgjahu lihet pas dore, pasi

në atë kohë xhamitë e para të ndërtuara po merrnin një rol parësor. Për shkak se namazgjahu ishte vendosur në periferi të Prizrenit të atëhershëm, në afërsi të të cilit ndodheshin fushat, namazgjahu shfrytëzohej nga bujqit, të cilët e përdornin për t'u falur ndërsa punonin tokat e tyre. Në vitet '50-ta të shekullit XX, pranë ndërtohet një depo e madhe, për ndërtimin e së cilës përdoret edhe një pjesë e materialit guror të Namazgjahut. Gjithashtu edhe për ndërtimin e objektit të ambulancës gjatë viteve '80-ta të shekullit XX janë shkatërruar

varrezat e vjetra që ishin përreth Namazgjahut. Ashtu siç mund të vihet re edhe tani, aty kanë mbetur vetëm 3 prej varreve të atëhershme, të cilat tani janë shndërruar në tyrbe. Hulumtimet arkeologjike në objektin e Namazgjahut janë bërë në vitin 1969 dhe 1989, por fatkeqësisht nuk është ndërmarrë

asnjë masë mbrojtëse. Në vitin 2000, Instituti i Monumenteve Muzeale të Prizrenit, duke vlerësuar rëndësinë e këtij objekti, harton projektin për restaurimin e Namazgjahut. Më 2001 -2002, me përkrahjen financiare të qeverisë së Turqisë dhe Këshillit të Komunës, u kryen punimet restauruese të objektit dhe të rregullimit të mjedisit rreth tij. Gjatë restaurimit i është kushtuar kujdes materialit dhe teknikës së ndërtimit, që ato të jenë sa më identike me ato burimore.



Namazgjahu, është një objekt i rëndësishëm, pasi është i rrallë në llojin e vet në trevat e Ballkanit. Edhe pse kjo tipologji e xhamive dikur ishte mjaft e përhapur në këto treva, për shkak të natyrës së shfrytëzimit, thjeshtësisë dhe konstruksionit të dobët, pothuajse janë zhdukur tërësisht. Në tërë hapësirat e Ballkanit kanë shpëtuar vetëm 4 prej tyre, ndërsa në Kosovë janë vetëm 2 të tilla, të dyja në rajonin e Prizrenit.

Muzeu Arkeologjik - Sahat Kulla

Muzeu arkeologjik është vendosur në hapësirat e hamamit (banjë publike e periudhës osmane), të ndërtuar në fundin e shek. XV, pikërisht në vitin 1498. Ndërtuesi i këtij objekti supozohet të jetë Shemsudin Ahmed Beu. Në mungesë të burimeve të shkruara, nuk dihet saktë ndërtuesi dhe data e ndërtimit ose deri kur është shfrytëzuar si hamam, por dihet se hamami nuk ka kryer funksionin e vet fillestar në mesin e shek. XIX, kur



mbi hapësirën e ngrohtë të hamamit është ndërtuar kulla e sahatit nga ana e Eshref Pashës. Objekti ka formë drejtkëndëshe dhe është ndërtuar me gurë të ndryshëm.

Pullazi dhe kubetë janë të mbuluara me pllaka plumbi. Kulla e sahatit është ndërtuar me tulla argjile të pjekur. Duke u bazuar në sistemin funksional të hamameve, vërehet se objektit i mungon pjesa hyrëse – e ftohtë (apodyterium). Në pjesën që duhej të ishte kjo hapësirë ndodhej një shtëpi banimi e vjetër mbi 100 vjeçare, që na bën me dije se, së paku aq kohë, hamami nuk ka kryer funksionin e vet. Kjo u dëshmuar kur objekti i banimit u rrënuar në vitin 2003 dhe gjatë hulumtimeve arkeologjike janë konstatuar themelet e hapësirave të lartcekura që i

mungonin hamamit, mbi të cilat është ndërtuar objekti i banimit.

Objekti është braktisur për një kohë të gjatë dhe është shfrytëzuar nga banorët përreth si depo, kotec, etj. Ky degradim ka vazhduar deri në fund të viteve 1960-ta, kur fillojnë punët restauruese dhe konservuese me përmasa të mëdha.

Më 1975 bëhet hapja solemne e objektit, por me funksion të ri, nga një hamam në Muze Arkeologjik. Në muze prezantohen materiale nga vend gjetjet arkeologjike të rajonit të Prizrenit, zbulimet nga komuna e Prizrenit, Dragashit, Rahovecit dhe Suharekës. Materiali i prezantuar ka një diapazon kronologjik të gjerë me këtë ecuri: neoliti i hershëm, eneoliti, periudha e bronzit, periudha e hekurit, periudha romake, mesjeta e hershme dhe mesjeta e vonë. Në vitin 2008 është bërë rinovimi i pjesshëm i objektit.



Xhamia e Suzi Efendisë

Suzi Efendiu është ndër poetët më të vjetër të këtyre trevave. Është lindur dhe ka vdekur në Prizren. Pranë lumit ka ndërtuar një shkollë me leximore (bibliotekë), një çeshme (krua), kanal për ujtiqjen e fushave dhe një urë prej guri. Për nder të tij kjo lagje quhej Lagjia e Suziut. Emri i



poetit dhe historianit të famshëm është Muhamed-Efendi, i biri i Mahmudit e i biri i Abdullahut me pseudonim “Poeti Suzi”. Një kohë Suziu ka qenë Kadi (gjykatës), derisa angazhohet si sekretar personal i Gazi Ali-beut Mihalogllu, ku merr pjesë në luftëra së bashku me të. Pasi kthehet në vendlindje, përjetimet e veta i shpreh në poezi. Ka shkruar më se 15.000 vargje. Ka qenë mësimsdhënës në shkollën që ka themeluar. Po ashtu edhe librarinë e ka pasuruar me tituj të autorëve të njohur. Vdiq dhe u varros në oborrin e xhamisë. Pranë varrit të Suziut është varrosur edhe vëllai i tij Nehariu.


Xhamia është ndërtuar në vitin 1513 dhe është ndër objektet më të vjetra të periudhës osmane. Në oborrin e xhamisë gjenden edhe shumë varreza me mbishkrime shumë të bukura që janë nga shek. XVII, XVIII dhe XIX. Në vitin 1955 tyrbja vihet nën mbrojtjen e ligjit.

Xhamia e Suziut gjendet në anën e majtë të Lumbardhit. Ka formë drejtkëndëshe me kulm katërujor të mbuluar me tjegulla. Në anën veriperëndimore është edhe hajati që është ngritur mbi njëmbëdhjetë shtylla prej druri. Themelet dhe pjesa e ulët e mureve janë prej guri, ndërsa në vazhdim muret janë prej qerpiçi (argjila e papjekur) të suvatuar me llaç.

Minarja e Arasta Xhamisë

Në pjesën e vjetër të Prizrenit, në anën e djathtë të lumit Lumbardhi, Evrenos-Zade Jakup Beu, mes viteve 1526 dhe 1538, ndërtoi mesxhidin, ku pastaj ndërtohet edhe minarja. Përreth xhamisë ndërtohen dyqane dhe kështu kjo pjesë shndërrohet në një treg (çarshi) të mbyllur – “Arasta”, që sikurse xhamia, kryesisht shfrytëzohej nga tregtarët. Gjatë kohës xhamia restaurohet dhe rinovohet disa herë, pëson edhe ndryshime, si në pamje, ashtu edhe në shfrytëzim. Në shek. XIX objekti nga ana e jashtme punohet me stilin neo-klasik, ndërsa nga ana e brendshme zhvillohet në dy etazhe, ku pjesën e katit përdhes tregtarët e shfrytëzonin si depo dhe zyrë, ndërsa pjesën e sipërme e shfrytëzonin si hapësirë për lutje. Restaurimi i fundit në objekt kryhet në vitin 1911.

Objekti ka pasur funksion fillestar si xhami deri në vitin 1960. Në emër të “modernizimit” dhe të “zhvillimit” qeveria e atëhershme rrënoi komplekse të tëra në bërthamën e vjetër të Prizrenit, ku për qëllim ka pasur ndryshimin e pamjes dhe organizimit të qytetit. Fatkeqësisht, nga këto ndërhyrje, rrënohet tërësisht tregu i mbyllur “Arasta”, natyrisht edhe





xhamia, ku minarja e saj kursehet, duke mbetur si obelisk para kompleksit të banesave shumëkatëshe, që nuk përshtatet fare me urbanizmin organik dhe siluetën e qytetit, duke zhdukur krejtësisht pamjen fillestare.

Në vitin 1970 minarja e xhamisë restaurohet dhe konservohet, duke u regjistruar si monument kulture. Një restaurim-konservim bëhet edhe në vitin 2007 me përkrahjen e shoqatës suedeze Cultural Heritage Without Borders (CHwB) – Trashëgimia Kulturore pa Kufij, Këshillit Komunal dhe IMM-së i Prizrenit.

Saraç xhamia – Xhamia e Kukli Beut

Xhamia e Saraçhanës gjendet në lagjen, ku kohë më parë zejtarët punonin gjëra nga lëkura, prej nga objekti ka marrë edhe emrin. Xhamia ndodhet pranë Teqesë Halveti dhe në afërsi të hamamit të Gazi Mehmed Pashës. Është një ndër më të vjetrat e qytetit, e ndërtuar në vitin 1531 nga ana e Kukli Mehmed-beut, në atë kohë vali (udhëheqës rajonal) prej Selanikut deri në Bosnje. Ndërtesa ka formë katrore 9.0 x 9.0 m, e ndërtuar me gurë natyror dhe llaç gëlqeror si material lidhës. Mbi bazën katrore formohet tamburi tetëkëndësh, ku mbështetet kubeja. Hapësira qendrore nga ana e brendshme është me kube ndërsa nga jashtë me kulm tetëkëndësh mbuluar me rrasa guri. Është objekti i vetëm i mbuluar ende me rrasa guri. Me rastin e zgjerimit të rrugës në vitin 1963 është rënuar hajati i xhamisë, ndërsa në vitet 1977 dhe 1994 janë bërë disa rinovime jo profesionale dhe të dëmshme nga të cilat humbën pikturat murale nga brenda, si dhe elemente të drurit. Po ashtu edhe gjatë viteve 2000-2003 janë bërë rinovime dhe riparime të ndryshme. Në vitin 2008 bëhet rindërtimi i hajatit.





Xhamia e Mehmed Pashës

Xhamia e Mehmed Pashës (Bajrakli) gjendet në pjesën jug-lindore të qytetit dhe ka vlerë të veçantë kulturore dhe historike. Rreth viteve 1563 Gazi Mehmed Pasha ndërtoi hamamin, xhaminë, tyrben, medresenë, bibliotekën, ders-hanen dhe objektet tjera përcjellëse. Xhamia e Mehmed Pashës është njëra nga xhamitë më të mëdha të Prizrenit. Ajo ka formë katrore me hajat të theksuar në të tri anët. Derisa hapësira qendrore e lutjeve është me një kube dominuese, pjesa e hajatit është me kulm treujor





të mbështetur në shtylla druri. Objekti është ndërtuar me gurë dhe është suvatuar në të dy anët. Pullazi i xhamisë (kubeja, pandantifet, hajati etj.) është veshur me pllaka plumbi dhe llamarine. Edhe pse Mehmed Pasha ndërtoi tyrben (mauzole) në oborrin e xhamisë, ai nuk u varros aty pasi vdiq larg Prizrenit, në betejë diku në Panoni (Hungari). Përveç rëndësisë arkitektonike, xhamia e Mehmed Pashës ka rëndësi historike pasi në këtë objekt është mbajtur Kuvendi i Lidhjes së Prizrenit. Gjatë festave dhe manifestimeve të ndryshme në këtë xhami valonte flamuri, prej nga merr nofkën “Bajrakli” (flamurtar). Objekti është restauruar disa herë. Restaurimi i fundit dhe më i madhi është bërë në vitin 1994-1996, kur është bërë ripikurimi i brendshëm. Në oborrin e xhamisë janë edhe disa varreza të vjetra. Në vitet '70-ta të shek. XX një pjesë e kompleksit aneksohet për t'u shndërruar në muze të Lidhjes së Prizrenit.

Hamami i Gazi Mehmed Pashës

Hamami i Gazi Mehmed Pashës gjendet në qendër të qytetit, pranë xhamisë së Kukli-Mehmed Beut dhe xhamisë së Emin Pashës. Ai është ndërtuar rreth viteve 1563. Në portën kryesore është vendosur pllaka me mbishkrim (1833), e cila tregon datën e restaurimit të hamamit nga ana e vëllezërve Tahir dhe Mehmed Pashë Rrotulli. Hamami ka shërbyer si banjë publike nga viti 1927 deri në vitin 1944 dhe ka qenë pjesë integrale e jetës shoqërore dhe kulturore. Ai u shpall monument kulture në vitin 1954.

Hamami është i llojit “çifte hamam”, që është përdorur nga të dy gjinitë në të njëjtin kohë. Është ndërtuar nga gurë të ndryshëm. Pjesa për meshkuj është pak më e madhe se pjesa tjetër për femra. Hamami ka të gjitha hapësirat që kanë hamamet e këtij lloji,



pra përbëhet prej pjesës së ftohtë (*apodyterium*), që ka shërbyer për pritje, për pije dhe si zhveshtore, pastaj vjen pjesa e vakët (*tepidarium*), që ka shërbyer për të pajisur klientët me mjetet e duhura, si peshqirë, sapunë, etj. Në këtë hapësirë ndodhen edhe nyjet sanitare. Nga kjo hapësirë kalohet në hapësirën kryesore, që është pjesa më e ngrohtë (*caldarium*), ku bëhej larja, djeritja, masazhi dhe dëfrimi. Në kuadër të hamamit bën pjesë edhe hapësira teknike (qyllhani), ku janë depot e ujit dhe kaldaja. Këto hapësira janë në pjesën jugore të objektit dhe këtu klientët nuk kanë pasur qasje. Muret kanë një trashësi rreth 90 cm dhe nga ana e jashtme janë të pa suvatuar, ndërsa nga ana e brendshme ato janë suvatuar me llaç gëlqeror-horasan. Pullazi i objektit ka 2 kube të mëdha në pjesën e ftohtë dhe 9 kube të vogla që janë mbi pjesën e ngrohtë të hamamit. Pullazi i pjesës së vakët dhe kaldajës është në formë qemeri. Në pjesën e ftohtë mbulesa është me tjugulla, ndërsa në pjesët tjera me pllaka plumbi. Deri





në vitin 1964 hamami ka qenë i rrethuar me lokale; atëherë kur fillon edhe rrënimi i tyre fillojnë edhe punët restauruese-konservuese. Edhe në vitet '70-të të shekullit XX janë kryer disa restaurime; gjithashtu edhe pas viteve '80-të, kur objekti përfundimisht lihet pa përkujdesje dhe shfrytëzohet si depo. Pas vitit 2000, pjesa e ftohtë e hamamit përdoret si galeri arti. Edhe pse gjatë kohës ka pasur disa ndërhyrje, përsëri hamami nga aspekti kompozicional dhe strukturor e ka ruajtur originalitetin, në sajë të të cilit vlerësohet si monument kulture.

Kompleksi i Lidhjes së Prizrenit

Kompleksi është vendosur në bërthamën e vjetër të qytetit dhe ka vlerë të veçantë kulturore, historike, fetare dhe mjedisore. Ky kompleks është formuar me ndërtimin e hamamit të Gazi Mehmed Pashës, ku pastaj rreth saj janë ndërtuar edhe objekte tjera si medrese, tyrbe, leximore dhe objekte banimi. Objektet e banimit janë kryesisht në pjesën jug-perëndimore të kompleksit të hamamit të Gazi Mehmed Pashës, në kuadër të së cilës bën pjesë edhe kompleksi muzeal i Lidhjes së Prizrenit. Këto objekte të arkitekturës folklorike janë të shprehura si objekte të veçanta dhe në varg. Në fund të shekullit XIX dhe



në fillim të shekullit XX, gjatë restaurimeve dhe rindërtimeve në objektet e banimit, shihet qartë ndikimi i stilit barok europian me një përzjerje të stilit neo-klasik, që u jep këtyre pamje specifike. Fatkeqësisht pas viteve '50-ta të shekullit XX fillojnë rrënimet masive të objekteve të vjetra, duke zgjeruar rrugët dhe duke ndryshuar kahjen e lumit Lumbardhë, në emër të “modernizimit” të qytetit. Tani nga ky kompleks kanë mbetur pak objekte banimi të ruajtura, sikurse janë shkatërruar edhe disa pjesë të medresesë. Në vitin 1968, për arsye të ndërtimit të rrugës, bëhet rrënimi i objekteve buzë lumit, duke lënë vetëm objektin e Rezidencës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që spostohet për disa metra. Edhe në vitet 1976-78 bëhen ndërhyrje të rëndësishme, duke rrënuar disa objekte në kompleksin e hamamit të Gazi Mehmed Pashës, për të formuar Muzeun e Lidhjes së Prizrenit për nder të 100 vjetorit të tij. Ndërkohë janë rindërtuar edhe disa shtëpi të tjera brenda kompleksit, pasi që ato ishin shumë të amortizuara. Objektet e kompleksit janë ndërtuar ngjashëm me objektet e banimit, pra struktura ndërtimore është prej guri në nivelin më të ulët dhe prej qerpiçi më lart (tulla prej argjile të papjekur). Streha e gjerë është e theksuar dhe ka qenë një element i rëndësishëm në kontrollimin e dritës në brendësi të objektit. Në vitin 2003 bëhet një rindërtim i oborrit dhe rinovimi i objekteve nga ana e Institutit të Monumenteve Muzeale të Prizrenit dhe Kuvendit Komunal.

Xhamia e Sinan Pashës

Xhamia e Sinan Pashës, edhe pse nuk është xhamia më vjetër, pa dyshim është më e bukura e qytetit dhe më gjerë. Pozita e saj e bën që të dominojë mbi sheshin dhe çarshinë e vjetër të Prizrenit. Është ndërtuar në vitin 1615 nga Sinan Pasha, që ka pasur pozita të ndryshme në





administratën osmane. Gjatë Luftës Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore xhamia shfrytëzohej si depo municioni nga ushtria bullgare dhe serbe. Me supozimin se një pjesë e materialit ndërtimor është marrë nga



manastiri i Arhangeljit që gjendet rreth 2 kilometra në periferi të Prizrenit, në vitet '30-ta të shek. XX, administrata e atëhershme tentoi të rrënojnë xhaminë për t'i kthyer gurët manastirit. Nga ky plan u arrit të rrënohet vetëm pjesa e hajatit, pasi protestat e mëdha të qytetarëve bënë që ideatorët e këtij plani të detyrohen të ndërpresin aksionin e rrënimin. Në vitet 1968-69 xhamia shndërrohet në muze të dorëshkrimeve orientale.

Objekti ka formë katrore me një shtim (aneks) në pjesën jug-lindore, që është një formë specifike pa asnjë rast tjetër në Kosovë, përveç xhamisë së Emin Pashës në Prizren, ndërtuar në shek. XIX, si kopje e kësaj xhamie. Objekti është ngritur nga niveli i rrugës rreth 3 metra. Materiali ndërtimor i përdorur është gurë lumi dhe llaç gëlqeror, ndërsa nga ana jashtme është veshur me gurë të gdhendur, që supozohet se janë marrë ose blerë nga manastiri i Krye-engujuve (Arhangeljit). Minarja e xhamisë është ndërtuar prej gurëve të shtufit dhe është e suvatuar nga ana e jashtme. Deri në pjesën e galerisë së minares ("sherefe") ka 122 shkallë (basamak). Nga ana e brendshme objekti është suvatuar dhe është pikturuar së paku dy herë. Pikturimi i fundit është bërë gjatë mesit të shek. XIX. Punimet restauruese konservuese janë bërë disa herë ndërsa ajo e konservimit të pikturave ka zgjatuar prej vitit 1973 deri në 1986, kohë gjatë së cilës ato

nuk janë përfunduar. Në vitin 2007 kanë filluar punët e restaurimit dhe konservimit të objektit dhe në vitin 2011 janë kompletuar punimet.

Xhamia e Emin Pashës

Pranë hamamit të Gazi Mehmed Pashës në lagjen Saraçhane, Emin Pasha, sanxhakbeu i Prizrenit në periudhën prej 1789 deri më 1843, ndërtoi xhaminë, mejtepin dhe objektet e tjera përcjellëse. Viti i ndërtimit vërtetohet nga mbishkrimi, i cili gjendet mbi derën hyrëse, ku



mes të tjerash përmendet që xhamia është ndërtuar më 1247 sipas hixhrit (kalendari islam), që korrespondon me vitin 1831.

Xhamia është ndërtuar në formë specifike për trevën dhe është e ngjashme me xhaminë e Sinan Pashës, por me përmasa më të vogla. Edhe pikturat e brendshme janë të ngjashme me mënyrën e pikturimit të fazës së dytë të xhamisë së Sinan Pashës. Vlen të theksohet se këto dy xhami janë të vetmet ku janë ruajtur pikturat murale. Pikturimi i mureve të brendshme dhe pjesërisht të jashtme është bërë në stilin barok ampir, me të cilin vërtetohet

depërtimi dhe ndikimi i artit evropian. Motivet janë të natyrës floreale, ku mbizotërojnë ngjyra e kaltër dhe e verdhë.

Planimetria e objektit është katrore me një pjesë të shtuar në formë abside në anën jug-lindore, ku është pjesa e mihrabit (kahja-drejtimi i lutjes), që e bën objektin të veçantë nga xhamitë tjera të këtyre trevave. Organizimi funksional është sikurse te xhamitë tjera, ku hyrja në objekt bëhet përmes hajatit



(veranda) që është ngritur mbi katër shtylla guri dhe është mbuluar me tri kube. Pastaj vjen hapësira qendrore e lutjeve, ku në anën e djathtë të hyrjes është mahvilli (galeria) ngritur mbi katër shtylla prej guri dhe me gardh të ulët prej druri. Mمبرi (shkallët ku bëhet predikimi) është ndërtuar prej guri. Kjo hapësirë është mbuluar me një kube qendrore dhe një gjysmë-kube në pjesën e absidës. Muret janë ndërtuar prej gurëve të ndryshëm dhe janë të suvatuar në të dy anët, ndërsa kubet janë të veshura me pllaka plumbi. Minarja elegante është ndërtuar prej guri dhe është e suvatuar nga ana e



jashtme. Në oborrin e xhamisë janë varrezat, ku është edhe varri i Emin Pashës. Fatkeqësisht objektet e tjera plotësuese të xhamisë janë rrënuar gjatë kohës.

Në aspektin historik objekti ka rëndësi ngaqë Emin Pasha i takon familjes aristokrate të Rrotllave, që ka pasur ndikim në rrjedhat historike në këto treva që nga shek. XVII.

Teqja Halveti

Objekti i teqes Halvetiane gjendet në lagjen e “Saraçëve”, pranë xhamisë së Kukli Mehmed-beut. Kjo teqe i përket sektit halvetian (rrjedh nga fjala arabe halvet “vetmi”). Emrin e ka marrë nga themeluesi saj, Piri i madh Omaru'l-Halvetiu (i cili vdiq më 1397-8 në Tabriz). Themelimi i teqesë halvetiane në Prizren lidhet me Sheh Osman Babën. Sipas të dhënave, ai ishte nga Vlesha, fshat i rrethit të Peshkopisë në Shqipëri. Ai kreu medresenë në Serez (Greqi), ku edhe është përcaktuar për rendin e halvetianëve. Pas mbarimit të shkollimit e hasim me shërbim në xhaminë e Kukli-Beut në Prizren. Me largimin nga Kukli, Mehmed-Beu e dhuroi truallin afër xhamisë dhe kështu filloi të zhvillojë tarikatën e vet, që më pas do të quhet Halveti. Ndërtesa e teqesë është ndërtuar në vitin 1835.



Objekti është i thjeshtë, i ndërtuar prej guri dhe qerpiçi, ndërsa mbulesa është me tjegulla tradicionale. Edhe pse përbëhet prej disa objekteve si teqja, sala e riteve (semihane), tyrbja, objekti i banimit dhe i pritjes, kompleksi në aspektin organizativ përbëhet prej dy pjesëve - teqesë dhe semihanës. Semihana ka formë gjashtëkëndëshe dhe është objekti kryesor ku zhvillohen lutjet e ritet tjera fetare. Në anën perëndimore është pjesa e tyrbes ku janë varrezat e prijësve të tarikatit, duke filluar prej themeluesit të



tarikatit Osman-baba dhe nëntë udhëheqësve të tjerë. Në oborrin e teqesë janë edhe dy kroje prej guri, njëri është në formë rrethore si shatërvan, ndërsa tjetri është në formë drejtkëndëshe me motive të gdhendura në pjesën ballore.

Edhe pse tani është jashtë kompleksit, vlen të përmendet objekti i banimit që gjendet në anën lindore. Shtëpia është ndërtuar në shek. XVIII; është me përmasa mjaft të mëdha dhe e pasur me elemente folklorike.

Kompleksi Tyrbeve të Karabash Efendiut

Kompleksi i tyrbeve të Karabash Efendiut ka rëndësi historike, shpirtërore dhe arkitekturore. Këto tyrbe janë varrezat e vetme të vjetra që kanë mbetur në Prizren. Këtu kryhen rituale të ndryshme nga persona që vijnë t'i vizitojnë këto tyrbe. Në këtë kompleks, përveç varrezave të vjetra, janë edhe tri tyrbe që u takojnë periudhave të ndryshme.



Tyrbja e Karabash Efendisë ka formë tetëkëndëshe dhe është më e vjetra (shek. XVIII). Ajo është ndërtuar me gurë dhe është e suvatuar nga të dy anët. Nga ana e jashtme ka kulme 8 - ujore dhe është mbuluar me tjegulla, ndërsa nga ana e brendshme është në formën e kupolës.

Tyrbja e Kemani Rabije Hanëm-it është ndërtuar në vitin 1905. Ka formë drejtkëndëshe të ndërtuar me gurë dhe të suvatuar nga të dy anët. Kulmi është mbuluar me tjegulla.

Tyrbja e Sheh Hysein-it është ndërtuar në pjesën e parë të shek. XX. Po ashtu ka formë drejtkëndëshe, të ndërtuar me gurë dhe të suvatuar nga të dy anët. Kulmi është mbuluar me tjegulla.

Në aspektin arkitekturor këto objekte kanë vlera të veçanta, pasi janë të vetmet tyrbe si një kompleks që qëndron së bashku në një vend me qindra varreza.

Në përgjithësi tyrbet janë ndryshuar pak, nëse nuk marrim parasysh ndërhyrjet e vogla të herë pas hershme. Por si tërësi, ky kompleks ka pësuar ndryshime të mëdha pasi që pas Luftës së II Botërore këtu është ndërtuar Spitali Rajonal i Prizrenit, Shkolla e Mesme Normale dhe shkolla e Lartë Pedagogjike.



Ndërtesa e Sheh Hasanit

Shtëpia e familjes Shehu gjendet pranë teqesë halvetiane në qendër të qytetit. Shtëpia ka qenë pjesë e kompleksit të teqesë që është shfrytëzuar nga kjo familje, por me rritjen e saj, familja Shehu tërhiqet dhe ndërton një objekt të ri, afër atij ekzistues. Është ndërtuar në shek.

XVIII dhe ka pasur edhe objekte plotësuese, por në vitet '50-ta shek. XX ky kompleks rrënohet bashkë me shumë të tjerë. Ndërtimet e mëvonshme si hotel "Theranda", ndërtesa e Postës dhe ajo e Bankës (ndërtuar rreth viteve '30) e kanë rrethuar shtëpinë, e cila sot nuk vërehet nga rruga.



Shtëpia i takon tipit të shtëpive të rrafshit në formë simetrike me çardak në mes. Më vonë çardakut i shtohet pjesa e qyshkut (erkerit) prej druri të rrethuar me parmak druri. Objekti është dykatësh me hyrje të orientuar nga jugu. Në katin përdhës ndodhet hajati, të cilit gjatë restaurimit në shek. XIX i është shtuar pjesa e sofës dhe organizimi i dhomave, që është i zakonshëm në këtë tip objektësh. Elementet që dominojnë në fasadë janë qyshku (doksati) prej druri, që gjendet mbi pjesën hyrëse nga ana jugore, si dhe strehët e tej zgjatura që mbështeten mbi pajanta druri. Objekti është me përmasa mjaft të mëdha dhe i pasur me elemente të drugdhendjes. Gjatë kohës janë bërë ndërhyrje në brendësi dhe në pjesën e jashtme nga ana e pronarëve, gjë që e ka dëmtuar mjaft origjinalitetin e objektit.

Ndërtesa e Sarajit



Në lagjen e Sarajit të vjetër, në pjesën rrafshinore të qytetit, gjendet shtëpia e familjes Grazhda, e ndërtuar në shek. XVIII dhe rinovuar e adaptuar më pas në shek. XIX. Objekti fillimisht ka pasur funksion administrativ (Saraji i Bejlerbeut) e pastaj është shfrytëzuar për banim. Në oborrin e saj, në pjesën lindore gjendet edhe mutfaku



(kuzhina verore), që ka mjaft rekuizita origjinale të kohës.

Ky është një shembull i arkitekturës orientale-vendore të tipit rrafshinor. Forma e objektit është drejtkëndëshe simetrike me çardak në mes, por gjatë kohës çardaku është mbyllur dhe objekti është ndarë në dysh. Është i

ngritur në etazh dhe pjesa hyrëse (hajati) me dekorimet është orientuar kah oborri. Dekorimet në pjesën ballore janë karakteristike, me elemente vegetative. Pjesa e brendshme e objektit është e pasur me elemente etnografike. Drugdhendja është shumë e theksuar dhe është punuar me një përkushtim e mjeshtëri të rrallë. Pullazi është katërujor, i mbuluar me tjegulla tradicionale, nga dalin oxhaqet në formë rrethore, po ashtu të përpunuara.

Shtëpia e Shehzades



Shtëpia e Musa-Efendi Shehzades gjendet në pjesën rrafshinore të qytetit në rrugën e Sarajit të vjetër, e ndërtuar në fund të shek. XVIII. Në shek. XIX është bërë rinovim i rrënjësishëm, sidomos në brendësi, ndërsa në shek. XX janë bërë ndërhyrje, ku janë mbyllur hapësira e hajatit në katin përdhes që gjendet në pjesën veri-lindore të objektit dhe qyshku në etazhe. Shtëpia i takon objekteve të banimit me çardak të tipit rrafshinor, e ngritur në etazh të llojit jo simetrik. Është e pasur me elemente etnografike në brendësi. Vlen të theksohen oxhaqet e dekoruara që gjenden në katin përdhes dhe dy në etazhe. Edhe drugdhendja është e pasur, sidomos përpunimi i tavaneve, dollapëve, musandrave, etj.

Në fasadën kryesore, që gjendet në anën lindore, janë punuar timpanone




prej druri me vje gjashtë cepëshe në mes, që janë karakteristike edhe për disa shtëpi tjera të qytetit. Në mesin e shek. XX, kur bëhet ndarja e pronësisë, oborri përgjysmohet dhe ndërtohet një objekt i ri, i cili e mbulon gjysmën e fasadës së shtëpisë. Në vitin 1999 nga ana e pronarit bëhet ndërimi i kulmit me betonarme, që si pasojë sjell shtrembërimin e qoshkut. Pas viteve '80-ta të shek. XX objekti nuk shfrytëzohet për banim.

Ura e vjetër e gurit

Ura e vjetër e gurit gjendet në bërthamën e vjetër të qytetit. Qytetin e Prizrenit lumi e ndan në dy pjesë, andaj urat kanë pasur rëndësi të veçantë në zhvillimin e tregtisë dhe jetës në përgjithësi. Mbi Lumbardhin e Prizrenit përgjatë historisë u ngritën shumë ura, por pa dyshim më e bukura, më funksionalja, më e frekuentuara e më imponantja, që u shndërrua në simbol të qytetit, është kjo urë. Për ndërtimin e saj nuk janë gjetur ende të dhëna, por duke u bazuar në tipologjinë e urave konstatohet se duhet të jetë e ndërtuar në fund të shek. XV.

Ura e vjetër është tre harkore ku harku i mesëm është më i madhi, kurse harqet anësore janë më të vogla dhe jo të njëjta, gjë që e bën atë jo simetrike. Gjatë rregullimit të rrugës kryesore në vitet e 50-ta të shek. XX, ura pëson ndryshime në dukjen e saj pasi që harku i djathtë (ana veriore) mbyllet për të zgjeruar rrugën. Edhe pse me pamje të shformuar, ura e ka kryer funksionin e vet deri më 1979, kur në Prizren vërshojnë ujërat me ç'rast ura rrënohet tërësisht. Pasi që ura kishte një rëndësi të veçantë për Prizrenin dhe banorët ishin të lidhur emocionalisht me të, vendoset





që të bëhet rindërtimi i saj. Kështu menjëherë fillohet me analizën e dokumentacionit dhe hartimin e projektit. Ura rindërtohet përsëri më 1982 bashkë me kejin në anën e djathtë të lumit.

Kroi (Çeshme) i gurit “Beledije”

Kroi “Beledije”, i njohur edhe si kroi i Tabakhanës është një nga krojet e vjetra të Prizrenit, i ndërtuar në pjesën e dytë të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Vendndodhja e tij ka qenë para ndërtesës së Kuvendit të vjetër (Beledije). Për shkak të zgjerimit dhe asfaltimit të rrugës në vitin 1963, kroi zhvendoset në qendër të qytetit, në afërsi të Muzeut të Lidhjes së Prizrenit. Kroi është në formë prizmi drejtkëndësh, punuar me gurë të gdhendur në formë bllaqesh. Mbi kurorën e profilizuar në përfundim të trupit, është formuar qemeri i kryqëzuar në të katër anët e mbi të

është vendosur guri gjysmë-sferik për dallim nga origjinali, që ka qenë në formë piramidale. Kroi në pjesën ballore (jugore) ka një profilim të cektë në formë kornize dhe brenda saj është vend-shenja “portale” ku duhet të ishte mbishkrimi, por fatkeqësisht ai mungon.

Në vitin 1925 në pjesën e qemerit ballor mbi kurorë është vendosur mbishkrimi i dytë ku shkruan “Sud - Opstina Prizren - 1925 god” (Gjykata - Komuna e Prizrenit - viti 1925). Një shkrim i ngjajshëm është vendosur edhe në kroin e gurit që gjendet para xhamisë së Sinan





Pashës. Kur është bërë dislokimi i kroit, në atë shesh është formuar edhe kanali i ujit që ka qarkulluar përgjatë sheshit, por pas një kohe të shkurtër ai mbetet jashtë funksionit, ashtu që sot kroi edhe pse mjaft elegant qëndron i vetmuar në një ambient të ri.

Ura e vjetër e Gurit në grykën e Lumbardhit

Në ambientin piktoresk të grykës së Lumbardhit, 4 kilometra larg Prizrenit, në rrugën për në Prevallë, në anën e djathtë të rrugës, gjendet ura e gurit. Kjo urë ndryshe quhet edhe ura e “kërk bunarit” (40 puseve), pasi që në afërsi të saj janë burimet që furnizojnë qytetin me ujë. Kjo urë një harkore ishte ndërtuar në aksin e rrugës së vjetër që lidhte Prizrenin me Shkupin, përmes maleve të Sharrit dhe Luginës së Vardarit. Për një kohë të gjatë





tregtia dhe lidhjet e tjera mes Prizrenit dhe Shkupit bëheshin nëpërmjet kësaj rruge.

Me ndërtimin e rrugës së re Prizren-Brezovicë në vitin 1952/55, ura dhe rruga e vjetër humbin funksionin e vet të mëparshëm, ashtu që nga ajo kohë ura lihet në mëshirë të kohës. Deri më tani nuk është hasur ndonjë shënim për këtë urë, andaj nuk dihet saktë koha e ndërtimit dhe ndërtuesi. Por duke u bazuar në mënyrën e ndërtimit, vërehet ngjashmëria me urën e gurit në qendër të qytetit, që bën të mendosh se kjo urë duhet të jetë e shek. XV.

Ura është me një hark të mbështetur në dy brigjet shkëmbore të lumit. Është ndërtuar me gurë lumi, ndërsa qemeri i dyfishtë me gurë të latuar. Ndërkohë kur komunikimi mbi këtë urë është shpeshuar, është bërë një ndërhyrje duke plotësuar (mbushur) dy anët e urës, kështu që pjerrësia është zbutur. Edhe me një shikim mund të vërehen këto mbushje, po ashtu me gurë, por me një mjeshtri shumë më të dobët se pjesa origjinale. Ura në të dy anët ka edhe mburojën prej guri të gdhendur.

Hidro centrali elektrik

Në ambientin piktoresk të grykës së Lumbardhit, 2.5 km larg Prizrenit, gjendet objekti i hidro centralit elektrik prizrenas. Ky mjedis piktoresk është ndërtuar midis viteve 1926 dhe 1928, në sajë të kontributit të qytetarëve dhe kredive bankare. Punimet përfunduan në 8 nëntor 1928. Objekti ka pasur elementet moderne të asaj kohe: kaptazha e ujit, pjesa për pastrimin e ujit nga mbeturinat, kanali, pajisjet për përcjelljen e ujit deri në turbinë dhe gjeneratori me fuqi


160 KVA. Për shkak të kërkesës së madhe për energji elektrike, në vitin 1936, është lëshuar në qarkullim gjeneratori i dytë me kapacitet të njëjtë. Me amortizimin e aparateve dhe kapacitetit joracional, objekti humbi funksionin burimor.





Me iniciativën e Institutit të Monumenteve Muzeale të Kosovës (IMMK), objekti u shndërrua në muze, i inauguruar në 8 nëntor të vitit 1979. Objekti nuk është i madh, në katin përdhës është kthina e madhe ku janë të vendosura dy turbina dhe pajisjet tjera përcjellëse, kurse në dhomën tjetër janë vendosur aparatet për përcjelljen e prodhimit të rrymës elektrike. Në katin e sipërm ka qenë dhoma e inxhinierit, ku punonte edhe mbikëqyrësi i centralit elektrik. Pas shndërrimit të objektit në muze, kjo dhomë është kthyer në restorant. Në oborr janë vendosur aparate nga centralet elektrike të ndryshme të Kosovës. Është zgjedhur vendi më i përshtatshëm për shfrytëzimin e ujit dhe është munduar që objekti industrial t'i përshtatet mjedisit, duke i dhënë formën e një kështjelle, nga kështjella e sipërme që gjendet në afërsi. Në të njëjtën kohë dhe me të njëjtin stil janë ndërtuar edhe dy godina për transformatorët që kanë shpërndarë energji elektrike nëpër qytetin e Prizrenit.





Sfidat e menaxhimit të qendrës historike

Si një nga bërthamat më të mbrojtura me karakter të ruajtur urban-arkitektonik dhe historik në Kosovë, qendra historike e Prizrenit paraqet edhe një histori përpjekjesh për ruajtjen e vlerave të saj. Përpjekjet e para për mbrojtjen institucionale të qendrës historike si tërësi dhe monumenteve në veçanti, filluan pas Luftës së Dytë Botërore me formimin e institucioneve përkatëse, fillimisht në Prishtinë (më 1956) dhe më vonë në Prizren (më 1967). Fatkeqësisht, edhe përkundër kësaj, degradimi i monumenteve dhe i zonës historike ka vazhduar për interesa të ndryshme materiale, politike etj. Shumë studime dhe propozime konkrete për mbrojtjen dhe rivitalizimin e qendrës historike janë bërë veçanërisht përgjatë viteve 1968-1974, kur ka pasur përpjekjet e pasuksesshme që qyteti të vihet nën mbrojtjen e UNESCO-s. Në degradimin e qendrës historike ndikoi edhe mungesa e planit zhvillimor të qytetit, që do mund të jepte propozime konkrete për kahjen e zhvillimit dhe të zgjerimit të Prizrenit.

Një nga arsytet që mbrojtja e qendrës historike nuk ka qenë efikase sa duhet, ka qenë detajimi i pamjaftueshëm teknik i planit të saj. Qendra historike, e definuar para vitit 1999, në pjesën më të madhe mbulonte të njëjtat hapësira sikurse zona e sotme dhe, përpos monumenteve, përfshinte tërësi apo komplekse të veçanta me status mbrojtjeje, sikurse janë Nënkalaja, Potokmahalla, Shatërvani etj. Qendra historike ishte e përcaktuar si zonë e parë dhe e dytë e mbrojtur dhe ishte konvertuar në një hartë, e cila përdorej për nevojat e stafit të institutit të atëhershëm për mbrojtjen e monumenteve. Përpjekjet intuitive të qytetarëve dhe përkujdesja institucionale pa dokumentacion specifik për trajtim me plane më të detajizuara, nuk mund të çonte larg. Sidoqoftë ishte rregull

i pashkruar që, në raste të ndërtimeve të reja në qendrën historike, të respektohej etazhiteti dhe vëllimi i objekteve në afërsi të vendit të projektuar. Një nga parimet që zbatohet dhe zbatohet edhe sot në praktikë, është që për çdo intervenim në zonën e qendrës historike, departamenti përkatës i urbanizmit të komunës kërkon pëlqimin paraprak nga Enti, sot Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren (IMMPz).

Pas vitit 1999, gjegjësisht më 2001, IMMPz zhvishet nga kompetencat komunale dhe kalon nën varësinë e Ministrisë së Kulturës. Kjo shumë shpejt ndikoi që IMMPz të mos ketë më qasje e të mos konsultohet për disa zhvillime urbane të nivelit lokal.

Gjatë procesit të dizajnit të planit urban të përgjithshëm të Prizrenit (2002-2004) IMMPz kërkoi që të aplikohet masa e moratoriumit për të gjitha ndërtimet në zonën e qendrës historike, pasi kjo ishte periudha e shpërthimit të ndërtimeve në qytet dhe druhej se kjo do të ndikonte negativisht në zonë. Fatkeqësisht ky propozim nuk u morr parasysht. Plani miratuar i ridefinon zonat e mbrojtura të qendrës historike të Prizrenit, duke themeluar zonën e parë, të dytë dhe kontakt zonën, koncept ky i ri në Prizren. Këto zona janë përafërsisht të njëjtat me kufijtë e vjetër dhe përfshijnë numrin më të madh të monumenteve të zonës urbane. Edhe pse ky dokument zhvillimi pati informata të mjaftueshme për zonën dhe sidomos për monumentet e listuara, duke qenë plan i përgjithshëm, ai nuk ka përmbajtur detaje për trajtimin edhe të objekteve përreth. Kjo krijoi probleme edhe më shqetësuese, kur kriteret apo kushtet teknike të caktuara nga IMMPz nuk respektohen, praktikë që fatkeqësisht është duke vazhduar edhe sot e kësaj dite.

Më 2005 filloi hartimi i planit të konservimit dhe zhvillimit për qendrën historike të Prizrenit, që përfundoi zyrtarisht dhe u miratua më 2009, si plan rregullues urban. Ky është një nga dokumentet më të rëndësishëm të prodhuar deri më sot për zonën historike të Prizrenit dhe paraqet një nga dokumentet e vetme referuese për shumë institucione të të dyja niveleve të qeverisjes, asaj lokale dhe qendrore. Plani ofron detaje të veçanta për trajtimin arkitektonik, të cilat kanë munguar në planet e mëparshme. Por edhe pse zyrtarisht është miratuar si plan rregullues urban, ai ka më shumë trajtime sesa është një plan rregullues urbanistik tipik që kërkohet me ligj. Megjithatë, duke qenë se njeh specifikat e zonës historike, plani ekzistues ka nevojë dhe e krijon mundësinë që të rishikohet apo të përplotësohet e të përditësohet me të dhënat e reja. P.sh plani i ndarë në nën-zona (I, II, III) ka nevojë për detajizim të mëtejshëm, sepse në të shumtën e rasteve është i përgjithësuar, duke krijuar paqartësi rreth asaj se cilat objekte duhen të ruhen e cilat jo. Kjo krijon paqartësi, sidomos në terrene të pjerrëta apo edhe ato rreth monumenteve. Po ashtu të dhënat e marra për gjendjen e objekteve në përgjithësi nuk janë të njëjta, sepse janë të vjetruara dhe nuk i përgjigjen ndryshimit të gjendjes që nga koha e miratimit të planit.

Përkundër që plani ekzistues i konservimit nuk ka mandat të tillë, në të ardhmen do të ishte e udhës që të definohet një strukturë menaxhuese, e cila do ta kishte kontrollin e përditshëm mbi gjendjen e zonës historike, strukturë e cila do të kishte përfaqësim të nivelit qendror dhe lokal. Mosfunksionimi si duhet i inspektoratit të ndërtimit në nivelin komunal


dhe, veçanërisht mungesa e inspektorëve të trashëgimisë kulturore (nga niveli qendror), sot paraqet një nga hallkat më kritike të mosfunksionimit dhe mosrespektimit të rregullave për mbrojtjen e zonës historike të qytetit të Prizrenit. Vlera e planit të konservimit, edhe pse është një nga punimet më të mira që institucionet tona kanë pasur deri më sot, po bie si shkak i mosrespektimit të lejeve gjatë ekzekutimit të punimeve.



Mbrojtja e zonës historike të qytetit të Prizrenit sot na paraqitet më shumë si sfida e zbatimit të ligjeve të aplikueshme, sesa e zbatimit të planeve urbane, të cilat megjithatë, pas miratimit zyrtar në nivel lokal, paraqesin po ashtu ligj të aplikueshëm për institucionet dhe qytetarët.

Burimet e përdorura

- *Arkiva e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit Marin Barleti nr. 11, 20000 Prizren Republika e Kosovës tel:+381 29 244 487, e-mail: qrtkpz@hotmail.com*
- *Plani i Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Qytetit të Prizrenit - CHwB Kosovo Office , Adresa: Qyteti Payton / R.Zogovic nr:8 10000 Prishtinë,Republika e Kosovës,tel.+381 38 243 918,web: www.chwb.org*
- *Prizreni 360 shkallë, webfaqja komunale për promovimin e qytetit të Prizrenit <http://prizren360.com/>*



OHRI

Qyteti i shekujve

nga Goran Patchev

Për shumë njerëz njihet si qyteti i dritave, qytet i traditës kulturore, Jerusalemi i Ballkanit ose muze i gjallë, por mbi të gjitha ai është qyteti ku janë lindur, rritur, zhvilluar dhe jetojnë qindra breza qytetarësh, për të cilët ky është thjesht qyteti i lindjes. Me thesaret e tij të famshme kulturore dhe historike Ohri na jep mundësinë të njohim të kaluarën e këtij rajoni. Duke qenë qendër urbane e gjallë dhe e populluar, me një ofertë turistike të larmishme, sot qyteti shpërthen me të reja moderne. Me një menaxhim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mbrojtjen tërësore të trashëgimisë kulturore, qyteti do të sigurojë një jetë më të mirë për brezat e ardhshëm.


Gjurmët e jetës njerëzore, që datojnë nga kohërat prehistorike deri në kohën moderne, duke përfshirë ndërtime të të gjitha periudhave dhe qytetërimeve, shumë artefakte dhe dokumentet e shkuara, shembuj të shumtë të trashëgimisë kulturore të lëvizshme, dëshmojnë se ky rajon ka qenë gjithmonë i banuar nga njerëzit, që kishin këtu përfitimet e siguruar nga prania së liqenit. Vlerat kulturore në këtë territor, me theks mbi spiritualitetin, ishin themelet për krijimin këtu të një qendre të madhe të krishtere në agim të Krishterimit.

Hyrje

Qyteti i Ohrit, i cili vjen në formë harku përreth një gjiri të vogël në skajin verilindor të Liqenit të Ohrit, ka qenë qendër kulturore dhe shpirtërore që prej antikitetit, siguruar kjo edhe nga përparësitë që sjellin kushtet e favorshme natyrore dhe mbrojtja e siguruar nga kodra që dominon gjirin. Veç vlerës shpirtërore, Liqeni i Ohrit në vetvete është një liqen i rrallë dhe shumë i vjetër, me ujë të pastër, qendër biodiversiteti, që ushqehet nga shumë burime në tabanin e tij.

Në periudhën Bizantine shenjtoret misionarë Klementi dhe Naumi u





vendosën në Ohër dhe qyteti u bë qendër dije dhe manastiri më ndikim në botën sllave ortodokse. Në kohëra të caktuara Kryepeshkopata e Ohrit shtrihej deri në Adriatik dhe në Egje.

Shtëpitë e qytetit të vjetër të Ohrit janë rregulluar artistikisht mbi shpatin e kodrës. Nën sundimin osman, të krishterët ishin kufizuar brenda mureve të qytetit dhe nevoja për ta përdorur sa më mirë hapësirën në dispozicion, frymëzoi reagime arkitekturore krijuese. Arkitektura luan një rol të veçantë në trashëgiminë kulturore të qytetit dhe lloji i veçantë i shtëpive qytetare orientale, të ndërtuara gjatë shekujve XVIII- XIX dhe fillimit të shekullit XX,



të cilat janë ruajtur këtu më mirë se në qytetet e tjera të vendit. Ndërtuesit popullorë i ndërtuan këto shtëpi të ndikuar nga traditat otomane dhe bizantine. Për këtë arsye nuk është çudi që arkitekti i madh Francez, La Corbusier, në librin e tij “Koleksion Veprash” i kushtoi vëmendje të veçantë shtëpive qytetare maqedonase dhe fasadave, ballkoneve e interierëve të tyre, kur shkruan rreth arkitekturës së qyteteve në Ballkan.



Disa legjenda thonë se Ohri kishte dikur 365 kisha, sot njihen pak më shumë se dyzet kisha apo rrënoja të tyre. Një nga më mbresëlënëset është Kisha e Shën Sofisë, katedralja e dikurshme (që nga koha e mbretërimit të Car Samuelit 976-1014), e ndërtuar në qendër të qytetit të vjetër të Ohrit, mbi themelet e një strukture të vjetër të krishtere me disa afreske të ruajtura shumë mirë. Më lart në kodër është Kisha e Shën Mërisë së Peribleptos (Më e Lavdishmja). Ky kompleks që përfshin edhe një galeri ikonash, ndodhet afër ndërtesës së rinovuar rishtas të ish “Muzeut të Studimeve Sllave”, tani seli e Kishës Ortodokse Maqedonase-Kryepeshkopata e Ohrit, Dioqeza Dibër-Kërçovë. Manastiri i restauruar i Shën Klementit dhe Shën Panteleimonit ndodhet në Plaoshnik, në shpatet me pemë nën fortesën e Car Samuelit.



Kur flitet për Ohrin si qendër e një rajoni dhe qytet-muze, duhet të kihet parasysh që ai përmban edhe një muze, origjina e të cilit është e lashtë në histori. Sepse, shekuj para themelimit të Muzeut Britanik në Londër (1753) dhe të Luvrit në Paris (1793), qyteti kishte një Muze të Arkipeshkvisë në Kishën e Shën Mërisë së Peribleptos, i cili ishte nga të parët dhe ndoshta më i vjetri në Europë dhe që ekzistoi për 400 vjet, 1516-1916. Ekzistenca një muzeu në Ohër që prej një pothuaj një mijë vjet më parë konfirmohet nga një vulë që daton në vitin 1516.

Muzeu i Ohrit i ditëve të sotme u themelua në vitin 1951, si pasardhës i muzeut të Arkipeshkvisë. Disa nga objektet më domethënëse të tij janë: dorëshkrime sllave dhe greke, relieve dhe skulptura antike, koleksione numizmatike dhe shumë objekte të tjera të lëvizshme muzeale.



Në 1979 dhe 1980, Ohri dhe Liqeni i Ohrit, ishin ndër të parët site që u pranuan në listën e Trashëgimisë Botërore nga UNESCO. Në fakt, Ohri është një nga vetëm 28 sitet e UNESCO-s që kanë njëkohësisht statusin sit kulturor dhe sit natyror.

Rëndësia Historike

Brijet e Liqenit të Ohrit kanë qenë të banuara që prej kohërave prehistorike. Zbulimet arkeologjike flasin për vendbanime të periudhës së Neolitit (Epoka e hershme e Gurit), 6.000 vjet para Krishtit. Vendbanime neolitike të pasura me materiale arkeologjike, datuar në këtë periudhë, janë zbuluar në periferinë e Ohrit, në Dolno Trnovo. Gërmimet arkeologjike vërtetojnë se banesat palafite prehistorike ekzistonin në zonën e Ohrit të sotëm 5.000 vjet para Krishtit, duke nënkuptuar se origjina e qytetit është 7.000 vjet e lashtë.



Sipas burimeve historike, banorët më të hershëm të njohur në rajonin e Liqenit të Ohrit ishin Brigianët, Ohrigianët dhe Enkelianët, ku këta të fundit sunduan për një kohë të gjatë. Sipas Herodotit dhe Apollodorit, këta nuk ishin ilirë, por fqinjët e tyre më të afërt. Më vonë, Dasaretët përmenden si banorë të kësaj zone dhe qytetit të Lyhnidës (emri antik i Ohrit) si kryeqytet i Dasaretisë.

Në mijëvjeçarin e parë para Krishtit, në afërsi të aeroportit të sotëm ndërkombëtar, disa dhjetëra kilometra në veri të Ohrit ekzistoi, për disa shekuj një vendbanim i fuqishëm, emri i të cilit sot është i panjohur.

Aty janë zbuluar gjetje të pasura arkeologjike: maska të arta, sandale, byzylykë, vazo bronzi etj. Këto kanë ardhur nga varret princërore të nekropolit të njohur gjerësisht me emrin Trebenishtë.

Ekzistenca e qytetit të lashtë të Lyhnidës është e lidhur me legjendën e fenikasit Kadmus i cili, i dëbuar nga Teba në Boeoti, u arratis tek Enkelianët dhe themeloi qytetin e Lyhnidës në brigjet e Liqenit të Ohrit. Rreth mesit të shekullit IV para Krishtit, Lyhnida dhe vendbanimet në brigjet e liqenit u morën nga Filipi II i Maqedonisë. Pasi pushtuan këtë rajon në vitin 148 para Krishtit, romakët ndërtuan Rrugën Egnatia, duke lidhur Durrësin e sotëm me Selanikun dhe Kostandinopojën nëpërmjet Lyhnidës.

Me përhapjen e Krishterimit, i cili filloi të depërtojë në këto anë nga fundi i shekullit III, tempujt klasikë u shkatërruan gradualisht dhe u zëvendësuan me kisha monumentale të hershme kristiane, fragmente të të cilave janë zbuluar në disa vende në Ohër dhe në rrethinat e tij. Misionari i parë i krishterë që erdhi në Lyhnidë ishte Erazmusi i Antiokisë. Të dhënat tregojnë se në shekullin V, ky qytet ishte seli peshkopate. Në shekullin VI, kur Lyhnida ishte pjesë e Perandorisë Bizantine, sllavët filluan të kapërcejnë Danubinë dhe të hyjnë në Gadishullin Ballkanik. Një fis sllav i quajtur Brsjaci u vendos në rajonin e Lyhnidës.

Emri Ohër përmendet për herë të parë në një protokoll të lëshuar nga Asambleja e Kostandinopojës në vitin 879. Besohet se emri ka rrjedhur nga fjalët Sllave –vo hrid – “mbi një kodër”, përderisa qyteti i vjetër qëndron në majën e një kodre. Klementi dhe Naumi, dy dishepujt më të njohur të vëllezërve misionarë Cirili dhe Metodi të Selanikut, erdhën në Ohër pas dështimit të misionit dhe dëbimit të tyre nga Moravia. Klementi ishte i pari që erdhi (886) dhe Naumi u bashkua me të më vonë (893) në rajonin e Kutmicevicës, e cila është në kufirin e sotëm të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Shqipërisë dhe Greqisë dhe përfshin Ohër, si





dhe qytetet tashmë të zhdukura të Devollit dhe Gllavenicës. Me ardhjen e tyre, Ohri u zhvillua si një qendër udhëheqëse në aktivitetin kulturor dhe letrar.



Klementi jetoi tridhjetë vjet mes sllavëve maqedonas. Shkolla e parë e Ohrit u themelua në kishën e manastirit të Shën Panteleimonit, e ndërtuar në vitin 893. 3500 nxënësit që dolën nga kjo shkollë shpërndanë shkrimin slavik, kulturën, artin dhe këngët liturgjike në disa vende sllave, duke shkuar deri në Kievin e Rusisë mesjetare. Nga fundi i shekullit IX dhe fillimi i shekullit X u themeluan alfabeti, spiritualiteti dhe kultura sllave. Ohri ishte një nga qendrat e tij kryesore dhe ka merita të shquara në përhapjen e spiritualitetit sllav në Europë dhe në botë, sidomos sa i përket procesit të evangjelizimit të Krishterimit Lindor Sllav, i cili filloi në brigjet e liqenit të Ohrit me përpjekjet e Shën Klementit dhe Shën Naumit. Ai u përhap nëpërmjet Presllavit bullgar në Kiev dhe Moskë dhe prej aty në Lindjen e Largët në Azi dhe në brigjet e Oqeanit Paqësor dhe Oqeanit Indian.

Shumë kohë pas vdekjes së Klementit në 916 dhe Naumit në 910, shkolla letrare e Ohrit vazhdoi të ishte një burim dorëshkrimesh të çmuara për studimet sllave dhe historinë e artit. Kjo shkollë e filloi punën brenda vendit në shekullin IX dhe ishte mbështetëse besnike e alfabetit Glagolitik. Asaj i atribuohen disa nga dorëshkrimet sllave më të çmuara, që datojnë nga kjo periudhë deri në shekullin e XII, kur alfabeti Glagolitik u zëvendësua me atë Cirilik.



Perandoria e Samuelit e kishte origjinën në rajonin e Ohrit. Rreth mesit të shekullit të X, një princ sllav nga rajoni i Ohrit, Nikolla, dhe djemtë e tij David, Aron, Moisi dhe Samuel u ngritën për herë të parë kundër sundimit bullgar në vitin 976 dhe krijuan shtetin e parë mesjetar maqedonas. Kufijtë e tij u zgjeruan vazhdimisht gjatë mbretërimit të Car Samuelit, i cili zgjati afro katër dhjetëvjeçarë, duke u shtrirë deri në brigjet e Danubit dhe Savës, Gjirin e Korintit dhe Detin Adriatik. Gjatë mbretërimit të Samuelit (976-1014) dhe pasardhësve të tij, Gavriilo Radomir dhe Jovan Vladislav deri në vitin 1018, kështjella u shkatërrua dhe u rindërtua. Me shndërrimin e shtetit të Samuelit në seli politike e fetare, Ohri u bë metropol i vërtetë mesjetar.

Pas humbjes së Samuelit në malin Belasika në vitin 1014, Perandori Bizantin Basili II zuri rob 14.000 ushtarë të Samuelit dhe i verboi, duke lënë me një sy një ushtar në njëqind dhe më pas ia ktheu përsëri Samuelit. Pasardhësit e Samuelit nuk mund të kontrollonin perandorinë e madhe, e cila shumë shpejt pësoi disfatë të plotë. Perandori Bazil II, pas marrjes së Ohrit, urdhëroi shkatërrimin e bedenave të qytetit dhe familja perandorake e Samuelit u zoi rob. Roli i patriarkanës së Ohrit u ul në shkallën e një kryepeshkopate.

Periudha e kryepeshkopatës, juridiksioni i së cilës shtrihej mbi një territor të gjerë nga Danubi deri në qytetin e Selanikut dhe detin Adriatik, ishte një kapitull interesant në historinë e Ohrit mesjetar. Duke dashur të

ruante ndikimin e saj mbi sllavët maqedonas, Gjykata e Kostandinopojës caktonte në krye të kryepeshkopatës së Ohrit funksionarët kishtarë më të aftë dhe me më shumë ndikim: shkrimtarë dhe filozofë, teologë të ditur dhe poetë. Kështu që Ohri u zhvillua në një qytet të begatë, i cili tërhoqi disa nga piktorët dhe arkitektët më të njohur të periudhës. Në shekullin e XI, Leo, një nga mbështetësit më të shquar të Kishës Ortodokse, u caktua Kryepeshkop i Ohrit. Ai urdhëroi që Katedralja e Shën Sofisë (Urtësia e Shenjtë) të rindërtohej dhe dekorohet sipas ideve të tij.



Pasi kryqtarët morën Kostandinopojën në vitin 1204, kryepeshkopët e Ohrit zgjidheshin nga zyrtarët lokalë kishtarë. Ata deklaruan pavarësinë e plotë të Kryepeshkopatës së Ohrit, duke u bazuar për këtë në aktet ligjore të Justinianit. Kjo i mundësoi kryepeshkopit të Ohrit, Demetrius Homatian, një orator dhe shkrimtar i shquar mesjetar dhe autor i veprës “Jeta e Shkurtër e Klementit të Ohrit”, të kurorëzonte si perandor despotin bizantin, Teodor Komnenin, pavarësisht kundërshtimit të fortë të patriarkut të Kostandinopojës.

Kryepeshkopata e Ohrit kishte shenjtorët e saj dhe sektet e saj specifike dhe më pas nisi të financonte punishtet e veta të piktorëve. Themeluesit e kishave të Ohrit nuk ishin vetëm fisnikë nga jashtë shtetit, por edhe kishtarë lokalë dhe abatë të manastirit të Shën Klementit. Sekti i Klementit dhe Naumit ishte veçanërisht i fuqishëm dhe të dy ata janë të portretizuar në muret me të dukshme të kishave.

Në shekujt XV dhe XVI, juridiksioni i Kryepeshkopatës u zgjerua për të përfshirë territore të reja në Ballkan dhe Mesdhe. Në shekullin e XVI, ajo e shtriu territorin e saj deri në koloni në Maltë, Pulia, Kalabri, Sicili, Venecia dhe Dalmaci.

Kryepeshkopata e Ohrit u shfuqizua duke u bërë pjesë e Patrikanës së Kostandinopojës me urdhër të Sulltanit Mustafai II, në vitin 1767. Statusi i saj u rivendos në 1958 në Këshillin e Dytë të Kishës dhe Popullit në



Ohër dhe tani mban emrin Kisha Ortodokse Maqedonase.

Perandoria Osmane e mbajti Ohrin për më shumë se 500 vjet, nga 1395 deri në 1912. Në fillim sultanët turq ndihmuan Kryepeshkopatën e Ohrit të shtrinte juridiksionin e saj. Kjo ndryshoi pas viti 1466, kur një numër i shqar qytetarësh të Ohrit ndihmuan rebelimin kundër sundimit turk, të udhëhequr nga lideri luftarak legjendar shqiptar Skënderbeu. Si pasojë, Kryepeshkopi Dorote dhe një numër kishtarësh dhe njerëz lokalë të pasur u larguan me forcë nga Ohri me urdhër të sultanit dhe, më vonë, vdiqën si të burgosur.



Në fund të shekullit të XIX, Ohri ishte një qendër e fuqishme ekonomike dhe kulturore. Punishtet e tij të lëkurës eksportonin prodhimet e tyre në disa qytete europiane, duke përfshirë Kostandinopojën, Selanikun, Lajpcigun dhe Vjenën. Gjithashtu pati një valë ndërtimesh, ndërsa drugdhendësit dhe piktorët u dyndën në qytet nga rrethinat e Dibrës.

Në vigjilje të shfuqizimit të Kryepeshkopatës së Ohrit dhe integritetit të saj në Patrikanën e Kostandinopojës në vitin 1767, në jetën kulturore të Ohrit pati një periudhë të ndikimit helen. Rezistenca ndaj dominimit shpirtëror grek u bë veçanërisht e fuqishme pas emërimit të peshkopit famëkeq Melentius si Mitropolit i Ohrit në vitin 1860. I pari që u ngrit kundër ndikimit kulturor grek ishte mësuesi i spikatur maqedonas, Dimitrie

Miladinov, nga Struga dhe mësues i poetëve maqedonas Grigor Prlicev dhe Rajko Zinzifov. Ai u helmua në një burg në Kostandinopojë së bashku me vëllanë e tij, poetin Konstantin Miladinov.

Në Ohër, lëvizja progresive e maqedonasve kundër dominimit grek u zhvillua nën udhëheqjen e poetit Grigor Prlicev, autor i veprave epike “Seradot” dhe “Skënderbe”. Pasi epika e tij “Seradot” fitoi një çmim në një konkurs në Athinë në vitin 1860, ai mori një ofertë për të shkuar me studime në Oksford, të cilën e refuzoi dhe u kthye në vendin e tij në Ohër. Lufta kundër dominimit kulturor grek në fund triumfoi dhe, me dekret të Sulltan Abd Al Aziz të miratuar në 1869, shkollat greke në Ohër u mbyllën. Për nder të letrarit të madh Grigor Prlicev, në pjesën e vjetër të Ohrit u ndërtua një muze memorial – shtëpia e Grigor Prlicevit.



Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, fqinjët Greqia, Bulgaria dhe Serbia luftuan për dominimin e territorit maqedonas. Në vitin 1894 në rrethin e Ohrit u organizuan aktivitete revolucionare për të përgatitur njerëzit për një kryengritje të armatosur. Natën e 2 Gushtit 1903, u organizua një rebelim në shkallë të madhe, i njohur si Kryengritja Llinden, me mbështetjen aktive të popullsisë maqedonase. Ndikimi i saj, siç edhe tregojnë zhvillimet e mëvonshme, u ndje edhe shumë larg Maqedonisë. Autoritetet ushtarake otomane reagueshan me shpejtësi me ndëshkime të rënda, ndërsa dega e Ohrit e organizatës revolucionare urdhëroi evakuimin e popullsisë rurale në rajonin e Rshanecit (verilindje të Ohrit). Ata i bënë rezistencë sulmeve të furishme të forcave shumë më superiore të armatosura turke, deri në fundin e gushtit të të njëjtit vit, kur Rshaneci u bë varr i përbashkët i një numri të madh grash, fëmijësh dhe të moshuarish, si dhe kryengritësish.

Ata që e vizituan Ohrin në periudhën pas kryengritjes nxorën konkluzionin se Ohri ishte i braktisur; kishin mbetur vetëm mbeturina të së kaluarës së tij të shquar dhe banorët e qytetit ishin të dërmuar dhe të zhytur në mjerim e frikë të madhe. Situata shoqërore dhe ekonomike në rajonin e Ohrit u përkeqësua. Si rezultat, gjatë dekadës së parë të shekullit XX, një numër i madh maqedonasish shkuan në Amerikë për të kërkuar punë. Një e dhënë tregon se vetëm në vitin 1907 shkuan në Amerikë 3.630 qytetarë të Ohrit me shpresë për të gjetur punë.

Pas përfundimit të sundimit otoman në 1912, Ohri u bë pjesë e mbretërisë së Jugosllavisë midis 1918 dhe 1941. Periudha midis dy Luftërave Botërore u shënua nga ndryshime të mëdha në strukturën e zonës qendrore të qytetit të vjetër me ndërtimin e objekteve më të mëdha me karakteristika të stilit akademik, d.m.th. stili neoklasik. Këto ndërtesa dominojnë mbi



strukturat e pallateve të vegjël dhe arkitektura është e ndryshme nga arkitektura e qytetit të vjetër. Pas periudhës së gjatë të shtypjes otomane, në këtë zonë lanë gjurmë edhe ndikimet europiane.

Pas Luftës së Dytë Botërore, (Ohri u çlirua në 7 Nëntor 1944), filloi industrializimi, zhvillimi i vullshëm dhe rinovimi i qytetit. Kjo periudhë karakterizohet nga përpjekje modeste konservimi për shumicën e objekteve të rëndësishme laike në Ohër.



Pavarësia e Republikës së Maqedonisë (8

Shtator 1991) riktheu sovranitetin e vendit. Njohja ndërkombëtare imponoi disa parakushte për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në të gjitha shoqatat dhe organizatat ndërkombëtare që punojnë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Kjo siguroi implementim efikas të standardeve ndërkombëtare në të gjitha fushat e mbrojtjes, si dhe krijimin e të gjitha enteve kompetente për ruajtjen e zonës si një sit botëror i trashëgimisë kulturore. Ohri është bërë një vend turistik i rëndësishëm, ka hedhur hapa të rëndësishme në zhvillimin e industrisë së turizmit dhe tani ka një rrjet të gjerë të institucioneve arsimore, kulturore, mjekësore e të tjera.



Çfarë thonë njerëzit e famshëm për Ohrin

Kalaja e Ohrit ka një formë pesë këndore, është e ndërtuar me gurë të latuar dhe ndodhet mbi një shkëmb të lartë. Cijatësia e saj e përgjithshme është 4. 400 hapa. Ka një fortesë të brendshme me drejtim nga veriu, me mure 40 metra të lartë dhe një fortesë të jashtme që ndodhet mbi një kodër. Asnjë burrë nuk mund të krahasohet me krijuesin e Kalasë së Ohrit. (Evlia Çelebi - udhëtar turk, 1670)

Çdo pjesë e Liqenit të Ohrit mund të shihet nga kjo pikë vrojtimi, përveç pjesës së tij më të largët jugperëndimore, ku Ohri ndodhet mbi një rrip shumë të ngushtë, Ahrida shumëshekullore, e cila, falë kodrës dhe kalasë së tij, që ndodhen mbi bregun e liqenit, është shumë e ngjashme me Gjenevën në brigjet e Liqenit Léman. Një krahasim i tillë i bërë nga vizitorët shkaktohet edhe nga ngjyra blu e transparencës e ujërave, që janë tipike për të dyja liqenet. Nëse duhet vendosur se cili nga ata është më i pastër, atëherë duhet zgjedhur Liqeni i Ohrit, sepse, ashtu si dhe në Rhonë afër Gjenevës, peshqit në fund të liqenit shihen edhe nga dritaret e manastirit. (Doktor Ami Bue -udhëtar francez, 1836/38)

*Me jep këto krahë, oh, më lër të fluturoj
Të shpejtoj drejt shtëpisë në tokën e harlisur që adhuroj*

Të kaloj shtigjet e së bukurës tokës sonë jugore
 Për të parë Ohrin, vështruar Strugën përsëri.
 Atje ku agimi me gishta ngjyrë rozë ndriçon shpirtin tim
 Atje ku kodrat me pemë duken të ndezura në perëndim
 Atje ku shkëlqimi i natyrës dhurata pa fund blaton
 Të korra det mblidhen në fusha
 Dhe bardhësia e qashtë e liqenit pamjen zgjeron
 E errësuar nga era, nuanca blu përfiton,
 Vështroni këto male, ato fusha hyjnore
 Këqyrni bukuritë e tyre që mbetet për gjithmon’.
(Konstantin Miladinov - poet maqedonas, 1860)

Ajo çka pashë atje më magjepsi, më zuri rob dhe unë nuk mund të
 largohesha nga Liqeni i Ohrit për orë, për ditë, për ditë dhe net të tëra.
(Branislav Nushiç - shkrimtar jugosllav, 1894)

Zona e Ohrit, kur i afrohesh me anije nga manastiri i Shën Naumit, mund
 të krahasohet me pamjet më të bukura në botë. Piramidat vjollcë të maleve
 shqiptare në perëndim varen njeri mbi tjetrin. Një fillad i butë trazon lehtë
 sipërfaqen e liqenit, ku pasqyrohen retë e bardha. Gradualisht, qyteti i
 bardhë kodrinor ravijëzohet në sipërfaqen e ujit blu me rrënojat e kalasë
 së Car Samuelit në krye. Kishat, kubetë, kullat shfaqen njëra pas tjetrës.
 Muret e bardhë të shtëpive, çatitë e kuqe dhe gri, gurët e verdhë, janë të
 gjitha në harmoni me ngjyrën e pastër të gjelbër të plepave, shelgjeve dhe
 pemëve frutore. Bregu duket si një vend në lulëzim; është plot e përplot me
 oleandër, lule vile, qiparisa, shkurre rozë dhe pemë fiku. **(Stojan Pribiçević -
 gazetar amerikan, 1905)**

Mund të shihet nga ballkoni ose të ndjehet dhe shihet nga dritarja e lartë se
 çfarë është, ç’pamje ka, qëllimi kryesor i kësaj arkitekture dhe nevojën më
 të madhe të këtyre njerëzve: ajrin e diellin dhe bukurinë e pamjes së Liqenit
 e të peizazhit rreth tij. **(Ivo Andriç - shkrimtar, fitues i Çmimit Nobel për
 Letërsi, 1955)**

Mund të thuhet se një pjesë e detit është shkullur nga oqeani dhe është
 hedhur mes maleve të paarrtshme që e rrethojnë atë kudo. Liqeni i Ohrit
 mund të quhet deti maqedonas i ujërave të ëmbla – dhe jo vetëm për
 shkak të ngrohtësisë të ngjyrës blu, e cila është më e gjallë se bluja e qiellit.
(Akademik Sinisha Stankoviç - biolog jugosllav, 1959)

Afresket e Ohrit janë unike. Ky art, mbi të gjitha, të bën për vete me fuqinë
 dhe burrërinë e tij. **(Akademik Viktor Lazarev - bizantolog sovjetik, 1961)**

I vizitova kishat në Ohër, janë rreth tridhjetë. Ato janë një provë se midis artit
 kishtar bizantin, Ravenës dhe Sicilisë, nga njëra anë dhe Rilindjes Italiane nga
 ana tjetër, nuk kishte ndonjë hendek. Ohri është një urë e rëndësishme e artit
 europian. **(Sir Herbert Read – historian britanik i artit, 1961)**

Është e pamundur të studiosh artin bizantin pa vizituar Maqedoninë... Duke
 parë afresket e Shën Sofisë në Ohër, është shumë e dallueshme mënyra sipas

së cilës artistët e panjohur arritën zgjidhjet vizuale artistike brenda kompozimit. Është krejtësisht e pajustificueshme të flitet rreth ekzistencës të një shkollë të pastër bizantine. (**David Talbot Rice - bizantolog britanik, 1961**)

Unë në të vërtetë erdha në Ohër për shkak të afreskeve...Perëndimi nuk e njih aspak rilindjen tonë. Perëndimi nuk e vlerësoi për një kohë të gjatë kontributin kombëtar sllav në artet bashkëkohore. (**Ilia Erenburg - shkrimtar sovjetik, 1965**)

Ohri ka plot kisha të vjetra. Një kishë ekzistonte shumë kohë më parë se shekulli VII, përpara mbërritjes së Klementit. Është ndërtuar nën kullën e lartë të kalasë dhe u kthye në xhami gjatë qeverisjes turke. Kjo kishë u rindërtua disa vjet më parë. Në pjesën e saj jugore mund të gjendet varri i Klementit. Klementi e ndërtoi vetë varrin dhe u varros aty në 26 Mars të viti 916. (**Tang Kuang Si - publicist kinez, shkrimtar dhe përkthyes, 1986**)

Ajo që është duke ndodhur aktualisht në sitet arkeologjike të Ohrit është magjepsëse. Është rilindje e vërtetë e arkeologjisë dhe artit maqedonas që lidhet me qytetin e Ohrit. (**Akademik Dejan Medakoviç - historian arti, 2002**)

Këto janë vetëm disa nga shumë përshtypje rreth Ohrit. Ato mund të jenë një ndihmë e madhe për dikë që të kuptojë Ohrin, bukurinë, kompleksitetin, vlerat e tij si dhe unitetin e tyre emocionues.

Monumente të Rëndësishme Arkeologjike dhe Arkitekturore

Matrica urbane e qytetit të vjetër të Ohrit është plot me site arkeologjike të shumta, qendra shpirtërore dhe arkitekturë banesash, karakteristike në këtë territor gjatë shekullit XIX, si dhe nga arkitekturë e kohëve të fundit, e krijuar nën ndikimin e neoklasicizmit europian dhe influencave të tjera bashkëkohore. Shtëpitë në Ohër janë orientuar drejt juglindjes në terrenin kodrinor dhe karakterizohen nga një lloj izolimi cilësor dhe pamjet e bukura të liqenit. Organizimi i tyre hapësinor është i përbashkët për të gjitha, ndarë vertikalisht në pjesën dimërore dhe pjesën verore. Në katin përdhes mbaheshin drutë e zjarrit, vera, rakia dhe ushqimet e përgatitura për dimër. Katet e sipërme shtrihen deri jashtë mureve kryesore në drejtim të rrugës dhe këtu është hapësira ku zhvillohen funksionet e jetës së përditshme të familjes. Katet e sipërme janë me përfaqësuese dhe me çardakun e mbyllur të dekoruar



me bollëk. Ato janë ndarjet më të mëdha dhe mundësojnë pamje të mrekullueshme mbi liqen. Përdoreshin për pritjen e miqve, për pagëzime dhe ngjarje të tjera të rëndësishme të familjes.

Peshkatarët që e kishin fatin të lidhur drejtpërdrejt me liqenin, kishin shtëpi të tipit të veçantë. Hyrje nga rruga, por edhe nga liqeni, ku peshku grumbullohej dhe përgatitej për shitje. Veçori të këtij qyteti janë të ashtuquajturat rrugë të errëta, tunele të mbuluara nga katet sipërme të shtëpive. Ndër monumente e mbrojtura të Ohrit që konsiderohen si pasuri kulturore përfshihen 23 ndërtesa të shenjta të krishtera, 74 ndërtesa laike, 7 ndërtesa të arkitekturës Islame dhe 10 site arkeologjike.

Prehistoria dhe Periudha Antike

Kushtet e favorshme gjeografike dhe klimatike, si dhe kontakti me liqenin, me ujërat e tij të ëmbla e të pasura me peshq, si elemente thelbësore për krijimin e jetës, kontribuan në krijimin e vendbanimeve palafite, ashtu edhe në ngritjen e ndërtesave afër bregut. Kjo mund të dëshmohet nga 15 sitet arkeologjike të regjistruara në këtë zonë që i përkasin periudhës parahistorike.

Në vitin 1997 u kryen të parat eksplorime arkeologjike nënujore në Maqedoni, në sitin e Plocha Michov Grad, në Gjirin e Eshtrave, përgjatë bregut jugor të gjysmë gadishullit Gradishte, afër me fshatin Peshtan. Në një thellësi prej 3 deri në 5 m u zbuluan shtylla druri të vendosura në fundin e liqenit dhe materiale të shumta të lëvizshme arkeologjike, që i përkisnin fundit të Periudhës së Bronzit dhe fillimit të Periudhës së Hekurit. Gjatë viteve 1998 – 2005 në sit u kryen ekspedita kërkimore të shumta nënujore, që zbuluan, numëruan, matën dhe pozicionuan 9102 shtylla. Duke u bazuar tek matjet e vendbanimit, u pa se ai shtrihej në një sipërfaqe prej 8500 m². Ishte ndërtuar mbi një platformë prej shtyllash





druri të ngulura në fundin e liqenit. U përcaktua se shtylla më e afërt me bregun verior të gjirit ishte rreth 12 m, duke nënkuptuar se një urë e lëvizshme lidhte vendbanimin me tokën e thatë. Sot, siti “Plocha Michov Grad”, brenda Gjirit të Eshtrave, është një kompleks muzeal tërheqës me një numër komponentësh: rindërtimi i vendbanimit palafit mbi liqen, një fortesë romake që është ruajtur, restauruar dhe prezantuar në pllajën më të lartë të Kodrës Gradishte, një muze, si dhe një strukturë për realizimin e turizmit nënujor.

Teatri Antik

Teatri Antik i Ohrit u ndërtua në vitin 200 para Krishtit, dhe është i vetmi teatër helenistik në vend, përderisa tre teatrot e tjerë në Skupi, Stobi dhe Herakle janë nga koha romake. Është e paqartë se sa njerëz uleshin në teatrin origjinal, përderisa sot ekziston vetëm pjesa e poshtme. Teatri i hapur ka një vendndodhje të përkryer; është i rrethuar nga dy kodra që e mbajnë të mbrojtur nga erërat, të cilat mund të ndërhyjnë me akustikën gjatë shfaqjeve.

Në kohërat romake, teatri përdorej edhe për luftime gladiatorësh. Megjithatë, për shkak se ishte edhe vend për ekzekutimet e krishterëve nga romakët, teatri u bë shumë i papëlqyer për vendasit. Si rezultat, teatri u braktis dhe u varros nga vendasit pas rënies së Perandorisë Romake. Fatmirësisht, kjo bëri që pjesa më e madhe e strukturës së tij të ruhej mirë, për t’u zbuluar më pas aksidentalisht në vitet 1960. Gjatë disa punëve ndërtimore rreth shtëpive në zonë, dolën në dritë blloqe të mëdhenj gurësh me gdhendje muzash dhe të perëndisë greke Dionis, të cilat i bënë arkeologët të besonin se në afërsi duhet të kishte pasur një teatër grek (Dionisi dhe muzat lidheshin me shfaqjet artistike).


Gërmimet arkeologjike, të kryera nga Muzeu Kombëtar i Ohrit e lokalizuan me shpejtësi teatrin dhe përcaktuan se ai nuk ishte romak, por ishte përshtatur për t’i shërbyer nevojave të shoqërisë romake. Gjatë këtyre gërmimeve të para, midis gjetjeve të tjera, u zbulua dhe maska e famshme teatrale në miniaturë, punuar prej fildishi. Gërmimet arkeologjike

në vitin 2001 dhanë rezultate vërtet të çmuara; u zbulua një monument me mbishkrime, i cili është një paraqitje e thjeshtë e emrit të qytetit Lyhniidë, po ashtu edhe 280 varre dhe ndërtime varresh, si edhe rrënojat e dy kishave – njëra në pjesën jugperëndimore, dhe tjetra në pjesën verilindore të sitit.



Që prej fundit të viteve 1980, teatri është bërë përsëri skenë shumë popullore për shfaqjet artistike, si p.sh. drama, koncerte, opera, balet, si pjesë e Festivalit të Verës në Ohër.

Fortesa e Ohrit e Car Samuelit



Të dhënat më të vjetra historike mbi Fortesën e Ohrit vijnë nga historiani klasik Tit Livi në shekullin III para Krishtit, kur ajo ishte fortesa e qytetit Lyhniidë. Një përshkrim më i detajuar i fortesës na vjen nga kronisti Malcus (Malala) dhe daton që nga viti 478. Fortesa e Ohrit e Car Samuelit është përshkruar si një fortesë e fuqishme, të cilën edhe Teodoriku, mbret i Ostrogotëve e pati të pamundur ta merrte. Fortesa e Ohrit është një nga fortifikimet më të mëdha mesjetare, që ruhet në Republikën e Maqedonisë. Me muret dhe bedenat e saj masive, ajo mbulon të gjithë majën e kodrës së Ohrit. Pjesa kodrinore e qytetit ishte e mbrojtur nga të gjitha anët, përveç jugut që është ballë për ballë me liqenin, me kulla dhe mure të larta dhe të gjata tre kilometra, duke u shtrirë deri tek porti. Hyrja në qytet bëhej përmes tri portave, nga të cilat është ruajtur vetëm Porta e Sipërme. Fortesa, përveç se shërbente për mbrojtje nga armiqtë, ishte edhe zonë e banuar dhe, me kalimin e kohës, u quajt Fortesa e Samuelit. Në vijim të gërmimeve epokale arkeologjike të kryera nga arkeologu Pasko Kuzman, u arrit në përfundimin se terreni i Fortesës së Samuelit në majën e





kodrës së Ohrit, bashkon disa shekuj në tre periudha të historisë së Ohrit: Periudha para Samuelit, Periudha e Samuelit dhe Periudha pas-Samuelit.

Kisha Peshkopale e Krishterimit të Hershëm

Në majën e kodrës së Ohrit, afër vendit të njohur si Plaoshnik (një term i vjetër sllav që do të thotë një vend i sheshtë në kodër), ndodhet një kishë monumentale e krishterimit të hershëm. Gërmimi i saj sistematik filloi në vitin 1961 dhe përfundoi në vitin 1964. Tempulli u ndërtua dhe dekorua në shekullin V, në atë kohë kur qyteti i Lyhniidës ishte një qendër e rëndësishme peshkopale e krishterimit të hershëm. Ajo ka shumë kënde që i japin formën e gjetes së tërfillit dhe është ndërtuar mbi themelet e një strukture më të vjetër klasike. Kompozime mozaiku, me motive figurative floreale dhe zoomorfe janë zbuluar në pjesën qendrore dhe në pagëzimore.



Janë ruajtur rreth 100 metra katror nga ky kompleks i madh mozaikësh. Tavanet me qemerë të kishës janë zburuar gjithashtu me mozaikë, të vendosur në një sfond të artë. Prania e këtij shkëlqimi vjen nga fakti se kjo kishë ka qenë selia e Peshkopatës së Lyhnidës. Gërmimet sistematike kanë treguar se kisha kishte dimensione të mëdha. Artistë të panjohur e dekoruan atë me mozaikë të mrekullueshëm.

Kisha dhe Manastire

Kisha e Shën Sofisë

Kisha katedrale e Shën Sofisë është një nga tempujt e krishterë më të vjetër dhe më të mrekullueshëm në Maqedoni. Kisha i dedikohet Shën Sofisë, që do të thotë, Krishtit si një urtësi hyjnore. U ndërtua mbi themelet e një ndërtimi të lashtë të shenjtë, pas misionit të madh të Shën Cirilit dhe Shën Metodit, kur sllavët maqedonas pranuan krishterimin në gjuhën sllave. Kisha e Shën Sofisë, me shumë gjasa, shërbeu si katedrale në kohën e Car Samuelit, i cili në fund të shekullit X, e transferoi fronin e tij nga Prespa në Ohër.

Nga jashtë, Shën Sofia e cila për një kohë të gjatë ishte kisha katedrale e kryepeshkopatës së Ohrit, ka formën e shkronjës "T" me dy çati anësore të pjerrëta, që bashkohen në mënyrë të tërthortë. Fillimisht mbi fasadën





perëndimore kishte një kupolë kryesore, galeri anësore dhe një kambanore të madhe, të cilat u shkatërruan të gjitha më vonë. Dy kubetë e vogla mbi narteksin e jashtëm, narteksti vetë dhe galeria e katit ta parë u ndërtuan në fillimin e shekullit XIV.

Sot kisha është një bazilikë tre-nefshe me një absidë altar trekëndore të altarit dhe me absida gjysmë rrethore në diakonikon dhe protezis. Ajo është ndërtuar me tulla të pjekura, gurë dhe llaç. Mbi diakonikon dhe protezis ka dy faltore të vogla nga periudha e Komnenëve në shekullin XII. Më vonë, në mesin e shekullit XIV, u ndërtuan pjesa e sipërme e narteksit dhe Faltorja e Shën Joan Pagëzorit. Narteksti i jashtëm me galerinë e tij në fasadën perëndimore të kishës u ndërtua në vitin 1313 në kohën e Kryepeshkopit Gregorius, siç edhe tregohet në një mbishkrim mbi tulla që ndodhet në gjatësinë e fasadës. Kisha konsiderohet si një kryevepër e arkitekturës mesjetare.



Kompleksi Arkeologjik i Plaoshnikut

Shën Klementi dhe Shën Panteleimoni është një manastir që ndodhet në Plaoshnik. I atribuohet Klementit të Ohrit, një dishepull i Shën Cirilit dhe Shën Metodit. Arkeologët kanë dalë në përfundimin se manastiri ishte vendi ku mësonin studentët e parë të alfabetit Glakolitik (përdorej për të përkthyer Biblën në sllavishten e vjetër kishtarë). Aty gjendet një kishë peshkopale e krishterimit të hershëm, që u gërmua midis viteve 1961 dhe 1964. Kisha u ndërtua në shek. V në formën e tërfillit. Janë zbuluar dhe konservuar mozaikë, të cilët janë pjesë e kishës. Kjo konsiderohet si një nga vendndodhjet arkeologjike më të rëndësishme në vend.

Manastiri qëndron mbi një kodër, e cila njihet si Plaoshnik dhe dominon Liqenin e Ohrit. Shën Klementi e ndërtoi manastirin e tij mbi një kishë të restauruar dhe një bazilike romake me pesë pjesë (rrënojat e bazilikës



mund të shihen ende nga jashtë manastirit). Burimet thonë se Shën Klementi nuk ishte i kënaqur me madhësinë e kishës dhe kështu që urdhëroi ndërtimin e një kisha të re mbi të dhe caktoi Shën Panteleimonin si shenjtorin e saj mbrojtës.

Klementi personalisht ndërtoi brenda manastirit një dhomë të nëndheshme, në të cilën u varros pas vdekjes, në vitin 916. Varri i tij ekziston edhe sot e kësaj dite.

Midis shekujve XV dhe XVII, manastiri u rrënuar dhe u kthye disa herë në xhami (e quajtur Xhamia Imaret).

Përveç rindërtimeve të shumta të gjatë Perandorisë Otomane, manastiri së fundmi është duke iu nënshtruar rindërtimeve dhe gërmimeve të mëdha. Rindërtimi filloi në vitin 2000 dhe kisha fizikisht u rindërtua plotësisht në vitin 2002.

Shumica e relikeve të Shën Klementit iu rikthyen kishës. Një kambanore, pjesërisht e rrënuar u restaurua në pjesën e djathtë të manastirit dhe dyshemetë e interierit të kishës u rinovuan me mermer. Rindërtimi u krye me punë dore, duke përdorur të njëjta materiale që u përdorën në



ndërtimin e kishës origjinale për të ruajtur kështu spiritualitetin origjinal të manastirit. Mjete moderne u përdorën vetëm për të pastruar interierin.

Në 10 Tetor 2007, gjatë gërmimeve në manastir arkeologët zbuluan një depo me 2.383 monedha veneciane. Monedhat kanë rëndësi të veçantë,





pasi ato tregojnë se Ohri dhe Venecia ishin të lidhur nga ana tregtare.

Meqë manastiri është më i shenjtë nga të gjitha kishat në Republikën e Maqedonisë, mijëra maqedonas të krishterë ortodoksë mbledhen në Plaoshnik gjatë festave të mëdha fetare si p.sh. Pashkët dhe Krishtlindjet për të festuar dhe marrë pjesë në liturgji.

Kisha e Shën Joan Teologut në Kaneo

Kisha u ndërtua dhe dekorua në fundin e shekullit XIII; dhuruesi dhe piktori i afreskeve janë të panjohur. Arkitektura e kishës ka rëndësi të madhe për studimin e monumenteve mesjetare të Ohrit si një kombinim shumë i suksesshëm i elementeve bizantine dhe armene. Kisha ndodhet në një nga vendet më të bukura të bregut të liqenit, mbi një shkëmb të lartë – duke dominuar qendrat e dikurshme të peshkimit në Kaneo (një fjalë latine që do të thotë zbardhim ose shkëndijë) në pjesën e vjetër të Ohrit.

Shën Joani në Kaneo, një nga pikat e referimit të Ohrit të vjetër, u restaurua në formën origjinale gjatë viteve 1963-1964, kur kambanorja dhe hajati, të dyja shtesa të shekullit XIX, u hoqën. Ishte me këtë rast që u zbuluan afresket në kube. Afresket në kube dhe rreth altarit janë ruajtur, megjithëse të dëmtuara në masë të konsiderueshme. Midis shekujve XVII dhe XIX kisha u rrënuar pjesërisht dhe u braktis dhe një numër i madh afreskesh u shkatërruan e humbën përgjithmonë.





Kisha e Shën Mërisë e Zotit Peribleptos

Sipas një mbishkrimi mbi murin e brendshëm të narteksit mbi hyrjen kryesore, kisha është ndërtuar nën emrin e Shën Mërisë të Zotit më të Lavdishëm (Peribleptos) në vitin 1925 nga komandanti i ushtrisë bizantine, Progon Zgur, një i afërm i Perandorit Androniku II Paleolog. Me kthimin në xhami të Kishës së Shën Sofisë, kisha e Shën Mërisë së Zotit Peribleptos u bë kisha katedrale e Kryepeshkopatës së Ohrit.

Pikturat në kishën e Shën Mërisë së Zotit Peribleptos shënojnë një kapitull të ri në pikturimin mesjetar. Ato shoqëruan një tendencë të re në artin bizantin, i cili u njoh me emrin Rilindja Paleologe. Ato janë gjithashtu punët më të hershme të njohura nga Mihali dhe Eutikiu, piktorë të shquar të afreskeve mesjetare, krijimet e të cilëve mund të vërtetohen afërsisht përgjatë tre dekadave.



Kisha ka formën e kryqit dhe mbulohet nga një kube me bazë tetëkëndëshe e dekoruar nga jashtë me friza cilindrike. Narteksi dhe pjesa qendrore u ndërtuan në të njëjtën kohë. Është ndërtuar me mjeshtëri me tulla dhe gurë travertin, duke krijuar kështu një

efekt të jashtëzakonshëm zbukurues dhe, në të njëjtën kohë, një harmoni të përkryer. Pa dyshim, Kisha e Shën Mërisë të Zotit Peribleptos radhitet midis arritjeve më të shquara të arkitekturës mesjetare.

Kisha e Shën Nikolla Bolnicki



Kisha është me interes si për arkitekturën, ashtu edhe për afresket. Në oborr gjenden rrënojat e mureve të qytetit, të cilët shtriheshin që prej Kalasë së Samuelit deri në breg të liqenit. Kisha ka qemerë gjysmë-rrethorë. Kambanorja në pjesën e saj perëndimore është unike në Maqedoni dhe u ndërtua me ndikime arkitekturore nga bregdeti Adriatik.

Kisha e Shën Mërisë Bolnicki

Kjo kishë u dekorua për herë të parë në vitin 1368. U dekorua përsëri në fund të shek. XIV dhe me të gjitha gjasat mori formën që ka aktualisht në shek. XV. Piktura të tjera murale iu shtuan në shek. XIX. Ikonostasi, mjaft i pasur me dekorime dhe motive lulësh, frutash dhe zogj të stilizuar, u



gdhend në vitin 1833 dhe është punë e drugdhendësit maqedonas Nikolla Darkovski Karaxhoviç i Lazaropoles.



Kisha e Shën Nikolla Çudotvoreci

Për banorët e pjesës së vjetër të Ohrit, kjo kishë është mjaft e njohur si kisha e Shën Nikolla Çudotvorec - Çelnički, sepse ndodhet në afërsi të Bogorodica - Çelnicas. Është e ndërtuar mbi rrënojat e një tempulli të hershëm të krishterë. Përgjatë shekujve kisha është rindërtuar dhe pikturuar me afreske. Është një nga galeritë më të rralla, ku pikturat murale

janë ruajtur në fragmente përgjatë periudhave që variojnë nga shek. XI deri në shek. XIV dhe më vonë. Nga viti 2000 deri në vitin 2005 u krye pastrimi dhe konservimi i afreskeve të shumta shekullore.

Monumentet Islamike



Xhamia Haxhi Durgut (Kryq)

Xhamia e Kryqit (Haxhi Durgut) është mjaft e njohur. Ajo ndodhet në vendin ku mendohet se ka qenë kisha e dikurshme e Shën Nedellës, dhe është një nga xhamitë më të vjetra në Ohër, e ndërtuar në vitin 1466. Një kryq i vogël ndodhet edhe sot në gjysmëhënën e majës së minares; sipas legjendës, kur turqit ishin duke rindërtuar minaren ata e hodhën kryqin në liqen, por ai u rishfaq përsëri në majë të minares. Kur ata e hodhën kryqin përsëri, minarja u shemb dhe kur ata e ringritën përsëri, kryqi u rishfaq në të njëjtin vend. Kjo vazhdoi të ndodhte vazhdimisht, derisa dikush pa një ëndërr se minarja nuk do të shembej, nëse ata nuk do të hiqnin kryqin nga maja e saj. Turqit e vendosën kryqin në gjysmëhënë dhe kështu vazhdon të ekzistojë edhe sot.



Xhamia e Ali Pashës

Xhamia e Ali Pashës ndodhet në pazarin e vjetër, afër fushës së vjetër. Sipas të dhënave historike dhe duke gjykuar nga pikëpamja arkitekturore për themelet e saj, xhamia është ndërtuar në fund të shek. XV dhe fillim të shek. XVI nga veziri Ali Pasha.

Sipas *Vakufnamesë* (një dokument në të cilin listohen pasuritë islame) të Ohrit që nga viti 1491, është e dukshme se kohë ekzistonin saraje dhe *vakëfe*, të cilat i përkisnin Ali Pashës. Ajo tregon gjithashtu se, midis shumë ndërtimeve të Ali Pashës, ishte edhe një xhami. Sipas zakonisht otoman, çdo pasha duhej të ndërtonte një xhami në vendin ku ai ishte emëruar. Kjo konfirmohet edhe nga veçoritë e dukshme të xhamisë së Ohrit që i gjejmë të pranishme edhe në xhamitë Hajdar Kadi në Manastir, Fuad Pasha dhe Ali Pasha në Stamboll.

Të gjitha xhamitë e ndërtuara midis shekujve XV dhe XVI janë të ngjashme: ato janë pa kolona, veçori kjo e fillimit të arkitekturës klasike otomane.



Çatia në kube është e shtypur dhe vrimat janë shumë të ngushta; kjo është një karakteristikë e ndërtesave lokale dhe mbështet faktin se ndërtuesi ishte lokal, me shumë gjasa nga Ohri.

Gjatë ndërtimit të një objekti pranë Xhamisë së Ali Pashait në vitin 1999, gërmimet nxorën në dritë mozaikë dyshemeje që vazhdonin nën ndërtesën e xhamisë. Mozaikët e kanë origjinën që nga bazilika e krishterimit të hershëm; në të njëjtën kohë u zbuluan mure të objekteve mesjetare të shenjta, të cilat konfirmojnë se kjo ishte vendndodhja e Kishës së Shën Nikollës. Me gërmimet e mëtejshme arkeologjike u krye një projekt studim për konservimin e plotë të mozaikëve, që do t'i prezantohet publikut së bashku me ndërtesën e ndërtuar rishtas.

Teqja dhe Xhamia Zejnel – Abedin

Teqja e dervishëve e urdhrit Halveti u ndërtua në gjysmën e parë të shek. XVII nga Zejnel Abedin Pasha si xhami e zakonshme dhe shkollë fetare ("medrese"). Aktualisht, pjesë e kompleksit të manastirit është edhe një faltore varrimi (tyrbe), që ka në qendër varrin e Haxhi-Muhamed Hajatit, me origjinë perse, i cili ishte udhëheqësi i parë i dervishëve (sheh) në Ohër.



Tyrbja (varri) Sinan- Çelebi

Shumë afër kishës së Shën Klementit dhe Panteleimonit në Plaoshnik është një tyrbe (varr) me varrin e Sinan





Çelebi, themeluesi i Imaretit (kuzhinë) bamirës për të varfrit, i cili ekzistoi deri në vitin 1912. Ai vdiq në vitin 1493; pranë varrit të tij në tyrbe ndodhet varri i Tashulës dhe fëmijës së saj, e cila ishte gruaja e Xheladin Beut, zot i qytetit në shekullin XIX.

Kulla e Sahatit

Kulla e Sahatit, e ndërtuar në rrëzë të pjesës lindore të kodrës së Ohrit në vitin 1726, binte çdo orë *alla turca*, deri në vitin 1912. Ajo ishte e lidhur ngushtësisht me pazarin e vjetër dhe ishte e rëndësishme për popullsinë myslimane, sepse lajmëronte pesë herë në ditë për faljet e përditshme në tempujt islamikë.



Arkitektura e qytetit të vjetër

Arkitektura e qytetit të vjetër të Ohrit zë në vend me rëndësi në trashëgiminë kulturore të qytetit, veçanërisht për shkak se është ruajtur pamja tipike e një qyteti oriental të shekullit XVIII dhe XIX, me tiparet e tij stilistike. Një arkitekturë e ngjashme mund që të gjendet edhe në vende të tjera, jo vetëm në Maqedoni; megjithatë, ky stil arkitekturor është zhvilluar me tipare origjinale, lokale, që janë krijuar nën ndikimin evropian. Mungesa e ajrit dhe dritës në rrugica vjen si rrjedhojë e shtëpive të mëdha me shumë kate, njëra më e madhe se tjetra, të gjitha me shumë dritare që shikojnë nga jugu, në drejtim të liqenit.



Hapësira e kufizuar për ndërtime rezultoi në rrugica shumë të ngushta midis shtëpive; disa nga rrugicat janë aq të ngushta sa që dy njerëz mund të kalojnë me vështirësi pa fërkuar shpatullat me njëri tjetrin.

Shtëpi të pakta të ruajtura nga shekulli XIX mund të gjenden në rrugët shumë të populluara, nëpër të gjithë qytetin e vjetër, secila prej tyre

me shkëlqimin e saj. Objektet e ruajtura të arkitekturës së banesave të Ohrit të vjetër janë monumente të admirueshme të së kaluarës së Maqedonisë dhe përfaqësojnë frymëzim për krijimtarinë bashkëkohore arkitekturore.



Shtëpia e parë Robevi u ndërtua në 15 Prill 1827, siç edhe dëshmohet nga mbishkrimi në gjuhën greke përmbi pllakën prej mermeri. Kjo familje e famshme tregtare e Ohrit jetoi në shtëpi për 35 vjet, kur në vitin 1862,



një kriminel i famshëm nga Ohri, Ustref Beu, e dogji të tërën. Më 1863-1864 shtëpia u rindërtua. Ajo ndahej në dy pjesë: majtas dhe djathtas. Konstantin Robev jetonte në anën e djathtë, ndërsa vëllai i tij Atanas Robev në pjesën e djathtë. Ndërtuesi kryesor ishte Todor Petkov, i cili e ndërtoi shtëpinë që nga themelet. Familja jetoi në shtëpinë e re deri në vitin 1900, kur vendos në Manastir dhe nisi ta përdorë shtëpinë si rezidencë verore. Midis viteve 1913-1919, gjatë Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, shtëpia priti ushtarë serbë. Ajo pësoi disa dëme gjatë periudhës së qëndrimit të tyre, ndërsa disa gdhendje u morën në Serbi (Nish). Shtëpia është mbrojtur si muze kulturor-artistik i Maqedonisë që prej mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Rindërtimi i fundit i kësaj shtëpie



të mrekullueshme u krye në vitet '90 të shekullit të kaluar. Tani në shtëpinë Robev është vendosur pjesa më e madhe muzeut, koleksioni arkeologjik që demonstroi thesaret arkeologjike të rajonit të Ohrit, nga prehistoria deri në ditët e sotme. Në "shirvan" (nën çati), ku është krijuar një rezidencë banimi e Ohrit, janë ekspozuar gjithashtu. Kati përkujtimor i familjes është Robev me detajet materiale origjinale të kohës së saj, është vendosur në krahun lindor të këtij konstruksioni të bukur, që mishëron cilësitë dhe traditat interesante të shekullit XIX.

Shtëpia Krapçe përfaqëson një arritje artistike unike. Ajo është shembull tipik i një shtëpie shekullit XIX, si pjesë e urbanizimit organik që përdor një hapësirë minimale afër liqenit dhe kishës së Shën Sofisë. Ndërtesa është tre kate e lartë, duke përfshirë katin përdhës. Kati i parë është i ndërtuar me gurë dhe konstruksion druri të lehtë "bondruçna". Çatia e ndërtesës ishte



e mbuluar fillimisht me tjegulla të vjetra të pikturuara të stilit turk. Muri i gurtë i fasadës perëndimore është vetëm 2.62 metra e gjerë dhe formon përmasa prej rombi në drejtim të lindjes. 2 katet e sipërme varen mbi rrugë për të rritur sipërfaqen e tyre. Elementi më karakteristik janë "timpanel" e fasadës perëndimore, të cilët rrisin strukturën hapësinore të shtëpisë, duke krijuar harmoni të mureve.

Ndërtesa fillimisht u ruajt siç ishte me përfundim të ndryshimeve të brendshme, por koha bëri të vetën dhe nevojiteshin masa mbrojtëse të përhershme. Çrregullime statike dhe çarje u shfaqën në mure. Punë e gjerë konservuese u bë për të ruajtur shtëpinë në formën e saj origjinale. Në vitin 1968, si rrjedhojë e çrregullimeve statike, pronarët bënë një set pjesësh prej çeliku, si kolona dhe binarë në fasadën jugore të ndërtesës. Në vitin 1999 ata bënë zëvendësimin e të gjithë strukturës së drurit,



konservimin e fasadave, balancimin vertikal dhe horizontal të mureve, si dhe ndërhyrje të tjera në interior.

Shtëpia Paçev ndodhet në bërthamën e qytetit të vjetër, të quajtur Varosh, në rrugën “Car Samuel” nr. 60, e rrethuar nga shtëpi të dendura, që i ngjishen njëra-tjetrës, të ndara nga rrugica të ngushta, duke shikuar nga jugu, në drejtim të liqenit. Ky kompleks shtëpish rrethon një nga shembujt e paktë autentikë të arkitekturës së vjetër në Ohër. Efekti vizual i krijuar nga shtëpitë mbi rrugë, është shpesh frymëzim për fotografi, piktura, kartolina, publikime të ndryshme, si dhe pulla poste, duke simbolizuar diçka unike, autentike dhe që njihet vetëm në Ohër.


Shtëpia u ndërtua në fund të shekullit XIX (me shumë gjasa në të njëjtën periudhë me shtëpinë Robevi). Kati përdhes është ndërtuar prej druri me njërën anë të zhytur në dhë dhe ka dy hyrje, si rezultat i ndarjes së dikurshme në dy pjesë të shtëpisë, e cila është rijetëzuar me shitoren e artizanatit, e izoluar nga pjesa tjetër e ndërtesës. Katet janë të ndërtuara me sisteme druri dhe kanë ruajtur të njëjtin funksion me të njëjtin planimetri të mjedisëve, me dysheme të ndërtuara mbi binarë dhe shkallë druri. Çatia është e ndërtuar prej druri dhe është e mbuluar me tjegulla të stilit turk. Fasada është sipas stilit të vjetër tipik tradicional, me ngjyrë të bardhë, me një kat me konsol mjaft të profilizuar. Gjendja e përgjithshme fizike dhe mbrojtja e kësaj shtëpie është e mirë, sepse është riparuar në vitin 2009.

Shtëpia Bojadjevi ndodhet në bërthamën e mbrojtur të qytetit. Ajo është gjysma jugore e një shtëpie vëllazërore dhe përfaqëson një mostër origjinale të arkitekturës së qytetit të vjetër të Ohrit. Karakteristikë është se ky objekt është ndër të paktët që nuk ndjek linjën e rrugës, por ka një orientim të lirë në brendësi të oborrit. Përmasat dhe stili i shtëpisë e bëjnë atë shembull tipik që plotëson kërkesat e një shtëpie për të pasur. Ndërtesa është tipike për epokën, me katin përdhes prej muresh guri me fuga dhe konstruksion muresh druri të mbuluara me suva. Dyshemetë dhe konstruksioni i çatisë janë prej druri, ndërsa çatia është e mbuluar me tjegulla me stil të vjetër turk të pikturuara. Interieri është mjaft i pasur me dekorime, veçanërisht dhoma e miqve. (tavane me suva të profiluar, rozeta qendrore në plastikë sekondare, sergjene të modeluara dhe oxhakë, panele druri dekorativ në mure me binarë të profiluar me kënde, musandra me kapakë karakteristike gdhendjesh vertikale dhe horizontale dhe rozeta, dyer tipikë)





Interieri është në një gjendje të keqe, i dëmtuar dhe i rrënuar. Konservimi dhe restaurimi është themelor, në mënyrë që të ruhen vlerat e tij autentike. Ndërtesa u shpall monument kulture në vitin 1951.



Galeria e Ikonave

e Ohrit ndodhet në kompleksin muzeal të Kishës së Shën Mërisë të Zotit Peribleptos. Koleksioni përbëhet nga tridhjetë ikona nga rajoni i Ohrit me cilësitë më të larta artistike, që e radhisin këtë galeri mes tri të më të famshmeve në botë.

Shumica e ikonave në këtë koleksion u krijuan mes shekujve XI dhe XIX në punishtet artistike në Ohër, ndërsa disa të tjera u sollën nga punishtet bizantine dhe të Selanikut. Piktoret e panjohur arritën përkryerje të plotë në punimin e ikonave, të cilat karakterizohen nga vizatimi i rafinuar, modulime të buta dhe ngjyra harmonike. Një vend i veçantë në këtë koleksion u përket ikonave të procesioneve, të pikturuara në të dyja anët, të cilat të bëjnë përshtypje për trajtimin plastik dhe shprehjen e botës së brendshme të shenjtorëve të pikturuar.

Artizanati i Ohrit

Pazari i Ohrit dhe mjeshtëritë e tij të vjetra janë zhvilluar prej shumë kohësh si rezultat logjik përgjatë kodrës e cila ishte qendër banimi, qendër fetare e kulturore. Territori i Ohrit prodhonte me bollëk produkte të kërkuara në tregjet jashtë vendit dhe përmes tij kalonin shumë rrugë të rëndësishme të trafikut në Gadishullin e Ballkanit, duke përfshirë rrugën Egnatia. Edhe pse pa urbanistë e arkitektë, qyteti u krijua dhe zhvillua me një harmoni unike, pa tendenca për uzurpim hapësire dhe pamjeje, duke zhvilluar kushtet e tij karakteristike gjeografike, historike dhe etno-sociale të jetesës dhe punës.



Njerëzit e Ohrit kanë një shpirt të veçantë artistik dhe kanë praktikuar shumë mjeshtëri për shekuj me radhë. Sot këto aftësi tradicionale shfaqen pak a shumë në të njëjtën mënyrë origjinale.

Perla e Ohrit



Një sekret i mbajtur me kujdes për pothuajse një shekull, është perla e Ohrit; me shkëlqimin dhe origjinalitetin e saj, ajo është e vetme në llojin e vet, një xhevahir për të cilën qyteti është kudo shumë i famshëm. Në pazarin e vjetër të Ohrit, mund të dëgjohen shumë histori të ngatërruara për krijimin e perlës. Familja Talevi konsiderohet si një nga familjet e rralla, që ruajnë me fanatizëm traditën dhe recetën e vetme për prodhimin e këtij xhevahiri të bukur e unik.



Historia sekrete e origjinës së perlës fillon me luspat e peshkut të Ohrit, Plasica. Por mënyra e përpunimit dhe teknika për smaltimin është një sekret familjar, i trashëguar vetëm tek pasardhësit meshkuj. Gjithçka që dihet është se receta është blerë nga në vitin 1924, nga një ushtar rus që qëndroi në Ohër dhe se është bërë me material të sjellë nga Betlehemi nga familja Talevi. Padyshim që perlat e mrekullueshme mbartin sekretin e prodhimit të fshehur në bukurinë e tyre.

Familja Talevi ka krijuar perla të Ohrit që prej vitit 1924. Sekretin e përgatitjes dhe procesi i emulsionit është trashëguar nga babi tek djali, vetëm tek pasardhësit meshkuj pa përjashtim, ndërsa femrat mësojnë vetëm të ndihmojnë, nëse është e nevojshme. Emulsioni i përdorur për të mbuluar perlën e Ohrit krijohet duke marrë argjend nga lëkura e peshkut plastica, i cili rritet vetëm në liqenin e Ohrit. Klement Talevi është brezi i dytë, i cili krijon perla të Ohrit. Djali i tij, Vane është i treti dhe nipërit

Klement dhe Mihajllo do të jenë brezi i katërt. Familja Filev zë një vend të rëndësishëm në dizajnin e perlës së Ohrit dhe është edhe mes kandidatëve për Mbretin e perlave të Ohrit. Ajo ka një traditë që daton nga viti 1923. Në vitin 1923, Mihajlo Filev gjeti sekretin për prodhimin e perlës nga lëkura e plasticës, specia e peshkut që është endemike në Liqenin e Ohrit. Familja Filev e trashëgoi mjeshtërinë e krijimit të perlave nga njëri brez tek tjetri. Për më shumë se 80 vjet, bizhuteria e perlave Filev ka qenë suvenir kryesor në qytetin e Ohrit, duke u përmirësuar nga çdo brez dhe duke u bërë pjesë e shumë koleksioneve të bizhuterive në Maqedoni dhe në mbarë botën.



Filigran

Përshkrimi i siteve të shenjta dhe kulturore në Ohër nuk do të ishte i plotë pa përmendur Vangjel Derebanin, dyqani i filigranit i të cilit është një muze i gjallë i punimit të bizhuterive. Mjeshtëria e punimit të argjendit, d.m.th. e filigranit është një traditë shekullore në Ohër. Në Familjen Dereban, si dhe në familjet e tjera që ushtrojnë këtë aktivitet, mjeshtëria e argjendarit kalon nga babai tek djali.

Drugdhendja

Drugdhendja maqedonase arrin kulmin në gjysmën e parë të shek. XIX me punimin e ikonostasit në kishën e Shën Spasit në Shkup dhe manastirin e Shën Jovan Bigorskit, që ndodhet në luginën e lumit Radika. Në atë kohë, përveç Petar Filipovskit nga fshati Gari, drugdhendësit më të famshëm ishin vëllezërit e tij Marko dhe Makarie Negriev Frckovski. Ata punuan së bashku për një periudhë kohe.

Shekulli XIX ishte shekulli i fshatarëve drugdhendës dhe piktorëve të afreskeve (zografi) maqedonas. Të grumbulluar në grupe, ata linin fshatrat e tyre Galicnik, Lazaropole, Gari, Osoj dhe Tresonce në pranverë dhe punonin nëpër Ballkan për të fituar jetesën. Vonë në vjeshtë ktheheshin në shpatet e malit Bistra dhe maleve të tjera në luginën e lumit Radika. Drugdhendësit maqedonas nga rrethinat e Dibrës zbukuruan me gdhendje në dru ikonostasat e kishave të Shën Bogorodica Bolnickës and Shën Bogorodica Kamenskos në Ohër. Ato konsiderohen si disa nga më të arrirat. Duke punuar në ikonostase, drugdhendësit, si artistë unikë në rajonin e krishterimit lindor, trokitnin në zemër të drurit, duke kërkuar melodinë e tij më shprehëse.

Në periudhën para dhe pas Luftës së Parë Botërore, drugdhendja filloi të bjerë me shpejtësi. Në vitin 1928, për të përtërirë këtë aktivitet artistik, skulptori akademik Branislav Jovancevik themeloi shkollën e drugdhendjes artistike në Dibër. Në vitin 1930, kjo shkollë u transferua në Ohër. Pas Luftës së Dytë Botërore në Ohër u themelua një shkollë për drugdhendjen, e cila më vonë u transferua në Shkup, si një departament i shkollës së arteve të aplikuar.



Drugdhendja në Ohër mori hov përsëri në gjysmën e dytë të shekullit XX. Përgjatë rrjedhës së shumë viteve pune, atelierë artistike të shkollës së drugdhendjes së Ohrit dhe Dibrës, si ndjekëse besnike e traditave të pasura të drugdhendjes në Maqedoni, krijuan një numër veprash me vlerë artistike të jashtëzakonshme. Në Ohër jetojnë e punojnë brezat e fundit të mjeshtërive të viteve të para të shekullit XX: Ljupco dhe Saso Xhambas, baba e bir, Ajri Doko, Dimçe Janko, Koço Ainoski, si dhe të tjerë ndjekës të traditave të drugdhendjes në Maqedoni.

Shkolla e pikturimit Bizantin

Ohri ka qenë një qytet me një traditë shumëshekullore e të pasur të pikturimit mesjetar. Përveç Sinait dhe Altos, Ohri ruan koleksionin më të pasur të ikonave bizantine të shekujve XI - XIX. Koleksioni, i ekspozuar në Galerinë e Ikonave, në kompleksin muzeal të kishës së Shën Mërisë të Zotit Peribleptos, përmban më se tridhjetë ikona me cilësi të jashtëzakonshme artistike. Shumica e janë krijuar në punishtet e mjeshtërive të Ohrit dhe disa janë sjellë si dhurata përgjatë shekujve nga Kostandinopoja dhe Selaniku.

Pothuajse të gjitha ikonat në galerinë e Ohrit të krijuara para shekullit XV,



karakterizohen nga zgjidhjet e shkëlqyera shumëngjyrëshe dhe bukuria e prekjeve të fundit të pikturit. Ato duken sikur janë thurur me kombinime të holla të ngjyrave të arta, vjollcë dhe blu dhe tonalitete të verdha të patheksuara që mund të prishin unitetin e ngjyrave. Disa nga këto ikona janë krijuar për procesione fetare, prandaj janë pikturuar në të dyja anët. Ikonat e koleksionit të Ohrit për procesionet fetare radhiten ndër veprat më të mira të artit bizantin të ikonave. Ikonat e Ohrit janë kryevepra të piktoreve të afreskeve të brezave të ndryshëm,

ndjekës të të gjitha lëvizjeve që u zhvilluan në pikturimin bizantin për disa shekuj. Ato janë pikturuar me teknika te ndryshme, shumica janë tempera në dru, disa janë mozaikë, ndërsa veprat e rrahura si relieve në argjend ose drugdhendjet janë të rralla.

Shumica e piktorëve të afreskeve të Ohrit bënin në të njëjtën kohë ikona për kishat e Ohrit. Edhe pse piktorët e afreskeve nuk vendosnin firmat e tyre, ne mund të ndjekim me një shkallë sigurie punën e disa piktorëve, të cilët bënin afreske dhe ikona në të njëjtën kohë. Më pas, piktorët e afreskeve të Ohrit përdornin karaktere nga afresket e kishës Shën Bogorodica Periblepta të shekullit XIII, si modele për të pikturuar ikona. Dhjetë nga ikonat e koleksionit të Ohrit janë të dekoruara me korniza argjendi. Këto korniza kanë domethënie të veçantë për studimin e arteve të aplikuara në mesjetë, veçanërisht për studimin e aktivitetit të dyqaneve mesjetare të artizanatit. Në kornizat që rrethojnë ikonat e Ohrit paraqiten karaktere shenjtorësh dhe profetësh, si dhe kompozime në miniaturë nga Testamenti i Vjetër dhe Testamenti i Ri, simbole të Ungjillit, si dhe zbukurime gjeometrike e floreale. Kornizat e ikonave të Ohrit janë vepra të punuar me mjeshtëri që prej shekullit XI dhe në vazhdim. Vlera e lartë artistike e tyre shprehet në punën e saktë të relieveve në miniaturë. Krijuesit e tyre ishin artistë me mundësitë më të mëdha krijuese për kohën.

Koleksioni aktual i ikonave të Ohrit u kompletua Luftës së Dytë Botërore. Meritë e veçantë për këtë i përket piktorit dhe konservuesit Zdravko Blazik. Ai i gjeti në gjendje shkatërrimi të pakthyeshme shumë prej ikonave, të cilat ishin dëmtuar, nxirë ose ishin ripikturuar në mënyrë jo profesionale. Piktori Blazik, pasi bëri një ekzaminim të detajuar, doli në përfundimin se armiku më i madh i drurit mbi të cilin ato ishin pikturuar ishte një lloj krimbi i njohur si 'Anobium'. Ky krimb i shkatërron ikonat, duke e kthyer palcën e drurit në material poroz. Për të shpëtuar ikonat, është e nevojshme një procedurë për zëvendësimin e drurit të dëmtuar. Por nxirja nga tymrat e shkrirë në llakun e sipërfaqes nuk lejonte identifikimin e

cilësive të vërteta të disa prej ikonave më të rëndësishme. Ndër to ikona përfshihet ikona e njohur e apostullit Mateo nga shekulli XIII, si dhe ikona mjaft e famshme e Bogorodica Psichosotrija (Shpëtues i shpirtit), e cila në



anën e pasme ka një kompozicion të Blagovestenie.

Përgjatë viteve, shumë ikona të Ohrit janë zhdukur përgjithmonë. Një numër i konsiderueshëm i tyre janë ekspozuar nëpër muze dhe koleksione



të ndryshme. Por është shumë e vështirë të përcaktohet sa ikona janë tashmë pjesë e koleksioneve të tjera. Për më tepër, është shumë e vështirë të përcaktohet se sa ikona kishte në Ohër në kohën kur qyteti i Klementit arriti prosperitetin e tij artistik.

Në vitin 2005, në bashkëpunim me piktorin Vladislav Kocarev, në Ohër, u hap shkolla e parë për pikturimin e ikonave bizantine. Çdo adhurues i artit mesjetar, mund të ndjekë një kurs dhjetë ditor për fillestarë, me leksione teorike dhe praktike mbi pikturimin e ikonave,

duke prodhuar ikona sipas traditës origjinale bizantine dhe më pas t'i marrë ato me vete në shtëpi.

Prodhimet e bakrit nga familja Marinov

Tradita familjare e prodhimit të sendeve prej bakri është ushtruar në familjen Marinov nga Ohri për nëntë shekuj. Slave Marinov, si brez i tretë dhe vajza e tij Maria Marinova, si brez i katërt në këtë mjeshtëri, kanë ndjekur me sukses traditën shumëshekullore: ata përdorin bakër ose bronz për të prodhuar bizhuteri të gdhendura me dorë ose të rrahura.

Pasioni për metalin i Anastas Dudan

Mjeshtëria e prodhimit artistik në metal është më se 2600 vjeçare në rajonin e Ohrit. Që prej shekullit VI para Krishtit, banorët e zonës kulturore të Trebenishtës prodhonin, me krijimtari të madhe, artefakte të shkëlqyera, që ende emocionojnë amatorët e artit. Me punët e tij në metal, Anastas Dudan nga Ohri ringjall si reminishencë objektet artistike historike, duke u përpjekur të arrijë vlerat artistike të mjeshtërive të vjetër. Ai nuk është i vetmi artist në Ohër që shpreh veten në metal, por është i vetmi që ka arritur rezultate të shkëlqyera në “ringjalljen” e vlerave të pakrahasueshme të ikonave dhe afreskeve maqedonase, duke sjellë thelbin e tyre nëpërmjet rrahjes së sipërfaqeve të metaleve. Dudan ka arritur rezultate të lakmueshme, duke përdorur njohuritë dhe mjeshtërinë e tij teknike në



zbukurimin e ikonave mesjetare të Koleksionit të famshëm të Ohrit. Ai gjithashtu arriti të rikrijojë vlerën artistike të shkëlqyer të dorëshkrimeve të vjetra maqedonase me një devocion të rrallë krijues, që buron nga thellësitë e shpirtit të tij.



Prodhimi i produkteve të lëkurës

Në pazarin e vjetër të Ohrit “çarshija” ndodhet një punishte e famshme e vëllezërve Gorgi dhe Milcho Belevi për prodhimin e sendeve të lëkurës. Ata janë shumë të njohur në Holandë. Vizitorët holandeze i vizitojnë ata shpesh me rekomandim dhe blejnë suvenire, si këpucë kërcimi prej lëkure dhe produkte të tjera.


Letra e prodhuar me dorë

Tradita e punimit të letrës në Maqedoni fillon në gjysmën e dytë të shekullit XVI, në manastirin e Shën Naumit. Përdorej për nevoja të brendshme dhe prodhohej në sasi të kufizuara. Punishtja kombëtare për letrën e punuar me dorë “Shën Klement Ohridski” e vazhdon këtë traditë. Ajo e ka filluar punën që nga 23.10.2002. Punishtja ndodhet në pjesën e mrekullueshme të qytetit, në shtëpinë e familjes Paçev, afër me Muzeun Kombëtar – Banesa Robev.



Menaxhimi

Plani i menaxhimit do të përcaktojë vizionin për të ardhmen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Ohrit dhe rajonit të tij, duke e parë statusin e Trashëgimisë Botërore, si potencial strategjik në dobi të komunitetit lokal dhe qytetarëve. I vetëdijshëm për vlerat e trashëgimisë natyrore



dhe kulturore që përmban, rajoni do e ndërtojë prosperitetin e vet duke u mbështetur në një politikë menaxhuese të menduar mirë, në mënyrë që t'u përgjigjet nevojave të brezave të sotëm, pa harruar qëllimin që tua kalojë këto vlera brezave të ardhshëm me gjithë bukurinë, diversitetin dhe autenticitetin e tyre. Zhvillimi i rajonit të Ohrit duhet të bazohet në marrëdhënie të drejtpeshuara dhe të harmonizuara mes trashëgimisë kulturore e asaj natyrore që ai ka, me zhvillimet e reja të zonës, si në tokë ashtu edhe në liqen, si dhe me nevojat sociale e veprimtaritë ekonomike që zhvillohen në sfondin e vet kulturor e natyror.

Falë trashëgimisë së pasur të kësaj zone, tradita për festimin e festave fetare kushtuar shenjtoreve, të cilët kanë një rëndësi ndërkombëtare, vazhdon edhe në





ditën tona. Veç tyre janë aktivitete kulturore dhe muzikore që kanë tashmë një traditë të gjatë, si p.sh. Festivali i Verës të Ohrit dhe Festivali Ballkanik Popullor i Këngëve dhe Lojërave.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar seminarit për gjuhën maqedonase me pjesëmarrjen e ekspertëve ndërkombëtarë - sllavistë, i cili mbahet prej shumë vitesh.

Ndërgjegjësimi për rëndësinë e rajonit dhe nevoja për mbrojtjen e tij është shprehur nëpërmjet krijimit të disa institucioneve rajonale që merren me mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të UNESCO-s.

Vlera potenciale monumentale e tërësisë urbane të Ohrit është shumë më domethënëse se shumica e thjeshtë e monumenteve të tij. Matrica e zgjidhjeve të vjetra dhe tërësia urbane e dikurshme janë ruajtur, por potenciali i përgjithshëm kulturor, historik, arkitekturor dhe artistik nuk është përcaktuar plotësisht, as edhe për sa i përket arkitekturës më me vlerë të rajonit, e identifikuar në monumente të veçanta.

Vlerësimi i trashëgimisë kulturore ka një objektiv të dyfishtë: të nënvizojë vlerën e entitetit arkitekturor dhe të çmojë rolin e tij në zgjerimin e njohurive tona rreth gjenezës së vendbanimeve urbane.

Bazuar në kërkimet e mëparshme të së kaluarës urbane dhe trashëgimisë së qytetit, si dhe në përvojat analoge në studimet e deritanishme për qytetin, shkalla fillestare e vlerësimit është kryer për:

1. Pasuritë kulturore: ansamble dhe struktura me potencial të lartë kulturor, historik, arkitekturor dhe artistik, burime të dhënash për ngjarje të së shkuarës në qytet, evente shoqërore dhe ndikime nga qendrat e zhvilluara shpirtërore, vlera komplekse të trashëgimisë: arkitektura, materiale të lëvizshme kishtare, arkivat kishtare etj. Përveç ndërtesave më të shenjta, të një rëndësie të veçantë janë gjithashtu edhe mbetjet arkeologjike.
2. Ansamblet stilistike arkitekturore si njësi hapësinore të ngritura në periudha të ndryshme kronologjike stilistike, elementë arkitekturorë të rëndësishëm të mbrojtur si dëshmi autentike.
3. Objekte të veçanta nga arkitektura e banesave në formën e tyre origjinale, të vendosura përgjatë rrugëve të vjetra elitë të qytetit.
4. Arkitekturën neolitike të përfaqësuar në arkitekturën e shenjtë dhe rezidenciale, si dhe në ndërtesat me karakter publik që datojnë nga periudha e fundit e shek. XIX dhe fillimi i shek. XX.
5. Fondin e pasur të gurëve të punuar, të cilët janë të rëndësishëm për gjenezën e hershme të arkitekturës dhe komplekseve urbane të zbuluara gjatë kërkimeve arkeologjike ose gjatë gërmimeve për ndërtimin e ndërtesave të reja.
6. Vlerën mjedisore të arkitekturës laike me të gjitha tiparet e saj stilistike, që ndodhet në lëndinat e pjerrëta ose në pjesën e qytetit pranë bregut.
7. Ndryshueshmërinë me ambientin: ndërtimin e ndërtesave shumëkatëshe me volume masive dhe arkitekturë të papërshtatshme në shpërpjesëtim me arkitekturën e vogël të qytetit.


Vizioni

Republika e Maqedonisë¹⁾ do të promovojë rëndësinë botërore të Ohrit si zonë e mbrojtur, duke përdorur statusin si potenciali strategjik për zhvillim të qëndrueshëm dhe progres për komunitetin lokal dhe qytetarët e tij.

Rajoni i Trashëgimisë Botërore Natyrore dhe Kulturore i Ohrit që ka krijuar ndërgjegjësim të plotë për vlerat kulturore dhe natyrore që ai përmban, do e bazojë zhvillimin dhe prosperitetin e tij në një politikë të menduar mirë për menaxhimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me qëllim plotësimin e nevojave të brezit të sotëm dhe duke u lënë brezave të ardhshëm një trashëgimi të bukur, autentike dhe të shumëllojshme.

Zhvillimi i zonës së mbrojtur do të bazohet mbi marrëdhënie të balancuara e harmonike me trashëgiminë natyrore dhe kulturore, si në hapësirën e rripit të gjerë përreth liqenit, por edhe në vetë liqenin; me nevojat sociale, veprimtarinë ekonomike dhe mjedisin natyror e kulturor.

1) "Republika e Maqedonisë" është termi që përdor për vendin qeveria dhe kështu njihet nga një numër vendesh. Në kontekstin e Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Europian dhe disa vendeve të tjera, vendi njihet si "Republika ish Jugosllave e Maqedonisë".



Objektivat strategjike dhe çështjet përkatëse

- Fuqizimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale për të ruajtur dhe mbrojtur vlerat universale të rajonit.
- Garantimi i zbatimit efikas të ligjeve dhe dokumentacionit të planifikuar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore nga urbanizimi i pakontrolluar.
- Vlerësimi dhe rivlerësimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore.
- Mbrojtja integrale e trashëgimisë natyrore dhe kulturore nëpërmjet kontrollit të përhershëm të zhvillimit urban lokal.
- Zhvillimi ekonomik i zonës së mbrojtur nëpërmjet shfrytëzimit të potencialëve, mbështetur në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Fuqizimi i potencialeve të burimeve njerëzore në të gjitha nivelet, duke sjellë staf të ri të specializuar ose duke specializuar më tej stafin profesional aktual.
- Rritja e qëndrueshme kulturore dhe shkencore e rajonit përmes restaurimit të funksioneve autentike të vjetra të disa zonave, paraqitja e një përmbajtjeje të re, të rëndësishme arkeologjike dhe zhvillimi i kapaciteteve të reja, në përputhje dhe në mbështetje të saj.²⁾

2) Nga "Trashëgimia natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, sit i trashëgimisë botërore, plan menaxhimi" Shkup, janar 2010

Probleme të menaxhimit

Siti i Trashëgimisë Botërore është i ndjeshëm ndaj ndryshimeve dhe rritjes, por të dyja këto janë të pashmangshme dhe të dëshirueshme për zhvillimin dhe jetën në atë sit. Megjithatë, ndryshimi i pakontrolluar dhe i tepërt i karakterit dhe thelbit të zonës së mbrojtur, mund të rrezikojë vetë vlerat që e kanë bërë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të zonës së Ohrit të përfshihet në Listën e Trashëgimisë Botërore. Një rrezik i veçantë është urbanizimi i tepruar dhe i pakontrolluar, që është duke ndodhur në mënyrë të vazhdueshme. Misioni i UNESCO-ICOMOS-IUCN në vitin 1998 konfirmoi se ndërtimi i shumë ndërtesave gjatë zonës së bregut të liqenit, nga fshati Radozda deri në ShënNaum, çon drejt një ndryshimi permanent në strukturën ekzistuese të vendbanimeve në bregdet, të vetë peizazhit, dhe pjesës së bregut pak a shumë të paprekur që u identifikuan si kërcënime për vlerat universale të Trashëgimisë Botërore të zonës së Ohrit. Për më tepër, urbanizimi aktual dhe shkalla në rritje e ndërtimeve të ndërtesave veçanta, si dhe zhvillimi i shpejtuar ekonomik, janë duke ndikuar negativisht në arkitekturën e vjetër urbane, në strukturën e qytetit të vjetër dhe në zonat rrethuese ku gjenden monumentet historike.

Qendra historike e Ohrit është shembull i gjallë se si dy qëllime të natyrshme mund të konfliktohen me njëri tjetrin: ruajtja e trashëgimisë në formë sa më autentike të mundshme nga njëra anë dhe përmirësimi




i kushteve të jetesës së banorëve të qytetit, nga ana tjetër. Kur Ohri u shpall Trashëgimi botërore më 1979, shumë nga shtëpitë ishin në gjendjen fillestare - një situatë kjo ideale nga pikëpamja e integritetit dhe autenticitetit. Por këto ndërtesa ishin mëse 100 vjeçare dhe, shumë prej tyre, gjendeshin në prag të rrëzimit. Për më tepër

ato nuk kishin mjetet elementare për të plotësuar kërkesat e jetesës në standardet bashkëkohore dhe, gjatë viteve, shumë pronarë i prishën banesat e veta dhe ndërtuan të reja në vend të tyre.

Kur UNESCO protestoi kundër këtij aktiviteti, qeveria u përpoq të siguronte, në shumë raste me sukses, se godinat e reja do të ndërtoheshin me të njëjtin stil historik si të vjetrat; megjithëse materiali i ndërtimit që u përdor për shtëpitë e reja, nuk ishte ai i përdorur në shtëpitë historike. Ndërsa shumica e ekspertëve ankoheshin për humbjen e vajtueshme të autenticitetit, mund të thuhet se së paku integritetit u ruajt dhe qytetit i



Plani i ndërtimit në zonën Plaoshnik



vjetër, ndryshe nga të tjerë si Dubrovniku për shembull, vazhdon të jetë zonë rezidenciale e banuar nga po ajo popullsia që ka pasur.

Një rast interesant, dhe shumë kundërthënës, është rasti i Projektit të Plaoshnikut. Plaoshniku është një sit i madh arkeologjik dhe historik në kodrën e pyllëzuar në perëndim të Ohrit të vjetër, që përmban dëshmi të të gjitha epokave kulturore që nga prehistoria deri te ajo osmane, por çka është më e rëndësishme, ka qenë vendi i shkollës së parë sllave ortodokse, ndërtuar nga Shën Klementi më 893. Kjo shkollë u bë një nga qendrat më të rëndësishme për përhapjen e krishterimit ortodoks në Ballkan dhe në Europën Lindore.

Në përpjekje për të rijetëzuar këtë traditë të lashtë madhështore dhe për të rikonfirmuar Ohrin si qendër dijeje, qeveria po planifikon të ndërtojë aty një Universitet të ri Sllav mbi rrënojat e shkollës së vjetër. Ndërsa ideja e rikrijimit të një institucioni të lashtë është në vetvete krejt në përputhje me kërkesat e UNESCO-s për rijetëzimin e qyteteve historike dhe, me siguri, do të kontribuonte shumë për vazhdimësinë traditës ortodokse të Ohrit, ekziston droja se projekti është në përmasa të tepruara, ndryshon karakterin e tanishëm të sitit dhe krijon probleme me trafikun në qytetin e vjetër, ngushton hyrjen në sitet arkeologjike dhe nënvlerëson trashëgiminë kulturore jo ortodokse.

Në të dyja rastet e përmendura, duhen kërkuar dialog dhe kompromis me synim ruajtjen e vlerave të Trashëgimisë Botërore, duke lejuar njëkohësisht që Ohri të mbetet një organizëm urban i gjallë dhe në ndryshim, që ofron mundësi për banorët e tij.

Bibliografi:

- E. Çelebi: "Udhërrëfyes", 1657;
B. Nusic: « Në brigjet e Liqenit të Ohrit » - Udhërrëfyes - Beograd, 1894;
B. Chipan: «Katedralja e Peshkopatës së Ohrit – Shën Sofia», 1995;
P. Mitreski: «Kolonja e Studentëve në Ohër 1938», 1940.
D. Grabrijan: «Shtëpia Maqedonase», Ljubljana, 1955.
B. Chipan: «Arkitektura e Qytetit të Vjetër në Ohër,» Libër Maqedonas - Shkup, 1982
Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeumeve - Ohër, «Muzetë në Ohër», 2001.
Harta Arkeologjike e Maqedonisë, Volumi 2 - Shkup, 1996.;
- W. Blazhic: « Pastrimi dhe konservimi i afreskeve në Kishën e Shën Klementit në Ohër», 1951
D. Kornjakov: «Puna pas restaurimi në kishën e Virgjëreshës Peribleptos», 1961.
Q. N.. Miljukov: «Antikitetet e Krishtera në Maqedoninë Perëndimore », 1899.
H. Gelyer: «Patriarkana e Ohrit », 1902.
I. Snegarov: «Historia e Peshkopatës së Ohrit», 1924.
J. Mano – Zisi: «Kontribute të vogla pikturash në kishën e shekullit të XIV të Ohrit », 1931.
F.Mesesnel: «Ohri», 1934.
N. Mavrodinov: « Piktura të Vjetra Bullgare », 1946.
V. R. Petkovic: «Afreskë me Shfaqjen e Diturisë», 1929.
P. Milkovic Pepek: «Puna e Mihalit dhe Eutihit», 1967
R. Ljubinkovic: «Mjeshtrit e pikturës së vjetër serbe », 1957
C. Grozdanov: «Shënime nga Ohri», 1969.
C. Grozdanov: «Portreti i Klementit të Ohrit në Artin Mesjetar», 1966.
D. Talbot Rice: "Pikturat Bizantine: Faza e Fundit. ", New York, 1968.
A. Grabar: « Shtrati i Solomonit « 1963.
Instituti i Historisë Kombëtare në Shkup: «Ohri dhe rajoni i Ohrit në histori» libri 1 dhe 2, 1985.
P. Mitreski: «Mjeshtëritë në Ohër – rajoni i Strugës (1918-1970),» NIO Fjala e Studentit, Shkup, 1983.
Lychnidos V - Punime, Ohër, 1983. :
V. Plevnes: «Ohri- Një qendër e zhvilluar artizanati në të shkuarën», (1962-1987)
Q. Mitreski: «Zhvillimi i Artizanatit në Ohër – Rajoni i Strugës (1919-1929)»
D. Stefania: «Dy emra dhe mbiemra tregtarësh të Pazarit të Ohrit në shek. XIX».
A. Salih: « Mjeshtëria e Kazanxinjve në Ohër»
V. Plevnes: «Mjeshtëria e Samarpunuesve në Ohër», Lyhndë-koleksioni vjetor i Muzeut Kombëtar në Ohër, libër 2-3, 1959.
B. Chipan: «Qytetet Maqedonase në shek. e XIX dhe perspektiva e tyre urbane», MANU, Shkup, 1978.;
- A. Urosevic: «Ohri – monografi gjeografike», Shkup, 1957.
V. Dereban: «Argjendaria Maqedonase», Bitola, 2001.
I. Stojanoski: «Flit për mos të harruar « Radio Ohri, 1996 dhe 2003.
D. Talbot Rice: Arti Bizantin, Londër, 1953
D. Talbot Rice: Fillimet e Artit të Krishterë, Londër, 1957
D. Talbot Rice: Arti i epokës Bizantine, Londër, 1963
A. Graber: Bizanti, Arti Bizantin i epokës Mesjetare, Paris, 1963
A. Graber: Arti i Mesjetës në Evropën Lindore, Paris 1968
F. Mesesnel: Ohri - Shkup, 1934
F. Grivec: Ohridska slika , Slovo, Zagreb, 1960
R. Kuzmanovski: D. Shaljik, Ohri - Beograd, 1966
France Mesesnel: "Ohri, qyteti dhe liqeni", Shkup, 1934
Vlagimjezh Pjanka: "Toponimet e Ohrit – baseni i Prespës", Shkup, 1970
Jovan F. Trifunovski: "Ohri dhe epoka e Strugës"-Beograd, 1992
Pasko Kuzman, Trashëgimia Kulturore Maqedonase, OHËR sit i trashëgimisë botërore, Shkup 2009

Burime nga Interneti:

<http://whc.unesco.org/en/list/99/documents>

<http://www.ohrid.com.mk/index.asp>

Autorët

Vassilis Birbos

Vassilis Birbos lindur në Janinë në vitin 1979, është inxhinier i diplomuar për planifikim hapësinor urban dhe zhvillim rajonal në Shkollën e Inxhinierisë të Universitetit të Thesalisë. Ai drejton një zyrë teknike të Janinës ku mundësohen studime në fusha të ndryshme si në planifikim hapësinor dhe urban, mbrojtje të mjedisit dhe efekteve në mjedis, si dhe zhvillim lokal e rajonal. Ai ka punuar më parë si konsulent teknik për Departamentin e Mjedisit dhe Planifikimin Hapësinor të Qarkut të Epirit dhe për Agjencinë Rajonale të Zhvillimit “EPIRUS SA” për 5 vjet. vmpirmpo@yahoo.gr

Stephan Doempke

Stephan Doempke, lindur në vitin 1955 në Mynster, Gjermani, ka studiuar psikologji, antropologji kulturore dhe shkenca religjioze në Mynster Wichita/Kansas dhe Berlin. Gjithë jetën ia ka kushtuar ruajtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore, së pari për njerëzit indigjenë të Amerikës së Veriut dhe Paqësorit. Në vitin 1989 ai iu bashkua grupit themelues të Shtëpisë Botërore të Kulturës në Berlin dhe punoi si koordinator për programin e Rusisë dhe Azisë Qendrore, Unionit Gjerman të Ruajtjes së Natyrës (NABU) nga viti 1993 deri më 1998. Ai mbështeti rijetëzimin e prodhimit të shajakut në Kirgizistan dhe ishte konsulent i lirë për gjenerimin e të ardhurave rurale në Mongoli, Etiopi, Kirgizistan, Taxhikistan dhe Mal të Zi. Në 2008 ai punoi si Koordinator i Programit të OKB-së për Kulturën dhe Trashëgiminë në Shqipëri dhe që prej atij viti e në vazhdim si ekspert në sitin e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, Gjirokastër, Shqipëri. PANDoempke@t-online.de

Maximilian Hartmuth

Maximilian Hartmuth (Ph.D.) është historian i specializuar për rajonin e Ballkanit. Aktualisht kërkues në Fondacionin Turk të Kulturës, ka redaktuar tre volume kushtuar studimeve të trashëgimisë së periudhës otomane (*Centres and peripheries in Ottoman architecture*, 2011; *Images of imperial legacy*, 2011; *Monuments, patrons, contexts: papers on Ottoman Europe presented to Machiel Kiel*, 2010) dhe mban autorësinë e një numri studimesh të pavarura në të njëjtën fushë, nga të cilat së fundmi “Historia e marrëdhënieve mes periferisë dhe qendrës si një histori e stilit në arkitekturën provinciale otomane” (2011), “Kafja turke dhe beton brut: një portret arkitekturor i Shkupit” (2010, me bashkautor I. Toliç) dhe “Pamjaftueshmërisht oriental?, një episod i hershëm për studimet dhe ruajtjen e trashëgimisë arkitekturore otomane në Ballkan” (2010).

Varvara Papadopoulos

Varvara N. Papadopoulos drejtoare e Eforatit VIII të Antikiteteve Bizantine (Shërbimi Rajonal i Ministrisë së Kulturës së Greqisë) me juridiksion në Prefekturën e Janinës dhe Thesprotisë dhe të Muzeut Bizantin të Janinës. Ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në arkeologji dhe histori arti në Universitetin Aristotel të Selanikut. Ka kryer Studime Mesjetare në Universitetin e Janinës (pasuniversitare) dhe është kandidatë për doktore në këtë universitet. Së fundmi është ngarkuar për menaxhimin e Eforatit XVIII të antikitetëve Bizantine, juridiksioni i të cilit përfshin monumentet bizantine dhe pas bizantine të Prefekturës së Artës dhe Prevezës.

Goran Paçev

Goran Paçev, lindur në Ohër në vitin 1967, FYROM. Diplomuar si inxhinier arkitekt në Universitetin e Shën Cirilit dhe Metodit – Fakulteti i Arkitekturës, Shkup. Përvoja e tij që prej 1996 ka filluar në kompani të ndryshme, duke punuar si arkitekt dizenjator për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit në Ohër. 7 vitet e fundit punon në Institutin Kombëtar për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeve – Ohër si konservues i autorizuar për mbrojtjen trashëgimisë kulturore të patundshme. Që prej vitit 2006 ai është anëtar i ICOMOS, FYROM, si president i nënkomitetit për digjitalizimin e monumenteve të kulturës. Prej 2009 është anëtar i Dhomës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve të Çertifikuar në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe anëtar i Shoqatës së Arkitekteve, AAM).

Bari Zenelaj

Bari Zenelaj, lindur më 1964 në Suharekë, Kosovë ka studiuar për gjuhësi dhe letërsi anglo- amerikane në Universitetin e Prishtinës. Për më se 10 vjet ka punuar si karikaturist dhe ilustrues për të gjitha gazetat e Kosovës. Bari krijoi një përvojë profesionale të vlefshme duke punuar për agjencitë e ndihmës dhe organizata të tjera të shoqërisë civile për më se 14 vjet.

Ai tani menaxhon Akademinë për Trajnim dhe Asistencë Teknike, një organizatë jo fitim prurëse në fushën e kulturës dhe integritit evropian.

Bari Zenelaj është martuar me Leonorën dhe ka dy fëmijë, Zellin 17 dhe Alpin 7 vjeç. Ata jetojnë në Prizren.

Kontakt : bari@atta-ks.org

Photo and Map Credits

8th Ephorate of Byzantine Antiquities: 78c, 79, 80, 82a, 82b, 83b, 84c, 85a, 85b, 88a, 89a, 89b, 90a, 92a

Srdjan Adamovic: 170a

Archive of the Comintern: 31c

Boris Chipan: 150c, 153

BBC: 115a

Vasileos Birbos: 106

Cultural Heritage without Borders: 144

Stephan Doempke: 10, 24, 26a, 27, 28, 30b, 33, 34b, 36b, 37e, 38a, 39a, 39b, 39c, 40a, 40b, 40c, 41a, 41b, 42a, 42b, 43b, 44a, 44b, 46, 47, 48b, 49a, 49b, 49c, 50a, 50c, 51a, 53a, 53b, 54a, 54b, 59a, 59b, 59c, 60a, 60b, 60c, 61b, 62a, 62b, 62c, 64a, 64b, 65b, 65c, 66a, 67a, 67c, 68a, 68c, 69a, 69b, 70a, 70b, 71, 72a, 72c, 73a, 73b, 73c, 76a, 76b, 81, 83a, 83c, 83d, 84a, 84b, 84d, 85c, 85d, 85e, 86a, 86b, 87, 88b, 90b, 91a, 91b, 92b, 94b, 95b, 96, 99a, 99b, 100a, 101b, 102a, 103, 105a, 105b, 108, 119a, 119c, 120, 122a, 122b, 122c, 122d, 124a, 126a, 126b, 126e, 128a, 129b, 130b, 131, 132c, 133a, 133b, 134a, 134b, 134c, 138, 148b, 152a, 154a, 155, 157, 159, 162a, 162b, 162c, 163b, 163c, 164, 165a, 165b, 165c, 166b, 166c, 167a, 167b, 168a, 168b, 169b, 171b, 171c, 172a, 174a, 177a

Stephan Doempke/Kreshnik Merxhani: 34a, 50b

Stephan Doempke/GCDO: 36a/37a

Ezilon: 112

GCDO: 30c, 31d, 32a, 35a, 37b, 37d, 38b, 45, 48a, 63, 65c

Stephen Fenner: 111a, 111b

Edward Finden: 82c

Friends of Macedonia: 152b

Milco Georgievski: 169a, 170b, 180b, 181a

N. Gkioulis: 91c

Google Earth: 25

Chris Hassler: 26b, 32b, 43a, 51b, 66b, 67d, 68b, 72b

Hellenic Library: 78b

Institut du Monde Arabe: 29a

Institute for Monuments of Culture (Prizren): 114, 117, 119b, 125a, 126c, 126d, 127a, 127b, 127c, 129a, 132a, 132d, 139a, 140a, 140b, 141a

A. Karadimou-Gerolimpou: 100b

Konstantinos Ignatiadis: 74, 82d

Alket Islami: 35b, 61a

Albert Kasi: 32c

Tony Lumb: 37c, 48c

Macedon1998: 151

Macedonia FAQ Development Team: 152c

Olivera Misheva: 174b, 177b, 179, 180a, 181b, 182b, 183a, 183b, 183c

Klairi Moustafellou: 75, 94a, 95a, 97a, 97b, 97c, 97d, 98

Municipality of Prizren: 118, 143

National Institute for Monuments of Culture and Museums - Ohrid: 149a, 149c, 154b, 156a, 156b, 178a

Numismatic Museum of Athens: 78a

Ohridski Biser: 178b

Goran Patcev: 149b, 150a, 160, 161, 163a, 169c, 172b, 175, 176a, 176b, 182a, 184a, 185, 187, 188, 189, 190

Prizren 360°: 110

Clara Puech: 101a

Emin Riza: 55a, 55b, 56a, 56b, 56c, 57a, 57b, 57c, 58a, 58b

Stojan Saveski: 147

Arben Shala: 121b, 121c, 123a, 124b, 125b, 128b, 129c, 130a, 132b, 133c, 136a, 136b, 136c, 136d, 137a, 137b, 137c, 137d, 139b, 141b, 141c, 142b

Roland Tasho: 64c, 65a, 67b

UNESCO: 70c

Marian Vare: 146, 166a

Adjola Vrekaj: 171a, 173a, 173b

Wikimedia Commons: 29b, 31a, 31b, 115b, 148a, 184b

www.exploringmacedonia.com: 178c

www.literaryhistory.com: 30a

www.travbuddy.com: 150b

Petros Xenikos: 102b

Bariu Zenelaj: 121a, 132b, 135a, 135b, 142a

Kontaktet për partnerët në EVAH

Partnerët



Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës

Sadi Petrela
Obelisku, Qafa e Pazarit
Gjirokastrë
Albania
Tel: +355 842 67-077
info@gjirokastra.org



Akademia për Trajnim dhe Asistentë Teknikë

Bariu Zenelaj
Qazim Berisha Nr:43
20000 Prizren
Kosovë
Tel +377 44 155-323
info@atta-ks.org



Fondacioni EGNATIA EPIRUS

Rruga Anthrakitou 5 & Tsechouli
45221 Janinë
Greqi
Tel +30 26510 72-315
eef@forthnet.gr



Shoqata e Tregtare e Artizanëve Maqedonas

Zoran Todorovski
Cedomir Kantardziev, 3
1000 Skopje
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
+389 2 273-4170
zoran.t@matacraft.org.mk

Partnerë të Asociuar



Qyteti i Regensburgut

Matthias Ripp, Menaxhimi I
Trashëgimisë Botërore
93047 Regensburg
Dr.-Martin-Luther-Rr. 1
Gjermani
+49 941. 507-4611
ripp.matthias@regensburg.de



Qyteti i Janinës

Bashkia, Sheshi 5 A. Papandreou
45221 Janinë, Epir
Greqi
+30 26510 79921-5, 26272
press@ioannina.gr



A Soul for Europe

Z. Stephanie Maiwald
c/o European House for Culture
Place Flagey 18
1050 Brussels
Belgium
+49 30 2639 229-47
maiwald@asoulforeurope.eu



Mozaik – Community Development Foundation

Soukbunar 42
71000 Sarajevo
Bosnia and Herzegovina
+387 33 266-480
info@mozaik.ba

Useful Addresses

Useful Addresses in Albania

Ministry for Tourism, Culture, Youth
and Sports
Rr. e Kavajës
1000 Tirana
Albania
Tel +355 4 222 9072
informacion@mtkrs.gov.al
www.mtkrs.gov.al

Institute for Monuments of Culture
Rr. Aleksandër Moisiu 76
1000 Tirana
Albania
Tel +355 4 450 4153
imk@albmail.com

Municipality of Gjirokastra
Çerciz Topulli Square
Gjirokastra
Albania
Tel +355 842 63 500

Cultural Heritage without Borders
Qafa e Pazarit
Gjirokastra
Albania
Tel +355 84 26812
info@chwb.org
www.chwb.org

Useful Addresses in Greece

Ministry for Education, Religious Affairs,
Culture and Sports
20-22 Bouboulinas St.
10682 Athens
Greece
Tel +30 210 820 1444
info@culture.gr
www.yppo.gr

8th Ephorate for Byzantine Antiquities
Its Kale, Kastro
45221 Ioannina
Greece
Tel +30 26510 25989
8eba@culture.gr

City of Ioannina
Town Hall, 5 A. Papandreou Square
45221 Ioannina
Greece
Tel +30 26510 79921-5, 26272
press@ioannina.gr

Center of Ioannina Traditional
Handcraft
11 Arch. Makariou St.
45221 Ioannina
Greece
Tel +30 26510 27650
info@kepavi.gr

Useful Addresses in Kosovo

Ministry of Culture, Youth and Sports
Nëna Terezë Square p.n.
10000 Prishtina
Republic of Kosovo
Tel +381 38 211 637
info@mkr-ks.org
www.mkr-ks.org

Institute for the Protection of
Monuments in Prizren
Marin Barleti no. 11
20000 Prizren
Republic of Kosovo
Tel +381 29 244 487
qrtpkz@hotmail.com

Cultural Heritage Foundation
Qazim Berisha no. 43
20000 Prizren
Republic of Kosovo
Tel +381 29 233 959
info@heritage-ks.org
www.heritage-ks.org

Association of Artisans and
Businessmen
The Artisan Center p.n.
20000 Prizren
Republic of Kosovo
Tel +381 29 222 323
info@shzap.org
www.shzap.org

Useful Addresses in the former Yugoslav Republic of Macedonia

Ministry for Culture
Cjuro Gjakovic 61
1000 Skopje
The former Yugoslav Republic of
Macedonia
Tel +389 2 324 0600
info@kultura.gov.mk
www.kultura.gov.mk

Cultural Heritage Protection Office
Cjuro Gjakovic 61
1000 Skopje
The former Yugoslav Republic of
Macedonia
Tel +389 2 328 9703
contact@uzkn.gov.mk
www.uzkn.gov.mk

National Institute for the Protection of
Monuments of Culture and Museum
– Ohrid
Boro Shain 10
6000 Ohrid
The former Yugoslav Republic of
Macedonia
Tel +389 46 262 498
zimohrid@t-home.mk

City of Ohrid
57 Dimitar Vlahov St.
6000 Ohrid
The former Yugoslav Republic of
Macedonia
Tel +389 46 262 489
protocol@ohrid.gov.mk
www.ohrid.gov.mk

